

Allahu njihet përmes arsyes

Harun Jahja

PËRMBAJTJA

Hyrje

PJESA E PARË

FAKTI I KRIJIMIT

NË DRITËN E FAKTEVE SHKENCORE

Parathënie

Prej mosqenies në ekzistencë

Shenjat/argumentet në qiej dhe në tokë

Shkencëtarët vërtetojnë shenjat/argumentet e Allahut

Faktet shkencore dhe Mrekullia e Kur'anit

PJESA E DYTË

GABIMI I MOHIMIT TË FAKTIT TË KRIJIMIT

Mashtrimi i evolucionit

Filozofitë që bën gabimin e mohimit të Allahut

Dëmet e një modeli të shoqërisë që nuk beson në Allahun

Banesa e vërtetë e premtuar: Jeta e përtejme (Ahireti)

Një qasje krejt tjetër ndaj materies

Relativiteti i kohës dhe realiteti i fatit

Përfundim

Fusnotat

HYRJE

Ekziston një arsye e rëndësishme pse ky libër është titulluar “Allahu njihet përmes arsyes”. Shumica e njerëzve thonë se ata e njohin Allahun dhe besojnë në Të. Mirëpo, në të vërtetë ata nuk e njohin dhe nuk e vlerësojnë Allahun me masën e Tij të vërtetë. Për këtë, njeriut i nevojitet/i duhet të ketë “arsye dhe urtësi.”

Ajo që duhet të përkujtohet këtu është se kur thuhet se njeriut i nevojitet “urtësia” për të kuptuar Allahun dhe për ta njohur Atë sipas masës së vërtetë të Tij, kjo nuk nënkupton “zgjuarsi”. Urtësia/mençuria dhe zgjuarsia janë dy nocione krejtësisht të ndryshme. Zgjuarsia është kapaciteti i trurit që njeriu posedon biologjikisht. Zgjuarsia as nuk rritet e as nuk zvogëlohet. Mirëpo, urtësia është një tipar i veçantë vetëm për besimtarët. Ajo u dhurohet si mirësi e madhe prej Allahut besimtarëve që kanë takva (frikën e Allahut). Urtësia është një kriter për të gjykuar në mes të së drejtës dhe të gabueshmës, të cilën Allahu ua dhuron robërve të Tij të vërtetë/të sinqertë. Aftësia e njeriut për të gjykuar, domethënë, urtësia e tij, rritet në përmasë të njëjtë me takvanë e tij.

Karakteristikat më të dallueshme të një personi të urtë janë frika e tij ndaj Allahut, të dëgjuarit e ndërgjegjes së tij, të vlerësuarit e çdo ngjarjeje që përjeton në pajtim me Kur’anin dhe të kërkuarit e kënaqësisë së Allahut gjatë gjithë kohës.

Madje edhe nëse dikush është personi më i zgjuar, më i mençur dhe më i dijshtëm në botë, ai do të jetë prapsepap “i padijshtëm” poqese i mungojnë këto veçori dhe poqese i mungon aftësia e të kuptuarit, s’do të jetë në gjendje të kuptojë shumë fakte.

Dallimin në mes të inteligjencës dhe urtësisë/mençurisë mund ta qartësojmë me një shembull: Një shkencëtar mund të ketë bërë hulumtim të gjatë dhe të hollësishëm mbi sistemin nervor të organizmit.

Ai mund të jetë personi më i dijshtëm/më i mirinformuar në botë për transmetimet e jashtëzakonshme nervore që ndodhin në organizëm. Megjithatë, poqese i mungon mençuria/urtësia, s’do të shkojë më larg se të qenit dikush që posedon informacion të bollshëm për proceset që ndodhin në mes të qelizave nervore. Me fjalë të tjera, ai nuk do të jetë në gjendje të kuptojë të vërtetën e rëndësishme që qëndron pas këtij informacioni. Mirëpo, dikush që posedon urtësi, duke parë ndodhitë e mrekullueshme që ndodhin në sistemin nervor dhe mekanizmat e përkryer hollësisht, kupton se një strukturë e tillë e përsosur duhet të ketë një Krijues, një projektues me urtësi supreme. Ai thotë: “Fuqia e cila e ka krijuar sistemin nervor në një mënyrë kaq të përsosur padyshim se duhet të jetë krijuesi i të gjitha gjallesave tjera. Dhe Ai ka fuqi të krijojë banesën e jetës së përtejme (ahiretit) pas vdekjes.”

Shtytja kryesore e këtij libri është t’ia mundësojë lexuesit të jetë dëshmitar i ekzistencës së Allahut me urtësinë e tij. Disa njerëz nuk besojnë në ekzistencën e Allahut dhe të tjerët thonë se besojnë në ekzistencën e Tij, por jo me urtësinë dhe vetëdijen e tyre, por sepse janë mësuar të bëjnë kështu. Mirëpo pasi që nuk mendojnë dhe nuk e përdorin urtësinë e tyre, nuk i përmbushin kërkesat që të besuarit në Allahun padyshim kërkon. Mirëpo, besimtarët e pajisur me urtësi, shohin detajet e ekzistencës së Allahut dhe të

krijimit me mendjen dhe arsyen e tyre dhe i frikësohen Allahut, I Cili ka fuqi të amshueshme.

Pasiqë iu referohet argumenteve të krijimit në Kur'an, Allahu shpall se këto argumente vlejné vetëm për ata që janë të urtë:

Dhe prej argumenteve të Tij, Ai ua dëfton vetëtimën edhe si frikë e dhe si shpresë, dhe nga qielli lëshon shi e me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj. Në këtë ka argumente për një popull që di të mendojë. (Sure Rum: 24)

PJESA E PARË

FAKTI I KRIJIMIT

NË DRITËN E FAKTEVE SHKENCORE

PARATHËNIE

Shikoni rreth vetes prej aty ku jeni ulur. Do të vëreni se gjithçka në dhomë është ‘e punuar’: muret, tapiceria, tavani, karriga në të cilën jeni ulur, libri që mbani në dorën tuaj, gota në tavolinë dhe detaje tjera të panumërta. Asnjëra prej tyre nuk rastis të ekzistojë në dhomën tuaj sipas vullnetit të tyre. Madje edhe leqet e thjeshta të tepihut janë punuar prej dikujt: ato nuk u shfaqën vetvetiu apo rastësisht.

Një person që bëhet gadi të lexojë një libër e din se ai është shkruar prej një autori për një arsye të veçantë. Madje as që do t’i shkonte ndërmend se ky libër mund të ishte krijuar rastësisht. Në të njëjtën mënyrë, një person që sheh një skulpturë nuk ka as më të voglin dyshim se ajo është punuar prej një skulptori. Dhe jo vetëm veprat e artit: madje edhe një numër i vogël i tullave që qëndrojnë njëra mbi tjetrën e shtojnë njeriun të mendojë se dikush i ka vendosur ato ashtu sipas një plani të caktuar. Prandaj, gjithkund ku ekziston rregull – qoftë ai i madh apo i vogël – themeluesi dhe mbrojtësi i këtij rregulli duhet të ekzistojë gjithashtu. Nëse, një ditë, dikush do t’iu afrohej dhe t’iu thoshte se hekuri i papërpunuar dhe thëngjilli u bashkuan për të formuar çelikut rastësisht, i cili pastaj ndërtoi Kullën e Ajfellit prap rastësisht, a nuk do të konsideroheshin si të çmendur ai dhe ata të cilët i besuan atij?

Pretendimi i teorisë së evolucionit, mënyra unike e të mohuarit të ekzistencës së Allahut, nuk ndryshon fare nga kjo. Sipas kësaj teorie, molekulat e pajetë formuan amino acidet rastësisht, amino acidet formuan proteinet rastësisht dhe në fund proteinet formuan krijesat e gjalla prap rastësisht. Mirëpo, mundësia e krijimit të një krijese të gjallë rastësisht është më e vogël se mundësia e formimit të Kullës së Ajfellit në të njëjtën mënyrë, sepse madje edhe qeliza më e thjeshtë e njeriut është më e sofistikuar se çfarëdo ndërtese e punuar prej njeriut në botë.

Si është e mundur të mendohet se barazpesha në botë ndodhi rastësisht kur harmonia e jashtëzakonshme e natyrës mund të vëzhgohet madje edhe me sy të lirë? Është pretendimi/pohimi më i paarsyeshëm të thuhet se gjithësia, secili argument i së cilës sugjeron ekzistencën e Krijuesit të saj, është krijuar vetvetiu.

Prandaj, duhet të ketë një zotërues të kësaj barazpese të vrojtueshme gjithandej prej organizmit tonë e deri te këndet më të largëta të gjithësisë paimagjinueshëm të pafund. Pra, kush është ky Krijues që paracaktoi gjithçka me kaq finesë/lehtësi dhe që krijoi gjithçka?

Ai nuk mund të jetë çfarëdo qenie materiale e pranishme në gjithësi, sepse Ai duhet të jetë vullnet që kishte ekzistuar para gjithësisë dhe që pastaj e krijoi gjithësinë. Krijuesi i Gjithëfuqishëm është Ai në të Cilin gjithçka gjenë ekzistencën, e që ekzistenca e të Cilit është e pa fillim dhe e pa fund.

Feja na njeh ne me Krijuesin ekzistencën e të Cilit e zbulojmë me arsye tonë. Prej asaj që Ai na ka zbuluar si fe, ne e dimë se Ai është Allahu, I Gjithëmëshirshmi dhe Mëshirëploti, I Cili krijoi qiejt dhe tokën prej asgjëje.

Edhe pse shumica e njerëzve posedojnë aftësinë për të kuptuar këtë fakt, ata i kalojnë jetët e tyre të pavetëdijshëm për këtë. Kur e shikojnë një pikturë të një pejzazhi, pyesin veten se kush është ai që e ka pikturuar atë. Pastaj, e lavdojnë artistin pamasë për veprën e tij të bukur artistike. Përkundër faktit se ata ndeshen me origjinale të panumërta të asaj pikturë, atë moment që kthejnë shikimin, ata prapë prapë e shpërfillin ekzistencën e Allahut, I Cili është i vetmi zotëruar i të gjitha këtyre bukurive. Në të vërtetë, nuk nevojitet madje as edhe një hulumtim i hollësishëm për të kuptuar ekzistencën e Allahut. Madje edhe nëse njeriu do t'i duhej të jetonte në një dhomë prej momentit të lindjes, dëshmi të panumërta vetëm në këtë dhomë do t'i mjaftonin që të kuptojë ekzistencën e Allahut.

Organizmi i njeriut është i stërmëshur me dëshmi që nuk do të mund të përmbaheshin në shumë enciklopedi shumë-vëllimëshe. Nëse i kushtojmë madje edhe vetëm disa minuta të mendimit të ndërgjegjshëm për gjithë këtë mjafton për të kuptuar ekzistencën e Allahut. Rregulli ekzistues mbrohet prej Allahut dhe mbahet prej Tij.

Organizmi njerëzor nuk është ushqimi i vetëm për të menduar. Jeta ekziston në secilin milimetër katror të tokës, qoftë e vrojtueshme apo jo nga njerëzit. Bota është e mbushur përplot me gjallesa të shumta, prej organizmave njëqelizor deri te bimët, prej insekteve deri te kafshët e ujit dhe prej zogjëve deri te zvarranikët. Nëse e merrni një grusht dhe dhe e shikoni atë, madje edhe aty mund të zbuloni gjallesa të shumëllojshme me veçori të ndryshme. E njëjta gjë vlen poashtu edhe për ajrin që e thithni. Madje edhe në lëkurën tuaj, ekzistojnë shumë gjallesa emrat e të cilave janë të panjohura për ju. Në zorrët e të gjitha gjallesave janë me miliona bakterie apo organizma njëqelizor që e ndihmojnë tretjen. Bota shtazore në botë është shumë herë më e madhe se popullata njerëzore. Kur ta marrim parasysh gjithashtu botën bimore, shohim se nuk ekziston madje as edhe një pikë e vetme në tokë ku nuk ka jetë. Të gjitha këto krijesa që janë të përhapura në një sipërfaqe prej miliona kilometrash katrorë kanë sisteme të ndryshme trupore, jetëra të ndryshme dhe kontribute të ndryshme ndaj barazpeshës ekologjike. Është e paarsyeshme të pretendohet se të gjitha këto janë krijuar rastësisht pa ndonjë qëllim apo arsye. Asnjë gjallesë nuk është krijuar sipas vullnetit të vet. Asnjë ndodhi e rastësishme nuk mundet të rezultojë kurrë me sisteme aq të komplikuar.

E gjithë kjo dëshmi na shpie në përfundimin se gjithësia se gjithësia funksionon me një 'vetëdije' të caktuar. Cili, është atëherë, burimi i kësaj vetëdije? Padyshim se nuk janë as gjallesat e as qeniet e pajetë që ekzistojnë në të. E as që mund të jenë ato ato të cilat e mbajnë këtë harmoni dhe e ruajnë këtë rregull. Ekzistenca dhe madhështia e Allahut zbulon veten në prova të panumërta në gjithësi. Në të vërtetë, nuk ekziston madje as edhe një njeri i vetëm në tokë që nuk do të pranojë këtë të vërtetë të qartë nga zemra. E prapë prapë ata e mohojnë atë padrejtësisht dhe me mendjemadhësi edhe pse shpirtërat e tyre janë të bindur për këtë siç deklarohet në Kur'an. (Sure Neml: 14)

Ky libër është shkruar për të nxjerrur në pah/të treguar këtë të vërtetë të cilës një pjesë e njerëzve i largohen për shkak të të qenit të saj në kundërshtim me interesat e tyre dhe gjithashtu për të demaskuar mashtrimet dhe përfundimet e pakuptim mbi të cilat

qëndrojnë një pjesë e pretendimeve të pavërteta. Për këtë arsye shumë tema të ndryshme janë prekur në këtë libër.

Ata që e lexojnë këtë libër edhe një herë do të shohin provat e padiskutueshme të ekzistencës së Allahut dhe do të jenë dëshmitarë se ekzistenca e Allahut përfshinë gjithçka: ‘arsyeja’ e dinë këtë. Ai është I Cili krijoi këtë rregull gjithëpërschkues dhe I Cili gjithashtu e mban atë vazhdimisht.

Prej mosqenies në ekzistencë

Pyetjet se si zuri fill gjithësia, ku shpie ajo dhe si ligjet që mbajnë këtë rregull dhe barazpeshë funksionojnë kanë qenë gjithmonë tema të interesimit. Shkencëtarët dhe mendimtarët kanë menduar në lidhje me këtë çështje pandërprerë dhe kanë krijuar mjaft teori.

Mendimi mbizotërues deri në fillim të shekullit 20të ishte se gjithësia kishte përmasa të pafund, se kishte ekzistuar përjetësisht dhe se do të vazhdonte të ekzistonte përgjithmonë. Sipas kësaj pikëpamjeje, të quajtur ‘modeli statik i gjithësisë’, gjithësia nuk kishte as fillim dhe as fund.

Duke vendosur bazat për filozofinë materialiste, kjo pikëpamje mohonte ekzistencën e një Krijuesi ndërsa pohonte se gjithësia është një grumbull i përhershëm, i qëndrueshëm dhe i pandryshueshëm i materies.

Materializmi është një sistem i të menduarit sipas të cilit materia është një qenie absolute dhe mohon ekzistencën e çdo gjëje përveç materies. Meqenëse i kishte rrënjët e saj në Greqinë e lashtë dhe duke fituar përkrahje gjithnjë e në rritje në shekullin e 19të, ky sistem i të menduarit u bë i njohur në formën e materializmit dialektik të Karl Marksit.

Siç kemi thënë më heret, modeli statik i gjithësisë i shekullit 19të përgatiti bazat e filozofisë materialiste. Në këtë libër *Principes Fondamentales de Philosophie (Principet Fundamentale të Filozofisë)*, Xhorxh Policeri deklaroi në lidhje me bazën e këtij modeli të gjithësisë se: “gjithësia nuk ishte një objekt i krijuar” dhe shtoi: Po të ishte, atëherë do të duhej të ishte krijohej përnjëherë nga Zoti dhe të vinte në jetë prej asgjëje. Për të pranuar krijimin, njeriut i duhet të pranoj, në rradhë të parë, ekzistencën e një momenti kur gjithësia nuk ekzistonte dhe se diçka u krijua nga asgjëja. Kjo është diçka me të cilën shkenca s’mund të pajtohet. 1

Kur Policeri pohoi se gjithësia nuk u krijua prej asgjëje, ai po mbështetej në modelin statik të gjithësisë të shekullit 19të dhe duke menduar që po parashtronte një pohim shkencor. Mirëpo, shkenca dhe teknologjia në zhvillim e shekullit 20të hodhi poshtë idetë primitive siç është modeli statik i gjithësisë që vuri bazat për materialistët. Sot, në prag të shekullit 21, fizika moderne ka vërtetuar me anë të eksperimenteve, vrojtimeve dhe llogaritjeve të shumta se gjithësia kishte një fillim dhe se ajo u krijua prej asgjëje me anë të një shpërthimi të madh.

Veç kësaj, u zbulua se gjithësia nuk ishte statike siç pretendonin materialistët, por ajo zgjerohej. Sot këto fakte pranohen nga e tërë bota shkencore.

Se gjithësia kishte një fillim nënkupton se gjithësia erdh në jetë prej asgjëje, domethënë, se ajo u krijua. Poqese ekziston një gjë e krijuar (e cila nuk kishte ekzistuar më parë), atëherë padyshim se duhet të ketë një Krijues. Të krijuarit prej mosqenies është diçka e paimagjinueshme për mendjen njerëzore. Prandaj, të krijuarit prej mosqenies është një gjë krejtësisht tjetër prej bashkimit të objekteve për të formuar një objekt të ri (siç janë veprat e artit apo shpikjet teknologjike). Është shenjë/argument vetëm i krijimit të Allahut se gjithçka u formua në mënyrë të përkryer përnjëherë dhe në një moment të vetëm, kur gjërat e krijuara nuk kishin shembuj të mëparshëm dhe madje as koha dhe as hapësira nuk ekzistonin ku të krijoheshin ato.

Ardhja në jetë e gjithësisë nga mosqenia është prova më madhështore e mundshme se ajo është krijuar. Marrja parasysh e këtij fakti do të ndryshojë shumë gjëra. Kjo i ndihmon njerëzit të kuptojnë domethënien e jetës dhe të rishikojnë qëndrimet dhe qëllimet e tyre. Kjo është arsyeja pse gjatë historisë, shumë njerëz janë përpjekur të shpërfillin faktin e krijimit të cilin ata nuk mund ta kuptonin plotësisht, edhe pse dëshmia për të ishte e qartë për ta. Ata sajuan alternative për të krijuar huti në mendjet e njerëzve. Sidoqoftë, vet dëshmitë shkencore përfundimisht u japin fund këtyre teorive.

Tani, le t'i hedhim një vështrim të shkurtër procesit zhvillimor të shkencës përmes të cilit u krijua gjithësia.

ZGJERIMI I GJITHËSISË

Në vitin 1929, në Observatorin e Kalifornia Mount Wilson, një astronom amerikan i quajtur Edvin Habëll bëri njëzëri prej zbulimeve më të mëdha në historinë e astronomisë. Gjersa vrojtonte yjet me një teleskop gjigant, ai zbuloi se drita që vinte prej tyre zhvendosej në drejtim të skajit të kuq të spektrit dhe se kjo zhvendosje ishte më e shprehur sa më i largët ishte ylli prej tokës. Ky zbulim kishte një efekt elektrizues në botën e shkencës, sepse sipas rregullave të pranuar të fizikës, spektret e rrezeve të dritës që lëvizin në drejtim të pikës së vrojtimit anojnë kah ngjyra vjollcë ndërsa spektret e rrezeve të dritës që lëvizin në drejtim të kundërt në raport me pikën e vrojtimit anojnë kah ngjyra e kuqe. Gjatë vrojtimit të Habëllit, u zbulua se drita që vinte prej yjeve anonte kah ngjyra e kuqe. Kjo nënkuptonte se ato vazhdimisht largoheshin prej nesh.

Së shpejti, Habëll bëri edhe një zbulim tjetër shumë të rëndësishëm: Yjet dhe galaktikat largoheshin jo vetëm prej nesh, por edhe prej njëra tjetrës. I vetmi përfundim që mund të nxjerrej prej një gjithësie ku gjithçka largohet prej çdo gjëje tjetër është se gjithësia 'zgjerohet' vazhdimisht.

Për ta pasur më të qartë, për gjithësinë mund të mendohet si për sipërfaqen e balonit që fryhet. Pikërisht ashtu sikurse pikat në sipërfaqen e balonit largohen prej njëra tjetrës me fryerjen e balonit, ashtu edhe objektet në hapësirë largohen prej njëra tjetrës me të zgjeruar të gjithësisë.

Në të vërtetë, kjo ishte zbuluar teorikisht madje edhe më heret. Albert Ajnshtajni, i cili konsiderohet si shkencëtari më i madh i shekullit, kishte ardhur në përfundim pas llogaritjeve që kishte bërë në fizikën teorike se gjithësia nuk mund të ishte statike. Megjithatë, ai e kishte mbajtur të heshtur këtë zbulim thjeshtë për t'mos rënë në kundërshtim me modelin e gjithësisë statike të kohës së tij të pranuar botërisht. Më vonë,

Ajnshtajni do ta identifikonte këtë veprim të tij si ‘gabimin më të madh të karrierës së tij’. Më pas, u bë e qartë nga vrojtimet e Habëllit se gjithësia zgjerohet.

Çfarë rëndësie kishte atëherë fakti se gjithësia zgjerohet për ekzistencën e gjithësisë? Zgjerimi i gjithësisë nënkuptonte se po të mund të lëvizte gjithësia mbrapsht në kohë, do të vërtetohej që gjithësia kishte zënë fill nga një pikë e vetme. Llogaritjet treguan se kjo ‘pikë e vetme’ që strehoi gjithë materien e gjithësisë do të duhej të kishte ‘vëllim zero’ dhe ‘dendësi të pakufishme’. Gjithësia kishte zënë fill prej shpërthimit të kësaj pike të vetme me vëllim zero. Ky shpërthim madhështor që shënoi fillimin e gjithësisë u emërua ‘Shpërthimi i Madh’ (Big Bengu) dhe teoria filloi të quhej ashtu. Duhet të theksohet se ‘vëllimi zero’ është një shprehje teorike e përdorur për qëllime përkrahëse. Shkenca mund ta definojë konceptin/idenë e ‘asgjësë’, i cili tejkalon kufijtë e të kuptuarit njerëzor, vetëm duke e përkrahur atë si ‘një pikë me vëllim zero’. Në të vërtetë, ‘një pikë pa vëllim’ don të thotë ‘asgjë/mosqenia’. Gjithësia erdh në jetë nga asgjëja/mosqenia. Me fjalë të tjera, ajo u krijua.

Teoria e Shpërthimit të Madh tregoi se në fillim të gjitha objektet në gjithësi ishin një tërësi dhe pastaj u ndanë. Ky fakt, i cili u zbulua me teorinë e Shpërthimit të Madh u shpall në Kur’an 14 shekuj më parë, kur njerëzit kishin një dijeni shumë të kufizuar për gjithësinë:

A nuk e dinë ata, të cilët nuk besuan se qiejt e toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi? A nuk besojnë? (Sure Enbija: 30)

Siç shpallet në këtë varg, gjithçka, madje edhe ‘qiejt dhe toka’ që ende nuk ishin krijuar, u krijuan me një Shpërthim të Madh prej një pike të vetme dhe i dhanë formë gjithësisë ekzistuese duke u ndarë prej njëra tjetrës.

Kur e bëjmë krahasimin e formulimeve në këtë varg me teorinë e Shpërthimit të Madh, vërejmë se ato pajtohen plotësisht me njëra tjetrën. Megjithatë, Shpërthimi i Madh u njoh si teori shkencore vetëm në shekullin e 20të.

Zgjerimi i gjithësisë është njëra prej provave më të rëndësishme shkencore se gjithësia u krijua nga asgjëja. Edhe pse ky fakt nuk u zbulua prej shkencës deri në shekullin e 20të, Allahu na ka bërë me dije për këtë të vërtetë në Kur’an të shpallur 1,400 vjet më parë:

Ne, me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë. (Sure Dharijat: 47)

KËRKIMI I ALTERNATIVAVE PËR TEORINË E SHPËRTHIMIT TË MADH

Siç shihet qartë, teoria e Shpërthimit të Madh vërtetoi se gjithësia ‘u krijua nga asgjëja/mosqenia’, me fjalë të tjera, se ajo u krijua prej Allahut. Për këtë arsye, astronomët e përkushtuar ndaj filozofisë materialiste vazhduan t’i bëjnë ballë Shpërthimit të Madh dhe të përkrahin teorinë e gjendjes së qëndrueshme. Arsyeja për këtë përpjekje zbulohet në fjalët në vazhdim të A.S. Eddington, njërit prej fizikanëve materialist më të shquar: ‘Filozofikisht, ideja e një fillimi të papritur të rregullit ekzistues të Natyrës është e neveritshme për mua.’ 2

Sir Fred Hojll ishte njëri prej atyre që u trazuan/shqetësuan nga teoria e Shpërthimit të Madh. Në mesin e shekullit, Hojlli përkrahu një teori të quajtur gjendja e qëndrueshme/pandryshueshme e cila ishte e ngjashme me qasjen e 'gjithësisë konstante/të pandryshueshme' të shekullit të 19të. Teoria e gjendjes së qëndrueshme pohonte se gjithësia ishte si e pafund në madhësi ashtu edhe e përjetshme në kohëzgjatje. Me të vetmin qëllim të qartë të përkrahjes së filozofisë materialiste, kjo teori ishte në kundërshtim të plotë me teorinë e Shpërthimit të Madh, e cila konsideronte se gjithësia kishte një fillim.

Ata që e mbrojtën teorinë e gjendjes së qëndrueshme iu kundërvunë Shpërthimit të Madh për një kohë të gjatë. Megjithatë, shkenca po punonte kundër tyre.

Disa shkencëtarë, në anën tjetër, kërkuan mënyra për të zhvilluar alternativa.

Në vitin 1948, Xhorxh Gamov doli me një ide tjetër në lidhje me Shpërthimin e Madh. Ai deklaroi se pas formimit të gjithësisë me anë të një shpërthimi të madh, një tepriçë e rrezatimit duhej të kishte ekzistuar në gjithësi e mbetur prej këtij shpërthimi. Veç kësaj, ky rrezatim duhej të ishte i shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme në tërë gjithësinë.

Kjo dëshmi e cila 'duhej të kishte ekzistuar' do të zbulohej së shpejti.

MË SHUMË DËSHMI: RREZATIMI KOZMIK NË PRAPAVI

Në vitin 1965, dy hulumtues të quajtur Arno Penzias dhe Robert Vilson zbuluan këto valë rastësisht. Ky rrezatim, i quajtur 'rrezatimi kozmik në prapavi', nuk dukej të rrezatonte nga një burim i caktuar/i veçantë por më tepër përshkonte gjithë hapësirën. Kështu, u kuptua se valët e nxehtësisë që rrezatonin në mënyrë të njëtrajtshme prej gjithandej në hapësirë kishin mbetur prej fazave fillestare të Shpërthimit të Madh. Penzias dhe Vilson u shpërblyen me Çmimin Nobël për zbulimin e tyre.

Në vitin 1989, NASA dërgoi në hapësirë satelitin për Hulumtim të Prapavisë Kozmike (Cosmic Background Explorer - COBE) për të hulumtuar rrezatimin e prapavisë/sfondit kozmike. Skanerëve të ndjeshëm iu nevojitën vetëm tetë minuta në këtë satelit për të vërtetuar matjet e Penzias dhe Vilson. COBE kishte gjetur mbeturinat e shpërthimit të madh që kishte ndodhur në fillimin e gjithësisë.

I definuar si zbulimi më i madh astronomik i të gjitha kohërave, ky zbulim vërtetoi qartë teorinë e Shpërthimit të Madh. Zbulimet e satelitit COBE 2 i cili u dërgua në hapësirë pas satelitit COBE poashtu vërtetoi matjet e bazuara në Shpërthimin e Madh.

Një dëshmi tjetër e rëndësishme për Shpërthimin e Madh ishte sasia e hidrogjenit dhe heliumit në hapësirë. Në llogaritjet më të vonshme, u kuptua se përqendrimi i hidrogjen-heliumit në gjithësi përputhej me llogaritjet teorike të përqendrimit të hidrogjen-heliumit të mbetur prej Shpërthimit të Madh. Po të mos kishte pasur gjithësia një fillim dhe po të kishte ekzistuar përjetësisht, përbërësi i saj i hidrogjenit do të duhej të ishte shpenzuar tërësisht dhe të shndërrohej në helium.

Të gjitha këto dëshmi bindëse bënë që teoria e Shpërthimit të Madh të përqafohej nga komuniteti shkencor. Modeli i Shpërthimit të Madh ishte pika më kulminante e arritur nga shkenca në lidhje me formimin dhe fillimin e gjithësisë.

Duke e mbrojtur teorinë e gjendjes së qëndrueshme bashkë me Fred Hojllin me vite të tëra, Denis Skiamia përshkruajti qëndrimin përfundimtar që kishin arritur ata pasiqë të

gjitha provat për teorinë e Shpërthimit të Madh u zbuluan. Skiama deklaroi se ai kishte marrë pjesë në debate të nxehta në mes të mbrojtësve të teorisë së gjendjes së qëndrueshme dhe të atyre të cilët e vunë në sprovë atë teori me shpresë që ta hudhnin poshtë. Ai shtoi se kishte mbrojtur teorinë e gjendjes së qëndrueshme jo pse e konsideronte atë si të vlefshme, por sepse kishte dëshirë që ajo të ishte e vlefshme. Fred Hojlli u ngrit kundër të gjitha kundërshtimeve me të filluar të shpalojes së provave kundër kësaj teorie. Skiama vazhdon duke thënë se ai së pari ishte pozicionuar së bashku me Hojllin, por me të filluar të grumbullimit të provave, atij i ishte dashur të pranoj se loja kishte mbaruar dhe se teoria e gjendjes së qëndrueshme duhej të hudhej poshtë. 3

Prof. Xhorxh Abel i Univerzitetit të Kalifornisë gjithashtu deklaroi se dëshmia ekzistuese në dispozicion tregon se gjithësia zuri fill miliarda vite më parë me Shpërthimin e Madh. Ai pranon se nuk ka zgjidhje tjetër pos të pranojë teorinë e Shpërthimit të Madh.

Me fitoren e Shpërthimit të Madh, koncepti i ‘materies së përjetshme’ që formoi bazën e filozofisë materialiste u hodh në grumbullin e mbeturinave të historisë. Çfarë atëherë kishte para Shpërthimit të Madh dhe cila ishte ajo fuqi që solli në ‘jetë’ gjithësinë me anë të këtij shpërthimi të madh kur ajo ishte ‘e paqenë’? Kjo pyetje padyshim se nënkupton, sipas fjalëve të Arthur Edingtonit, faktin ‘filozofikisht të pafavorshëm’ për materialistët, domethënë, ekzistencën e një Krijuesi. Filozofi i famshëm ateist Antoni Flu bën këtë koment në lidhje me këtë çështje:

Është e njohur se pranimi është i mirë për shpirtin. Prandaj do të fillojë duke pranuar se ateisti Stratonist do të duhej të turpërohej nga koncensusi bashkëkohor kozmologjik. Sepse duket se kozmologët po ofrojnë një provë shkencore se ajo për çka luftonte St. Thomas nuk mund të dëshmohej filozofikisht, domethënë, se gjithësia kishte një fillim. Për aq kohë sa për gjithësinë të mendohet me rehati të jetë jo vetëm e pa fund por gjithashtu edhe e pa fillim, është e lehtë të përpiqet që ekzistenca e saj e thjeshtë dhe çfarëdo që zbulohet të jenë veçoritë e saj më fundamentale, do të duhej të pranoheshin si baza sqaruese. Edhe pse besoj se ende mbetet e saktë, padyshim se nuk është as e lehtë dhe as e rehatshme që të mbahet ky qëndrim përballë historisë së Shpërthimit të Madh. 4

Shumë shkencëtarë të cilët nuk kushtëzojnë vetveten verbërisht të jenë ateistë kanë pranuar rolin e një Krijuesi të plotfuqishëm në krijimin e gjithësisë. Ky Krijues duhet të jetë një qenie E Cila ka krijuar si materien ashtu edhe kohën, por E Cila është e pavarur prej të dyjave. Astrofizikani i mirënjohur Hju Ros ka këtë për të thënë: Poqese fillimi i kohës është i njëkohshëm me fillimin e gjithësisë, siç shprehet teorema e hapësirës, atëherë shkaktari i gjithësisë duhet të jetë një qenie që vepron në një dimension kohor krejtësisht të pavarur dhe paraekzistues në raport me dimensionin e kohës së gjithësisë. Ky përfundim është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të kuptuarit tonë të asaj se kush është Zoti dhe kush apo çfarë nuk është Zoti. Kjo na tregon se Zoti nuk është vet gjithësia dhe as që Zoti është i përfshirë brenda gjithësisë. 5

Materia dhe koha janë krijuar prej Krijuesit të plotfuqishëm I Cili është i pavarur prej gjithë këtyre nocioneve. Ky Krijues është Allahu, I Cili është Zoti i qiejve dhe i tokës.

BARAZPESHAT E BRISHTA NË HAPËSIRË

Në të vërtetë, Shpërthimi i Madh shkaktoi një telashe shumë më të madhe për materialistët se pranimet e lartpërmendura të filozofit ateist, Antoni Flu. Sepse Shpërthimi i Madh jo vetëm që provon se gjithësia u krijua prej asgjëje, por gjithashtu se ajo erdh në jetë në një mënyrë shumë mirë të planifikuar, sistematike dhe të kontrolluar.

Shpërthimi i Madh ndodhi me shpërthimin e pikës e cila përmbante gjithë materien dhe energjinë e gjithësisë dhe me shpërndarjen e saj në hapësirë në të gjitha drejtimet me një shpejtësi të llahtarshme. Prej kësaj materieje dhe energjie, u krijua një barazpeshë madhështore që përmban galaktikat, yjet, diellin, tokën dhe të gjithë trupat tjerë qiellor. Veç kësaj, u formuan ligjet e quajtura 'ligjet e fizikës', të cilat janë të njëtrajtshme në tërë gjithësinë dhe nuk ndryshojnë. Të gjitha këto tregojnë se një rregull i përkryer u krijua pas Shpërthimit të Madh.

Shpërthimet, megjithatë, nuk shkaktojnë rregull. Të gjitha shpërthimet e vrojtueshme tregojnë prirje të shkaktojnë dëm, të shpërbërjnë dhe shkatërrojnë atë që është e pranishme. Për shembull, shpërthimet e bombave atomike dhe hidrogjenike, shpërthimet e gazërave shpërthyesë, shpërthimet vullkanike, shpërthimet e gazit natyror, shpërthimet diellore: ato të gjitha kanë efekte shkatërruese.

Poqese do të ndesheshim me një rregull shumë të detajuar pas një shpërthimi – për shembull, poqese një shpërthim i nëndheshëm do të shkaktoje formimin e veprave të përkryera të artit, pallateve madhështore apo shtëpive imponante – do të mund të vinim në përfundim se pas këtij shpërthimi ekzistonte një ndërhyrje 'e mbinatyreshme' dhe se të gjitha grimcat e shpërndara prej shpërthimit janë shtyrë të lëvizin në mënyrë shumë të kontrolluar.

Citati i Sir Fred Hojllit, i cili e pranoi gabimin e tij shumë vjet pas kundërshtimit të Teorisë së Shpërthimit të Madh, e shpreh këtë situatë shumë mirë:

Sipas teorisë së shpërthimit të madh gjithësia filloi me një shpërthim të vetëm. Mirëpo siç mund të shihet më poshtë, një shpërthim thjeshtë e shpërndanë materien, ndërsa shpërthimi i madh (big bengu) në mënyrë të mistershme ka shkaktuar efektin e kundërt – me bashkimin e materies në formën e galaktikave. 6

Kur deklaroi se Shpërthimi i Madh i hapi udhën rregullit është kundërtë, ai padyshim se e interpretoi Shpërthimin e Madh me një paragjykim materialist dhe supozon se ky ishte një 'shpërthim i pakontrolluar'. Mirëpo, ai ishte në realitet ai i cili rra në kundërshtim me vetveten duke bërë një deklaratë të tillë thjeshtë për t' mos pranuar ekzistencën e një Krijuesi. Sepse poqese me një shpërthim u shfaq një rregull madhështor, atëherë ideja e një 'shpërthimi të pakontrolluar' do të duhej të anulohet dhe do të duhej të pranohet se shpërthimi ishte jashtëzakonisht i kontrolluar.

Një aspekt tjetër i këtij rregulli mahnitës të formuar në gjithësi pas Shpërthimit të Madh është krijimi i një 'gjithësie të banueshme'. Kushtet për formimin e një planete të banueshme janë aq të shumta dhe aq komplekse sa që është gati e pamundshme të mendohet se ky formim është i rastësishëm.

Pol Dejvis, një profesor i famshëm i fizikës teorike, llogariti se sa 'mirë i harmonizuar' ishte ritmi/shpejtësia e zgjerimit pas Shpërthimit të Madh dhe ai arriti në një përfundim të pabesueshëm. Sipas Dejvis, po të kishte qenë ritmi i zgjerimit pas Shpërthimit

të Madh më i ndryshëm madje me një përpjestim prej një në një bilion herë, asnjë lloj i yllit të banueshëm s'do të formohej:

Një matje e kujdesshme e vendos shkallën e zgjerimit shumë pranë një vlere kritike në të cilën gjithësia do t'i shmangej vet gravitacionit të saj dhe të zgjerohej përjetësisht. Pak më ngadalë dhe gjithësia do të rrënohej, pak më shpejtë dhe materiali kozmik do të ishte shpërbërë shumë kohë më parë. Është me rëndësi të pyetemi me saktësi se sa me finesë ka qenë 'e mirë harmonizuar' shkalla e zgjerimit për të rrënë në këtë vijë ndarëse të ngushtë në mes të dy katastrofave. Po të kishte dalluar shkalla e zgjerimit në kohën I S (kohë në të cilën modeli i zgjerimit tashmë ishte përcaktuar me vendosmëri) nga vlera aktuale për më shumë se 10-18, do të mjaftonte që kjo barazpeshë e brishtë të rrënohej. Fuqia shpërthyesë e gjithësisë kështu përputhet me një saktësi gadi të pabesueshme në raport me fuqinë e saj gravituese. Është e qartë, se shpërthimi i madh nuk ishte ndonjë shpërthim i vjetër, por një shpërthim me një madhësi hollësisht të rregulluar. 7

Ligjet e fizikës që u shfaqën së bashku me Shpërthimin e Madh nuk ndryshuan fare në një periudhë prej 15 miliardë vjetësh. Veç kësaj, këto ligje u rezistojnë llogaritjeve aq të përpikta sa që edhe një ndryshim prej një milimetri nga vlerat e tyre ekzistuese mund të rezultojë me shkatërrimin e tërë strukturës dhe konfiguracionit/trajtës të gjithësisë.

Fizikani i famshëm Prof. Stefën Hoking deklaroi në librin e tij "Një histori e shkurtër e kohës" se gjithësia është e bazuar në llogaritje dhe barazpesha të harmonizuara në mënyrë më delikate se që mund të paramendojmë. Hoking deklaroi në lidhje me shkallën e zgjerimit të gjithësisë:

Pse filloi gjithësia me një shkallë aq pranë shkallës kritike të zgjerimit që ndanë modelet që rrënohen prej atyre që vazhdojnë të zgjerohen përgjithmonë, aq sa madje edhe tani, dhjetë mijë milionë vite më vonë, ende vazhdon të zgjerohet gadi në shkallën kritike? Po të kishte qenë shkalla e zgjerimit një sekond pas shërthimit të madh më e vogël madje edhe për një pjesë në njëqind mijë milionë milionë, gjithësia do të rrënohej para se të arrinte madhësinë e saj të tanishme. 8

Pol DeJvis poashtu sqaron pasojën e pashmangshme që rrjedh prej këtyre llogaritjeve dhe barazpeshave pabesueshëm të sakta:

Është vështirë t'i bëhet ballë përshtypjes se përbërja ekzistuese e gjithësisë, aq dukshëm e ndryshme ndaj ndryshimeve të vogla në numra, është planifikuar me shumë kujdes... Bashkëveprimi në dukje i mrekullueshëm i vlerave numerike që natyra ka përcaktuar për konstantat e saj fundamentale duhet të mbetet dëshmia më bindëse për një element të projektimit kozmik. 9

Në raport me të njëjtin fakt, një profesor amerikan i astronomisë, Xhorxh Grinstain, shkruan në librin e tij "Gjithësia Simbiotike":

Kur i analizojmë të gjitha provat, shfaqet me këmbëngulje mendimi se një ndërmjetës i mbinatyreshëm – apo më saktë Ndërmjetësi – duhet të jetë i përfshirë. 10

KRIJIMI I MATERIES

Atomi, materiali ndërtues i materies, erdh në jetë pas Shpërthimit të Madh. Këto atome pastaj u bashkuan për të formuar gjithësinë me yjet e saj, tokën dhe diellin. Pastaj, atomet e njëjta themeluan jetën në tokë. Gjithçka që shihni rreth vetes: trupi juaj, karriga në

të cilën jeni të ulur, libri që mbani në dorën tuaj, qielli që shihni nga dritarja, dheu, betoni, frutet, bimët, të gjitha gjallesat dhe çdo gjë që ju mund të imagjinoni ka ardhë në jetë me grumbullimin e atomeve.

Prej çfarë atëherë përbëhet atomi, materiali ndërtues i çdo gjëje, dhe çfarë strukture ka ai?

Kur e analizojmë strukturën e atomeve, shohim se të gjitha ato kanë një projektim dhe rregull mahnitës. Çdo atom ka një bërthamë në të cilën ekziston një numër i caktuar i protoneve dhe neutroneve. Përveç këtyre, ka elektrone të cilat lëvizin rreth bërthamës në një orbitë konstante me një shpejtësi prej 1,000 kilometrave në sekond. 11

Elektronet dhe protonet e një atomi janë të barabarta në numër, sepse protonet e ngarkuara pozitivisht dhe elektronet e ngarkuara negativisht gjithnjë e mbajnë ekuilibrin e njëra tjetrës. Po të ishte njëri prej këtyre numrave i ndryshëm, nuk do të ekzistonte ndonjë atom, pasi që barazpesha e tij elektromagnetike do të çrregullohej. Bërthama e një atomi, protonet dhe neutronet në të dhe elektronet rreth tij janë gjithnjë në lëvizje. Ato sillen si rreth vetes ashtu edhe rreth njëra tjetrës në mënyrë të pagabueshme në shpejtësi të caktuara. Ato shpejtësi janë gjithnjë në përpjestim me njëra tjetrën dhe sigurojnë ekzistencën e atomit. Asnjë çrregullim, mospajtim apo ndryshim nuk ndodhë asnjëherë.

Është një gjë shumë e jashtëzakonshme që entitete të tilla tejet të rregullta dhe të përcaktuara të mund të vinin në jetë pas një shpërthimi madhështor që ndodhi në mosqenie. Po të ishte Shpërthimi i Madh një shpërthim i pakontrolluar, i rastësishëm, atëherë ai duhej të ishte pasuar prej ngjarjeve të rastësishme dhe gjithçka që u formua më pas do të duhej të ishte shpërbërë në një kaos të madh.

Në të vërtetë, një rregull i përkryer ka mbizotëruar gjithkund prej fillimit të ekzistencës. Për shembull, edhe pse atomet janë formuar në vende dhe kohë të ndryshme, ato janë aq të organizuara sa që duken sikur të ishin prodhuar nga një fabrikë e vetme me një vetëdije të secilit lloj. Së pari, elektronet ia gjejnë vetes bërthamën dhe fillojnë të sillen rreth saj. Më vonë, atomet bashkohen për të formuar materien dhe të gjitha këto shkaktojnë krijimin e objekteve kuptimplota, të qëllimshme dhe të arsyeshme. Kurrë nuk ndodhin gjëra të dykuptueshme, të padobishme, jonormale dhe të paqëllimshme. Gjithçka prej njësisë më të vogël gjer te përbërësit më të mëdhenjë është e organizuar dhe ka qëllime të shumëfishta.

Gjithë kjo është një dëshmi solide e ekzistencës së Krijuesit, I Cili është i lartësuar me fuqi dhe tregojnë faktin se gjithçka vie në jetë sido që Ai të dëshirojë dhe kurdo që Ai të dëshirojë. Në Kur'an, Allahu flet kështu për krijimin e Tij:

E Ai është që krijoi qiejt dhe tokën me qëllim të caktuar, e (ruajuni dënimit) ditën kur thotë: "Bëhu"! Ajo bëhet. Fjala e Tij është e njëmendte... (Sure En'am: 73)

PAS SHPËRTHIMIT TË MADH

Ashtu siç Roxher Penrouz, një fizikan i cili ka bërë kërkime të gjera për zanafillën e gjithësisë, ka theksuar faktin se gjithësia qëndron ku është jo thjeshtë si rezultat i rastësisë tregon se ajo padyshim ka një qëllim. Për disa njerëz, 'gjithësia është thjeshtë aty' dhe thjeshtë vazhdon të jetë aty. Ne vetëm rastisëm të gjejmë veten tonë mu në mes të gjithë kësaj. Kjo pikëpamje me siguri se nuk do t'na ndihmonte që të kuptojmë gjithësinë. Sipas

pikëpamjes së Penrouz, ekzistojnë shumë gjëra të fshehta që ndodhin brenda gjithësisë ekzistencën e së cilës ne sot nuk mund ta marrim me mend. 12

Idetë e Roger Penrouz janë me të vërtetë domethënëse. Siç nënkuptojnë këto fjalë, shumë njerëz gabimisht ushqejnë mendime se gjithësia me gjithë harmoninë e saj të përkryer ekziston për asgjë dhe se ata jetojnë në këtë gjithësi prap kot së koti.

Megjithatë, nuk mundet assesi të konsiderohet si diçka e zakonshme se një rregull krejtësisht i përkryer dhe i mahnitshëm ndodhi pas Shpërthimit të Madh, i cili konsiderohet nga komuniteti shkencor të jetë mënyra e formimit të gjithësisë.

Shkurt, kur e analizojmë sistemin madhështor në gjithësi, shohim se ekzistenca e gjithësisë dhe funksionimi i saj mbështeten në barazpesha tejet të brishta dhe në një rregull tejet kompleks që të mund të shpjegohej me anë të shkaqeve të rastësishme. Siç është e qartë, assesi nuk është e mundshme që kjo barazpeshë e brishtë dhe ky rregull të jenë formuar vetvetiu dhe me anë të rastësisë pas një shpërthimi të madh. Formimi i një rregulli të tillë që pasoi një shpërthim të tillë si Shpërthimi i Madh do të ishte i mundshëm vetëm si rezultat i një krijimi të mbinatyrshëm.

Ky plan dhe rregull i pakrahasueshëm në gjithësi padyshim se vërteton ekzistencën e një Krijuesi me dijeni, fuqi dhe urtësi/mençuri të pakufizuar, I Cili ka krijuar materien prej asgjëje dhe I Cili e kontrollon dhe e drejton atë vazhdimisht. Ky Krijues është Allahu, Zoti i qiejve, i tokës dhe i çdo gjëje që është në mes tyre.

Të gjitha këto fakte na tregojnë poashtu se si pohimet e filozofisë materialiste, e cila është thjeshtë një dogmë e shekullit të 19të, janë zhvlerësuar nga shkenca e shekullit të 20të.

Duke e vënë në dukje planin, projektimi dhe rregullin madhështor që mbizotëron në gjithësi, shkenca bashkëkohore ka vërtetuar ekzistencën e një Krijuesi I Cili ka krijuar dhe sundon të gjitha qeniet: domethënë, Allahun.

Duke pasur pushtetin mbi një numër shumë të madh të njerëzve me shekuj të tërë dhe madje duke e maskuar vetveten me maskën e ‘shkencës’, materializmi, duke konsideruar se gjithçka përbëhet prej asgjë tjetër përveç materies, ka bërë një gabim trashanik dhe ka mohuar ekzistencën e Allahut, I Cili e ka krijuar dhe rregulluar materien nga asgjëja. Një ditë, materializmi do të mbahet në mend në histori si një besim primitiv dhe paragjykes që i kundërvihet si arsyes ashtu edhe shkencës.

Shenjat/argumentet në qiej dhe në tokë

Paramendoni se po ndërtoni një model të një qyteti të madh duke bashkuar me miliona tulla të vogla. Le të ketë në këtë qytet rrokaqiej, rrugë gjarpëruese, stacione të trenit, aeroporte, qendra tregtare, metro dhe poashtu lumenjë, liqene, pyje dhe një plazh. Le të ketë poashtu me mijëra njerëz që jetojnë në të që bredhin nëpër rrugët e tij, që rrinë në shtëpitë e tyre dhe punojnë në zyret e tyre. Merrni parasysh çdo hollësi. Madje edhe semaforët, biletaritet dhe tabelat në stacionet e autobusëve.

Po t’ju afrohej dikush dhe t’ju thoshte se të gjitha copëzat e këtij qyteti, të cilin ju e keni themeluar duke e planifikuar gjer në detalin më të vogël dhe secilën pjesë të të cilit ju e

keni zgjedhur me mund të madh, ishin bashkuar rastësisht për të formuar këtë qytet, çfarë do të mendonit për gjendjen mentale të atij personi?

Tani, kthehu tek qyteti të cilin e ke ndërtuar dhe mendo se si i tërë qyteti do të bëhej rrafsh me tokë po të kishit harruar të vëni në vend madje edhe një copëz të vetme apo po t'ia kishit ndryshuar vendin e saj. A mund të paramendoni se çfarë barazpeshe dhe rregulli do t'ju duhej të vendosni?

Jeta në botën në të cilën jetojmë është bërë e mundshme poashtu me akumulimin e një numri aq të madh të hollësive të paimagjinueshme për mendjen njerëzore. Mungesa e madje njëres prej këtyre hollësive apo të disa prej tyre do të nënkuptonte fundin e jetës në tokë.

Gjithçka, çdo detal duke u nisur prej atomit, njësisë më të vogël të materies gjer te galaktikat që strehojnë me miliarda yje, prej hënës, një sateliti të pandashëm të tokës, gjer te sistemi diellor, të gjitha funksionojnë në një harmoni të përkryer. Ky sistem i mirë-organizuar funksionon në mënyrë të përsosur, mu sikurse një orë. Njerëzit kanë aq shumë besim se ky sistem me miliarda vite i vjetër do të vazhdojë të funksionojë pa harruar madje as edhe detalin më të vogël në mënyrë që ata të bëjnë plane lirshëm për diçka që ata mendojnë se do të realizohet në 10 vitet e ardhshme. Askush nuk çanë kokën nëse dielli do të agojë në ditën e ardhshme. Pjesa më e madhe e njerëzve nuk brengoset nëse toka mundet ndonjëherë të ndodhë t'i shmanget gravitacionit të diellit dhe të fillojë të lëvizë në drejtim të së panjohurës në hapësirën tmerrësisht të errët; apo të pyet 'Çfarë e ndalon këtë që të mos ndodhë?'

Në të njëjtën mënyrë, kur njerëzit bëhen gadi të flejnë, ata janë shumë të sigurt se zemrat e tyre apo sistemet e frymëmarrjes nuk do të çlodhen ashtu siç vepron truri i tyre. Mirëpo, madje edhe vetëm disa sekonda të ndalimit të cilitdo prej këtyre dy sistemeve jetike lehtë mund të shkaktojnë pasoja që njeriut mund t'i kushtojnë me jetë.

Kur të hiqen 'syzet e njohjes/intimitetit' të cilat rrethojnë gjithë jetën dhe bëjnë që çdo ngjarje të vlerësohet sikur ajo 'të ndodhte sipas rrjedhës së saj të natyrshme', njeriu do të jetë i lirë të shoh se gjithçka përbëhet prej sistemeve aq ngusht të varura prej njëra tjetres dhe të planifikuara me përpikmëri sikurse të ishim të kapur fort për jetën me dhëmbët tonë. E vëreni një rregull të mrekullueshëm që mbizotëron në çdo vend ngado që ta drejtoni shikimin tuaj. Padyshim se ekziston një fuqi madhështore që krijon një rregull dhe harmoni të tillë. Zotëruesi i kësaj fuqie madhështore është Allahu, I Cili krijoi gjithçka nga asgjëja. Në një varg të Kur'anit thuhet:

Ai është që krijoi shtatë qiej në harmoni të plotë me njëri tjetrin. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë mospajtim, andaj, drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje? Mandej, herë pas here drejto shikimin, e shikimi do të kthehet të ti i përulur dhe i molisur. (Sure Mulk: 3-4)

Kur i vështrojmë gjallesat në qiej, në tokë dhe në gjithë atë që shtrihet në mes tyre, shohim se ato të gjitha e dëshmojnë ekzistencën e Krijuesit të tyre me rregullin e tyre. Në këtë kapitull, ne do të ndalemi në fenomenet natyrore dhe organizmat e gjallë që çdokush i sheh, por kurrë nuk mendon për to dhe për mënyrën se si erdhën në jetë dhe vazhdojnë të

ekzistojnë. Po ti shënonim të gjitha shenjat/argumentet e Allahut në gjithësi, ato do të mbushnin me mijëra vëllime të enciklopedive. Prandaj, në këtë kapitull, do të merremi shkurt me disa çështje që meritojnë që gjerësisht të mendojmë për to.

Mirëpo, madje edhe këto përmendje të shkurta do të ndihmojnë njerëzit e vetëdijshëm 'që posedojnë arsye' të vërejnë faktin më të rëndësishëm të jetërave të tyre apo së paku do t'ju ndihmojnë t'i përkujtojnë ato edhe njëherë.

Se Allahu ekziston.

Atij i takon zanafilla e qiejve dhe e tokës dhe Ai njihet përmes arsyes.

MREKULLITË NË TRUPIN TONË

'Një sy gjysëm i zhvilluar nuk mund të shoh'

Syri është njëra prej dëshmime më të dukshme se gjallesat janë krijuar. Të gjitha organet e të pamurit, duke përfshirë sytë e shtazëve dhe syrin e njeriut, kanë një projektim tejet mahnitës dhe të përkryer. Ky organ i jashtëzakonshëm është aq shumë kompleks sa që tejkalon madje edhe pajisjet më të sofistikuar në botë.

Syri i njeriut është një sistem shumë i komplikuar që përbëhet prej bashkimit të nga 40 komponenteve të veçanta. Le të marrim parasysh vetëm njërin prej këtyre komponenteve: për shembull, thjerra. Zakonisht nuk e kuptojmë, por ajo që na mundëson që t'i shohim gjërat qartë është përqendrimi i vazhdueshëm automatik i thjerrës. Poqese dëshironi, mund të bëni një eksperiment të vogël në lidhje me këtë: mbani gishtin tuaj tregues lart. Pastaj shikoni në majën e gishtit tuaj, pastaj në murin pas tij. Sa herë që të shikoni nga gishti juaj në mur do të ndjeni një përshtatje.

Kjo përshtatje bëhet nga muskuj të vegjël përreth thjerrës. Sa herë që të shikojmë diçka, këta muskuj hyjnë në veprim dhe na mundësojnë të shohim atë që shikojmë qartë duke ndryshuar trashësinë e thjerrës dhe duke e kthyer atë në këndin e duhur në raport me dritën. Thjerra bën këtë përshtatje në çdo sekond të jetës sonë dhe nuk gabon kurrë. Fotografët bëjnë përshtatjet e njëjta në kamerat e tyre me dorë dhe nganjëherë iu duhet të mundohen mjaft kohë për të gjetur fokusin e duhur. Gjatë 10 deri 15 viteve të fundit, teknologjia bashkëkohore ka prodhuar kamera me fokus automatik, por asnjë kamerë nuk mund të përqendrohet aq shpejtë sikurse syri.

Në mënyrë që syri të shoh, 40 apo rreth 40 komponente themelore të cilat e përbëjnë atë duhet të jenë të pranishme në të njëjtën kohë dhe të punojnë së bashku në mënyrë të përkryer. Thjerra është vetëm njëra prej tyre. Poqese të gjitha pjesët tjera përbërëse siç janë kornea, irida, bebëza, retina dhe muskujt e syrit janë të gjitha të pranishme dhe funksionojnë siç duhet, por vetëm kapaku i syrit mungon, atëherë syri së shpejti do të pësojë dëmtim të rëndë dhe do të pushojë së kryeri funksionin e tij. Në të njëjtën mënyrë, poqese të gjitha nënsistemet ekzistojnë por prodhimi i lotëve ndërpritet, atëherë syri do të thahet dhe do të verbohet brenda disa orëve.

Pretendimi "i zvoglueshmërisë/reduktimit" i teorisë së evolucionit humbet tërë kuptimin përballë strukturës së komplikuar të syrit. Arsyeja qëndron në atë se për të funksionuar syri, të gjitha pjesët e tij duhet të jenë të pranishme njëkohësisht. Një shkencëtar evolucionist e pranon këtë të vërtetë: Veçoria e përbashkët e syve dhe e krahëve

është se ato mund të funksionojnë vetëm nëse janë plotësisht të zhvilluara. Me fjalë të tjera, një sy gjysëm i zhvilluar nuk mund të shoh; një zog me krahë gjysëm të zhvilluar nuk mund të fluturojë. 13

Kjo dëshmon se syri është shfaqur papritur dhe i plotë me të gjitha komponentet e tij të padëmtuara. Kjo domethënë se syri është krijuar prej Allahut në mënyrë të përkryer pikërisht sikurse edhe të gjitha organet tjera tonat. Në Kur'an theksohet se të pamurit u është dhuruar gjallesave prej Allahut:

Thuaj: "Ai është që ju krijoi, ju dhuroi të dëgjuarit, të pamurit dhe mendjen, kurse pak po falënderoni" (Sure Mulk: 23)

Ushtria brenda njeriut

Çdo ditë zhvillohet një luftë në pjesët më të thella të trupit tuaj që ju nuk mund ta merrni me mend. Në njërën anë janë virusët dhe bakteriet që kanë për qëllim që të depërtojnë në trupin tuaj dhe ta marrin atë nën kontrollë dhe në anën tjetër janë qelizat e imunitetit që e mbrojnë organizmin prej këtyre armiqëve.

Armiqët presin në një gjendje të gatshme për sulm për të hyrë në vendin ku kanë për qëllim dhe shkojnë në drejtim të zonës së planifikuar me rastin e parë që t'u jipet. Së pari, ushtarët të cilët gjellitin dhe neutralizojnë ushtarët armiq (fagocitet) arrijnë në fushëbetejë. Megjithatë, ndonjëherë luftimi është më i ashpër se që mund të përballojnë këta ushtarë. Në raste të tilla, ushtarët tjerë (makrofagët) thirren. Kyqja e tyre shkakton alarm në zonën në shënjestër dhe ushtarët tjerë (qelizat ndihmëse T) gjithashtu thirren për të luftuar.

Këta ushtarë njohin shumë mirë popullatën lokale. Ata shpejtë dallojnë ushtrinë e tyre nga ajo armike. Ata i aktivizojnë menjëherë ushtarët e përcaktuar për prodhimin e armëve (qelizat B). Këta ushtarë kanë aftësi të jashtëzakonshme. Edhe pse ata kurrë nuk e shohin armikun, mund të prodhojnë armë që do ta bëjnë armikun të padobishëm. Përveç kësaj, ata i bartin armët që i prodhojnë në largësinë e duhur. Gjatë këtij udhëtimi, ata përmbushin detyrën e vështirë të mosshkaktimit të çfarëdo dëmi as ndaj vetes dhe as ndaj aleatëve të tyre. Më vonë, ekipet sulmuese ndërhyjnë (qelizat vrasëse T). Këto zbrazin materialin e helmueshëm që bartin me vete në pikën më vitale të armikut. Në rast të fitores, një grup tjetër i ushtarëve arrijnë në fushëbetejë (qelizat shtypëse T) dhe të gjithë luftëtarët i kthejnë në kampin e tyre. Ushtarët që arrijnë të fundit në fushëbetejë (qelizat e memories) regjistrojnë të gjitha të dhënat e rëndësishme në lidhje me armikun, në mënyrë që ato të mund të përdoren në rast të ndonjë invazioni të ngjashëm në të ardhmen.

Ushtria e mrekullueshme e diskutuar më lartë është sistemi i imunitetit në trupin njerëzor. Gjithçka e shpjeguar më lartë bëhet prej qelizave mikroskopike që s'mund të vëzhgohen me sy të lirë. (Për më shumë informacion ju lutemi shikoni "Për njerëzit e kuptueshëm": Shenjat/Argumentet në qiej dhe në tokë nga Harun Jahja)

Sa njerëz janë të vetëdijshëm se kanë një ushtri aq të organizuar, të disiplinuar dhe të përkryer brenda trupave të tyre? Sa prej tyre janë të vetëdijshëm se janë të rrethuar nga të gjitha anët prej mikrobeve që, poqese nuk ndalohen, mund të bëjnë që ata të sëmuren rëndë apo edhe të vdesin? Me të vërtetë, ekzistojnë shumë mikrobe të rrezikshme në ajrin që ne thithim, në ujën që pijmë, ushqimin që hajmë dhe sipërfaqet që prekim. Ndërsa njeriu është i

pavetëdijshtëm për gjithë atë që ndodhë, qelizat në trupin e njeriut bëjnë përpjekje të mëdha për të shpëtuar njeriun prej sëmurjes që madje mund të shkaktojë vdekjen e tij.

Aftësia e qelizave të imunitetit për të dalluar qelizat armike prej qelizave trupore, aftësia e qelizave B për të përgatitur një armë për të asgjësuar armikun që ato kurrë nuk e kanë parë, aftësia e tyre për të bartur këto armë aq larg sa të jetë nevoja pa ndikuar në mënyrë të pafavorshme ndaj çfarëdo qelize trupore, qelizat që pranojnë sinjalet duke përbushur detyrën e tyre plotësisht pa bërë kurrfarë kundërshtime, secila prej tyre duke e ditur se çfarë duhet të bëj, kthimi i tyre në vendet e tyre pa ndonjë problem posa të kenë mbaruar punën e tyre dhe aftësisht e qelizave të memories janë vetëm disa prej karakteristikave dalluese të këtij sistemi.

Për gjithë këto arsye, historia e formimit të sistemit të imunitetit kurrë nuk është pranuar prej asnjërit prej shkrytarëve evolucionist.

Është jashtëzakonisht e vështirë për një person pa sistem të imunitetit apo që nuk funksionon si duhet që të mbijetojë, pasi që ai do t'u ekzpozohet të gjitha mikrobeve dhe virusëve në botën e jashtme. Sot, njerëz të tillë mund të ekzistojnë vetëm në hapësira të mbyllura të veçanta pa ndonjë kontakt të drejtpërdrejt me cilindo apo çkado jashtë. Prandaj, është e pamundur për një person pa sistem të imunitetit të mbijetojë në një mjedis primitiv. Kjo na shpie te fakti se një sistem jashtëzakonisht kompleks siç është sistemi i imunitetit ka mundur të krihohej përnjëherë dhe me të gjitha pjesët përbërëse të tij.

NJË SISTEM I PLANIFIKUAR GJER NË HOLLËSINË E FUNDIT

Frymëmarrja, të ngrënit, të ecurit, etj, janë funksione shumë të natyrshme njerëzore. Por shumica e njerëzve nuk mendojnë për mënyrën se si këto veprime themelore ndodhin. Për shembull, kur e hani një frut, nuk mendoni se si do të jetë ai i dobishëm për trupin tuaj. E vetmja gjë në mendjen tuaj është të hani një ushqim të shëndoshë; në të njëjtën kohë, trupi juaj është i përfshirë në procese tejet të detajuara të papërfytyrueshme për ju që ky ushqim të jetë i shëndoshë.

Sistemi i tretjes ku këto procese të detajuara ndodhin fillon të funksionojë posa një pjesë e ushqimit futet në gojë. Duke qenë i përfshirë në sistem që nga fillimi, pështyma e lagë ushqimin dhe ndihmon që të bluhet prej dhëmbëve dhe të rrëshqet poshtë ezofagut/gurmazit.

Gurmazi ndihmon që ushqimi të bartet në stomak ku një barazpeshë e përkryer funksionon. Këtu ushqimi tretet prej acidit hidroklorik të pranishëm në stomak. Kjo thartirë është aq e fortë sa që është në gjendje të zbërthejë jo vetëm ushqimin por gjithashtu edhe muret e stomakut. Natyrisht, një e metë e tillë nuk është e lejuar në këtë sistem të përkryer. Një tajitje e quajtur mukozë e cila tajitet gjatë tretjes mbulon të gjitha muret e stomakut dhe siguron një mbrojtje të përkryer kundër efektit shkatërrues të acidit hidroklorik. Në këtë mënyrë stomaku ndalohet prej shkatërrimit të vetvetes.

Pjesa e mbetur e sistemit të tretjes është planifikuar në të njëjtën mënyrë. Pjesët e dobishme të ushqimit të zbërthyer prej sistemit të tretjes thithen prej mureve të zorrëve të holla dhe hyjnë në qarkullimin e gjakut. Sipërfaqja e brendshme e zorrës së hollë mbulohet me zgjatje të vogla të quajtur 'villus'. Në majë të qelizave mbi villus janë zgjatjet

mikroskopike të quajtur mikrovillus. Këto zgjatje funksionojnë si pompa për të thithur ushqimin. Në këtë mënyrë ushqimi i absorbuar prej këtyre pompave shpërndahet në tërë organizmin me anë të sistemit qarkullues.

Ajo që meriton vëmendjen tonë këtu është se evolucioni nuk mundet assesi të shpjegojë sistemin e shprehur shkurtimisht më heret. Sipas evolucionit organizmat e sotëm kompleks kanë evoluar prej qenieve primitive me akumulimin e shkallëzuar të ndryshimeve të vogla strukturore. Mirëpo, siç theksohet qartë, sistemi në stomak nuk ka mundur assesi të formohet hap pas hapi. Mungesa e madje një faktori do të shkaktonte vdekjen e organizmit.

Kur pranohet ushqimi në stomak, lëngjet e stomakut fitojnë aftësinë të zbërthejnë ushqimin si rezultat i një vargu ndryshimesh kimike. Tani, paramendoni një gjallesë në të ashtuquajturin proces evolutiv në trupin e të cilit një transformim i tillë i planifikuar kimik nuk është i mundshëm. Kjo gjallesë e paaftë të fitojë këtë aftësi nuk do të ishte në gjendje të tret ushqimin që e ka ngrënë dhe do të vdiste prej urisë me një masë të patretur të ushqimit në stomakun e saj.

Përveç kësaj, gjatë taitjes së këtij acidi tretës, muret e stomakut duhet në të njëjtën kohë të prodhojnë taitjen e quajtur mukozë. Përndryshe, acidi në stomak do të shkatërronte stomakun. Prandaj, në mënyrë që jeta të vazhdojë, stomaku duhet të taitis të dyja lëngjet (acidin dhe mukozën) në të njëjtën kohë. Kjo tregon se jo një evolucion gradual i rastësishëm por një krijim i vetëdijshëm me të gjitha sistemet e tij duhej, në të vërtetë, të ishte në punë.

Ajo që gjithë kjo tregon është se organizmi njerëzor i përngjan një fabrike gjigante të përbërë prej shumë makinave të vogla që punojnë së bashku në harmoni të përkryer. Po sikurse të gjitha fabrikat kanë një projektues, një inxhinier dhe një planifikues, trupi njerëzor ka një Krijues të Madhërishtëm.

Sistemi skeletor

Skeleti është një mrekulli inxhinierike në vete. Është sistem mbështetës strukturor i organizmit. Ai i mbron organet vitale si truri, zemra dhe mushkëritë dhe mbështet organet e brendshme. Ai pajisë organizmin e njeriut me një aftësi superiore për lëvizje që nuk mund të imitohet prej asnjë mekanizmi artificial. Indi i eshtrave nuk është inorganik/i pajetë siç mendojnë shumica e njerëzve. Indi i eshtrave është një bankë/depozit minerale të trupit që përmbanë shumë minerale të rëndësishme si kalciumi dhe fosfati. Në pajtim me nevojat trupore, ose i depoziton këto minerale ose i shpërndanë këto në organizëm. Përveç gjithë këtyre, eshtrat gjithashtu prodhojnë qelizat e kuqe të gjakut.

Përveç funksionimit të përkryer të pandërprerë të skeletit, eshtrat që e përbëjnë atë kanë gjithashtu një strukturë të jashtëzakonshme. Duke pasur për detyrë mbajtjen dhe mbrojtjen e organizmit, eshtrat janë të krijuara me aftësinë dhe fuqinë për të përmbushur këtë funksion. Edhe rrethanat më të këqija të mundshme janë marrë gjithashtu parasysh. Për shembull, kocka e kofshës mund të bartë një peshë që mund të peshojë një ton në pozicionin vertikal. Çuditërisht, në secilin hap që bëjmë, ashti bartë një peshë të barabartë me tri herë peshën e trupin tonë. Kur një atlet kërcen me purtekë dhe lëshohet në tokë, çdo centimetër katror i kombikut të tij i ekspozohet një presioni prej 1,400 kilogrameëve. Çfarë e bën këtë

strukturë, e cila formohet me anë të ndarjes dhe kopjimit të qelizës së vetme origjinale, aq të fuqishme? Përgjigja në këtë pyetje fshihet në krijimin e pabarazueshëm të eshtrave.

Një shembull prej teknologjisë së sotme do të ishte i dobishëm për të sqaruar më tej këtë çështje. Sistemi i skeleve përdoret në ndërtimin e ndërtesave të gjera dhe të larta. Elementet përkrahëse të konstruksioneve të bëra me këtë teknikë nuk kanë një strukturë monolite/njëcopëshe, por përbëhen prej shumë shufrave të kryqëzuara që formojnë një skele. Me ndihmën e llogaritjeve komplekse që mund të bëhen vetëm me anë të kompjuterëve, do të ishte e mundshme të ndërtohen ura dhe ndërtime industriale më të forta dhe më të lira.

Struktura e brendshme e eshtrave është e ngjashme me atë të sistemit të skeleve që përdoren për ndërtimin e atyre urave dhe kullave. I vetmi dallim i rëndësishëm është se sistemi në eshtra është më i komplikuar dhe më superior në krahasim me ato të projektuara nga njerëzit. Me anë të këtij sistemi, eshtrat janë jashtëzakonisht të fortë dhe prapëseprap mjaft të lehtë për përdorim të rehatshëm nga njerëzit. Po të ishte rasti i kundërt, p.sh., po të ishte brendia e eshtrave e fortë dhe e plotë sikurse pjesa e tyre e jashtme, do të ishte tepër e rëndë që të bartej nga një njeri dhe me lehtësi do të thyhej apo plasaritej nga goditja më e vogël për shkak të strukturës së saj të ngurt dhe të fortë.

Projektimi i përkryer i eshtrave tona na ndihmon që të jetojmë jetën tonë në mënyrë shumë të thjeshtë, të arrijmë të kryejmë madje edhe detyrat më të vështira lehtë pa dhimbje. Një tjetër karakteristikë e strukturës së ashtit është lakueshmëria/fleksibiliteti i saj në pjesë të caktuara të trupit. Pikërisht sikurse që kafazi i krahërorit mbronë organet vitale të trupit si zemrën dhe mushkëritë, ai gjithashtu zgjerohet dhe mblidhet/tkurret për të lejuar ajrin që të hyj dhe dal jashtë mushkërive.

Elasticiteti/përshtatshmëria e eshtrave mund të ndryshojë me kohë. Për shembull, tek femrat, këllqet zgjerohen kah muajt e fundit të shtatzënisë dhe ndahen prej njëra tjetrës. Ky është një detal tejet i rëndësishëm, sepse gjatë lindjes, ky zgjerim lejon që koka e foshnjës të dal nga mitra e nënës pa u shtypur.

Aspektet e mrekullueshme të eshtrave nuk kufizohen me këto. Përveç fleksibilitetit/lakueshmërisë, fortësisë dhe peshës së lehtë të tyre, eshtrat kanë poashtu aftësinë për të riparuar vetveten. Kur një asht të thyhet, njeriut i nevojitet vetëm që ta mbajë këtë asht të vendosur mirë për t'i lejuar që të riparojë vetveten. Siç është e qartë, ky, sikurse të gjitha proceset tjera në organizëm, është një proces tejet kompleks në të cilin bashkëpunojnë me miliona qeliza.

Aftësia lëvizëse e skeletit është një detal tjetër i rëndësishëm për ta marrë parasysh. Në secilin hap që bëjmë, rruazat kurrizore që përbëjnë shtyllën tonë kurrizore lëvizin mbi njëra tjetrën. Kjo lëvizje dhe fërkim i vazhdueshëm normalisht mund të shkaktojë që rruazat kurrizore të hahen/konsumohen. Për të parandaluar këtë, në mes të secilës rruazë, kërcet rezistente, të quajtura 'disqe', janë të vendosura. Këto disqe funksionojnë si absorbues të goditjes/amortizues. Në secilin hap, një forcë imponohet nga toka në organizëm si reaksion ndaj peshës trupore. Kjo forcë nuk i shkakton ndonjë dëm trupit për shkak të amortizuesve të shtyllës kurrizore dhe formës së lakuar "të shpërndarjes së forcës" së saj. Po të mos ekzistonte kjo lakueshmëri dhe përbërje speciale që zvoglon forcën e reaksionit, forca e

liruar do të transmetohej drejtpërdrejt në kafkë dhe maja e shpinës do të depërtonte në tru duke e shkatërruar kafkën.

Gjurmët e krijimit janë gjithashtu të dukshme në sipërfaqet e kyçeve të eshtrave. Kyçet nuk kanë nevojë të lubrifikohen/vajosen edhe pse lëvizin pandërprerë një jetë të tërë. Biologët bënë hulumtime për të gjetur arsyen: si eliminohet fërkimi në kyçe?

Shkencëtarët vërejtën se kjo u zgjodh me anë të një sistemi që mund të konsiderohet si një “mrekulli absolute e krijimit”. Sipërfaqet e kyçeve të ekspozuara fërkimit janë të mbuluara me një shtresë të hollë poroze të kërcit. Nën këtë shtresë është një masë lubrifikuese/lyrëse. Kurdoherë që ashti shtyp kyçin, ky lubrifikues derdhet me vrull prej poreve dhe bën që sipërfaqja e kyçit të rrëshqas “si në vaj”.

Vetëm paramendoni po të mos ishte gjithçka kaq e përkryer dhe e tërë këmba të ishte formuar prej një ashti të gjatë të vetëm. Atëherë, ecja do të ishte një problem serioz dhe do të kishim trupa shumë të ngathët dhe të plogësht. Madje edhe të uleshim do të ishte vështirë dhe ashti i këmbës lehtësisht do të thyhej për shkak t’i nënshtrohej vështirësive gjatë veprimeve të tilla. Megjithatë, skeleti i njeriut ka një strukturë që lejon të gjitha llojet e lëvizjeve trupore.

Allahu krijoi dhe ende krijon, të gjitha veçoritë e skeletit. Allahu e thërret njeriun, të cilin Ai e ka krijuar, të mendojë për këtë:

...Shiko se si i kombinojmë eshtrat e pastaj i veshim me mish... (Sure Bekare: 259)

Njeriu duhet të mendojë për këtë, të çmoj fuqinë e Allahut, I Cili e ka krijuar atë dhe të jetë falënderues ndaj Tij. Poqese nuk e bën këtë, ai do të jetë në humbje të vërtetë. Allahu, I Cili krijoi eshtrat dhe i veshi ato me mish, është i aftë ta bëjë këtë përsëri. Kjo theksohet në këtë varg:

A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pike uji (fare), kur qe, ai kundërshtar i rreptë. Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: "Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur?" Thuaj: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të pare. Ai posedon dijeni të plotë për çdo krijim. (Sure Ja Sin: 77-79)

Bashkërenditja në organizmin e njeriut

Në organizmin e njeriut, të gjitha sistemet punojnë njëkohësisht në një mënyrë të koordinuar dhe në harmoni të plotë për një qëllim të përcaktuar, domethënë, për të mbajtur organizmin në jetë. Madje edhe lëvizjet më të vogla të cilat i bëjmë çdo ditë, si frymëmarrja apo qeshja, janë rezultat i bashkërenditjes së përkryer në organizmin njerëzor.

Në brendinë tonë është një rrjet tejet i komplikuar dhe i bashkërenditur në mënyrë gjithëpërfshirëse që vepron pa u ndalur fare. Qëllimi është vazhdimësia e të jetuarit. Kjo bashkërenditje është veçanërisht e dukshme në sistemin lëvizës të trupit, sepse, madje edhe për lëvizjen më të vogël, sistemi skeletor, muskujt dhe sistemi nervor duhet të punojnë me një bashkëpunim të përkryer.

Parakusht i bashkërenditjes në organizëm është shpërndarja e saktë e informacionit. Vetëm duke bërë një shpërndarje të saktë të informacionit mund të bëhen vlerësime të reja. Për këtë qëllim, një rrjet tejet i zhvilluar i inteligjencës vepron në organizmin njerëzor.

Për të kryer një veprim të bashkërenditur, së pari, do të duhej të njiheshin organet e përfshira në këtë veprim dhe raportet e tyre. Ky informacion vie prej syve, mekanizmi i barazpeshës në veshin e brendshëm, muskujt, kyçet dhe lëkura. Në çdo sekond, përpunohen me miliarda të dhëna, vlerësohen dhe merren vendime të reja në pajtim me to. Njeriu madje nuk është i vetëdijshëm për proceset që kryhen në organizmin e tij me një shpejtësi marramendëse. Ai vetëm lëvizë, qeshë, qanë, vrapon, han dhe mendon. Nuk shpenzon mund të madh në kryerjen e këtyre veprimeve. Madje edhe për një buzëqeshje të mekur, shtatëmbëdhjetë muskuj duhet të punojnë së bashku në të njëjtën kohë. Mosfunksionimi apo keqfunksionimi i madje njërit prej këtyre muskujve ndryshon shprehjen në fytyrë. Në mënyrë që të jemi në gjendje të ecim, pesëdhjetë e katër muskuj të ndryshëm në shputa, këmbë, ije dhe shpinë duhet të bashkëpunojnë.

Ekzistojnë me miliarda receptorë mikroskopik në muskujt dhe kyçe, që japin informacion në lidhje me gjendjen ekzistuese të trupit. Mesazhet që vijnë prej këtyre receptorëve arrijnë sistemin qendror nervor dhe urdhëra të rinjë dërgohen tek muskujt në pajtim me vlerësimet e bëra.

Përsosmëria e bashkërenditjes së trupit do të kuptohet më mirë me shembullin vijues. Vetëm për të ngritur dorën, shpatulla duhet të kërruset, muskujt e përparmë dhe të pasëm të dorës – të quajtur “triceps” dhe “biceps” – duhet të mblidhen dhe të lëshohen dhe muskujt në mes të bërrylit dhe kyçit të dorës duhet ta përdredhin kyçin e dorës. Në secilën pjesë të veprimit, me miliona receptorë në muskuj pasojnë informacionin menjëherë në sistemin qendror nervor për pozicionin e muskujve. Pastaj, sistemi qendror nervor u tregon muskujve atë që duhet të bëjnë në hapin e ardhshëm. Natyrisht se njeriu nuk është i vetëdijshëm për cilëndo prej këtyre proceseve, por vetëm dëshiron ta ngritë dorën e tij dhe e bën atë menjëherë.

Për shembull, për të mbajtur trupin tuaj drejtë, të dhëna të shumta që vijnë prej miliarda receptorëve në muskujt e këmbës, shputave, shpinës, stomakut, gjoksit dhe qafës suaj vlerësohen dhe një numër i ngjashëm i urdhërave u japin muskuve në çdo sekond.

Nuk shpenzojmë mund të madh as për të folur. Njeriu kurrë nuk mendon se sa larg njëra tjetrës duhet të jenë kordet zanore, sa shpesh do të duhej të dridhen ato, në çfarë sekuece, sa shpesh dhe cilët prej qindra muskujve të gojës, gjuhës dhe fytit do të duhej të mblidheshin dhe çlodheshin. As që llogaritë se sa centimetra kub ajër do të duhej të merrej në mushkëri dhe sa shpejtë dhe sa shpesh ky ajër do të duhej të nxjerrej jashtë. Këtë s’do të mund ta bënim madje edhe po të dëshironim! Madje edhe një fjalë e vetme e shqiptuar nga goja, është rezultat i funksionimi të përbashkët të shumë sistemeve që shtrihen prej sistemit të frymëmarrjes së njeriut e deri te sistemi nervor, prej muskujve deri te eshtrat.

Çfarë ndodhë në rast se shfaqet ndonjë problem në këtë bashkërenditje? Shprehje të ndryshme do të mund të shfaqeshin në fytyrat tuaja kur ne duam të buzëqeshim apo nuk do të ishim në gjendje të flasim apo të ecim kur ne dëshirojmë. Megjithatë, mund të qeshemi, të flasim, të ecim kurdoherë që dëshirojmë dhe asnjë problem nuk shfaqet, sepse gjithçka që

përmendëm këtu përmbushet si pasojë e faktit të Krijimit i cili logjikisht kërkon “fuqi dhe mençuri të pafund”.

Për këtë arsye, njeriu duhet gjithnjë të mbaj mend se qenien dhe jetën e tij ia ka borxh Krijuesit të tij, Allahut. Njeriu nuk ka pse të jetë mendjemadh apo të mburret për asgjë. Shëndeti, bukuria apo fuqia e tij nuk janë vepër e tij dhe nuk i janë dhënë atij përjetësisht. Ai padyshim se do të plakët dhe do të humbas shëndetin dhe bukurinë e tij. Në Kur'an, kjo shprehet kështu:

Dhe çdo gjë që u është dhënë juve është kënaqësi dhe shije e kësaj bote, ndërsa ajo që është te Allahu (thevabi) është shumë më e mirë dhe e përhershme, pra, a nuk mendoni? (Sure Kasas: 60)

Nëse një person dëshiron të fitojë veti shumë më superiore se këto, përjetësisht në ahiret, ai duhet t'i jetë mirënjohës Allahut për mirësitë që Ai ia ka dhuruar atij dhe ta jetojë jetën e tij në pajtim me urdhërat e Tij.

Siç shihet në këta shembuj, të gjitha organet dhe sistemet në organizmin njerëzor bartin karakteristika “të mrekullueshme”. Po të analizohen këto karakteristika, njeriu do të shoh se në çfarë barazpesha të brishta varet ekzistenca e tij dhe mrekullitë e krijimit të tij dhe do të fillojë të kuptojë edhe një herë veprën madhështore të Allahut siç tregohet me shembullin e njeriut.

SHTAZËT DHE BIMËT

Me miliona lloje të shtazëve dhe bimëve të pranishme në botë shquhen si prova që dëshmojnë ekzistencën dhe fuqinë e Krijuesit tonë.

Të gjitha këto gjallesa, një numër i kufizuar i të cilave do të përshkruhen si shembuj këtu, meritojnë të ekzaminohen veçan. Ato të gjitha kanë sisteme trupore të ndryshme, taktika të ndryshme mbrojtjeje, mënyra unike të të ushqyerit dhe mënyra interesante të riprodhimit. Fatkeqësisht, nuk është e mundur të përshkruhen të gjitha gjallesat me të gjitha veçoritë e tyre në një libër të vetëm. Enciklopedi me shumë vëllime nuk do të mjaftonin për të përmbushur këtë detyrë.

Megjithatë, madje edhe disa shembuj për të cilët do të bëjmë fjalë këtu do të mjaftojnë të dëshmojnë se jeta në tokë nuk mundet asesi të shpjegohet me anë të rastësive apo ndodhive të rastësishme.

PREJ LARVËS DERI TE FLUTURA

Po të kishit 450-500 vezë dhe po t'ju duhej t'i ruani ato jashtë, çfarë do të bënit? Mënyra më e mençur për ju do të ishte që të ndërmerri masa paraprake për të parandaluar që ato t' mos shpërndahen gjithandej, të themi, nga era apo faktorë të tjerë të mjedisit. Duke qenë prej insekteve që bëjnë më së shumti vezë njëkohësisht (450-500), krimbat e mëndafshit përdorin një mënyrë shumë inteligjente për të mbrojtur vezët e tyre: ato i bashkojnë vezët me një substancë të trashë ngjitëse/viskoze (fije/pe) që ato tajitin për të parandaluar që ato të shpërndahen gjithandej.

Larvat të cilat dalin prej vezëve të tyre së pari e gjejnë një degë të sigurtë për vete dhe pastaj lidhen për atë degë me të njëjtën fije. Më vonë, për të kaluar në një shkallë më të lartë të zhvillimit të tyre, ato fillojnë të tjerrin një fshikëz për vete me fijen/perin që ato tajitin. Nevojiten 3-4 ditë që një larvë e cila ka parë jetën me sy së voni për të përfunduar këtë proces. Gjatë kësaj periudhe, larva bën me mija rrotullime dhe prodhon një fije të një mesatareje prej 900 – 1,500 metra të gjatë. 14 Në fund të këtij procesi, fillon një detyrë të re përmes së cilës i nënshtrohet një metamorfoze për t’u shndërruar në një flutur elegante.

As veprimi i ndërmarr nga nëna krimb i mëndafshit për të mbrojtur vezët e saj, as sjellja e një larve të vogël që i mungon çfarëdo vetëdije, arsimimi apo dijenie nuk mund të shpjegohet me anë të evolucionit. Pikësëpari, aftësia e nënës për të prodhuar fijen që ajo përdor për të siguruar vezët është e mrekullueshme. Njohja e mjedisit më të përshtatshëm për vete nga ana e larvës së porsalindur, thurja e fshikëzës nga ana e saj në pajtim me të, të nënshtroarit e saj një metamorfoze dhe arritja e kësaj metamorfoze pa kurrfarë problemi tejkalojnë të kuptuarit njerëzor. Prandaj, ne thjeshtë mund të themi se çdo larvë vie në jetë me një paradijeni për atë se çfarë të bëj, që domethënë se asaj iu ‘mësuan’ të gjitha këto gjëra para se të lindte.

Le ta shpjegojmë këtë me një shembull. Çfarë do të mendonit po të shihnit një foshnje të porsalindur që do të ngritej në këmbë disa orë pas lindjes së saj, që do të mbledhte gjërat që i nevojiten për të mbaruar shtratin e saj (si jorganin, jastëkun, dyshekun) dhe që pastaj do t’i vendoste të gjitha këto me mjeshtëri, që do ta rregullonte shtratin e saj dhe të shtrihej në të? Pasi që të vinit në vete prej tronditjes që do të shkaktonte kjo ndodhi, me siguri se do të mendonit se foshnja duhet të jetë mësuar në një mënyrë të jashtëzakonshme në mitrën e nënës së saj për të kryer një proces të tillë. Rasti i larvave nuk ndryshon prej atij të foshnjës në këtë shembull.

Kjo prap na shpie deri te përfundimet e njëjta: këto krijesa të gjalla vijnë në jetë, sillen dhe jetojnë në mënyrën e përcaktuar prej Allahut I Cili i ka krijuar ata. Vargu Kur’anor që thekson se Allahu ka frymëzuar bletën dhe e ka urdhëruar atë të bëj mjaltë (Sure Nahl: 68-69) na jap një shembull të fshehtësisë madhështore të botës së qenieve të gjalla. Kjo fshehtësi është se të gjitha qeniet e gjalla i janë përrulur vullnetit të Allahut dhe e ndjekin fatin e përcaktuar prej Tij. Për këtë arsye bleta bën mjaltë dhe krimbi i mëndafshit prodhon mëndafsh.

SIMETRIA E KRAHËVE

Kur i vështroni krahët e fluturës në fotografi, shohim që një simetri e përkryer mbisundon në to. Këta krahë të larmishëm janë aq të zbukuruar me motive, pika dhe ngjyra sa që secila prej tyre është si një vepër arti.

Kur i vështroni krahët e këtyre fluturave, do të vëreni se modelet dhe ngjyrat në të dyja anët janë plotësisht identike, pa marrë parasysh se sa të ndërlikuara mund të duken ato. Madje edhe pika më e vogël është e pranishme në të dy krahët, duke paraqitur në këtë mënyrë një simetri dhe rregull të përkryer.

Përveç kësaj, asnjëra prej ngjyrave në këta krahë të hollë nuk përzihen me njëra tjetrën, secila duke qenë e ndarë në mënyrë të theksuar prej tjetrës. Në të vërtetë, këto ngjyra formohen me anë të grumbullimit të luspave të vogla të grumbulluara njëra mbi

tjetrën. A nuk është e mrekullueshme se si këto luspa të vogla që lehtësisht zhdaraviten me prekjen më të lehtë të dorës suaj të mund të rradhiten në të dy krahët pa asnjë gabim në dispozicion të tyre ashtu që të prodhojnë saktësisht modelin e njëjtë. Zhvendosja e madje një luspe të vetme do të shkatërronte simetrinë e krahëve dhe të dëmtonte estetikën e tyre. Megjithatë, kurrë nuk shihni ndonjë çrregullim në krahët e cilësdo flutur në tokë. Ato janë aq të rregullta dhe elegante sikur të ishin punuar prej një artisti. Dhe ato me të vërtetë janë punuar prej një Krijuesi të Madhërishëm.

KAFSHA ME QAFËN MË TË GJATË: GJIRAFI

Gjirafat kanë karakteristika të shumta mahnitëse. Njëra prej këtyre është se qafa e tyre qëndron në shtatë rruaza të shpinës, mu sikurse te të gjithë gjitarët tjerë, edhe pse ajo është aq e gjatë. Një fakt tjetër mahnitës për gjirafat është se ato nuk kanë kurrfarë problemi që të pompojnë gjakun në trurin e tyre në maje të qafës së tyre të gjatë. Pak të menduar do ta bënte njeriun të vërejë se sa e vështirë duhet të jetë që gjaku të pompohet aq lartë. Por gjirafat nuk kanë kurrfarë problemi në lidhje me këtë, sepse zemrat e tyre janë të pajisura me tipare për të pompuar gjakun aq lart sa është e nevojshme. Kjo iu mundëson atyre që të vazhdojnë të jetojnë në mënyrë të pamundimshme.

Sidoqoftë, ato ndeshen me një problem tjetër gjersa pijnë ujë. Në thelb, gjirafat do të duhej të vdisnin prej shtypjes së lartë sa herë që përkulen për të pirë ujë. Mirëpo, sistemi i përkryer në qafat e tyre eliminon krejtësisht këtë rrezik. Kur ato përkulen, valvulat në enët e qafave të tyre mbyllen dhe ato ndalojnë gjakun e tepërt që të rrjedhë në tru.

Nuk ka dyshim se gjirafat nuk i kanë fituar këto veçori duke i planifikuar ato në pajtim me nevojat e tyre. Është madje edhe më e papranueshme të themi se gjithë këto veçori vitale u formuan me kalimin e kohës përmes një procesi të shkallëzuar evolutiv. Që një gjirafë të mbetet gjallë, është thelbësore për të të ketë një sistem pompimi për të bartur gjakun në tru dhe një sistem valvulash për të ndaluar shtypjen e lartë të gjakut në atë moment që ajo të përkulet. Po të mos ekzistonte madje edhe vetëm një prej këtyre karakteristikave apo po të mos funksiononte si duhet, atëherë do të ishte e pamundshme për gjirafën që të vazhdonte të jetojë.

Përfundimi që mund të nxjerrim prej gjithë kësaj është se specia e gjirafës erdh në jetë me të gjitha karakteristikat jetike për të jetuarit e saj. Është e pamundshme për një qenie të paqenë të zotëroj trupin e saj dhe të fitojë veçoritë thelbësore në mënyrë të ndërgjegjshme. Pra, gjirafat dëshmojnë në mënyrë të padiskutueshme se janë krijuar përmes një krijimi të ndërgjegjshëm, domethënë prej Allahut.

BRESHKAT E DETIT

Breshkat e detit që jetojnë në oqeane nxitojnë në turma drejt bregdetit kur vie koha që të shumohen. Mirëpo, ky nuk është një bregdet i zakonshëm. Bregdeti tek i cili arrijnë ato për t'u shumuar duhet të jetë ai ku ato kanë lindur. 15

Nganjëherë breshkat e detit duhet të udhëtojnë edhe 800 kilometra për të arritur atje. Por udhëtimi i gjatë dhe i vështirë nuk e ndryshon situatën. Ato arrijnë në bregdetin ku kanë lindur për të sjellë në jetë pasardhësit e tyre, pa marrë parasysh rrethanat.

Është plotësisht e pashpjegueshme se si një qenie e gjallë mund të gjej rrugën e kthimit pikërisht tek bregdeti i njëjtë 20-25 vite pas largimit të saj prej atje. 16

Edhe më e jashtëzakonshme është se mund të gjejë drejtimin e vendit të vet të lindjes në thellësitë e oqeanit ku aq pak dritë depërton dhe pastaj ta dallojë atë në mesin e bregdeteve të shumta të ngjashme.

Më në fund, me mijëra udhëtarë pa kompas takohen në të njëjtin bregdet në të njëjtën kohë. Fillimisht një misterie, arsyet që përbëjnë themelin e këtij takimi këmbëngulës erdhën si një befasi e madhe kur u zbuluan përfundimisht. Pasiqë breshkat e dijnë se pasardhësit e tyre nuk mund të mbijetojnë në kushtet e detit, ato i propozojnë vezët e tyre nën rërë në bregdet. Por pse të gjitha ato takohen në të njëjtin bregdet, në të njëjtën kohë? A nuk do të mbijetonin zogjtë e çelur po ta bënin të njëjtën gjë në kohëra të ndryshme dhe në bregdete të ndryshme? Ata që bënë hulumtime në lidhje me këtë çështje u ndeshën me një situatë shumë interesante. Mijëra pasardhës nën rërë duhet të kapërcejnë një numër pengesash të vështira pas thyerjes së vezëve të tyre me xhungën e fortë në kokën e tyre. Të vegjëlit me një mesatare të peshës prej 31 gramësh nuk mund ta gërmojnë shtresën e tokës mbi to vet dhe ata të gjithë e ndihmojnë njëri tjetrin. Kur mijëra të vegjël në bregdet fillojnë të gërmojnë tokën, ata ia dalin të arrijnë në sipërfaqe të rërës brenda disa ditëve. Mirëpo, para se të dalin në sipërfaqe, presin pak për të rënë muzgu. Sepse gjatë ditës, ekziston rreziku që të bijnë pre e grabitësve. Veç kësaj, do të ishte fare e vështirë për ta që të lëvizin duke u zvarritur në rërën e përcëlluar nga drita e diellit. Kur të bie nata, ata ngjiten në sipërfaqe pas përfundimit të procesit të gërmimit. Edhe pse është errësirë, ata nxitojnë drejt detit dhe largohen prej bregut të detit për t'u kthyer atje përafërsisht pas 20-25 vite më vonë.

Është e pamundur që këta të vegjël të dijnë se duhet të gërmojnë për t'u ngjitur në sipërfaqe pasi që dalin prej vezëve të tyre dhe të presin një kohë në një largësi të caktuar prej detit. Assesi nuk është e mundur që ata të dijnë, kur janë ende të propozuar në rërë, nëse është ditë apo natë, se grabitqarët ekzistojnë jashtë dhe se ata do të mund të binin pre e tyre, se rëra është përcëlluese për shkak të diellit, se kjo do të mund t'ju shkaktonte dëm atyre dhe se ata duhet të nxitojnë për në det. Pra, si ndodh kjo sjellje e ndërjegjshme?

E vetmja përgjigje në këtë pyetje është se këta të vegjël janë 'programuar' disi të sillen në këtë mënyrë, që domethënë se Krijuesi i tyre ka frymëzuar tek ta instinktin që iu ndihmon të mbrojnë jetërat e tyre.

BRUMBULLI BOMBARDUES

Brumbulli bombardues është një insekt për të cilin është bërë një sasi enorme e hulumtimit. Veçoria që e bën këtë insekt aq të njohur është se ai përdor metoda kimike për të mbrojtur veten prej armiqëve të tij.

Në momente kur i kanoset rreziku, insekti nxjerr çurg peroksidin e hidrogjenit dhe hidrokinonin e depozituar në trupin e tij në drejtim të armikut për ta mbrojtur veten. Para betejës, struktura të specializuara të quajtura lobet tajitëse bëjnë një përzierje shumë të koncentruar të këtyre dy materieve kimike. Përzierja e depozituar në një ndarje të veçantë të quajtur ndarja depozituese. Kjo ndarje është e lidhur me një tjetër të quajtur ndarja e shpërthimit. Të dy ndarjet mbahen të veçuara prej njëra tjetrës me anë të një muskuli shtërngues/unazor. Atë moment që insekti ndjen rrezik, shtërngon muskulin që e rrethon

ndarjen depozituese derisa njëkohësisht liron muskulin unazor dhe materia kimike në ndarjen depozituese bartet në ndarjen e shpërthimit. Një sasi e madhe e nxehtësisë lirohet dhe vie te një avullim. Avulli i liruuar dhe gazi i oksigjenit bëjnë presion në muret e ndarjes së shpërthimit dhe kjo materie kimike lëshohet çurg në armikun përmes një kanali i cili shpie jashtë trupit të brumbullit. 17

Ende është një fshehtësi e madhe për hulumtuesit se si një insekt mund të mbajë brenda vetes një sistem të fuqishëm që është aq i fortë sa të nxitë një reagim kimik që lehtë mund t'i shkaktojë dëm ndërkohë që izolon vetveten nga efektet e atij sistemi. Padyshim, ekzistenca dhe funksionimi i këtij sistemi janë tejet të komplikuar që t'i mveshen vet insektit. Ende mbetet çështje diskutuese ajo se si brumbulli bombardues bën që një sistem i tillë të funksionojë në trupin e tij të vogël prej vetem rreth dy centimetra gjatësi, kur ekspertët njerëzor mund ta kryejnë atë vetëm në laboratore.

E vetmja e vërtetë e qartë këtu është se ky insekt është një shembull konkret që plotësisht hedh poshtë teorinë e evolucionit, sepse është e pamundshme që ky sistem kompleks kimik të jetë formuar përmes një vargu ndryshimesh të rastësishme dhe të jetë bartur në gjeneratat e ardhshme. Madje edhe vetëm një mungesë apo 'defekt' më i vogël në një pjesë të vetme të sistemit do ta lënte insektin të pambrojtur, ashtuqë së shpejti do të vritej apo do të bënte që të pëlciste. Prandaj, i vetmi shpjegim është se arma kimike në organizmin e insektit është krijuar me të gjitha pjesët e saj përnjëherë dhe pa asnjë defekt.

Foletë e termiteve

Askush nuk mund të mos çuditet kur shikon folenë e termiteve të ngritur mbi tokë. Kjo sepse foletë e termiteve janë mrekulli arkitekturale që arrijnë deri në 5–6 metra lartësi.

Kur krahasojmë madhësinë e termiteve me atë të folesë së tyre, shohim se ato ia dalin të realizojnë me sukses një projekt arkitektural me madhësi 300 herë më të madh sesa përmasat e tyre. Por ajo që është madje edhe më mahnitëse është se termitet janë të verbëra.

Një person që kurrë nuk i ka parë foletë gjigante të ndërtuara prej termiteve të verbëra me siguri se do të mendonte se ato janë ndërtuar prej grumbujve të rërës të vendosur mbi njëri tjetrin. Mirëpo, një fole e termiteve dëshmon të jetë një projektim i mrekullueshëm i pakapshëm për mendjen njerëzore: brenda saj ekzistojnë tunele ndërlidhëse, korridore, sisteme ventilimi, kantiere të posaçme për prodhimin e këpurdhave dhe dalje sigurie.

Po të mbledhni me mijëra njerëz të verbër dhe t'u jipnit të gjitha llojet e pajisjeve teknike, kurrë s'do të mund t'i bënit të ndërtojnë një fole të ngjashme me atë të bërë prej kolonisë së termiteve. Pra, vetëm mendoni:

- Si mundet një termit me gjatësi prej 1-2 cm. të ketë mësuar informacionin arkitektural dhe inxhinierik që nevojitet për të ndërtuar një konstruksion aq delikat?

- Si mundën mijëra termit të verbëra të arrijnë të punojnë në harmoni për të ndërtuar këtë konstruksion i cili është një mrekulli artistike?

- Nëse e ndani një fole të termiteve në dy pjesë gjatë etapave të para të ndërtimit të saj dhe pastaj i ribashkoni ato, do të shihni se të gjitha korridoret, kanalet dhe rrugët përputhen me njëra tjetrën. Si mund të shpjegohet kjo ngjarje e mrekullueshme

Përfundimi që mund të nxjerrim prej këtij shembulli është se Allahu ka krijuar të gjitha qeniet e gjalla në mënyrë unike dhe pa asnjë shembull të mëparshëm. Madje edhe një

fole e termiteve mjafton për një person për të kuptuar Allahun dhe të besojë se Ai është I Cili krijoi gjithçka.

Qukapiku

Siç e dimë të gjithë, qukapikët ndërtojnë foletë e tyre duke shpuar trungjet e pemëve me sqepat e tyre. Kjo mund të tingëlloj si një gjë që shumica e njerëzve e dinë. Por, gjëja që shumë njerëz nuk e vënë re është fakti se si është e mundur që qukapikët nuk pësojnë hemoragji/gjakderdhje në tru, për shkak të goditjeve të forta në pemë. Ajo që qukapiku bën është në një mënyrë e ngjashme me ngulitjen e gozhdës në mur prej një njeriu me kokë. Poqese njeriu do të mundohej të bënte një gjë të tillë, me siguri do të pësonte tronditje në tru të përcjellur me gjakderdhje. Por qukapiku mund të godas një trung të fortë me sqep 38–43 herë brenda dy apo tre sekondave dhe të mos i ndodhë absolutisht asgjë.

Nuk ndodhë asgjë sepse struktura e kokës së qukapikut është krijuar e tillë që ta përballojë me sukses këtë punë. Kafka e qukapikut ka një sistem të mrekullueshëm amortizimi që redukton dhe amortizon forcën e goditjeve. Pjesa e përparme e kafkës së tij dhe disa muskuj të kafkës që kufizohen me sqepin dhe vend bashkimit e nofullës së tij janë aq të fuqishme sa e ndihmojnë zbutjen e efektit të goditjeve të fuqishme gjatë çukitjes. 19

Projektimi dhe planifikimi nuk përfundon me këtë. Pasiqë kryesisht preferojnë drurët e pishave, qukapikët kontrollojnë moshën e drurëve para se të fillojnë të shpojnë në to dhe i zgjedhin ato që janë mbi moshën 100 vjeçare, sepse drurët e pishave mbi 100 vjeçare vuajnë një sëmundje që bën që lëvorja e fortë dhe e trashë të zbutet. Kjo u zbulua vetëm tash së voni nga shkenca dhe ndoshta ju do të lexoni për këtë për herë të parë në jetën tuaj; qukapikët e kanë ditur këtë me shekuj të tërë.

Kjo nuk është arsyeja e vetme pse qukapikët preferojnë drurët e pishave. Qukapikët shpojnë zgavrat rreth foleve të tyre, roli i të cilave nuk është kuptuar fillimisht. Më vonë u kuptua se këto zgavra çelen për t'i mbrojtur ata prej një rreziku të madh. Me kalimin e kohës, rrëshira ngjitëse që rrjedhë prej drurëve të pishës mbush zgavrat dhe avanpost/posti i përparëm i folesë së qukapikut kështu mbushet me një pellg përmes së cilit qukapikët mund të mbrohen prej gjarpërinjëve, armiqëve të tyre më të mëdhenjë.

Një tjetër veçori e qukapikëve është se gjuhët e tyre janë mjaft të holla për të depërtuar madje edhe në foletë e milingonave në drunjë. Gjuhët e tyre janë gjithashtu ngjitëse, gjë e cila ju mundëson atyre të mbledhin milingonat që jetojnë aty. Përsosmëria e krijimit të tyre më tej zbulohet nga fakti se gjuhët e tyre kanë një strukturë e cila i parandalon ata prej dëmtimit nga thartira në organizmat e milingonave. 20

Qukapikët, secila karakteristikë e të cilëve është diskutuar në një paragraf tjetër më lartë, dëshmojnë me të gjitha tiparet e tyre të detajuara se ata janë 'krijuar'. Po të kishin evoluar në mënyrë të rastësishme siç pretendon teoria e evolucionit, ata do të vdisnin para se të fitonin aso tipare jashtëzakonisht të qëndrueshme dhe do të zhdukeshin. Megjithatë, pasiqë janë krijuar nga Allahu me një 'projektim' të posaçëm të përshtatshëm për jetën e tyre, ata filluan jetërat e tyre duke bartur të gjitha karakteristikat jetike.

MASKIMI

Një prej strategjive mbrojtëse të kafshëve është arti i maskimit. Disa kafshë kanë mbrojtjen e posaçme të një strukture trupore dhe ngjyrimi i cili i është përshtatur tërësisht vendbanimit të tyre. Organizmat e këtyre gjallesave janë aq të harmonishëm me mjedisin e tyre sa që kur i vështroni fotografitë e tyre, nuk mund të dalloni nëse janë bimë apo kafshë apo t'i dalloni prej mjedisit që i rrethon.

Siç do të shihet në faqet vijuese, ngjashmëria e pabesueshme e një insekti me një gjethë që e ndihmon atë t'i shmanget vëmendjes së armiqëve të tij. Është e qartë se kjo kafshë e vogël nuk ka bërë që trupi i saj të duket si një gjethë. Ndoshta nuk është madje e vetëdijshme se mbrohet sepse duket si një gjethë. Megjithatë, maskimi është aq i shkathët sa që shquhet lehtë si një taktikë mbrojtëse e planifikuar posaçërisht dhe 'e krijuar'.

SYTË E RREJSHËM

Ekzistojnë disa metoda të pabesueshme dhe paimagjinueshëm interesante të mbrojtjes në botën shtazore. Njëra prej këtyre është sytë e rrejshëm. Me sy të tillë të rrejshëm, lloje të ndryshme të fluturave, larvave dhe peshqëve i bindin armiqët e tyre se janë të 'rrezikshëm'.

Fluturat në fotografinë në anën e majtë hapin krahët e tyre posa ndjejnë rrezik dhe shfaqin një palë sy në të dy krahët e tyre që duken mjaft kërcënues për armiqët e tyre.

Le të mendojmë: a mundën këta sy tejet bindës të jenë rezultat i një rastësie? Si e din flutura se një palë sy të frikshëm shfaqen kur ajo hap krahët e saj dhe se kjo pamje do të frikësonte armikun e saj? A mos ndoshta flutura e ka parë këtë motiv në krahët e saj dhe ka vendosur se ky motiv është i frikshëm dhe se do të mund ta përdorte në një moment rreziku?

Një motiv i tillë bindës mund të jetë vetëm rezultat i një projektimi të ndërgjegjshëm, jo i rastësive. Veç kësaj, nuk është asses i mundur të mendohet se flutura është e vetëdijshme për motivet në krahët e saj dhe se ka zbuluar këtë si një taktikë mbrojtëse për veten e saj. Është e qartë se Allahu, I Cili e krijoi fluturën, i dhuroi trupit të saj një motiv të tillë dhe e frymëzoi në insekt instinktin për ta përdorur atë në momente të shfaqjes së rrezikut.

ZAMBAKËT E UJIT

Lulet e vogla në tokë kryesisht konsiderohen një gjë e zakonshme nga njerëzit, pavarësisht nga përsosmëria e tyre e përgjithshme. Ajo që i ndalon njerëzit që të kuptojnë mrekullitë e krijimit në këto lule është njohja e shkaktuar duke i parë ato gjithkund dhe çdo ditë. Prandaj, lulet që rriten në një vend krejtësisht tjetër, nën rrethana krejtësisht tjera dhe në madhësi krejtësisht të ndryshme do të vlerësohen pa 'syzet e njohjes/intimitetit' dhe kështu do t'na ndihmojnë të kuptojmë ekzistencën e Allahut.

Zambakët e ujit të Amazonit që rriten në baltën ngjitëse që mbulon fundin e lumit Amazon janë mjaft interesante për të hequr 'syzet e njohjes/intimitetit' prej njerëzve, sepse ato vazhdojnë t'i jetojnë jetërat e tyre jo në mënyrën me të cilën njerëzit janë të mësuar dhe që e shohin çdo ditë, por me një përpjekje shumë më të ndryshme.

Këto bimë fillojnë të rriten në baltë në fund të lumit Amazon dhe pastaj zgjaten drejt sipërfaqes së lumit. Qëllimi i tyre është që të arrijnë dritën e diellit e cila është thelbësore për ekzistencën e tyre. Kur ato përfundimisht arrijnë sipërfaqen e ujit, ndalojnë të rriten dhe zhvillojnë sytha gjembor të rrumbullakët. Sythat zhvillohen në gjethe gjigante me një shtrirje prej dy metrash për një kohë të shkurtër prej disa orëve. 'Duke e ditur' se sa më shumë që e mbulojnë sipërfaqen e lumit me gjethe të bollshme, aq më shumë do të jenë në gjendje të shfrytëzojnë dritën e diellit, këta zambak të ujit e shfrytëzojnë dritën e diellit deri në maksimum për të kryer fotosintezën. Ata 'e dinë' se përndryshe nuk do të jenë në gjendje që të mbijetojnë në fund të lumit për shkak të mungesës së dritës. Padyshim se është fare frymëzuese që një bimë të përdor një taktikë aq 'inteligjente'.

Megjithatë, vetëm drita e diellit nuk iu mjafton zambakëve të ujit të Amazonit. Ata kanë poashtu nevojë të njëjtë për oksigjen, por është e qartë se ky oksigjen nuk ekziston në një terren me baltë në të cilin rrënjët e tyre janë të vendosura. Kjo është arsyeja pse zambakët e ujit zgjasin kërcëjt e tyre që zhvillohen prej rrënjëve të tyre lart në drejtim të sipërfaqes së ujit ku gjethet e tyre qëndrojnë mbi ujë. Nganjëherë këta kërcëj rriten deri në 11 metra; ata lidhen për gjethe dhe funksionojnë si bartës të oksigjenit në mes të gjetheve dhe rrënjëve. 21

Si mundet që një syth në fazat e tij fillestare të jetës në thellësitë e një lumi të dijë se i nevojitet oksigjeni dhe drita e diellit për të mbijetuar, se nuk do të mund të jetojë pa to dhe se gjithçka që i nevojitet është e pranishme në sipërfaqen e ujit? Një qenie rishtazi e njohur me jetën nuk është e vetëdijshme as për faktin se ky ujë ka një pikë në të cilën përfundon, dhe as për ekzistencën e diellit apo të oksigjenit.

Prandaj, nëse e tërë kjo ngjarje vlerësohet nga këndvështrimi i evolucionistëve, këto bimë shumë kohë më parë do të duhej të kishin pësuar disfatë nga kushtet e mjedisit dhe do të zhdukeshin. Sidoqoftë, zambakët e ujit janë ende të pranishëm sot me gjithë përsosmërinë e tyre.

Lufta e pabesueshme për të mbijetuar e zambakëve të ujit vazhdon edhe pasi që ato të arrijnë dritën dhe oksigjenin në sipërfaqen e ujit, ku ato përdredhin përpjetë buzët e gjetheve të tyre gjigante për të parandaluar që ato të fundosen.

Ato mund të vazhdojnë jetërat e tyre me të gjitha këto masa paraprake, mirëpo ato poashtu nuk e dinë se këto nuk janë të mjaftueshme për riprodhimin e tyre. Ato kanë nevojë për një gjallesë që do ta bartë polenin e tyre tek një zambak tjetër uji dhe kjo gjallesë është brumbulli (koleopteran) i cili është krijuar me një dobësi të veçantë për ngjyrën e bardhë. Ata i preferojnë këta zambakë të bardhë uji prej të gjitha luleve tërheqëse të lumit Amazon. Kur vizitohen zambakët e ujit të Amazonit prej krijesave të cilat do të vazhdojnë llojin e tyre, ato i mbyllin të gjitha gjethet e tyre, i burgosin ato dhe iu ofrojnë polen me bollëk. Ato i lirojnë ata pasiqë i mbajnë një natë dhe pastaj e ndryshojnë ngjyrën e tyre në mënyrë që t'mos e sjellin të njëjtin polen prapa tek to. Një herë me ngjyrë të bardhë të kulluar, zambakët madhështor të ujit do të stolisin tani lumin Amazon me ngjyrë trëndafili.

A mundet që plane të tilla të përkryera dhe të llogaritura në mënyrë të përkryer të jenë vepër e një sythi të pandërgjegjshëm për gjithçka? Natyrisht se jo. Ato janë vepër e urtësisë së Allahut, I Cili krijoi gjithçka ekziston. Të gjitha hollësitë e përmbledhura këtu

tregojnë se bimët, sikurse gjitha gjallesat tjera në gjithësi, erdhën në jetë tashmë të pajisura me sistemet më të përshtatshme dhe kjo duke iu falënderuar Krijuesit të tyre.

A MUND TË FORMOHET NJË AEROPLAN PËRMES RASTËSISË?

Fizikani i njohur Sir Fred Hojll bën një vrojtim mahnitës për zanafillën e jetës. Në librin e tij “Gjithësia Inteligjente” ai bën komentin në vazhdim për teorinë e evolucionit e cila pretendon se gjallesat u krijuan rastësisht:

Gjasa që forma më të larta të jetës mund të jenë shfaqur në këtë mënyrë (rastësisht) mund të krahasohet me gjasën që një tornado/uragan që kalon nëpër një depo hedhurinash/rrangullinash të mund të montonte një Boing 747 prej materialeve që gjendjen aty. 22

Ky krahasim i Hojllit është jashtëzakonisht i përshtatshëm. Shembujt për të cilët kemi folur më lartë gjithashtu zbulojnë se të dyja, si ekzistenca e jetës dhe përsosmëria e sistemeve të pranishme të saj na shtyjnë të kërkojmë fuqinë madhështore që bën që ato të krijohen. Sikurse që një tornado/uragan nuk mund të prodhojnë një aeroplan si rezultat i rastësive, poashtu nuk është e mundur që gjithësia të jetë krijuar si rezultat i ndodhive të paparashikueshme dhe veç kësaj të strehoj struktura jashtëzakonisht komplekse brenda vetes. Gjithçka që kemi thënë në këtë kapitull na bën që të ndeshemi me dëshminë e planifikimit të përkryer jo vetëm në mjedisin e atypëratyshëm por gjithashtu edhe në thellësitë e hapësirës. Ai që vlerëson këto argumente të cilat janë aq të qarta sa të jenë të pamohueshme si nga arsyeja ashtu edhe nga ndërgjegjja mund të vie vetëm deri te një përfundim:

Nuk ka vend për rastësi në gjithësi; gjithësia u KRIJUA me të gjitha hollësitë e përfshira në të.

Dhe Allahu, Krijuesi i këtij sistemi të përkryer, është Ai I Cili posedon fuqi dhe dijeni të pafund.

Shkencëtarët vërtetojnë Shenjat/Argumentet e Allahut

Ajo që kemi shtjelluar gjer më tani na tregon se vetitë e gjithësisë të zbuluara prej shkencës tregojnë për ekzistencën e Allahut. Shkenca na shpie në përfundimin se gjithësia ka një Krijues dhe se ky Krijues është i përkryer për nga fuqia, urtësia dhe dijenia. Është feja e cila na tregon udhën e njohjes së Allahut. Prandaj është e mundshme të themi se shkenca është një metodë që ne përdorim për të kuptuar më mirë dhe për të hulumtuar realitetet që adresohen nga feja. Sidoqoftë, sot, disa prej shkencëtarëve që ecin përpara në emër të shkencës marrin një qëndrim krejtësisht të ndryshëm. Sipas pikëpamjes së tyre, zbulimet shkencore nuk nënkuptojnë krijimin e Allahut. Ata, përkundrazi, kanë projektuar një kuptim ateist të shkencës duke thënë se nuk është e mundshme të arrihet Allahu përmes të dhënave shkencore: ata pretendojnë se shkenca dhe feja janë dy nocione që nuk bien ndesh me njëra tjetrën.

Në të vërtetë, ky kuptim ateist i shkencës është shumë i vonshëm. Deri para disa shekujve, shkenca dhe religjioni nuk është menduar kurrë të jenë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe shkenca u pranua si metodë e të dëshmuarit të ekzistencës së Allahut. I ashtuquajturi kuptim ateist i shkencës lulëzoi vetëm pasi filozofitë materialiste dhe pozitiviste përshkuan botën e shkencës në shekujt e 18të dhe 19të.

Në veçanti pasi që Çarlls Darvini postuloi teorinë e evolucionit në vitin 1859, qarqet që mbanin një pikëpamje materialiste për botën filluan që të mbrojnë ideologjikisht këtë teori, të cilën ata e konsideronin si një alternativë ndaj fesë. Sipas teorisë së evolucionit gjithësia nuk ishte krijuar prej një krijuesi por kishte ardhë në jetë rastësisht. Si pasojë, u pohua se feja ishte në kundërshtim me shkencën. Hulumtuesit britanik Majkëll Baigent, Riçard Leigh dhe Henri Linkoln thanë në lidhje me këtë çështje:

Për Isak Njutnin, një shekull e gjysmë para Darvinit, shkenca nuk ishte e ndarë prej religjionit, por, përkundrazi, një aspekt i religjionit dhe përfundimisht i nënshtrohej atij. ...Por shkenca e kohës së Darvinit u bë pikërisht ajo, duke e ndarë veten prej kontekstit në të cilin ekzistonte më parë dhe duke e vendosur veten si një rival absolut, si depo alternative e të kuptuarit. Si pasojë, shkenca dhe religjioni nuk bashkëpunonin më, por më tepër iu kundërvunë njëra tjetrës dhe njerëzimi u shty të zgjedhë në mes tyre. 23

Siç e theksuam më parë, e ashtuquajtura ndarje në mes të shkencës dhe religjionit ishte plotësisht ideologjike. Disa shkencëtarë, të cilët besonin seriozisht në materializëm, kushtëzuan vetveten të dëshmojnë se gjithësia nuk kishte krijuar dhe shpikën teori të ndryshme në lidhje me këtë. Teoria e evolucionit ishte më e famshme dhe më e rëndësishme prej tyre. Në fushën e astronomisë gjithashtu u zhvilluan teori të caktuara si ajo e “gjendjes së qëndrueshme/të pandryshueshme” apo “teoria e kaosit/çrregullsisë”. Mirëpo, të gjitha këto teori që e mohuan krijimin u shkatërruan prej vet shkencës, siç kemi treguar qartë në kapitujt e mëparshëm. Sot, shkencëtarët që ende u qëndrojnë besnik këtyre teorive dhe këmbëngulin në mohimin e çdo gjëje që është fetare, janë njerëz dogmatik dhe fanatik, të cilët i kanë vënë kusht vetvetes që të mos besojnë në Allahun. Zoologu dhe evolucionisti i famshëm anglez D.M.S. Vatson e pranon këtë dogmatizëm kur shpjegon se pse ai dhe kolegët e tij pranojnë teorinë e evolucionit:

Nëse është ashtu, do të paraqet një paralele ndaj vet teorisë së evolucionit, një teori e pranuar botërisht, jo sepse mund të vërtetohet përmes dëshmisë logjike të kuptueshme, por për shkak të alternativës së vetme, krijimi i posaçëm, është qartë i pabesueshëm. 24

Ajo që Vatson nënkupton me “krijimin e posaçëm” është krijimi i Allahut. Siç pranohet, ky shkencëtar e konsideron si “të papranueshëm”. Por pse? A është për shkak se shkenca thot ashtu? Në të vërtetë ajo nuk thot. Përkundrazi, shkenca e vërteton të vërtetën e krijimit. E vetmja arsye pse Vatson e konsideron këtë fakt si të papranueshëm është sepse ai i ka vënë kusht vetes të mohoj ekzistencën e Allahut. Të gjithë evolucionistët tjerë marrin të njëjtin qëndrim.

Evolucionistët nuk mbështeten në shkencë por në filozofinë materialiste dhe ata e shtrembërojnë shkencën për t’u pajtuar me këtë filozofi. Një gjenetikor dhe evolucionist i sinqertë i Universitetit të Harvardit, Richard Levontin, pranon këtë të vërtetë:

Nuk është se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material të botës së dukurive, por, përkundrazi, se ne jemi të

detyruar a priori prej besnikërisë sonë ndaj shkaqeve materiale të krijojmë një aparat/mjet hulumentimi dhe një strukturë konceptesh që prodhojnë shpjegime materiale, pa marrë parasysh se sa kundër-intuitive, pa marrë parasysh se sa mistike/e mjegulltë për të panisurën. Veç kësaj, se materializmi është absolut, në mënyrë që të mos lejojmë Hyjnoren tek porta. 25

Në anën tjetër, sot, sikurse edhe në histori, ka shkencëtarë që i kundërvihen këtij grupi dogmatik materialist, shkencëtarë të cilët vërtetojnë ekzistencën e Allahut dhe e konsiderojnë shkencën si një mënyrë të njohjes së Allahut. Disa trende që zhvillohen në SHBA siç është “Kreacionizmi” apo “Projektimi Inteligjent” provojnë me anë të fakteve shkencore se të gjitha gjallesat u krijuan prej Allahut.

Kjo na tregon se shkenca dhe religjioni nuk janë burime kundërvënëse të informacionit, por se, përkundrazi, shkenca është një metodë që vërteton të vërtetat absolute që ofron religjioni. Përplasja në mes të religjionit dhe shkencës mund të vlej vetëm për religjone të caktuara që përfshijnë disa elemente paragjyquese si edhe burime hyjnore. Mirëpo, kjo padyshim se nuk vlen për Islamin, i cili mbështetet vetëm në shpalljen e kulluar të Allahut. Veç kësaj, Islami përkrah në veçanti hetimin shkencor dhe bën të ditur se të hetuarit e gjithësisë është një metodë për të hulumentuar krijimin e Allahut. Vargu vijues i Kur’anit e adreson këtë çështje:

A nuk shikojnë ata me vëmendje kah qielli se si mbi ta kemi ndërtuar atë, e kemi zbukuruar atë duke mos pasur në të ndonjë zbrazëti. Edhe tokën se si e kemi shtrirë, e në të kemi vendosur kodra përforcuese dhe kemi bërë që në të të mbijnë gjithfarë bimësh të bukura. Ne, nga qielli lëshuam shiun e dobishëm dhe më të bëmë që të kultivohen kopshte e drithëra të korren. Dhe rritëm trungje të gjata hurmash me fruta të paluara njëra mbi tjetrën. (Sure Kaf: 6-7, 9-10)

Siç lënë të kuptohet vargjet e mësipërme, Kur’ani gjithmonë i shtyen njerëzit të mendojnë, të gjejnë dhe të studiojnë gjithçka në botën në të cilën jetojmë. Kjo është për shkak se shkenca e mbështetë religjionin, e shpëton individin prej padijenisë dhe e shtynë atë të mendoj në mënyrë më të ndërgjegjshme, hap plotësisht botën e mendimeve/ideve të njeriut dhe i ndihmon të kuptojë argumentet e vetëkuptueshme të Allahut në gjithësi. Fizikani i mirënjohur gjerman Maks Planku tha se “çdokush i cili, pa marrë parasysh lëminë e tij, e studion shkencën seriozisht do të lexojë frazën në vijim në derën e tempullit të shkencës: ‘Beso’”. Sipas tij, besimi është një veçori thelbësore e një shkencëtari. 26

Të gjitha çështjet që i kemi trajtuar gjer më tani thjeshtë vlerësojnë se ekzistenca e gjithësisë dhe e të gjitha gjallesave nuk mund të shpjegohet përmes rastësive. Shumë shkencëtarë që kanë lënë gjurmën e tyre në botën e shkencës kanë vërtetuar dhe vazhdojnë të vërtetojnë këtë realitet madhështor. Sa më shumë që mësojnë njerëzit për gjithësinë, aq më i madh bëhet admirimi për rregullin e përkryer të saj. Çdo hollësi rishtazi e zbuluar mbështet krijimin në një mënyrë të padiskutueshme.

Shumica e fizikanëve modern e pranojnë faktin e krijimit kur hyjmë në shekullin e 21të.

Sipas Dejvid Darling poashtu as koha, as hapësira, as material, as energjia dhe madje as edhe një pikë e vogël apo vrimë nuk ekzistonin në fillim. Një lëvizje e vogël dhe e shpejtë dhe një dridhje modeste dhe lëkundje u shfaq. Darling përfundon duke thënë se kur kapaku i kësaj kutie kozmike u hap, kërcejtë e mrekullisë së krijimit u shfaqën prej poshtë saj. 27

Veç kësaj, tashmë është e ditur se gadi të gjithë themeluesit e degëve të ndryshme shkencore besuan në Allahun dhe në librat e Tij hyjnor. Fizikanët më të mëdhenjë në histori, Njutni, Faradej, Kelvin dhe Maksvell janë vetëm disa shembuj të shkencëtarëve të tillë.

Në kohën e Isak Njutnit, fizikanit të madh, shkencëtarët besonin se lëvizjet e trupave qiellor dhe të planeteve mund të shpjegoheshin me anë të ligjeve të ndryshme. Sidoqoftë, Njutni besonte se krijuesi i tokës dhe hapësirës ishte i njëjtë dhe prandaj ato duhej të shpjegoheshin me anë të ligjeve të njëjta:

Ai tha:

Ky sistem më se i bukur i diellit, planeteve dhe kometeve mund të buronte vetëm prej këshillës dhe autoritetit suprem të një Qenie inteligjente dhe të plotfuqishme. 28

Siç është e qartë, me mijëra shkencëtarë të cilët kishin bërë hulumtime në fushat e fizikës, matematikës dhe astronomisë që prej Mesjetës të gjithë pajtohen me idenë se gjithësia u krijua prej një Krijuesi të vetëm dhe gjithmonë përqendrohen në një pikë të njëjtë. Themeluesi i astronomisë fizike, Johan Kepler, deklaroi besimin e tij të fuqishëm në Zotin në njërin prej librave të tij ku ai shkruajti:

Pasiqë ne astronomët jemi priftërinjë të Zotit të lartësuar në lidhje me librin e natyrës, na ka hije të jemi të vëmendshëm, jo për madhështinë e mendjeve tona, por më tepër dhe mbi të gjitha për madhështinë e Zotit. 29

Fizikani i madh, Villiam Thompson (Lordi Kelvin), i cili themeloi termodinamikën në bazë formale shkencore, ishte poashtu një i krishterë i cili besonte në Zotin. Ai fuqishëm iu kundërvu teorisë së evolucionit të Darvinit dhe e hodhi poshtë plotësisht. Në vitin 1903, pak para vdekjes së tij, ai bëri një deklaratë të qartë se: “Në lidhje me zanafillën e jetës, shkenca...konfirmon pozitivisht fuqinë krijuese.” 30

Njëri prej profesorëve të fizikës në Universitetin e Oksfordit, Robert Mateus deklaroi në një fakt në librin e tij të botuar në vitin 1992 ku ai shpjegon se molekulat e ADN-së u krijuan prej Zotit. Mateusi thotë se të gjitha këto etapa zhvillohen në harmoni të përkryer prej një qelize të vetme deri te një foshnje e gjallë, pastaj deri te fëmija i vogël dhe përfundimisht deri te një adoleshent. Të gjitha këto ndodhi mund të shpjegohen vetëm me anë të një mrekullie, pikërisht sikurse në të gjitha fazat/etapat e biologjisë. Mateus pyet se si mundet që një organizëm aq i përkryer dhe kompleks të lind prej një qelize aq të thjeshtë dhe të vogël dhe si krijohet një NJERI i lavdishëm prej një qelize madje më të vogël se një pikë në shkronjën i. Ai në fund përfundon se kjo nuk është asgjë më pak se një mrekulli. 31

Disa shkencëtarë tjerë të cilët pranojnë se gjithësia është krijuar prej një Krijuesi dhe të cilët janë të njohur përmes attributeve të tyre të cituara janë:

Robert Bojll (babai i kimisë bashkëkohore)

Iona Uilliam Peti (i njohur për studimet e tij për statistikë dhe ekonomi bashkëkohore)

Majkell Faradej (njëri prej fizikanëve më të mëdhenjë të të gjitha kohërave)
Gregor Mendel (babai i gjenetikës; ai e zhvlerësoi Darwinizmin me zbulimet e tij në shkencën e gjenetikës)
Luis Paster (emri më i madh në bakteriologji; ai i shpalli luftë Darwinizmit)
Xhon Dalton (babai i teorisë atomike)
Bleiz Paskal (njëri prej matematikanëve më të rëndësishëm)
Xhon Rej (emri më i rëndësishëm në historinë natyrore britanike)
Nikolaus Steno (një stratograf i famshëm i cili hulumtoi shtresat e tokës)
Karolus Lineus (babai i klasifikimit biologjik)
Xhorxh Kuvier (themeluesi i anatomisë krahasuese)
Methju Mauri (themelues i oqeanografisë)
Thomas Anderson (njëri prej pionierëve në fushën e kimisë organike)

Faktet shkencore dhe mrekullia e Kur'anit

Kur'ani u dërgua në tokë 14 shekuj më parë prej Allahut. Kur'ani nuk është libër i shkencës. Ai megjithatë përfshinë disa shpjegime shkencore përbrenda kontekstit të tij fetar. Këto shpjegime kurrë nuk kanë rënë në kundërshtim me zbulimet e shkencës moderne. Përkundrazi, fakte të caktuara që vetëm kanë mundur të zbulohen me teknologjinë e shekullit 20të në fakt u zbuluan në Kur'an 14 shekuj më parë. Kjo na tregon se Kur'ani është njëra prej provave më të rëndësishme që zbulon ekzistencën e Allahut.

NJË PAMJE MBI GJITHËSINË PËRMES SYVE TË KUR'ANIT

Krijimi i gjithësisë

Në ajetin e mëposhtëm, përshkruhet zanafilla e gjithësisë:

”Ai është Krijuesi fillestar i qiejve dhe i tokës (pa pasur asnjë shembull)...” (El-En'am 101)

Ky informacion i dhënë në Kur'an është në pajtueshmëri të plotë me zbulimet e shkencës bashkëkohore. Përfundimi në të cilin ka arritur astrofizika sot, është se i tërë universi, së bashku me dimensionet e materies dhe të kohës, u krijua si rezultat i një shpërthimi të madh, i cili ndodhi menjëherë. Ky fenomen i njohur me emrin “Big Beng”, vërtetoi se gjithësia ishte krijuar nga asgjëja si

rezultat i një shpërthimi në një pikë të vetme. Qarqet shkencore moderne janë të një mendimi në lidhje me faktin se Big Bengu është i vetmi shpjegim i arsyeshëm dhe i vërtetuar i zanafillës së gjithësisë dhe i mënyrës së krijimit të tij.

Para Big Bengut, materia nuk ekzistonte. Nga kjo gjendje mosekzistence, në të cilën as lënda, as energjia, madje as koha nuk ekzistonin dhe kjo mund të përshkruhet vetëm në

mënyrë metafizike arrijmë në përfundimin se materia, energjia dhe koha janë të tëra të krijuara. Ky argument është një

nga zbulimet e fundit të fizikës bashkëkohore, i cili është shpallur në Kur'an 1400 vjet më parë.

Në Kur'an, i cili u shpall katërbëdhjetë shekuj më parë, në kohën kur shkenca e astronomisë ishte akoma primitive, zgjerimi I universit përshkruhet në këtë mënyrë:

”Ne me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë. ” (Edh-Dharijat 47)

Fjala “qiell” e përmendur në këtë ajet është përdorur në vende të ndryshme në Kuran me kuptimin e hapësirës dhe gjithësisë. Edhe këtu, kjo fjalë është përdorur me këtë kuptim. Me fjalë të tjera, në Kur'an është shpallur se gjithësia “zgjerohet”. Pikërisht ky është përfundimi i arritur sot prej shkencës.

Deri para fillimit të shekullit XX, i vetmi mendim i përhapur në botën e shkencës ishte se “gjithësia ka një natyrë të qëndrueshme dhe ka ekzistuar përherë pa fillim”. Mirëpo, në fillimet e shekullit XX, fizikani rus Aleksander Fridman dhe kozmologu belg Xhorxh Lemetër llogaritën teorikisht se gjithësia është në lëvizje të vazhdueshme dhe zgjerohet.

Ky fakt u vërtetua gjithashtu prej të dhënave të vëzhguara më 1929. Astronauti amerikan Edvin Habëll, ndërsa po vëzhgonte qiellin me një teleskop, zbuloi se yjet dhe galaktikat largoheshin vazhdimisht nga njëra-tjetra. Një gjithësi, ku çdo gjë lëviz vazhdimisht duke u larguar prej çdo gjëje tjetër, nënkuptontë një gjithësi vazhdimisht në zgjerim.

Ky argument është sqaruar në Kur'an në një kohë kur kjo ishte e panjohur për çdokënd. Kjo për arsye se Kur'ani është fjala e Zotit, Krijuesit dhe Sundimtarit të tërë gjithësisë.

NDARJA E “QIEJVE DHE E TOKËS”

Një prej ajeteve që bën fjalë për krijimin e qiejve është edhe ajeti i mëposhtëm:

”A nuk e dinë jobesimtarët se qiejtë dhe toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo gjëje. Përse nuk besojnë pra?” (El Enbija 30)

Fjala origjinale “retk”, e përkthyer “të ngjitura”, në këtë varg, do të thotë “të përziera me njëra-tjetrën, të bashkuara në një masë solide/të plotë” në gjuhën arabe. Kjo fjalë përdoret në ato raste kur u referohemi dy pjesëve të ndryshme, të cilat përbëjnë një tërësi. Fraza “Ne i ndamë” është folja arabe “feteka” dhe nënkupton diçka që vjen si rezultat i shkëputjes/ndarjes së një pjese të strukturës së ngjitur“retk”. P.sh. çarja e farës së bimës në momentet para të mbirjes është një nga rastet në të cilat

përdoret kjo folje në gjuhën Arabe.

Le të shqyrtojmë përsëri ajetin kuranor, duke pasur në mendje faktet e lartpërmendura. Në ajet, qielli dhe toka janë subjekti i parë i gjendjes “retk”. Më pas ata

ndahen (feteka), duke u shkëputur nga njëri-tjetri. Kureshtja jonë rritet kur rikujtojmë momentet e para të Big Bengut dhe shohim se e gjithë

materia e gjithësisë përfshihej në një pikë të vetme. Me fjalë të tjera, çdo gjë, duke përfshirë “qiejt dhe tokën”, të cilat nuk ishin krijuar ende, ishin pjesë e kësaj pike në gjendjen “retk”. Pas një shpërthimi të fuqishëm, lënda e kësaj pike u nda (feteka) dhe më pas ndodhi procesi i krijimit të strukturës së tërë gjithësisë.

Kur krahasojmë ajetin kuranor me zbulimet shkencore, shohim se ato përputhen në mënyrë të përkryer me njëra-tjetrën. Fakti më interesant dhe më habitës është se këto zbulime u bënë vetëm në shekullin 20të.

ORBITAT

Duke iu referuar Kur’anit, Dielli dhe Hëna lëvizin në orbita të caktuara:

”Zoti krijoi natën e ditën, diellin e hënën dhe secili prej tyre noton në orbitë.”
(El Enbija 33)

Në një ajet tjetër përmendet se Dielli nuk është i palëvizshëm, por lëviz në një orbitë të caktuar.

”Edhe dielli lëviz drejt kufirit të tij përfundimtar. Ajo lëvizje është përcaktim i të Plotfuqishmit, të Diturit.” (Ja Sin 38)

Këto argumente të komunikuara në Kuran u zbuluan prej vëzhgimeve astronomike në epokën tonë. Sipas llogaritjeve të ekspertëve të astronomisë, Dielli udhëton me një shpejtësi marramendëse prej 720.000 km në orë në drejtim të yllit Vega në një orbitë të veçantë të quajtur Maja Diellore. Kjo do të thotë se Dielli përshkon afërsisht 17.280.000 km në ditë. Bashkë me Diellin, të gjitha planetet dhe satelitët brenda sistemit gravitacional të Diellit përshkojnë gjithashtu të njëjtën distancë. Për më tepër, të gjitha yjet në gjithësi bëjnë një lëvizje të ngjashme të planifikuar.

Në Kur’an është shpallur se e tërë gjithësia është e mbushur plot me rrugë e orbita sikurse kjo:

”Beto hem në qiellin plot rrugë.” (Edh-Dharijat 7)

Në gjithësi ndodhen rreth 200 miliardë galaktika dhe secila prej tyre përmban rreth 200 miliardë yje. Pjesa më e madhe e këtyre yjeve kanë planete dhe pjesa më e madhe e këtyre planeteve kanë satelitë. Këta trupa qiellor lëvizin në orbita të caktuara, sipas një lëvizjeje të përlllogaritur në mënyrë preçize. Për miliona vite me radhë, të gjithë këta trupa kanë “notuar” në orbitën e tyre në një harmoni dhe rregull të përkryer. Për më tepër, një numër i madh kometash lëvizin në orbitat e përcaktuara për to.

Orbitat në gjithësi nuk janë karakteristikë vetëm e trupave qiellorë. Edhe vetë galaktikat udhëtojnë me një shpejtësi marramendëse në orbita të projektuara për to. Gjatë kësaj lëvizjeje, asnjë prej trupave qiellorë nuk i zë rrugën, apo përplasat me të tjerët.

Sigurisht që në kohën e shpalljes së Kur'anit njerëzimi nuk zotëronte teleskopë elektronikë apo teknologjinë e avancuar të vëzhgimit të trupave miliona kilometra në hapësirë, ashtu siç nuk dispononte njohuritë e sotme të fizikës apo astronomisë. Ndaj në atë kohë nuk ishte e mundur të zbulohesh në

mënyrë shkencore se hapësira është “plot me rrugë dhe orbita”, siç është shpallur në ajetin kur'anor...

Mirëpo, kjo na është thënë haptazi në Kur'an që është shpallur në atë kohë, sepse Kur'ani është fjala e Zotit.

RRUMBULLAKSIA E TOKËS

”Ai i krijoi qiejt e tokën me qëllim të caktuar. Ai ia mbështjell natën ditës dhe ditën ia mbështjell natës.” (Ez-Zumer 5)

Fjalët e përdorura në Kur'an për të përshkruar gjithësinë janë mjaft të qarta. Fjala arabe, e cila është përkthyer “mbështjellë” në ajetin e mësipërm, është fjala “tek'uir”. Në anglisht, kjo fjalë përdoret për të përshkruar “mbështjelljen e një gjëje rreth një gjëje tjetër”. (P.sh. në fjalorët e gjuhës Arabe kjo fjalë përdoret për të përshkruar mbështjelljen e një gjëje rreth një gjëje tjetër, siç mbështillet çallma rreth kokës.)

Njoftimi i dhënë në këtë ajet për mbështjelljen e ditës dhe natës me njëra tjetrën përmban informacion të saktë për formën e tokës. Kjo mund të ndodhë vetëm nëse toka është e rrumbullakët. Kjo do të thotë se rrumbullakësia e tokës është thënë në mënyrë të tërthortë në Kur'an, që në shekullin VII.

Nuk duhet të harrojmë se gjuha arabe është një gjuhë shumë e pasur dhe përdorimi i kësaj foljeje është i rrallë, gjë që tregon fare qartë se përdorimi i saj është bërë me qëllim.

Sidoqoftë, ne duhet të sjellim ndërmend se njohuritë e astronomisë të asaj kohe e perceptonin botën krejt ndryshe. Atëherë mendohej se bota ishte një plan i sheshtë dhe të gjitha përlllogaritjet dhe shpjegimet shkencore ishin të bazuara mbi këtë besim. Ajetet Kur'anore përmbajnë informacione, të cilat ne i kemi mësuar vetëm në shekullin e kaluar. Përderisa Kur'ani është fjala e Zotit, fjalët më të sakta janë përdorur në të kur përshkruhet gjithësia.

ÇATI E SIGURTË

Në Kuran, Zoti na tërheq vëmendjen ndaj një vetie mjaft interesante të qiellit:

”Qiellin e kemi bërë si çati të sigurtë e të mbrojtur, por ata zbrapsen prej atyre argumenteve.” (El Enbija 32)

Kjo veti e qiellit është vërtetuar prej kërkimeve shkencore të kryera në shekullin XX.

Atmosfera, e cila rrethon tokën, kryen shërbime jetike për të siguruar vazhdimësinë e jetës. Duke shkatërruar mjaft meteorë të mëdhenj e të vegjël me të arritur tokën, ajo i ndalon ata që të përplasen me tokën dhe të dëmtojnë gjallesat.

Për më tepër, atmosfera filtron rrezet e dritës që vijnë nga hapësira, të cilat janë të dëmshme për krijesat e gjalla. Fakti më interesant është se atmosfera lejon të kalojnë vetëm rrezet e padëmshme e të nevojshme - drita e tejudkshme, rrezet e shkurtra ultravjollcë dhe valët e radios. I gjithë ky rrezatim është i domosdoshëm për jetën. Atmosfera lejon kalimin vetëm të një pjese të rrezeve të shkurtra

ultravjollcë, të cilat janë shumë të rëndësishme për procesin e fotosintezës dhe për mbijetesën e të gjitha gjallesave. Pjesa më e madhe e rrezeve të gjata ultravjollcë, të lëshuara nga dielli, filtrohen prej shtresës së ozonit në atmosferë dhe vetëm një pjesë e kufizuar dhe thelbësore e spektrit të rrezeve ultravjollcë arrijnë në Tokë.

Funksioni mbrojtës i atmosferës nuk mbaron këtu. Atmosfera mbron gjithashtu tokën prej të ftohtit ngrirës të hapësirës, i cili arrin deri në minus 270 gradë celsius.

Nuk është vetëm atmosfera ajo që e mbron Tokën nga efektet shkatërruese dhe dëmtuese të hapësirës. Së bashku me atmosferën, brezi Van Alen, një shtresë, e krijuar si rezultat i fushës magnetike të Tokës, gjithashtu shërben si një fushë mbrojtëse kundër rrezatimeve të dëmshme, të cilat kërcënojnë planetin tonë. Ky rrezatim, i cili vazhdimisht lëshohet prej diellit dhe yjeve të tjera, është vdekjeprurës për gjallesat. Nëse brezi Van Alen nuk do të ekzistonte, energjia e shpërthimeve masive të quajtura shpërthime diellore, të cilat ndodhin vazhdimisht në Diell, do të shkatërronin çdo formë jete në Tokë.

Dr. Hugh Ross, duke folur mbi rëndësinë që ka për jetën tonë brezi Van Alen, ndër të tjera thotë:

Në fakt, Toka ka dendësinë më të lartë se çdo planet tjetër në Sistemin Diellor. Bërthama e madhe e hekur-nikelit është shkaku i ekzistencës së fushës sonë të madhe magnetike. Kjo fushë magnetike formon mburojën mbrojtëse Van-Alen, e cila e mbron Tokën nga rrezet bombarduese. Nëse nuk do të ishte kjo mburojë, jeta në Tokë do të ishte e pamundur. I vetmi planet tjetër shkëmbor që ka fushë

magnetike është Merkuri, por fuqia e fushës së tij është 100 herë më e vogël se e Tokës. Madje as Afërdita, planeti ynë simotër, nuk ka fushë magnetike.

Brezi mbrojtës Van-Alen është një dizajn/strukturë që gjendet vetëm në Tokë. 32

Energjia e liruuar në vetëm njërën prej këtyre shpërthimeve të viteve të fundit është e barabartë me energjinë e liruuar nga shpërthimi i 100 miliardë bombave atomike të ngjashme me atë që u hodh në Hiroshimë. Pesëdhjetë e tetë orë pas shpërthimit u vërejt se gjilpërat magnetike të busullave paraqitnin një lëvizje jo të zakonshme dhe 250 km mbi atmosferën e Tokës, temperatura papritmas u rrit në 2500°C.

Me pak fjalë, një sistem mbrojtës i përkryer funksionon mbi Tokë. Ai e rrethon botën tonë dhe e mbron prej kërcënimeve të jashtme. Vetëm kohët e fundit, shkencëtarët arritën të mësojnë për këtë, kurse Zoti na ka njoftuar në Kur'an për funksionimin e atmosferës si mburojë mbrojtëse të Tokës shekuj më parë.

FUNKSIONI I MALEVE

Kur'ani na tërheq vëmendjen ndaj një funksioni gjeologjik mjaft të rëndësishëm të maleve.

”Ne kemi krijuar male të patundura në tokë, me qëllim që ajo të mos lëkundet dhe tronditet bashkë me to...” (El Enbija 31)

Siç vihet re, në këtë ajet është shpallur se malet luajnë rol në parandalimin e tronditjeve dhe lëkundjeve të Tokës.

Ky fakt nuk ishte i njohur nga askush në kohën kur u shpall Kurani. Në të vërtetë, ai u zbulua jo shumë kohë më parë dhe kjo vetëm si rezultat i zbulimeve të gjeologjisë bashkëkohore. Sipas këtyre zbulimeve, malet shfaqen si rezultat i lëvizjeve dhe përplasjeve të shtresave masive, të cilat formojnë koren e Tokës.

Kur dy shtresa përplasen me njëra-tjetrën, shtresa më e fortë rrëshqet poshtë shtresës tjetër, e cila përket në majë, duke formuar lartësitë dhe malet. Shtresa e poshtme fillon e zgjerohet duke u

shtrirë thellë në tokë.

Në një tekst shkencor, struktura e maleve është përshkruar si më poshtë:

Atje ku kontinentet janë më të trasha, si p.sh. vargmalet, korja zhytet thellë në mantel. 33

Në një ajet kuranor, kjo veti e maleve është vënë në dukje nga një krahasim i maleve me “kunjat”:

A nuk e bëmë Ne tokën të përshtatshme për jetë, ndërsa malet i bëmë si kunja? (En-Nebe 6-7)

Me fjalë të tjera, malet ngriten në ato pika ku bashkohen shtresat e tokës, të cilat mbahen të lidhura me t’iu afruar njëra tjetrës dhe “I fiksojnë” ato. Shkurt, ne mund t’i krahasojmë malet me gozhdët, të cilat mbajnë dërrasat të mbërthyera së bashku.

Veç kësaj, presioni që ushtrohet nga malet në koren e Tokës parandalon që ndikimi i aktivitetit të magmës në qendër të tokës të arrij sipërfaqen e tokës duke e thyer kështu koren e tokës.

Kjo veti fiksuese e maleve në literaturën shkencore është përshkruar me termin “isostazi”:

Isostazi do të thotë: ekuilibri i përgjithshëm i kores së Tokës i mbajtur nga qarkullimi i materialeve shkëmbore poshtë sipërfaqes, si rezultat i shtypjes gravitacionale. 34

Ky rol kaq i rëndësishëm i maleve, i cili u zbulua nga gjeologjia moderne dhe nga kërkimet sizmike, është shpallur në Kur’an shekuj më parë si një shembull i dijes absolute të krijimit të Zotit.

Është Zoti Ai që krijoi male të patundura në tokë me qëllim që ajo të mos lëkundet dhe tronditet nën këmbët tuaja... (Sure Lukman: 10)

MREKULLIA E HEKURIT

Hekuri është një nga elementet e përmendura në Kuran. Në suren Hadid, d.m.th. në suren e Hekurit thuhet:

”Ne e kemi zbritur hekurin, në të cilin ka forcë të madhe dhe dobi për njerëzit..., (Sure Hadid 25)

Fjala “zbritëm poshtë” e përdorur veçanërisht për hekurin në këtë ajet, mund të mendohet se ka një kuptim metaforik që do të thotë se hekuri është dhuruar për të mirën e njerëzimit. Por nëse ne do të merrnim në konsideratë kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, e cila është “i zbritur fizikisht nga qielli”, do të kuptojmë se në këtë ajet gjendet një mrekulli shkencore mjaft domethënëse.

Në saje të kërkimeve astronomike është zbuluar se hekuri i gjendur në rruzullin tokësor ka ardhur prej yjeve gjigande të hapësirës.

Metalet e rënda në gjithësi janë krijuar në bërthamën e yjeve të mëdha. Mirëpo, sistemi ynë diellor nuk zotëron një strukturë të përshtatshme që të prodhojë vetë hekur. Hekuri mund të prodhohet në yje shumë më të mëdha se Dielli, tek të cilat temperatura arrin disa qindra miliona gradë. Kur sasia e hekurit në një yll tejkalon një nivel të caktuar, ylli nuk mund ta mbajë atë më gjatë dhe si rezultat ai shpërthen në një shpërthim të quajtur “nova” ose “supernova”. Si rezultat i këtij shpërthimi, meteorët që përmbajnë hekur shpërndahen nëpër univers dhe lëvizin nëpër hapësirë, derisa të tërhiqen prej forcës gravitacionale të ndonjë trupi qiellor.

E gjithë kjo na bën të qartë se hekuri nuk është formuar në Tokë, por është bartur nëpërmjet meteorëve pas shpërthimit të yjeve në hapësirë dhe “ka zbritur në tokë” në të njëjtën mënyrë siç është shpallur në ajetin kuranor. Është e qartë se ky fakt nuk njihet shkencërisht në shekullin VII, në kohën e shpalljes së Kuranit.

Përveç kësaj, vargu i 25të i Sures Hadid, që i referohet hekurit, përfshinë dy kode interesante matematikore:

Sura Hadid është Sura e 57të e Kur’anit. Vlera numerike e fjalës “Al-Hadid” në Arabishte, me fjalë tjera Abxhadi i tij, është numri i njëjtë: 57

Vlera numerike e fjalës “Hadid” vet është 26, dhe 26 është numri atomik i hekurit.

SHIU

Shiu është me të vërtetë njëri prej faktorëve më të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e jetës në tokë. Është kusht paraprak për vazhdimësinë e gjallërisë në një rajon. Shiu, i cili bartë një rëndësi të madhe për të gjitha gjallesat duke përfshirë edhe qeniet njerëzore, është përmendur në vargje/ajete të ndryshme të Kur’anit, ku japet informacion i konsiderueshëm për formimin e shiut, sasinë dhe efektet e tij. Ky informacion, i cili s’ka mundur të dihej kurrë prej njerëzve të asaj kohe, na tregon se Kur’ani është fjala e Allahut.

Tani, le të shqyrtojmë informacionin e dhënë në Kur’an për shiun.

SASIA E SHIUT

Një prej shumë informacioneve të dhëna në Kur’an rreth formimit të shiut është fakti se ai zbret në Tokë në një masë të caktuar. Kjo është përmendur në suren Zuhruf si më poshtë:

”Ai lëshon nga qielli shiun me masë të caktuar. Me të Ne i japim jetë një vendi të vdekur. Ja, kështu edhe ju do të ngalleni nga varret.” (Sure Zuhruf : 11)

Fakti i zbritjes së kësaj sasive shiu të matur dhe të përcaktuar është konfirmuar prej kërkimeve të kohëve të fundit. Është llogaritur se në një sekondë avullojnë afërsisht 16 milionë tonë ujë nga Toka. Kjo shifër arrin në 513 trilionë tonë ujë në vit. Kjo sasi është e barabartë me sasinë e shiut që bie në Tokë gjatë një viti. Kjo lë të kuptosh se uji qarkullon brenda një cikli të ekuilibruar “me masë të caktuar”. Jeta në Tokë varet nga ky qarkullim i ujit. Sikur njerëzit të shfrytëzonin të gjithë potencialin teknologjik që disponojnë, nuk do të mund ta realizonin dot këtë qarkullim në mënyrë artificiale.

Madje edhe një devijim i vogël i këtij ekuilibri, shumë shpejt do të sillte një çekuilibrim të madh ekologjik dhe për rrjedhojë, fundin e jetës në Tokë. Por kjo nuk ndodhë asnjëherë dhe shiu vazhdon të bjerë çdo vit pikërisht në të njëjtën sasi, ashtu siç është shpallur në Kur’an.

FORMIMI I SHIUT

Formimi i shiut mbeti një mister për një kohë të gjatë. Vetëm pas shpikjes së mjeteve të parashikimit të motit u bë e mundur të zbuloheshin fazat me anë të të cilave formohet shiu. Formimi i shiut zhvillohet në tri faza. Së pari, avujt e ujit ngrihen lart në qiell me anë të erës, më pas formohen retë dhe në fund shfaqen pikat e shiut.

Këto faza përcaktohen qartë në Kur’an shekuj më parë ku japet informacioni i saktë për formimin e shiut:

Zoti është Ai që i dërgon erërat, të cilat lëvizin retë. Ai i shtrin retë në qiell ashtu siç dëshiron dhe i bën të ndara në pjesë, pastaj përmes tyre sheh se si bie shiu, e kur ia lëshon atë kujt të dojë prej robërve të vet, qe, ata gëzohen. (Sure Rum: 48)

Tani, le të shohim më hollësisht këto tri faza të përshkruara në ajetin kuranor.

FAZA E PARË: “Zoti është Ai që i dërgon erërat...”

Flluska ajri të panumërta, të cilat formohen nga shkumëzimi i ujit të oqeanëve, plasin vazhdimisht dhe shkaktojnë veçimin e disa grimcave të ujit, të cilat ngrihen lart në qiell. Këto grimca të pasura me kripë (të cilat quhen aerosole) transportohen nga erërat dhe ngrihen në atmosferë. Këto grimca, të cilat quhen aerosole, formojnë retë duke mbledhur rreth vetes avujt e ujit që ngrihen prej detit, si pika të vogla me anë të një mekanizmi të quajtur “kurthi i ujit”.

FAZA E DYTË: “... (erërat) lëvizin retë. Ai i shtrin retë në qiell ashtu siç dëshiron dhe i bën të ndara në pjesë ...”

Retë formohen nga avujt e ujit, të cilët kondensohen rreth kristaleve të kripës apo grimcave të pluhurit që gjenden në ajër. Meqë pikat e ujit në këto re janë mjaft të vogla (me diametër 0.01 dhe 0.02 mm), retë “qëndrojnë pezull” në ajër dhe përhapen në qiell. Në këtë mënyrë, qielli mbushet plot

me re.

FAZA E TRETË: “...dhe përmes tyre sheh se si bie shiu.”

Grimcat e ujit, të cilat rrethojnë kristalet e kripës dhe grimcat e pluhurit, zmadhohen dhe formojnë pikat e shiut, të cilat bëhen më të rënda se ajri, ndaj dhe shkëputen nga retë, duke filluar të bijnë në tokë në formë shiu.

Siç shihet, çdo fazë e formimit të shiut është shpallur në ajetet e Kur'anit. Për më tepër, këto faza janë shpjeguar saktësisht sipas radhës së duhur. Si shumë fenomene të tjera natyrore në botë, përsëri është Kur'ani që ofron shpjegimin më të saktë edhe në lidhje me këtë dukuri, dhe përsëri, që ua ka bërë të njoftuar këto fakte njerëzve shumë shekuj përpara se ato të zbuloshehin nga shkenca.

Në një ajet tjetër është dhënë informacioni i mëposhtëm rreth formimit të shiut:

”A nuk e ke parë se si i drejton Zoti retë, pastaj i bashkon, pastaj i grumbullon njëra mbi tjetrën dhe atëherë ti shikon shiun se si rrjedh prej tyre. Ai lëshon nga lart breshër prej reve të mëdha si malet. Me breshrin Ai godet kë të dojë dhe e largon nga kush të dojë. Shkëlqimi I vetëtimës së tij (breshrit) gati ta merr shikimin.” (Sure Nur: 43)

Gjatë studimit të llojeve të reve, shkencëtarët u gjendën përpara një sërë rezultatesh të papritura mbi formimin e reve të shiut. Retë e shiut krijohen dhe formohen në bazë të një sistemi fazash të përcaktuara mirë. Fazat e formimit të Kumulonimbus, një lloj i reve të shiut janë këto:

FAZA E PARË: Retë shtyhen nga era: Retë Kumulonimbus fillojnë të formohen, kur era shtyn copa të vogla reje në një zonë ku ato bashkohen.

FAZA E DYTË: Bashkimi: Pas kësaj, retë bashkohen duke formuar një re më të madhe.

FAZA E TRETË: Grumbullimi mbi njëra-tjetrën: Kur retë e vogla bashkohen bashkë, rriten lëvizjet nga poshtë-lart brenda resë së madhe, të cilat në qendër janë më të forta se në pjesët anësore të resë, sepse pjesët e jashtme të resë e mbrojnë qendrën prej efekteve ftohëse. Këto lëvizje bëjnë që trupi i

resë të rritet vertikalisht, duke marrë formën e mullarit. Duke u rritur vertikalisht, reja shtrihet në zona më të ftohta të atmosferës, ku pikat e ujit dhe breshrit formohen dhe fillojnë të rrisin përmasat e tyre. Kur këto pika uji e breshri bëhen tepër të rënda dhe lëvizja nga poshtë-lart nuk mund t'i mbajë pezull, atëherë ato fillojnë të bien nga reja në formë shiu, breshri etj. 35

Detajet e formimit, të strukturës dhe funksionimit të reve janë zbuluar nga meteorologët nëpërmjet përdorimit të mjeteve të sofistikuar si aeroplanët, satelitët, kompjuterët, ballonat, etj. Është e qartë se në këtë ajet Zoti na jep një informacion që nuk kishte si të njihej 1400 vjet më parë.

DETET QË NUK PËRZIHEN ME NJËRA TJETRËN

Një nga veçoritë karakteristike të deteve është shpallur në një prej ajeteve të Kuranit, si më poshtë:

”Ai i bëri dy detet të bashkohen me njëri-tjetrin. Ndërmjet tyre ka një pengesë që nuk i lejon të përzihen.” (Err-Rrahman 19-20)

Kjo karakteristikë e deteve që rrinë ngjitur me njëri-tjetrin, pa u përzier mes tyre, është zbuluar jo shumë kohë më parë nga studiuesit e oqeanëve. Për shkak të forcës fizike të quajtur “tensioni sipërfaqësor”, ujërat e deteve fqinj nuk përzihen. I shkaktuar nga dallimi i dendësisë së ujërave,

tensioni sipërfaqësor i ndalon detet të përzihen me njëra tjetrën, sikur ndërmjet tyre të ekzistonte me të vërtetë një pengesë. 36

Aspekti interesant i këtij fenomeni është se ai është shpallur në Kuran në kohën kur njerëzit nuk kishin njohuri mbi fizikën, tensionin sipërfaqësor, apo oqeanografinë.

KRIJIMI I NJERIUT

Shumë çështje të ndryshme përmenden në Kur’an ku u bëhet thirrje njerëzve që të besojnë. Ndonjëherë qiejt, ndonjëherë kafshët dhe ndonjëherë bimët paraqiten si argument për njeriun nga Allahu. Në shumë ajete tjera, njerëzve u bëhet thirrje të drejtojnë vëmendjen ndaj vet krijimit të tyre. Atyre shpesh u përkujtohet ardhja në jetë e njeriut, fazat në të cilat ka kaluar krijimi i tij dhe se çfarë është ai në thelb:

”Ne ju kemi krijuar juve; përse pra nuk e pranoni të vërtetën? A keni menduar ndonjëherë për farën (spermën) që nxirrni? Mos vallë ju e krijoni atë, apo jemi Ne që e krijojmë?” (Sure Ēakia 57-59)

Krijimi i njeriut, bashkë me mrekullitë e shumta që përmban, është theksuar në mjaft ajete të tjera. Disa pjesë të informacionit të përmendur në këto ajete kuranore janë aq të hollësishme saqë është e pamundur që një njeri, i cili ka jetuar në shekullin VII të kishte njohuri për to. Disa prej këtyre janë si më poshtë:

1- Njeriu nuk është krijuar nga e tërë fara, por nga një pjesë mjaft e vogël e saj (spermës).

2- Është mashkulli ai që luan rol në përcaktimin e gjinisë së fëmijës dhe jo femra.

3- Embrioni njerëzor ngjitet në mitrën e nënës si një shushunjë.

4- Embrioni zhvillohet brenda tri errësirave (shtresave) në mitër.

Në kohën e shpalljes së Kuranit, njerëzit e dinin me siguri që faktori bazë në lindjen e njeriut ishte fara e mashkullit. Po ashtu, fakti që foshnja lind mbas një periudhe prej nëntë muajsh kuptohej nga të gjithë dhe s’kishte nevojë për vëzhgime të mëtejshme. Ndërsa informacioni i përmendur në pikat që cituam më lart ishte i paarritshëm dhe i pakonceptueshëm nga niveli i njohurive që zotëronin njerëzit e asaj kohe. Këto të dhëna kanë mundur të vërtetohen në mënyrë shkencore vetëm në shekullin XX.

Tani le t’i studiojmë ato një nga një.

Një pikë e farës

Gjatë marrëdhënieve seksuale, nga organi seksual i mashkullit dalin njëherësh rreth 250 milionë spermatozoidë, të cilët nisin një udhëtim të mundimshëm në trupin e femrës,

derisa arrijnë te veza. Nga 250 milionë spermatozoidë vetëm një mijë prej tyre ia dalin të arrijnë në destinacionin e

duhur. Në fund të kësaj "gare", veza lejon vetëm një qelizë spermatozoide që të depërtojë brenda saj. Ky është thelbi i njeriut, i cili nuk është krijuar nga e tërë sperma, por nga një pjesë shumë e vogël e saj. Në Kuran thuhet:

"A mos mendon njeriu se do të lihet pa u ngarkuar me përgjegjësi. A nuk ka qenë ai dikur një pikë e farës që derdhet?" (El Kijame 36-37)

Siç shihet, Kurani na informon se njeriu nuk është krijuar nga e gjithë sperma, por nga një pjesë shumë e vogël e saj. Ky fakt që theksohet në këtë shpallje është zbuluar prej shkencës bashkëkohore dhe është një dëshmi e qartë e origjinës hyjnore të saj.

Përzierja në farë (spermë)

Fara nuk përmban vetëm spermatozoide, por edhe një përzierje lëngjesh të ndryshme. Këto lëngje kanë funksione të ndryshme, siç është mbajtja e sheqerit, i cili është i nevojshëm për t'u dhënë energji

spermatozoideve, neutralizimi i acideve gjatë hyrjes në mitër dhe krijimi i një ambjenti rrëshqitës në mënyrë që t'u lejojë lëvizje të lirë spermatozoideve.

Kur përmendet fara në Kuran, ky fakt, i cili është zbuluar nga shkencë bashkëkohore, përmendet gjithashtu dhe fara përshkruhet si një lëng i përzier:

Vërtet Ne e krijuam njeriun prej një pike uji të përzier me qëllim që ta sprovujmë atë, andaj e bëmë të dëgjojë e të shohë. (Sure Insan: 2)

Një ajet tjetër, po ashtu, bën fjalë për farën si një përzierje. Në të theksohet se njeriu është krijuar nga "esenca" e kësaj përzierje:

"Ai e përsosi krijimin e çdo gjëje dhe filloi krijimin e njeriut nga balta. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të shtohen prej esencës së një lëngu të dobët." (Sure Sexhde 7-8)

Fjala arabe "sulale" e përkthyer si "kuintesencë", nënkupton diçka esenciale ose pjesën më të mirë të diçkaje. Në raste të tjera ajo nënkupton "një pjesë të një tërësie". Kjo tregon që Kurani është fjala e Atij që e njeh krijimin e njeriut në detajet më të hollësishme. Ai është Zoti, Krijuesi i njeriut.

Gjinia e foshnjes

Jo shumë kohë më parë mendohej se gjinia e foshnjes përcaktohej prej qelizave të nënës. Ose më saktë, besohej se gjinia ishte e përcaktuar nga qelizat e mashkullit dhe të femrës së bashku. Por në Kuran na është dhënë një informacion i ndryshëm, sipas të cilit të dy gjinitë janë krijuar nga "pika e farës që hidhet".

**”Ai i krijoi të dy gjinitë, mashkullin dhe femrën, prej pikës së farës që hidhet.”
(Sure Nexhm 46-47)**

Zhvillimi i disiplinave të gjenetikës dhe biologjisë molekulare ka vërtetuar shkencërisht saktësinë e këtij informacioni të dhënë në Kur'an. Tani është e qartë se gjinia përcaktohet nga qelizat spermatozoide të mashkullit, ndërsa femra nuk luan asnjë rol në këtë proces.

Kromozomet janë elementet bazë në përcaktimin e gjinisë. Dy nga 46 kromozomet, të cilat përcaktojnë strukturën e njeriut, janë të njohura si kromozomet e gjinisë. Këto dy kromozome të mashkullit janë emërtuar ”XY”, ndërsa të femrat ”XX”, sepse forma e këtyre kromozomeve ngjason me këto shkronja. Kromozomi Y mban kodin gjenetik të mashkullit.

Formimi i një foshnjeje fillon me bashkimin e dy kromozomeve, atë të babait dhe atë të nënës. Pasiqë femra ka vetëm kromozome X, qelizat e saj reproduktuese (vezoret) përmbajnë vetëm kromozomet X. Meshkujt në anën tjetër, posedojnë të dy kromozomet X dhe Y, kështuqë gjysma e qelizave të tyre reproduktuese (spermatozoidet) përmban kromozomet X, ndërsa gjysma tjetër përmban kromozomet Y. Nëse një vezore bashkohet me një spermatozoid që përmban një kromozom X, atëherë pasardhësi do të jetë femër; nëse bashkohet me një spermatozoid që përmban kromozomin Y, pasardhësi do të jetë mashkull.

Me fjalë të tjera, gjinia e foshnjës përcaktohet nga ajo se cili kromozom i mashkullit bashkohet me atë të femrës.

Asgjë prej këtij informacioni nuk dihej para shekullit XX, gjatë të cilit u zbuluan gjenet. Me të vërtetë, më parë besohej se gjinia e foshnjës përcaktohej nga gjendja (shëndeti, etj) e organizmit të femrës. Kjo është edhe arsyeja pse gratë fajësoheshin kur lindnin vajza.

Trembëdhjetë shekuj para zbulimit të gjeneve, në Kuran shpallet lajmi i cili hodhi poshtë këtë besim të kotë, duke bërë të qartë se gjinia e njeriut nuk e ka pikënisjen nga femra, por te sperma e mashkullit.

Ngjitja e lëngut të mpiksuar në mitër

Nëse do të vazhdonim t'i studionim më tej argumentet e shpallura në Kur'an rreth formimit të embrionit të njeriut, përsëri do të hasim në disa mrekulli shkencore të tjera shumë të rëndësishme.

Kur qeliza spermatozoide bashkohet me vezën e femrës, fillon të formohet qeliza bazë e embrionit. Kjo qelizë e vetme, e cila njihet në biologji me emrin ”zigotë”, fillon menjëherë të riprodhohet nëpërmjet ndarjes dhe më pas shndërrohet në një ”copë të vogël mishi”.

Sidoqoftë, gjatë periudhës së zhvillimit, embrioni nuk qëndron në zbrazëti. Ai ngjitet në mitër siç ngjiten rrënjët e një bime, të cilat fiksohen fort në tokë nëpërmjet lozeve të tyre. Nëpërmjet kësaj lidhjeje, embrioni arrin të marrë prej trupit të nënës substancat e nevojshme për jetë.

Në këtë pikë, një mrekulli mjaft domethënëse është shpallur në Kur'an. Duke iu referuar zhvillimit të embrionit në barkun e nënës, Zoti përdor në Kur'an fjalën ”alek”:

”Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi çdo gjë. Krijoi njeriun prej alekut (mpiksjes) (në mitrën e nënës). Lexo, se Zoti yt është më bujari!” (El-Alek 1-3)

Nga ana gjuhësore, fjala alek ka kuptimin e ”diçkaje të varur apo të ngjitur në diçka tjetër”. E njëjta fjalë përdoret për të përshkruar shushunjat që ngjiten ne trup për të thithur gjakun.

Sigurisht, përdorimi i kësaj fjale për të përshkruar në mënyrë mjaft të përshtatshme zhvillimin e embrionit në barkun e nënës, vërteton edhe një herë se Kur’ani është shpallje nga Zoti, Zoti i Botërave.

Mbështjellja e muskujve rreth eshtrave

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i informacionit të dhënë në ajetet e Kur’anit janë fazat e zhvillimit të një qenieje njerëzore në mitrën e nënës. Në këto ajete pohohet se në mitrën e nënës së pari zhvillohen eshtrat dhe më pas formohen muskujt që I mbështjellin ato:

“Pastaj e shndërruam pikën në alek (mpiksje), pastaj alekun e shndërruam në copë mishi, pastaj këtë copë mishi e shndërruam në eshtra, pastaj eshtrave u veshëm mishin, pastaj e bëmë njeriun krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është Zoti, Krijuesi më i mirë.” (Sure Mu’minun: 12-14)

Embriologjia është një disiplinë shkencore që studion zhvillimin e embrionit në mitrën e nënës. Deri pak kohë më parë, embriologët ishin të mendimit se eshtrat dhe muskujt në embrion zhvillohen në të njëjtën kohë. Për këtë arsye, për një kohë të gjatë, disa njerëz pretendonin se këto ajete ishin në kundërshtim me shkencën. Por kërkimet e fundit mikroskopike, të bëra duke u mbështetur në teknologjinë moderne, zbuluan se shpallja në Kur’an është e saktë fjalë për fjalë.

Vëzhgimet në nivele mikroskopike treguan se zhvillimi i embrionit në barkun e nënës ndodh në përputhje të plotë me mënyrën se si përshkruhet në Kur’an. Së pari, indet kërcore të embrionit kthehen në eshtra. Më pas, qelizat muskulore, të cilat zgjedhen prej indeve përreth eshtrave bashkohen dhe mbështjellin eshtrat.

Ky proces është shpjeguar si më poshtë në një botim shkencor të titulluar Zhvillimi i Njeriut:

Gjatë javës së shtatë, skeleti fillon të shpërndahet nëpër tërë embrionin dhe eshtrat marrin formën e tyre natyrale. Në fund të javës së shtatë dhe gjatë javës së tetë, muskujt zënë vendin e tyre rreth formave të kockës. 37

Pra, fazat e zhvillimit të njeriut të përshkruara në Kur’an janë në harmoni të plotë me zbulimet e embriologjisë bashkëkohore.

Fazat e foshnjës në mitër

Në Kur’an është shpallur se njeriu është krijuar në barkun e nënës në tri faza.

”... Ai u krijoi në barqet e nënave tuaja, krijim (etapë) pas krijimi në tri errësira. Ky është Allahu, Zoti juaj, vetëm i Tij është pushteti, nuk ka tjetër pos Tij. E, si pra, i shmangeni (adhurimit të Tij)?” (Sure Zumer: 6)

Siç mund të shihet nga ajeti i mësipërm, njeriu është krijuar në barkun e nënës në tri faza të veçanta. Me të vërtetë, biologjia bashkëkohore ka zbuluar se zhvillimi embrional i foshnjës realizohet në tre sektorë të veçantë në barkun e nënës. Sot, në të gjitha tekstet e embriologjisë që studiohen në

fakultetet e mjekësisë, ky subjekt trajtohet si pjesë e njohurive themelore. Për shembull, në librin Embriologjia elementare njerëzore, i cili është një referencë e rëndësishme në fushën e embriologjisë, ky fakt përshkruhet si më poshtë:

“Jeta në mitër kalon në tri faza: paraembrionale (dy javët e para dhe gjysma e javës së tretë), embrionale – deri në fund të javës së tetë dhe fetale – fundi i javës së tetë e deri në lindje.” 38

Këto faza u referohen etapave të ndryshme të zhvillimit të një foshnjeje. Shkurt, karakteristikat kryesore të këtyre etapave janë dhënë më poshtë:

Faza paraembrionale:

Në këtë fazë të parë, zigota rritet nëpërmjet ndarjes dhe, kur bëhet një grumbull shumëqelizor, ajo ngjitet në muret e mitrës. Ndërsa vazhdojnë të rriten, qelizat organizohen në tri shtresa.

Faza embrionale:

Kjo fazë zgjat për pesë javë e gjysmë, gjatë së cilës foshnja quhet ”embrion”. Në këtë fazë, sistemet dhe organet kryesore të trupit fillojnë të shfaqen prej shtresave qelizore.

Faza fetale:

Në këtë fazë, embrioni quhet ”fetus”. Kjo fazë fillon në javën e tetë të shtatzanisë dhe zgjat deri në momentin e lindjes. Karakteristikë dalluese e kësaj faze është se fetusi merr formën e një qenieje njerëzore me fytyrë, duar dhe këmbë. Megjithëse fillimisht është vetëm 3 cm i gjatë, që të gjitha

organet e tij janë të dallueshme. Kjo fazë zgjat për rreth 30 javë dhe zhvillimi vazhdon deri në javën e

lindjes.

Informacioni mbi zhvillimin e foshnjës në barkun e nënës u bë i mundur vetëm pasi u bënë vëzhgime

me mjete dhe metoda bashkëkohore. Si shumë argumente të tjera shkencore, disa pjesë të këtij informacioni janë shpallur në ajetet e Kur’anit. Fakti se një informacion kaq i hollësishëm dhe i saktë është dhënë në Kur’an në një kohë kur njerëzit kishin njohuri të pakta mbi çështjet e mjekësisë, është një tregues i qartë se Kur’ani nuk është fjala e njeriut, por është fjala e Zotit.

IDENTITETI NË SHENJAT E GISHTËRINJVE

Ndërsa pohohet në Kur'an se është një gjë e lehtë për Zotin ta ringjallë njeriun pas vdekjes së tij, shenjat e gishtërinjëve të njerëzve theksohen në mënyrë të veçantë:

Po, Ne jemi të zotë t'i krijojmë përsëri edhe majat e gishtërinjve të tij!” (Sure Kijame 3-4)

Theksimi i shenjave të gishtërinjve ka një domethënie mjaft të veçantë, sepse secili ka shenjën e tij unike të gishtërinjve, e cila nuk i ngjason askujt. Çdo person që jeton apo ka jetuar në këtë botë ka formën e tij unike të shenjave të gishtërinjve.

Për këtë arsye, shenjat e gishtërinjve janë një provë shumë e rëndësishme e identitetit, veçori vetëm e pronarit e tyre, ndaj dhe sot përdoren pikërisht për këtë qëllim në mbarë botën.

Por më e rëndësishmja është se kjo veçori e shenjave të gishtërinjve u zbulua nga fundit i shekullit XIX. Përpara kësaj periudhe, njerëzit i shihnin shenjat e gishtërinjve si disa rrathë të zakonshëm, pa ndonjë rëndësi apo kuptim specifik. Është Kura'ni ai që na flet për këtë karakteristikë dalluese të

shenjave të gishtërinjve, e cila nuk u kuptua veçse në ditët tona.

PJESA E DYTË

ATA QË NUK JANË NË GJENDJE TË SHOHIN FAKTIN E KRIJIMIT

Mashtrimi i evolucionit

Teoria e evolucionit është një filozofi dhe një kuptim i botës që prodhon hipoteza të rrejshme, supozime dhe skenare të imagjinuara në mënyrë për të shpjeguar ekzistencën dhe zanafillën e jetës me anë të rastësive. Rrënjët e kësaj filozofie shkojnë prapa deri në lashtësi dhe në Greqinë antike.

Të gjitha filozofitë ateiste që e mohojnë krijimin, drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë përqafojnë dhe mbrojnë idenë e evolucionit. E njëjta gjë vlen sot për të gjitha ideologjitë dhe sistemet që janë armiqësore ndaj fesë.

Nocioni i evolucionit është mbuluar me një maskë shkencore për një shekull e gjysmë të fundit në mënyrë që të arsyetohet vetveten. Edhe pse e paraqitur si një teori e ashtuquajtur shkencore gjatë mesit të shekullit të 19të, teoria, përkundër përpjekjeve më të mira të përkrahësve të saj, nuk është vërtetuar gjë më tani me anë të asnjë zbulimi apo eksperimenti shkencor. Vërtet, “pikërisht shkenca” në të cilën mbështetet aq shumë teoria ka dëshmuar dhe vazhdon të dëshmojë vazhdimisht se teoria nuk ka vlerë në realitet.

Eksperimentet laboratorike dhe llogaritjet e probabilitetit e kanë bërë përfundimisht të qartë se amino acidet prej të cilave buron jeta nuk kanë mundur të formohen rastësisht. Qeliza, e cila kinse u shfaq rastësisht në gjendjen primitive dhe të pakontrolluar të tokës sipas evolucionistëve, ende nuk mund të sintetizohet madje edhe në laboratorët më të sofistikuar të teknologjisë më të përparuar të shekullit 20të. As edhe një “formë kalimtare” e vetme, krijesa të cilat supozohet të tregojnë evolucionin gradual të organizmave të përparuar prej atyre më primitiv siç pretendon teoria neo-Darviniste, kurrë nuk është gjetur askund në botë përkundër hulumtimeve më se të kujdesshme dhe të zgjatura në regjistrin e fosileve.

Duke u përpjekur të mbledhin dëshmi për evolucionin, evolucionistët padashje kanë dëshmuar me duart e tyre se evolucioni s’ka mundur të ndodhë fare!

Personi i cili fillimisht paraqiti teorinë e evolucionit, para së gjithash në formën në të cilën ajo mbrohet sot, ishte një biolog amater anglez i quajtur Çarlls Robert Darwin. Darvini së pari botoi idetë e tij në një libër të titulluar Origjina e Llojeve me anë të Seleksionimit Natyror në vitin 1859. Në librin e tij Darvini pretendon se të gjitha gjallesat kishin një stërgjysh të përbashkët dhe se ato evoluan prej njëra tjetrës me anë të seleksionimit natyror. Ato që më së miri iu përshtatën mjedisit ku jetonin bartën vetitë e tyre tek gjeneratat pasuese dhe me anë të akumulimit gjatë epokave/periudhave të gjata kohore, këto kualitete dobiprurëse shndërruan/transformuan individët në specie krejtësisht të ndryshme prej paraardhësve të tyre. Pra, qenia njerëzore ishte produkti më i zhvilluar/më i përparuar i

mekanizmit të seleksionimit natyror. Me pak fjalë, zanafilla e një specie ishte një tjetër specie.

Idetë e çuditshme të Darvinit u muarën dhe u promovuan nga qarqe të caktuara ideologjike dhe politike dhe teoria u bë shumë e famshme. Arsyeja kryesore ishte se niveli i njohurive të asaj kohe nuk ishte ende i mjaftueshëm për të nxjerr në shesh se skenaret e imagjinuara të Darvinit ishin të rrejshme. Kur Darvini paraqiti supozimet e tij, disiplinat e gjenetikës, mikrobiologjisë dhe biokimisë nuk ekzistonin ende. Po të kishin ekzistuar, Darvini do të kishte mundur të kuptonte me lehtësi se teoria e tij ishte krejtësisht joshkencore dhe prandaj s'do të kishte provuar të përparonte pohime aq të pakuptimta: informacioni që përcakton speciet tashmë ekziston në gjene dhe është e pamundur që seleksionimi natyror të krijojë specie të reja duke i ndryshuar gjenet.

Ndërsa ndjehej jehona e librit të Darvinit, një botanist austriak me emrin Gregor Mendel zbuloi ligjet e

trashëgimisë në vitin 1865. Jo shumë i dëgjuar deri në fund të shekullit, zbulimi i Mendelit mori rëndësi të veçantë në fillimin e viteve 1900. Ky zbulim shënoi lindjen e shkencës së gjenetikës. Më pas, u zbulua struktura e gjeneve dhe kromozomeve. Zbulimi, në vitin 1950, i ADN-së, e cila mban informacionin e koduar gjenetik e vuri teorinë e evolucionit në një krizë të thellë, sepse origjina e sasisë së pafund të informacionit në ADN assesi nuk mund të shpjegohej me anë të ndodhive të rastësishme.

Përkundër gjithë këtyre zhvillimeve shkencore, asnjë formë kalimtare, të cilat supozohej të shfaqnin evolucionin gradual të organizmave të gjallë prej specieve primitive tek ato të përparuara, nuk janë gjetur kurrë përkundër hulumtimeve të gjata.

Këto zhvillime është dashur që të rezultojnë me hudhjen e teorisë së Darëinit në shportën e plehërave të historisë. Megjithatë, kjo nuk ndodhi, meqë qarqe të caktuara insistuan në rishikimin, ripërtëritjen dhe ringritjen në nivele "shkencore" të kësaj teorie. Këto përpjekje marrin kuptim vetëm nëqoftëse kuptojmë se pas teorisë së evolucionit nuk shtrihen mendime korrekte shkencore, por qëllime ideologjike.

Megjithatë, disa qarqe që besonin në domosdoshmërinë e mbështetjes së një teorie që kishte arritur në një rrugë pa krye së shpejti ngritën një model të ri. Emri i këtij modeli të ri ishte neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie, speciet evoluan si rezultat i mutacioneve, ndryshimeve të vogla në gjenet e tyre dhe ato që ishin më të afta mbijetuan përmes mekanizmit të seleksionimit natyror. Mirëpo, kur u vërtetua se mekanizmat e propozuar nga neo-Darvinizmi ishin të pavlefshme dhe se ndryshimet e vogla nuk mjaftonin për formimin e qenieve të gjalla, evolucionistët vazhduan të kërkonin modele të reja. Ata dolën me një pretendim të ri të quajtur "barazpesha e ndërprerë" e cila nuk ka mbështetje mbi asnjë bazë shkencore apo racionale. Sipas këtij modeli qeniet e gjalla papritmas evoluan në një specie tjetër pa ndonjë formë kalimtare. Me fjalë të tjera, speciet pa "paraardhës" evolutiv u shfaqën papritmas. Ata u munduan ta mbulojnë këtë me skenare të pakapshme. Për shembull, ata thanë se zogu i parë në histori ka mundur papritmas në mënyrë të pashpjegueshme të ketë dalur prej vezës së një reptili. Sipas teorisë së njëjtë kafshët mishngrënëse të tokës kanë mundur të shndërrohen në balena gjigante, që i janë nënshtruar një transformimi të befasishtë dhe gjithëpërfshirës.

Këto pohime, që në tërësi bien në kundërshtim me të gjitha rregullat e gjenetikës, biofizikës dhe biokimisë janë poaq shkencore sa edhe përrallat e bretkocave që shndërrohen në princa! Sidoqoftë, duke qenë në një gjendje të dëshpëruar për krizën në të cilën ndodhej pohimi neo-Darvinist, disa paleontologë evolucionist përqaftuan këtë teori, e cila dallohet si edhe më e çuditshme se vet neo-Darvinizmi.

I vetmi qëllim i këtij modeli ishte që të ofronte një shpjegim për boshllëqet në të dhënat fosile/regjistrin e fosileve që modeli neo-Darvinist nuk mund ta shpjegonte. Megjithatë, nuk është aq e logjikshme të shpjegohet boshllëku në regjistrin e fosileve të evolucionit të zogjëve me një pretendim se “një zog papritmas doli nga një vezë e zvarranikut”, sepse, me vet pranimin e evolucionistëve, evolucioni i një specie në një tjetër kërkon një ndryshim të madh dhe të favorshëm në informacionin gjenetik. Mirëpo, asnjë mutacion çfarëdoqoftë nuk përmirëson informacionin gjenetik apo të shtoj informacion të ri në të. Mutacionet vetëm çrregullojnë informacionin gjenetik. Pra, “mutacionet e mëdha” të imagjinuara nga modeli i barazpeshës së ndërprerë, do të mund të shkaktonte vetëm degradime dhe dëmtime “të mëdha” në informacionin gjenetik.

Teoria e barazpeshës së ndërprerë ishte qartë vetëm një produkt i imagjinatës. Përkundër kësaj të vërtetë të qartë, mbrojtësit e evolucionit nuk ngurruan të nderojnë këtë teori. Fakti se modeli i evolucionit i propozuar prej Darvinit nuk mund të vërtetohej nga të dhënat fosile i shtyri ata që të veprojnë kështu. Darvini pohonte se speciet iu nënshtruan një ndryshimi gradual, i cili kishte nevojë për ekzistencën e monstrumëve gjysëm-zog/gjysëm-zvarranik dhe gjysëm-peshk/gjysëm-zvarranik. Mirëpo, as edhe një prej këtyre “formave kalimtare” nuk është gjetur përkundër studimeve gjithëpërfshirëse të evolucionistëve dhe qindra dhe mijëra fosileve që u zhvarrosën.

Evolucionistët u kapën pas modelit të barazpeshës së ndërprerë me shpresë që të fshehin këtë dështim të madh të fosileve. Siç kemi theksuar më parë, ishte shumë e qartë se kjo teori është një fantazi, kështuqë ajo shumë shpejt e konsumoi vetveten. Modeli i barazpeshës së ndërprerë kurrë nuk u paraqit si model i qëndrueshëm, por më tepër u përdor si një shpëtim në rastet që hapur nuk i përshtateshin modelit të evolucionit gradual. Pasiqë evolucionistët sot e kuptojnë se organet komplekse si sytë, krahët, mushkëritë, truri dhe të tjera në mënyrë të qartë hedhin poshtë modelin e evolucionit gradual, në këto pika të veçanta ata janë të detyruar të strehohen në interpretimet fantastike të modelit të barazpeshës së ndërprerë.

A ekziston ndonjë e dhënë fosile që do të vërtetonte Teorinë e Evolucionit?

Sipas teorisë së evolucionit, evolucioni i një specie në një specie tjetër ndodhë gradualisht, hap pas hapi gjatë miliona vjetëve. Përfundimi logjik i nxjerrur prej një pretendimi të tillë është se organizma të gjallë monstruoz të quajtur “forma kalimtare” duhet të kenë jetuar gjatë këtyre periudha të transformimit. Pasiqë evolucionistët supozojnë se të gjitha gjallesat evoluan prej njëra tjetrës hap pas hapi, numri dhe llojllojshmëria e këtyre formave kalimtare do të duhej të ketë qenë me miliona.

Po të kishin jetuar me të vërtetë krijesa të tilla, atëherë ne do të duhej të shihnim eshtrat e tyre gjithkund. Në të vërtetë, poqese kjo tezë është e saktë, numri i formave të

ndërmjetme kalimtare duhet të jetë madje edhe më i madh se numri i specieve të kafshëve të gjalla sot dhe eshtrat e tyre të fosilizuar do të duhej të ishin në mbarë botën në sasi të mëdha.

Prej Darvinit, evolucionistët kanë hulumtuar fosilet dhe rezultati për ta ka qenë një zhgënjim dërrmues. Askund në botë – as në tokë e as në thellësitë e detit – nuk është zbuluar asnjëherë asnjë formë e ndërmjetme kalimtare në mes të dy specieve.

Vet Darvini ishte plotësisht i vetëdijshëm për mungesën e formave të tilla kalimtare. Shpresa më e madhe e tij ishte që ato do të gjindeshin në të ardhmën. Përkundër shpresës së tij, ai e vërejtë se pengesa më e madhe për teorinë e tij ishin format kalimtare që mungonin. Për këtë arsye, në librin e tij Zanafilla e Specieve, ai shkruajti:

Pse, nëse speciet kanë rrjedhur prej specieve tjera me anë të ndryshimeve graduale delikate, nuk shohim gjithandej forma të panumërta kalimtare? Pse nuk është e gjithë natyra e parregullt, në vend se speciet të jenë, siç i shohim mirë të përcaktuara? ...Por, pasi që sipas kësaj teorie forma të panumërta kalimtare duhet të kenë ekzistuar, pse nuk i gjejmë të futura/ngulitura në numër të madh në korën e tokës? ...Në regjionin e ndërmjetëm, duke pasur kushte të ndërmjetme të jetës, pse nuk gjejmë lloje të ndërmjetme që kanë lidhje të drejtpërdrejt me njëra tjetrën? Kjo vështirësi më ka hutuar plotësisht për një kohë të gjatë.

39

Darvini kishte të drejtë të shqetësohej. Ky problem shqetësoonte edhe evolucionistët e tjerë poashtu. Një paleontolog i famshëm britanik, Derek V. Ager, pranon këtë fakt të sikletshëm:

Argumenti që shfaqet poqese ekzaminojmë të dhënat fosile në hollësi, qoftë në nivel të rendeve apo të specieve, zbulojmë – pandërprerë – jo një evolucion gradual, por një eksplodim të papritur të një grupi në llogari të tjetrit. 40

Boshllëqet në të dhënat fosile nuk mund të sqarohen me anë të të menduarit sipas dëshirës se një numër i pamjaftueshëm i fosileve është zhvarrosur dhe se këto fosile që mungojnë një ditë do të gjinden. Një paleontolog evolucionist tjetër, T. Neville George, shpjegon këtë mënyrë të gjykuarit:

Nuk ka nevojë më të kërkohet falje për varfërinë e të dhënave fosile. Në një mënyrë, është bërë gadi pamenaxhueshëm e pasur dhe zbulimi është duke lënë prapa integrimin... Të dhënat fosile megjithashtë vazhdojnë të përbëhen kryesisht prej boshllëqeve. 41

Jeta u shfaq në tokë papritur dhe në forma komplekse

Kur shqyrtohen shtresat gjeologjike tokësore dhe të dhënat fosile, duket se organizmat e gjallë u shfaqën njëkohësisht. Shtresa më e vjetër tokësore në të cilën janë gjetur fosile është ajo e Kambrianit, e cila ka një moshë 530-520 milionë vjeçare.

Gjallesat e gjetura në shtresat që i përkasin periudhës Kambriane shfaqen në të dhënat fosile të gjitha papritur; nuk gjenden paraardhës që të kenë ekzistuar më parë. Fosilet e gjetura në shkëmbinjtë Kambrianë janë fosile kërminjsh, trilobitesh, sfungjerësh, krimbash toke, meduzash, iriqësh deti dhe jovertebrorësh të tjerë. Ky mozaik i larmishëm i organizmave të gjallë i përbërë prej një numri kaq të madh qeniesh komplekse është shfaqur kaq papritur, sa që është quajtur në literaturën gjeologjike

"Shpërthimi i Kambrianit".

Shumica e formave të jetës të zbuluara në këtë shtresë kanë sisteme të ndërlikuara si sy, apo sisteme qarkullimi dhe struktura fiziologjike të avancuara si velëzat, dhe kështu me rradhë. Nuk ka gjurmë në të dhënat fosile për të treguar se këta organizma nuk kishin ndonjë paraardhës. Riçard Monasterski, botuesi i revistës "Earth Sciences (Shkencat Tokësore)", thotë për shfaqjen e papritur të gjallesave:

Pesëqind milionë vjet më parë u shfaqën papritur format komplekse të kafshëve që ne shikojmë sot. Ky moment, tamam në fillim të periudhës Kambriane, 550 milionë vjet më parë, shënon shpërthimin evolutiv që mbushi detet me krijesat e para komplekse të botës. Një numër i madh i kafshëve të sotme ka qenë i pranishëm që në Kambrianin e hershëm dhe ato ishin të ndara mirë nga njëra-tjetra, ashtu siç janë sot. 42

Duke mos qenë në gjendje të gjejnë përgjigjet në pyetjen se si ndodhi që ky numër i madh i llojeve të ndryshme të kafshëve të vërshoi në tokë krejt papritur, evolucionistët parashtrojnë një periudhë imagjinare prej 20 milionë vjetësh para Periudhës Kambriane për të shpjeguar se si zuri fill jeta dhe "ndodhi e panjohura". Kjo periudhë është quajtur "boshllëku evolutiv". Asnjë dëshmi për këtë nuk është gjetur kurrë dhe koncepti është ende i mjegullt dhe i padefinuar madje edhe në ditët tona.

Në vitin 1984, jovertebrorë kompleks të panumërt u zhvarrosën në Çengjiang, i vendosur në platonë qendrore të Junanit në malësinë e Kinës jugperëndimore. Në mesin e tyre ishin trilobitet, tani të zhdukura, por aspak më jokomplekse se çfarëdo pakurrizori/jovertebrori i kohës së sotme.

Paleo-antropologu evolucionist suedez, Stefan Bengtson, e përshkruan këtë si më poshtë:

Nëse çfarëdo ngjarje në historinë e jetës ngjason me mitet e krijimit të njeriut, është ky shumëfishim i jetës në det kur organizmat shumëqelizore mbisunduan si aktorë dominant në ekologji dhe evolucion. Hutuese (dhe shqetësuese) për Darwinin, kjo ndodhi akoma na huton. 43

Shfaqja e papritur/e përnjëhershme e këtyre gjallesave komplekse pa paraardhës nuk është më pak hutuese (dhe shqetësuese) për evolucionistët sot se sa që ishte për Darwinin 135 vjet më parë. Për gadi një shekull e gjysmë ata nuk kanë bërë asnjë hap matanë pikës që e vuri Darwinin në pozitë të pavoritshme.

Siç mund të shihet, të dhënat fosile tregojnë se gjallesat nuk evoluuan nga forma primitive tek ato më të avancuara, por ato u shfaqën të gjitha njëherësh dhe në një gjendje të përsosur. Mungesa e formave kalimtare nuk është veçori e periudhës Kambriane. As edhe një formë e vetme kalimtare që të vërtetonte "përparimin" e supozuar evolutiv të kurrizorëve – prej peshqve deri te amfibiet, zvarranikët, zogjët dhe gjitharët – nuk është gjetur kurrë. Çdo gjallesë shfaqet përnjëherë dhe në formën e saj ekzistuese, të përkryer dhe të plotë, në të dhënat fosile.

Me fjalë të tjera, gjallesat nuk erdhën në ekzistencë nga evolucioni. Ato u krijuan.

Falsifikimet e evolucionit Mashtrimet në vizatime

Të dhënat fosile janë burimi kryesor për ata të cilët kërkojnë prova për teorinë e evolucionit. Kur të shqyrtohet në mënyrë të kujdesshme dhe pa paragjykim, të dhënat fosile hedhin poshtë teorinë e evolucionit para se ta mbështesin atë. Megjithatë, interpretimet çorientuese të fosileve nga evolucionistët dhe paraqitja e tyre e paragjykuar në opinion kanë lënë përshtypjen tek shumë njerëz se të dhënat fosile në të vërtetë e mbështesin teorinë e evolucionit.

Ndjeshmëria e disa gjetjeve në të dhënat fosile ndaj gjithfarë interpretimesh është ajo që më së miri u shërben qëllimeve të evolucionistëve. Fosilet e zhvarrosura në të shumtën e kohës nuk janë të kënaqshme për identifikim të besueshëm. Ato zakonisht përbëhen prej fragmenteve të shpërndarë dhe jo të plota të eshtrave. Për këtë arsye është shumë lehtë të shtrembërohen të dhënat e disponueshme dhe të përdorën sipas dëshirës. Nuk çudit pse rikonstruktivet (vizatimet dhe modelet) e bëra prej evolucionistëve të bazuara në mbeturina të tilla të fosileve përgaditen në mënyrë krejtësisht spekulative për të vërtetuar tezat e evolucionit. Pasiqë njerëzit ndikohen pa vështirësi me anë të informacionit vizual, këto modele të rikonstruktura imagjinare përdoren për t'i bindur ata se krijesat e rikonstruktura kanë ekzistuar me të vërtetë në të kaluarën.

Hulumtuesit evolucionist vizatojnë krijesa të imagjinuara të ngjashme me njeriun, duke u nisur zakonisht prej një dhëmbi të vetëm, ose një fragment/copëz të nofullës së poshtme apo të krahut dhe ia paraqesin ato opinionit në një mënyrë senzacionale, sikurse të ishin ato hallka në evolucionin njerëzor. Këto vizatime kanë luajtur një rol të madh në vendosjen e imazhit të “njerëzve primitiv” në mendjet e shumë njerëzve.

Këto studime të bazuara në mbeturinat e eshtrave mundën vetëm të zbulojnë karakteristikat e përgjithshme të krijesës në fjalë. Elementet dalluese janë të pranishme në indet e buta të cilat zhduken shpejt me kalimin e kohës. Me interpretimin spekulativ të indeve të buta, gjithçka bëhet e mundshme përbrenda kufijve të imagjinatës të regjisorit/prodhuesit të rikonstruktimit. Earnst A. Hooten prej Universitetit të Harvardit shpjegon këtë situatë kështu:

Të përpiqesh të restaurosh pjesët e buta është një ndërmarrje edhe më e rrezikshme. Buzët, sytë, veshët dhe maja e hundës nuk japin kurrfarë të dhëna për pjesët kockore që ndodhen nën to. Me një lehtësi të njëjtë mund të modeloni në kafkën e një Neandertali tiparet e një shimpanze apo vijat e një filozofi. Këto restaurime të supozuara të tipeve të lashta të njeriut kanë një vlerë shumë të vogël apo kurrfarë vlere shkencore dhe mundën vetëm të çorientojnë publikun... Pra mos i besoni rikonstruktivet. 44

Studimet e bëra për të fabrikuar fosile të rrejshme

Të paaftë për të gjetur dëshmi të vlefshme në të dhënat fosile për teorinë e evolucionit, disa evolucionistë kanë provuar të fabrikojnë dëshmitë e tyre. Këto përpjekje, të cila janë përfshirë madje edhe në enciklopedi nën titullin “falsifikimet e evolucionit”, janë treguesi më i efektshëm se teoria e evolucionit është një ideologji dhe filozofi që evolucionistët janë të vendosur ta mbrojnë me çdo kusht. Dy prej këtyre falsifikimeve më skandaloze dhe më famëkeqe janë përshkruar më poshtë.

Njeriu i Piltdaunit:

Një doktor i njohur dhe një paleo-antropolog i shquar, Charles Daëson, deklaroi në 1912 se kishte gjetur një kockë nofullë dhe një fragment kafke në një gropë, në Piltdaun, Angli. Megjithëse kocka e nofullës anonte më shumë nga ajo e majmunit, ndërsa dhëmbët dhe kafka ishin si ato të njeriut, këto mostra të menduara si 500 mijë vjeçare u etiketuan me emrin "Njeriu i Piltdaunit" dhe u paraqitën në disa muze si prova absolute të evolucionit të njeriut. Për më shumë se 40 vjet, shumë artikuj shkencorë u shkruan për "Njeriun e Piltdaunit" si dhe u bënë shumë interpretime dhe piktura, kurse fosilet paraqiteshin si një argument i rëndësishëm i evolucionit të njeriut.

Në vitin 1949, shkencëtarët e ekzaminuan fosilin edhe njëherë dhe erdhën në përfundim se "fosili" ishte një falsifikim I qëllimshëm që përbëhej prej një kafke njeriu dhe kockës së nofullës së një orangutangu.

Duke përdorur metodën e fluorit për të përcaktuar vjetërsinë, hulumtuesit zbuluan se kafka ishte vetëm disa mijëra vjeçare e vjetër. Dhëmbët në kockën e nofullës të cilat i përkisnin një orangutangu ishin të vendosura artificialisht në të dhe veglat "primitive" të zbuluara së bashku me fosilet ishin thjesht falsifikime të vrazhda të mprehura me pajisje hekuri. Ky falsifikim u bë publik në vitin 1953 në analizën e hollësishme të bërë nga Oakley, Veiner dhe Clark. Kafka i përkiste një njeriu 500 vjeçar, ndërsa kocka e nofullës i përkiste një majmuni të ngordhur pak kohë më parë! Dhëmbët ishin rregulluar më vonë dhe i ishin shtuar nofullës dhe bashkimet ishin bërë në atë mënyrë që të dukeshin si ato të njeriut. Pastaj të gjitha pjesët ishin veshur me dikromat potasiumi për t'i dhënë një pamje të vjetër. (Kjo veshje u zhduk kur ato u zhytën në acid.) Le Gros Klark, i cili bënte pjesë në grupin që nxori në shesh mashtrimin, nuk mundi ta fshehtë habinë e tij për këtë situatë dhe tha:

Provat e gërvishtjeve artificiale binin menjëherë në sy. Në të vërtetë ato dukeshin kaq qartë sa që çdokush mund të pyesë: Si është e mundur që kjo t'i shpëtonte vëzhgimeve të mëparshme? 45

Njeriu i Nebraskës

Në vitin 1922, Henry Fairfield Osborn, menaxheri i Muzeut Amerikan të Historisë së Natyrës deklaroi se kishte zbuluar në Nebraskën perëndimore fosilin e një dhëmballe, e cila i përkiste periudhës së Pliocenit. Për këtë dhëmb u pohua se kishte karakteristikat e atij të njeriut dhe majmunit. Argumentimet shkencore filluan dhe sipas disa interpretimeve ky dhëmb i përkiste Pitekantropus Erektus, ndërsa sipas disa të tjerëve ky dhëmb ishte më afër njerëzve. Fosili që ngriti një debat të zjarrtë, u quajt "Njeriu i Nebraskës". Atij iu dha menjëherë një emër shkencor: Hesperopitekus

Haroldkuki.

Shumë autoritete e mbështetën Osbornin. Duke u bazuar në këtë dhëmb të vetëm, u bë rindërtimi i kokës dhe trupit të Njeriut të Nebraskës. Për më tepër, Njeriu i Nebraskës madje u vizatua si një familje e tërë.

Në vitin 1927 u gjetën poashtu edhe pjesë të tjera të skeletit. Sipas këtyre copave të zbuluara së fundi, dhëmbi nuk i përkiste as një njeriu e as një majmuni. U zbulua se ai i përkiste një specie të zhdukur derri të egër amerikan të quajtur Prostenops.

A kishin njerëzit dhe majmunët një paraardhës të përbashkët?

Sipas pohimeve të teorisë së evolucionit, njerëzit dhe majmunët e kohës sonë kanë paraardhës të përbashkët. Këto krijesa evoluuan në kohë dhe disa prej tyre u bënë majmunët e sotëm, ndërsa grupi tjetër që ndjekti një vijë tjetër të evolucionit u bënë njerëzit e sotëm.

Evolucionistët I thërrasin të ashtuquajturit paraardhës të parë të përbashkët të njerëzve dhe majmunëve "Australopitekus" që don të thotë "majmuni i Afrikës së jugut". Australopitekët, që nuk janë gjë tjetër veçse një specie e vjetër majmunësh të zhdukur, kanë ekzistuar në disa lloje. Disa kanë pasur struktura të ndërtuara mirë, ndërsa disa të tjerë kanë qenë të vegjël dhe me shtat të hollë. Evolucionistët e klasifikojnë fazën tjetër të evolucionit të njeriut si "homo", "njeri". Sipas evolucionistëve gjallesat në serinë "homo" janë më të zhvilluara se Australopiteku dhe jo shumë të ndryshëm nga njeriu modern. Njeriu i sotëm, Homo Sapiens, thuhet se ka formuar fazën e fundit të këtij evolucioni.

Çështja qëndron në faktin se qeniet e quajtura Australopitekus në këtë skenar të imagjinuar të fabrikuar prej evolucionistëve janë në të vërtetë majmunë që u zhdukën dhe qeniet në rendin Homo janë pjesëtarë të racave të ndryshme njerëzore që jetuan në të kaluarën dhe pastaj u zhdukën. Evolucionistët u ndisën fosile të ndryshme majmunësh dhe njerëzish në një renditje prej më të voglit gjer tek më i madhi në mënyrë që të formojnë një tablo të "evolucionit njerëzor". Hulumtimet, megjithatë, kanë treguar se këto fosile asesi nuk nënkuptojnë një proces evolutiv dhe disa prej këtyre paraardhësve të supozuar të njeriut ishin majmunë të vërtetë ndërsa disa prej tyre ishin njerëz të vërtetë.

Tani le t'i hedhim një vështrim Australopitekut, i cili përfaqëson shkallën e parë të skemës së evolucionit njerëzor për evolucionistët.

Australopitekët: Majmunët e zhdukur

Evolucionistët pohojnë se Australopitekët janë paraardhësit më primitiv të njeriut bashkëkohor. Këta janë një specie e vjetër me një strukturë të kokës dhe kafkës të ngjashme me atë të majmunëve të sotëm, mirëpo me një kapacitet më të vogël të kafkës. Sipas pretendimeve të evolucionistëve, këto krijesa kanë një veti të rëndësishme që dëshmon se ata janë stërgjyshët e njerëzve: bipedalizmin/dykëmbësinë.

Lëvizjet e majmunëve dhe njerëzve janë krejtësisht të ndryshme. Qeniet njerëzore janë krijesat e vetme të gjalla që lëvizin lirshëm në dy këmbë. Disa kafshë kanë aftësi të kufizuar të lëvizjes në këtë mënyrë, por ato kanë skelete të kërrusura.

Sipas evolucionistëve, këto gjallesa të quajtura Australopitekë kishin aftësi të ecin duke e mbajtur trupin të kërrusur më tepër se duke mbajtur trupin drejtë si qeniet njerëzore. Madje edhe kjo ecje e kufizuar në dy këmbë mjaftonte për t'i inkurajuar evolucionistët t'i konsideronin këto krijesa sikurse ato të ishin stërgjyshërit e njeriut.

Megjithatë, dëshmia e parë që hudhte poshtë supozimet e evolucionistëve se Australopitekët ishin dykëmbësh erdh prej vet evolucionistëve. Studimet e hollësishme të bëra në fosilet e Australopitekëve i shtynë madje evolucionistët të pranojnë se ato dukeshin "tejet" të ngjashme me ato të majmunëve.

Duke qenë se kishte bërë një hulumtim të hollësishëm anatomik në fosilet e Australopitekëve në mesin e viteve të 1970ta, Çarlls E. Oksnard e krahasoi strukturën skeletore të Australopitekëve me atë të orangutangëve modernë:

Një pjesë e rëndësishme e njohurisë së sotme tradicionale për evolucionin njerëzor mbështetet në studimet e dhëmbëve, nofullave dhe copëzave të kafkës së fosileve të australopitekëve. Këto të gjitha tregojnë se lidhja e ngusht e australopitekut me familjen njerëzore mund t' mos jetë e vërtetë. Të gjitha këto fosile dallojnë prej gorillave, shimpanzave dhe njerëzve. Të studiuar si një grup, australopiteku duket më shumë si orangutangu. 46

Ajo që më të vërtetë i turpëroi evolucionistët ishte zbulimi se Australopiteku nuk kishte mundur të ecte në dy këmbë dhe me një mbajtje të kërrusur të trupit. Fizikisht do të ishte shumë e paefektshme për Australopitekusin, gjoja dykëmbësh por me një ecje të kërrusur, të lëvizte në atë mënyrë për shkak të kërkesave enorme të energjisë që do të kërkonte. Me anë të simulimeve kompjuterike të bëra në vitin 1996, paleo-antropologu anglez Robin Krompton demonstroi gjithashtu se një ecje e tillë “e përzier/e kombinuar” ishte e pamundshme. Krompton erdh deri te përfundimi vijues: një qenie e gjallë mund të ec ose drejtë ose me të katërtat. Një tip/lloj i ndërmjetëm i të ecurit nuk mund të mbahet për periudha të gjata për shkak të shpenzimit të skajshëm të energjisë. Kjo nënkupton se Australopitekusi nuk ka mundur të jetë të dyja, edhe dykëmbësh edhe të ketë një mbajtje të kërrusur të trupit.

Sipas të gjitha gjasave studimi më i rëndësishëm që provon se Australopitekusi nuk ka mundur të jetë dykëmbësh u bë në vitin 1994 nga hulumtuesi anatomist Fred Spur dhe ekipi i tij në Degën e Anatomisë së Njeriut dhe Biologjisë Qelizore të Universitetit të Liverpulit në Angli. Kjo ekipë bëri studime për dykëmbësinë e gjallesave të fosilizuara. Hulumtimi i tyre hetoi mekanizmin e barazpeshës së pavullnetshme të gjetur në kërmillin e veshit dhe zbulimet treguan bindshëm se Australopitekët nuk kanë mundur të jenë dykëmbësh. Kjo parandaloi çfarëdo pretendimi se Australopiteku ishte i ngjashëm me njeriun.

Rendi Homo: Qeniet e vërteta njerëzore

Hapi pasues në evolucionin e imagjinuar njerëzor është “Homo”, domethënë, rendi njerëzor. Këto qenie të gjalla janë njerëz të cilët nuk ndryshojnë prej njerëzve bashkëkohor, mirëpo që kanë disa dallime racore. Duke dashur/u përpjekur që t'i zmadhojnë këto dallime, evolucionistët i paraqesin këta njerëz jo si një “racë” të njeriut bashkëkohor, por si një “specie” tjetër. Megjithatë, siç do të shohim së shpejti, njerëzit e rendit Homo nuk janë asgjë tjetër pos tipe të racave të zakonshme të njeriut.

Sipas skemës imagjinare të evolucionistëve, evolucioni imagjinuar i brendshëm i species Homo është si vijon: Së pari Homo erektusi, pastaj Homo sapiens arkaik dhe Njeriu i Neandertalit, pastaj Njeriu i Kromanjonit dhe më në fund njeriu modern.

Përkundër pohimeve të evolucionistëve për të kundërtën, të gjitha “speciet” që i kemi numëruar më lartë nuk janë asgjë tjetër përveç qenie të vërteta njerëzore. Le ta shqyrtojmë së pari Homo erektusin, të cilit evolucionistët i referohen si specia më primitive e njeriut.

Dëshmia më mahnitëse që tregon se Homo erektusi nuk është një specie “primitive” është fosili i “Djaloshit të Turkanës”, njëres prej mbetjeve më të vjetra të Homo erektusit. Llogaritet se ky fosil ishte i një djali 12 vjeçar, i cili do të ishte 1.83 cm i gjatë në adoleshencë. Struktura e drejtë e skeletit të këtij fosili nuk dallon prej asaj të njeriut modern. Struktura skeletore e tij e gjatë dhe e hollë është në përputhje të plotë me atë të njerëzve që jetojnë në zonat tropikale të kohës sonë. Ky fosil është njëra prej dëshmimeve më të rëndësishme se Homo erektusi është thjeshtë një mostër e racës bashkëkohore njerëzore. Paleontologu evolucionist Riçard Leakey e krahason Homo erektusin dhe njeriu modern si më poshtë:

Njeriu do të vërente dallime poashtu në formën e kafkës, në shkallën e daljes përpara të fytyrës, të trashësisë së vetullave dhe kështu me rradhë. Këto dallime me siguri se nuk janë aspak më të shprehura se ato që i shohim sot në mes të racave të ndara gjeografike të njerëzve modern. Ndryshimi i tillë biologjik lind kur popullatat janë gjeografikisht të ndara prej njëra tjetrës për periudha të konsiderueshme kohore. 47

Leakey don të thot se dallimi në mes të Homo erektusit dhe neve nuk është më i madh se dallimi në mes të zezakëve dhe eskimezëve. Veçoritë e kafkës së Homo erektusit rezultuan nga mënyra e të ushqyerit të tyre dhe migrimit gjenetik dhe për shkak të mosasimilimit të tyre me raca tjera njerëzore për një periudha të gjatë kohore.

Një tjetër dëshmi e fuqishme se Homo erektusi nuk është një specie “primitive” është se fosilet e kësaj speciejë të një moshe prej njëzet e shtatë mijë vjet dhe madje trembëdhjetë mijë vjet janë zhvarrosur. Sipas një artikulli të botuar në Time – që nuk është një botim periodik shkencor, por që megjithatë kishte një ndikim gjithëpërfshirës në botën e shkencës – fosilet e Homo erektusit të vjetra njëzet e shtatë mijë vjet u zbuluan në ishullin Java. Në moçalin Koë në Australi, fosile rreth trembëdhjetë mijë vjet të vjetra u zbuluan që mbanin karakteristika të Homo-Sapiens Homo Erektus. Të gjitha këto fosile tregojnë se Homo erektusi vazhdoi të jetojë deri në kohërat shumë të afërta me kohën tonë dhe nuk ishin asgjë tjetër përveçse një racë njerëzore që prej atëherë është varrosur në histori.

Homo Sapiensi Arkaik dhe Njeriu i Neandertalit

Homo Sapiensi Arkaik është paraardhësi i drejtpërdrejtë i njeriut bashkëkohor në skemën imagjinare të evolucionit. Në të vërtetë, evolucionistët nuk kanë shumë për të thënë për këta njerëz, pasi që ekzistojnë vetëm dallime të vogla në mes tyre dhe njerëzve modern. Disa hulumtues madje thonë se përfaqësuesit e kësaj race ende jetojnë sot dhe i marrin si shembull Aborigjinët në Australi. Sikurse Homo sapiensët, Aborigjinët kanë gjithashtu vetulla të trasha të dala/të theksuara, një strukturë të nofullës të futur brenda dhe një vëllim pak më të vogël të kafkës. Për më tepër, zbulime të rëndësishme janë bërë që lënë të kuptohet se njerëz të tillë kishin jetuar në Hungari dhe në disa fshatra në Itali jo shumë kohë më parë.

Evolucionistët tregojnë me gisht nga fosilet njerëzore të zhvarrosura në luginën Neander të Holandës të cilat u emëruan Njeriu i Neandertalit. Shumë hulumtues bashkëkohor e përcaktojnë Njeriun e Neandertalit si një nën-specie të njeriut modern dhe e quajnë atë “Homo sapiens neandertalensis”. Padyshim se kjo racë jetoi së bashku me njerëzit modern në të njëjtën kohë dhe në të njëjtat territore. Gjetjet provojnë se

Neandertalet varrosnin të vdekurit e tyre, punonin instrumente muzikore dhe kishin afri kulturore me Homo sapiens sapiens që jetonin gjatë periudhës së njëjtë kohore. Kafkat dhe strukturat skeletore krejtësisht moderne të fosileve Neandertale nuk lënë hapësirë për çfarëdo spekulimi. Një autoritet i spikatur për këtë çështje, Erik Trinkhaus nga Universiteti i Nju Meksikos shkruan:

Krahasimet e detajuara të mbetjeve skeletore të Neandertalit me ato të njerëzve modern kanë treguar se nuk ekziston asgjë në anatominë e Neandertalit që do të tregonte në mënyrë bindëse aftësi inferiore lëvizëse, manipuluese, intelektuale apo gjuhësore në raport me ato të njerëzve modern. 48

Në të vërtetë, Neandertalët kishin madje disa përparësi “evolutive” ndaj njerëzve modern. Kapaciteti i kafkës së Neandertalëve ishte më i madh se ai i njeriut modern dhe ata ishin më të fuqishëm dhe më muskuloz se që jemi ne. Trinkhaus shton: “Njëra prej veçorive më karakteristike të Neandertalëve është vëllimi tejet i madh i trupit të tyre dhe eshtrave të gjymtyrëve. Të gjithë eshtrat e ruajtur sugjerojnë një fuqi rrallëherë të realizuar nga njerëzit modern. Për më tepër, kjo fuqi jo vetëm që është e pranishme tek mashkujt e rritur, siç mund të supozojë njeriu, por është gjithashtu e dukshme tek femrat e rritura, adoleshentët dhe madje edhe fëmijët.”

Thënë me saktësi, Neandertalët janë një racë e veçantë njerëzore që u asimilua me racat e tjera me kalimin e kohës.

Të gjithë këta faktorë tregojnë se skenari i “evolucionit njerëzor” i fabrikuar prej evolucionistëve është pjellë e imagjinatës së tyre dhe se njerëzit gjithmonë kanë qenë njerëz dhe majmunët majmunë.

Jeta nuk mund të rrjedhë prej rastësive

Teoria e evolucionit thot se jeta filloi me një qelizë që u formua rastësisht në kushtet e atmosferës fillestare tokësore. Prandaj, le të ekzaminojmë përbërjen e qelizës me krahasime të thjeshta për të treguar se sa e paarsyeshme është t’i përshkruhet ekzistenca e qelizës – një strukturë e cila ende mban fshehtësinë e saj në shumë drejtime, madje edhe në kohën kur ne jemi gadi të shkelim në shekullin e 21të – dukurive natyrore dhe rastësive.

Me të gjitha sistemet e saj funksionuese, sistemet e komunikimit, transportit dhe menaxhimit, një qelizë nuk është më pak komplekse se cilido qytet. Përmban centrale elektrike që prodhojnë energjinë që shpenzohet nga qeliza, fabrikat që prodhojnë enzimet dhe hormonet e domosdoshme për jetën, një bazë të dhënash ku i tërë informacioni i nevojshëm për të gjitha produktet që duhet prodhuar regjistrohet, sisteme komplekse transportimi dhe tuba për mbartjen e materialeve të

papërpunuara dhe produkteve nga një vend në tjetrin, laboratorë të avancuar dhe rafineri për zbrëthimin e materialeve të papërpunuara në pjesë të dobishme, membranë të specializuara në kontrollimin e hyrjes dhe daljes së materialeve etj. Këto që përmendëm përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të këtij

sistemi kompleks të habitshëm.

Proteinat sfidojnë rastësinë

Dhe nuk është vetëm qeliza që nuk mund të prodhohet: formimi i një proteine të vetme, nën kushtet e natyrës, nga mijëra proteina komplekse që ndërtojnë qelizën, është i pamundur.

Proteinat janë molekula gjigande të përbëra prej njësive më të vogla të quajtura aminoacide, të cilat janë të rregulluara në një renditje të veçantë në sasi dhe struktura të veçanta. Këto molekula përbëjnë elementin bazë të një qelize të gjallë. Proteina më e thjeshtë përbëhet prej 50 aminoacidesh, por ka proteina që janë të përbëra nga mijëra aminoacide. Mungesa, shtimi apo zëvendësimi i qoftë një

aminoacidi në qelizat e gjalla, duke qenë se secila ka një funksion të veçantë, bën që proteina të bëhet grumbull i padobishëm molekular. E paaftë të provojë "formimin e rastësishëm" të amino acideve, teoria e evolucionit përmbysët në pikën e formimit të proteinave. Ne mund të provojmë lehtë, me llogaritje të thjeshta të probabilitetit që çdokush mund t'i kuptojë, se struktura funksionale e proteinave assesi nuk mund të ndodhë rastësisht.

Ekzistojnë njëzet amino acide të ndryshme. Poqese e marrim parasysh se një molekulë mesatare e proteinës përbëhet nga 288 aminoacide, këto mund të kombinohen në 10300 mënyra të ndryshme. Nga të gjitha këto kombinime vetëm një formon proteinën e kërkuar. Zinxhirët tjerë të aminoacideve ose janë tërësisht të padobishëm ose potencialisht të dëmshëm për gjallesat. Me fjalë të tjera, probabiliteti i formimit të një proteine është "1 në 10300". Mundësia që ky "1" të ndodhë prej një shifre "astronomike" që përbëhet prej 1-shit të pasuar prej 300 zerosh praktikisht është zero; është i pamundshëm. Për më tepër, një proteinë me 288 aminoacide është, në një farë mënyre, tepër modeste në krahasim me disa proteina gjigande që përbëhen prej mijëra aminoacidesh. Kur bëjmë një llogari të thjeshtë për probabilitetin e formimit të rastësishëm të këtyre proteinave edhe vetë fjala "e pamundur" bëhet e papërshtatshme.

Poqese formimi i rastësishëm i vetëm një prej këtyre proteinave është i pamundur, është biliona herë e pamundur për rreth një milion proteina për t'u bashkuar rastësisht për të ndërtuar një qelizë të plotë njerëzore. Aq më tepër, që një qelizë nuk është e përbërë vetëm nga proteinat. Përveç proteinave, qeliza gjithashtu ka acide nukleike, karbohidrate, lyra, vitamina dhe shumë kimikate të tjera si elektrolitë të rregulluar në harmoni me një sasi, strukturë dhe funksion të caktuar. Secila prej tyre funksionon si një

njësi ndërtuese në organele të ndryshme.

Siç kemi parë, evolucionin nuk është në gjendje të shpjegojë formimin e madje një proteine të vetme prej miliona sosh në qelizë, e lëre më të shpjegojë qelizën.

Prof. Dr. Ali Demirsoj, një prej autoriteteve më të shquara të mendimit evolucionist në Turqi, në librin e tij Kalitim ve Evrim (Trashëgimia dhe Evolucionin), bën fjalë për probabilitetin e formimit të rastësishëm të Citokromit-C, njëri prej enzimeve më të domosdoshme për jetën:

Probabiliteti i formimit i një sekuence/vargu të Citokromit-C është i barabartë me zero. Domethënë, nëse jeta kërkon një sekuencë të caktuar, mund të thuhet se kjo ka probabilitetin që ka mundësi të realizohet një herë në mbarë gjithësinë. Përndryshe, disa fuqi metafizike matanë përcaktimit tonë duhet të kenë vepruar në formimin e saj. Të

pranohet kjo e fundit nuk i shkon për shtati qëllimeve të shkencës. Prandaj ne duhet të shqyrtojmë hipotezën e parë. 49

Pas këtyre rreshtave, Demirsoj pranon se ky probabilitet, të cilin ai e kishte pranuar vetëm për shkak se “i shkonte më për shtati qëllimeve të shkencës”, është jorealit:

Probabiliteti i sigurimit të sekuencës së veçantë të amino acidit të Citokromit-C ka poaq gjasa sa edhe mundësia që një majmun të shkruaj historinë e njerëzimit me një makinë shkrimi – duke supozuar se majmuni do t’i shtyp tasterët me hamendje. 50

Sekuena e saktë e amino acideve të duhura thjeshtë nuk mjafton për formimin e njërës prej molekulave të proteinës të pranishme në gjallesa. Përveç kësaj, secila prej njëzet llojeve të ndryshme të amino acideve të pranishme në përbërjen e proteinave duhet të jetë e majtë. Kimikisht, ekzistojnë/ka dy lloje të ndryshme të amino acideve të quajtura “të majta” dhe “të djathta”. Dallimi në mes tyre është simetria e pasqyrës në mes të strukturave të tyre tre-dimensionale, e cila është e ngjashme me atë të dorës së djathtë dhe të majtë të një personi. Amino acidet e cilësdo prej këtyre dy llojeve gjenden në numra të barabartë në natyrë dhe ato mund të lidhen në mënyrë të përkryer me njëra tjetrën. Mirëpo, hulumtimi zbulon një fakt mahnitës: të gjitha proteinat e pranishme në strukturën e gjallesave përbëhen prej amino acideve të majta. Madje edhe një amino acid i djathtë i vetëm i ngjitur në strukturën e një proteine e bën atë të padobishme.

Le të supozojmë për një moment se jeta lindi rastësisht siç pohojnë evolucionistët. Në këtë rast, amino acidet e djathta dhe të majta që u prodhuan rastësisht do të duhej të ishin të pranishme në natyrë në sasi afërsisht të barabarta. Çështja se si proteinat mund të zgjedhin vetëm amino acidet e majta dhe se si as edhe një amino acid i djathtë i vetëm nuk kyqet në procesin jetësor është një gjë që ende huton evolucionistët. Në Enciklopedinë e Shkencës Britanike, një mbrojtës i zjarrtë i evolucionit, autorët tregojnë se amino acidet e gjithë organizmave të gjallë në tokë dhe materiali ndërtimor i polimereve komplekse siç janë proteinat kanë të njëjtën asimetri të majtë. Ata shtojnë se kjo është e barazvlershme me hudhjen e një monedhe një milion herë dhe të zgjedhurit e kokës gjithmonë. Në enciklopedinë e njëjtë, ata thonë se nuk është e mundshme të kuptohet se pse molekulat bëhen të majta apo të djathta dhe se kjo zgjidhje është e lidhur në mënyrë magjepse me burimin e jetës në tokë. 51

Nuk është e mjaftueshme për aminoacidet të rregullohen në numra, sequenca dhe struktura të duhura tre-dimensionale. Formimi i proteinës kërkon gjithashtu që aminoacidet me më shumë se një krah të lidhen me njëra-tjetrën vetëm nëpërmjet krahëve të caktuar. Një lidhje e tillë quhet "lidhje peptide". Aminoacidet mund të realizojnë lidhje të ndryshme, por proteinat ndërtohen vetëm prej atyre me lidhje “peptide”. Hulumtimi ka treguar se vetëm 50% e amino acideve, që kombinohen me hamendje, kombinohen me një lidhje peptide dhe pjesa tjetër kombinohet me lidhje të ndryshme që nuk janë të pranishme në proteinë. Që të funksionojë ashtu siç duhet, secili aminoacid që përbën proteinën duhet të jetë i lidhur vetëm me lidhje peptide, ashtu siç duhet që aminoacidet të jenë vetëm të majta. Ky probabilitet është i njëjtë me probabilitetin që të gjitha proteinat të ishin të majta. Në mënyrë të padiskutueshme, nuk ka mekanizëm kontrollues për të zgjedhur dhe lënë jashtë amino acidet e djathta dhe të sigurohet personalisht se çdo amino acid të bëjë një lidhje peptide me tjetrën.

Nën këto rrethana, probabilitetet që një molekulë mesatare e proteinës që përbëhet prej pesëqind amino acideve të rregullohet në sasi të sakta dhe në sekuencën e duhur, përveç probabiliteteve që të gjitha amino acidet që përmban të jenë të majta dhe të kombinohen duke përdorur vetëm lidhjet peptide janë si më poshtë:

- Probabiliteti i të qenit në sekuencën e duhur = $1/20500 = 1/10650$
- Probabiliteti i të qenit i majtë = $1/2500 = 1/10150$
- Probabiliteti i kombinimit duke përdorur një "lidhje peptide" = $1/2499 = 1/10150$

PROBABILITETI I PËRGJITHSHËM = $1/10950$ domethënë, "1" probabiliteti në 10950

Siç mund të shihni më lartë, probabiliteti i formimit të një molekule të proteinës që përbëhet prej pesëqind amino acideve është "1" pjesëtuar me një numër të formuar duke vendosur 950 zero pas një 1-shi, një numër i pakapshëm për mendjen njerëzore. Ky është vetëm një probabilitet në letër. Praktikisht, një mundësi e tillë ka gjasa "0" të realizimit. Në matematikë, një probabilitet më i vogël se 1 në 1050 konsiderohet statistikisht të ketë një probabilitet "0" të realizimit.

Derisa pamundësia e formimit të një molekule të proteinës të përbërë prej pesëqind amino acideve arrin një shkallë të tillë, ne mund të vazhdojmë të shtyjmë kufijtë e mendjes në nivele më të larta të pamundësisë. Në molekulën e "hemoglobinës", një proteinë shumë e rëndësishme për jetën, ka pesëqind e shtatëdhjetë e katër aminoacide, që është një numër shumë më i madh se ai i amino acideve që përbëjnë proteinën e lartëpërmendur. Tani imagjini: vetëm në një prej miliarda rruazave të kuqe të gjakut gjenden rreth 280 milionë molekula hemoglobine. Mosha e supozuar e tokës nuk është e mjaftueshme për t'i lejuar vetes formimin qoftë edhe të një proteine, e lëre më të një rruaze të kuqe të gjakut, me anë të metodës "provo dhe gabo". Konkluzioni i nxjerrë nga të gjitha këto është se evolucioni bie në humnerat e llahtarshme të pamundësisë që në fazën e formimit të një proteine të vetme.

Kërkimi i përgjigjeve për lindjen e jetës

Fare të vetëdijshëm për gjasat e tmerrshme për mundësinë e formimit të jetës rastësisht, evolucionistët nuk janë në gjendje të sigurojnë një shpjegim të arsyeshëm për besimet e tyre, kështuqë ata fillojnë të kërkojnë mënyra për të demonstruar se gjasat nuk ishin aq të pafavorshme.

Ata dizajnuan një numër eksperimentesh laboratorike për të adresuar çështjen se si mundet që jeta të lind vetvetiu prej materies së pajetë.

Eksperimenti më i njohur dhe më i respektuar prej këtyre eksperimenteve është ai i njohur si "Eksperimenti i Millerit" apo "Eksperimenti i Urey-Millerit", i cili u ndërmor nga hulumtuesi amerikan Stenli Miller në vitin 1953.

Me qëllimin që të provoj se amino acidet kanë mundur të krijohen rastësisht, Milleri krijoi një atmosferë në laboratorin e tij që ai supozoi se do të kishte ekzistuar në tokën primitive (por që më vonë u dëshmuua të jetë jorealiste) dhe filloi punën. Përzierja që ai përdori për këtë atmosferë primitive përbëhej prej amoniakut, metanit, hidrogjenit dhe avullit të ujit.

Milleri e dinte se metani, amoniaku, avulli i ujit dhe hidrogjeni nuk do të reagonin ndaj njëri tjetrit në kushtet natyrore. Ai ishte i vetëdijshëm se i duhej të injektonte energji në këtë përzierje për të filluar një reaksion. Ai supozoi se kjo energji mund të kishte ardhur prej shkrepimave të vetëtimës në atmosferën primitive dhe duke u mbështetur në këtë supozim, ai përdori një zbrazje artificiale elektrike në eksperimentet e tij.

Milleri vloi këtë përzierje gazi në 100°C për një javë dhe, përveç kësaj, ai futi një rrymë elektrike në këtë dhomë dhe vërejti se tri prej njëzet amino acideve, të cilat përbëjnë elementet themelore të proteinave, ishin sintetizuar.

Ky eksperiment nxiti një eksitim të madh midis evolucionistëve dhe ata e promovuan atë si një sukses të jashtëzakonshëm. Të inkurajuar nga mendimi se ky eksperiment padyshim vërtetoi teorinë e tyre, evolucionistët menjëherë përgatitën skenare të reja. Milleri gjoja kishte provuar se amino acidet kishin mundur të formohen vetvetiu. Duke u mbështetur në këtë, ata në nguti ngritën hipoteza për fazat e ardhshme. Sipas skenarit të tyre, amino acidet më vonë rastësisht ishin bashkuar në sekuenca të duhura për të formuar proteinat. Disa prej këtyre proteinave të formuara rastësisht u vendosën në struktura të ngjashme me ato të membranës së qelizës, të cilat u krijuan “në njëfarë mënyre” dhe formuan një qelizë primitive. Qelizat u bashkuan me kalimin e kohës dhe formuan organizma të gjallë. Mbështetja kryesore e këtij skenari ishte eksperimenti i Millerit.

Mirëpo, eksperimenti i Millerit nuk ishte asgjë tjetër përveç imagjinatë dhe që prej asaj kohe është dëshmuar si i pavlefshëm në shumë drejtime.

Pavlefshmëria e Eksperimentit të Millerit

Gadi një gjysëm shekulli ka kaluar që prej se Milleri ndërmori eksperimentin e tij. Edhe pse është treguar si i pavlefshëm në shumë drejtime, evolucionistët ende përkrahen Millerin dhe rezultatet e tij si provë absolute se jeta mund të ishte formuar vetvetiu prej materies së pajetë. Megjithatë, kur vlerësojmë eksperimentin e Millerit në mënyrë kritike, pa paragjykimin dhe subjektivizmin e të menduarit evolucionist, është e qartë se situata nuk është aq rozë siç do të dëshironin evolucionistët që ne të mendojmë. Milleri i vendosi vetes qëllimin që të argumentojë se amino acidet mund të formoheshin vetvetiu në kushtet primitive të tokës. Disa amino acide u prodhuan, por drejtimi i eksperimentit bie në kundërshtim me qëllimin e tij në shumë drejtime, siç do të shohim tani. F. Miller i izoloi amino acidet prej këtij mjedisi posa ato u formuan, duke përdorur një mekanizëm të quajtur “kurthë e ftohtë”. Po të mos kishte bërë kështu, kushtet e mjedisit në të cilin u formuan amino acidet do t’i shkatërronin menjëherë molekulat.

Është fare e pakuptim të supozohet se ndonjë mekanizëm i vetëdijshëm i këtij lloji ishte pjesë integrale e kushteve fillestare të tokës, që përmbante rrezatim ultravjollcë, bubullima, kimikate të ndryshme dhe një përqindje të lartë të oksigjenit të lirë. Pa një mekanizëm të tillë, secili amino acid që kishte arritur të formohej përnjëherë do të shkatërrohej.

Mjedisi atmosferik fillestar që Milleri u përpoq të simuloj në eksperimentin e tij nuk ishte realist. Nitrogjeni dhe dioksidi i karbonit duhej të ishin përbërës të atmosferës fillestare, por Milleri shpërfilli këtë dhe përdori metan dhe amoniak në vend të tyre.

Pse? Pse këmbëngulnin evolucionistët në pikën se atmosfera primitive përmbante sasi të mëdha të metanit (CH₄), amoniakut (NH₃) dhe avullit të ujit (H₂O)? Përgjigja është e thjeshtë: pa amoniak, është e pamundur të sintetizohet një amino acid. Kevin McKean flet për këtë në një artikull të botuar në revistën Discovery:

Milleri dhe Urey e imituan atmosferën e lashtë të tokës me një përzierje të metanit dhe amoniakut. Sipas tyre, toka ishte një përzierje e vërtetë homogjene e metalit, shkëmbinjëve dhe akullit. Mirëpo, në studimet e kohëve të fundit, u kuptua se toka ishte shumë e nxehtë në ato kohëra dhe se ajo përbëhej prej nikelit dhe hekurit të shkrirë. Prandaj, atmosfera kimike e asaj kohe duhej të ishte e formuar kryesisht prej nitrogenit (N₂), dioksidit të karbonit (CO₂) dhe avullit të ujit (H₂O). Mirëpo, këto nuk janë poaq të përshtatshme si metani dhe amoniaku për prodhimin e molekulave organike. 52

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri edhe vet pranoi se mjedisi atmosferik që ai përdori në eksperimentin e tij nuk ishte realist.

Një tjetër pikë e rëndësishme që zhvlerëson eksperimentin e Millerit është se kishte sasi të mjaftueshme të oksigjenit për t'i shkatërruar të gjitha amino acidet në atmosferë në kohën në të cilën evolucionistët menduan se amino acidet u formuan. Ky përqendrim i oksigjenit padyshim se do të pengonte formimin e amino acideve. Kjo situatë shfuqizon në tërësi eksperimentin e Millerit, në të cilin ai krejtësisht shpërfilli oksigjenin. Po të kishte përdorur oksigjenin në këtë eksperiment, metani do të shpërbëhej në dioksid karboni dhe ujë dhe amoniaku do të shpërbëhej në nitrogen dhe ujë.

Në anën tjetër, pasi që ende nuk ekzistonte shtresa e ozonit, asnjë molekulë organike nuk ka mundur kurrsesi të jetojë në tokë sepse ishte krejtësisht e pambrojtur ndaj rrezeve të forta ultravjollcë.

Përveç disa amino acideve të domosdoshme për jetë, eksperimenti i Millerit prodhoi edhe shumë acide organike me karakteristika fare të dëmshme ndaj strukturave dhe funksioneve të gjallesave. Po t' mos i kishte izoluar/veçuar amino acidet dhe po t'i kishte lënë në të njëjtin mjedis me këto materie kimike, shkatërrimi apo transformimi/shndërrimi i tyre në lëndë përbërëse të ndryshme përmes reaksioneve kimike do të ishte i pashmangshëm. Për më tepër, një numër i madh i amino acideve të djathta u formua gjithashtu. Ekzistenca e vet këtyre amino acideve hodhi poshtë teorinë, madje edhe në kuadër të vet argumentimit të saj, sepse amino acidet e djathta nuk janë në gjendje të funksionojnë në përbërjen e organizmave të gjallë dhe i bëjnë proteinat të padobishme kur përfshihen në përbërjen e tyre.

Si përfundim, rrethanat në të cilat u formuan amino acidet në eksperimentin e Millerit nuk ishin të përshtatshme për krijimin e formave të jetës. Ambienti në të cilin u formuan ato ishte një përzierje e acidit që shkatërroi dhe oksidoi çfarëdo molekule të dobishme që ka mundur të përfitohet.

Në të vërtetë, vet evolucionistët hedhin poshtë teorinë e evolucionit, siç e kanë zakon të bëjnë shpesh, duke e përkrahur këtë eksperiment si "provë". Nëse eksperimenti provon çfarëdoqoftë, është ajo se amino acidet mundën vetëm të prodhohen në një mjedis të kontrolluar laboratorik ku të gjitha kushtet e domosdoshme janë projektuar në mënyrë të veçantë dhe të ndërgjegjshme. Domethënë, eksperimenti tregon se ajo që i sjellë në jetë (madje edhe pranë-jetën e amino acideve) nuk mund të jetë rastësi e pandërgjegjshme, por

më saktë/më parë vullnet i ndërgjegjshëm – me një fjalë, Krijimi. Kjo është arsyeja pse secila fazë e Krijimit është një argument që na dëshmon ekzistencën dhe fuqinë e Allahut.

Molekula e mrekullueshme: ADN-ja

Teoria e evolucionit ka qenë e paaftë të sigurojë një shpjegim të përshtatshëm për ekzistencën e molekulave që janë bazat e strukturës qelizore. Për më tepër, zhvillimet në shkencën e gjenetikës dhe zbulimi i acideve nukleike (ADN-së dhe ARN-së) shkaktuan probleme të reja për teorinë e evolucionit.

Në vitin 1955, puna e dy shkencëtarëve, Xhejms Watson dhe Frensis Krik, mbi ADN-në hapi një faqe të re në biologji. Shumë shkencëtarë përqëndruan vëmendjen e tyre në drejtim të shkencës së gjenetikës. Sot, pas shumë vite kërkimesh, struktura e ADN-së po njihet gjithnjë e më shumë.

Molekula e quajtur ADN, që gjendet në bërthamën e çdo 100 trilionë qelizave të trupit tonë, përmban të gjithë informacionin strukturor të trupit të njeriut. Informacioni që ka të bëjë me të gjitha karakteristikat e një personi, që nga pamja e jashtme deri në strukturën e organeve të brendshme,

është i regjistruar në ADN me anë të një sistemi të veçantë kodimi. Informacioni në ADN është i koduar brenda sekuencës së katër bazave speciale që e ndërtojnë molekulën. Këto katër baza janë specifikuar si A, T, G dhe C, sipas gërmës me të cilën fillon emri i tyre. Të gjitha ndryshimet strukturore midis njerëzve varen nga ndryshimet në sekuencën e këtyre gërmave. Ekzistojnë përafërsisht 3.5 miliardë nukleotide, domethënë, 3.5 miliardë gërma në një molekulë të ADN-së.

Të dhënat e ADN-së që i takojnë një organi apo proteine të veçantë përfshihen në komponentet e posaçme të quajtura “gjene”. P.sh. informacioni për syrin ekziston në një varg të gjeneve të posaçme, ndërsa informacioni për zemrën ekziston në një varg krejt tjetër të gjeneve. Qeliza prodhon proteina duke përdorur informacionin në të gjitha këto gjene. Amino acidet që përbëjnë strukturën e proteinës definoohen me anë të rregullimit të rradhitjes së tri nukleotideve në ADN.

Në këtë pikë, jemi para një detaji të rëndësishëm që meriton t’i kushtohet vëmendje. Një gabim në sekuencën e nukleotideve që ndërtojnë gjenin, e bën gjenin plotësisht të padobishëm. Kur merret në konsideratë se ka 200.000 gjene në trupin e njeriut, bëhet akoma më shumë e qartë se sa e pamundur është për miliona nukleotide që përbëjnë gjenet të formohen rastësisht në sekuencat e duhura. Një biolog evolucionist, Frenk Selisbëri, komenton këtë pamundësi duke thënë:

Një proteinë mesatare mund të përfshijë 300 aminoacide. Gjeneri i ADN-së që kontrollon këtë duhet të ketë 1000 nukleotide në zinxhirin e tij. Meqenëse ka 4 lloje nukleotidesh në një zinxhir ADN-je, atëherë formimi i rastësishëm i informacionit gjenetik për këtë proteinë ka probabilitet 1 në 41000. Duke përdorur pak algjebër nxjerrim se 41000 është e barabartë me 10600, d.m.th. numri 1 me 600 zero prapa, një numër që qëndron jashtë mundësive tona të perceptimit. 53

Numri 41000 është i barabartë me 10600. Këtë numër e fitojmë duke i shtuar 600 zero 1-shit. Pasiqë 10-shja me 11 zero tregon një trilion, shifra me 600 zero është me të vërtetë një numër që është vështirë të merret me mend.

Evolucionisti Prof. Ali Demirsoj, u detyrua të bënte këtë koment për këtë problem:

Në fakt, probabiliteti i formimit të një proteine dhe një acidi nukleik (ADN – ARN) është një probabilitet i pavlerësueshëm. Gjasat e shfaqjes së një zinxhiri të caktuar proteinik janë kaq mospërfillëse sa mund të quhen astronomike. 54

Përveç gjithë këtyre pamundësive, ADN-ja mezi mund të përfshihet në një reaksion për shkak të formës së saj spirale të zingjirit të dyfishtë. Kjo poashtu e bën të pamundshme të mendohet se ajo mund të jetë baza e jetës.

Veç kësaj, derisa ADN-ja mund të riprodhohet vetëm me ndihmën e disa enzimeve, që janë aktualisht proteina, sinteza e këtyre enzimeve mund të arrihet vetëm nga informacioni i koduar në ADN. Për shkak se ato varen nga njëra-tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë që të riprodhohen, ose njëra prej tyre duhet jetë “krijuar” para tjetrës. Mikrobiologu amerikan Xhejkobson e komenton këtë kështu:

Udhëzimet për riprodhimin e planeve, për energjinë dhe nxjerrjen e pjesëve nga ambienti ekzistues, për sekuencën e rritjes dhe për mekanizmin veprues që përkthen instruksionet për rritjen – të gjitha këto duhet të ishin njëkohësisht prezente në atë momentin (kur jeta nisi). Ky kombinim ngjarjesh është krejt i pamundur të ndodhë dhe shpesh i mveshet ndërhyrjes hyjnore. 55

Citimi i mësipërm u shkruajt dy vjet pas zbulimit të strukturës së ADN-së nga Xhejms Vatson dhe Frensis Krik. Megjithë zhvillimet e shkencës ky problem mbetet i pazgjidhur për evolucionistët. Për të përmbledhur, nevoja për ADN-në në riprodhim, domosdoshmëria e pranisë së disa proteinave për riprodhim dhe kërkesa për të prodhuar këto proteina sipas informacionit në ADN hedh poshtë në tërësi tezat evolucioniste.

Dy shkencëtarë gjermanë Junker dhe Scherer shpjegojmë se sinteza e secilës molekulë që nevojitet për evolucionin kimik, ka nevojë për kushte të veçanta. Probabiliteti i kombinimit të këtyre materialeve, të cilat teorikisht sigurohen nga metoda të ndryshme, është zero:

Deri tani nuk njihet asnjë eksperiment, me anë të të cilit ne mund të përftojme të gjitha molekulat e nevojshme për evolucionin kimik. Prandaj, është e domosdoshme të prodhohen disa molekula të ndryshme në vende të ndryshme në kushte shumë të përshtatshme dhe pastaj të transportohen në një vend tjetër për t'u futur në reaksion, duke i mbrojtur nga elementët e dëmshëm si hidroliza dhe fotoliza. 56

Shkurt, teoria e evolucionit është e paaftë të provojë ndonjë prej fazave të evolucionit që evolucionistët pohojnë se ka ndodhur në nivelin e molekulës.

Për të përmbledhur atë që kemi thënë deri më tani, as amino acidet dhe as produktet e tyre, proteinat që formojnë qelizat e qenieve të gjalla, s'ka pasë mundësi të prodhohen kurrë në çfarëdo ambienti të ashtuquajtur “atmosfera primitive”. Për më tepër, faktorët e tillë si struktura tejet komplekse e proteinave, veçoritë e djathta dhe të majta dhe vështirësitë në formimin e lidhjeve peptide janë vetëm pjesë e arsyes se pse ato kurrë nuk do të prodhohen as edhe në çfarëdo eksperimenti të ardhshëm.

Madje edhe nëse supozojmë për një moment se proteinat në njëfarë mënyre u formuan rastësisht, kjo prapsepap do të ishte e pakuptim, sepse proteinat nuk janë asgjë fare të vetme: ato nuk mund të riprodhohen vetvetiu. Sinteza e proteinës është e mundshme vetëm me informacionin e koduar në molekulat e ADN-së dhe ARN-së. Pa ADN dhe ARN, është e pamundshme që një proteinë të riprodhohet. Sekuenca e duhur prej njëzet amino acideve të koduara në ADN përcakton strukturën e secilës proteinë në organizëm. Megjithatë, siç u bë e qartë plotësisht prej gjithë atyre që kanë studiuar këto molekula, është e pamundshme që ADN-ja dhe ARN-ja të formohen rastësisht.

Fakti i krijimit

Me rënien e teorisë së evolucionit në secilën fushë, emra të shquar në degën e mikrobiologjisë sot pranojnë faktin e krijimit dhe kanë filluar të mbrojnë pikëpamjen se gjithçka është krijuar prej një Krijuesi të ndërgjegjshëm si pjesë e një krijimi madhështor. Ky është tashmë një fakt që njerëzit nuk mund ta shpërfillin. Shkencëtarët që mund t'i qasen punës së tyre mendjehapur kanë zhvilluar një botëkuptim të quajtur “projektimi/dizajnimi inteligjent”. Michael J. Behe, njëri prej shkencëtarëve më të shquar prej tyre, deklaroi se ai pranon qenien absolute të Krijuesit dhe përshkruan gjendjen e pashpresë të atyre të cilët e mohojnë këtë fakt:

Rezultati i këtyre përpjekjeve të grumbulluara për të hetuar qelizën – për të hetuar jetën në nivelin molekular – është një klithmë e zëshme, e qartë, depërtuese e “projektimit”! Rezultati është aq i qartë dhe aq domethënës sa që duhet të renditet si njëra prej arritjeve më të mëdha në historinë e shkencës. Ky triumf i shkencës do të duhej të ngjallte britmat “Eureka” prej dhjetë mijë grykave.

Por, asnjë shishe nuk u hap, asnjë duartrokitje. Në vend të kësaj, një heshtje kurreshtare e turbullt rrethon kompleksitetin e ngurtë të qelizës. Kur kjo çështje ngritet në opinion, këmbët fillojnë të tërhiqen zvarrë dhe frymëmarrja fillon të vështirësohet pak. Jozyrtarisht njerëzit janë paksa më të relaksuar; në mënyrë shumë të qartë e shprehin atë që është e evidente por pastaj e mbërthejnë shikimin në tokë, lëkundin kokat dhe e lënë me kaq. Pse komuniteti shkencor nuk e përqafton me xhelozzi zbulimin e vet befasues? Pse vëzhgimi i projektimit trajtohet me dorëza intelektuale? Dilema qëndron në faktin se ndërsa njëra anë e elefantit emërtohet si dizajnim inteligjent, ana tjetër duhet të emërtohet si Zot. 57

Sot, shumë njerëz nuk janë madje as të vetëdijshëm se ata janë në një situatë që të pranojnë një grumbull idesh të gabuara si të vërtetë në emër të shkencës, në vend se të besojnë Allahun. Ata të cilët nuk e marrin fjalinë “Allahu ju krijoi prej asgjëje” si mjaft shkencore mund të besojnë se qenia e parë e gjallë u krijua prej vetëtimave që goditnin një “supë primitive” para miliarda viteve.

Siç e kemi përshkruar tjetërkund në këtë libër, barazpeshat në natyrë janë aq të brishta dhe aq të shumta sa që është krejtësisht e paarsyeshme të pohohet se ato u zhvilluan “rastësisht”. Pa marrë parasysh përpjekjet e atyre që nuk mund të lirohen nga kjo mungesë e arsyes, argumentet e Allahut në qiej dhe në tokë janë plotësisht të qarta dhe të pamohueshme.

Allahu është Krijuesi i qiejve, i tokës dhe i gjithë asaj që është në mes tyre.

Argumentet e qenies së Tij kanë përfshirë tërë gjithësinë.

Filozofitë që bën gabimin e mohimit të Allahut

Në kapitujt e mëparshëm pamë argumentet e qarta të ekzistencës së Allahut. Padyshim, ajo që kemi përshkruar këtu është vetëm një pjesë shumë e vogël e dëshmive të Tij të pafund. Ngado që të kthehet njeriu, ndeshet me argumentet që tregojnë ekzistencën e Krijuesit.

Atëherë, pse ka ende aq shumë ateistë në botë? Veç kësaj, pse ndodhë që disa shkencëtarë vazhdojnë të jenë ateistë? Pse këmbëngulin në mohimin e ekzistencës së Allahut, përkundër aq shumë argumenteve të qarta? Kur kërkojmë përgjigje në këto pyetje, ndeshemi me një numër paragjykimesh filozofike të cilat u japin formë besimeve të njerëzve ateist – përfshirë edhe ato të shkencëtarëve ateist. Përgjithësisht e përkufizuar si materializëm, kjo pikëpamje filozofike konsideron se gjithësia është e amshueshme dhe funksionon pa pasur nevojë për një Krijues. Sipas ateistëve, materia është e vetmja fuqi që ekziston. Materia nuk është krijuar dhe funksionon në një mënyrë të pakontrolluar pa ndërhyrjen e një Krijuesi. Ka shumë filozofë në histori që kanë mbrojtur këtë pikëpamje. Shumë, prej pasuesve të religjioneve pagane të Sumerëve të vjetër deri te filozofët atomist të Greqisë së lashtë dhe materialistët dialektik e kohërave moderne, kanë mohuar ekzistencën e Allahut për shkak të ndikimit të kësaj pikëpamjeje.

Mohimet e tyre, megjithatë, nuk qëndrojnë në themele të forta. Ata thjeshtë kanë bindur veten për amshueshmërinë e materies dhe me forcë kanë përqaftuar këtë besim. Ata e kanë pranuar teorinë e evolucionit me të njëjtin arsyetim dhe kanë këmbëngulur në besimin e tyre. Dhe siç shkruajti njëherë mikrobiologu i famshëm amerikan, kur përballen me të kuptuarit se jeta është tejet komplekse për të zënë fill rastësisht, ata vetëm mund të qëndrojnë të heshtur dhe të ndryshojnë temën.

Kjo situatë tregon se ka paragjykime që bëjnë që njerëzit t'i përkushtohen materializmit dhe pëfundimit të tij të natyrshëm, ateizmit. Mohimi i ekzistencës së Allahut nga ana e tyre nuk rrjedhë nga vlerësimi i fakteve konkrete nga një këndvështrim real, por më tepër nga shpërfillja e këtyre fakteve konkrete.

Për më tepër, ata mundohen që t'ia imponojnë mohimin e tyre publikut në tërësi.

AUTORËT E “KOMPLOTEVE TË LIGA”

Propaganda e organizuar kundër besimit në Allahun tregon se këto lëvizje manipulohen prej qendrave të veçanta. Me fjalë të tjera, ekziston një numër i qendrave me autoritet që bëjnë përpjekje të konsiderueshme të thyejnë besimet fetare të shoqërisë. Nuk çuditë fakti se Allahu na ka tërhekur vërejtjen për këto grupe në Kur'an. Në një ajet, një grup njerëzish të ndëshkuar me zjarrin e xhehenemit në ahiret u bëjnë thirrje udhëheqësve të tyre të cilët i kanë larguar nga rruga e drejtë në këtë botë dhe thonë:

Jo, por dredhia juaj ditë e natë (na largoi prej besimit), kur ju na thërrisnit të mos e besojmë Allahun dhe t'i bëjmë Atij shokë. (Sure Sebe': 33)

Këto grupe të cilat, duke kurdisur komplete të liga, i urdhërojnë të tjerët të jenë mosmirënjohës ndaj Allahut janë shfaqur në secilën periudhë të historisë me emra dhe

pamje të ndryshme. Karakteristikat themelore të tyre megjithatë kanë qenë gjithnjë të njëjta. Allahu i ka përshkruar ata në Kur'an si "ata që kanë çuar jetë të shfrenuar" (Sure Mu'minin: 64) apo "Krerët kryelartë nga populli/mesi i tyre" (Sure A'raf: 75), që nënkupton se këta njerëz janë ata që janë tejet të privilegjuar në aspektin material, të cilët gëzojnë autoritet në shoqëri dhe të cilët tregojnë mburrje dhe mendjemadhësi për shkak të asaj që posedojnë. Duke e konsideruar religjionin si një kërcënim për koncesionet që kanë përfituar me të padrejtë dhe tirani, ata dëshirojnë që ta asgjësojnë atë. Për këtë arsye ata fabrikojnë "komplete të liga" për të çuar komunitetin e tyre drejtë braktisjes së fesë.

Natyrisht se nuk mund të ketë një përkufizim të vetëm të forcave të tilla të organizuara. Ata marrin identitete dhe forma të ndryshme në shoqëri të ndryshme. Megjithatë, kur i hedhim një vështrim historisë së tre apo katër shekujve të fundit, ndeshemi me një organizatë ndërkombëtare që i përgjigjet përshkrimit në Kur'an.

Ajo organizatë është masoneria e lirë.

Në këtë pikë nevojitet të theksojmë gjithashtu se lufta globale e masonerisë së lirë është ndërmarrë dhe përkrahur nga një qendër e pushtetit që përmendet në Kur'an: Çifutëria. Edhe pse Judaizmi është një religjion hyjnor dhe Çifutët janë pasues të atij religjioni, ata kanë luajtur, siç e kemi përmendur më lartë, një rol vendimtar në propagandën anti-fetare të ndërmarrë në mbarë botën. Kjo kryesisht për shkak të ndryshimit arbitrar të Dhjatës së vjetër nga ana e rabinëve dhe futjes dhëlpërsisht të besimeve paragjykuese në religjionin e pastër të shpallur nga Profeti Musa. Pasiqë kishte pushuar së qeni një religjion hyjnor si pasojë e ndryshimeve të bëra nga ana e rabinëve çifut, Çifutëria është shëndrruar në një ideologji materialiste dhe shoveniste. Përfundimisht çifutë të ndryshëm ultra-konzervativ, të cilët e konsiderojnë religjionin si një koncept të rezervuar për ta, kanë marrë qëndrimin se Krishtërimi dhe Islami janë "religjione të rrejshme" që duhet të shfuqizohen. Veç kësaj, ky bashkëveprim interesant i bën njerëzit në fjalë të veprojnë si forca që përpiqen të shlyejnë të gjitha besimet fetare nga kjo botë.

Kjo është pikërisht logjika e bashkimit në mes të Çifutërisë dhe masonerisë së lirë.

ROLI I MASONERISË SË LIRË

Duke i pasur rrënjët në botën perëndimore, prej nga më pas u përhap gjetkë, kjo organizatë sekrete ka qenë gjithnjë burimi i të gjitha aktiviteteve dhe të menduarit anti-fetar në secilin vend në të cilin ka depërtuar.

Një hetim i kujdesshëm i historisë së luftës kundër religjionit të luftuar në cilindo vend të botës gjatë disa shekujve të fundit zbulon se masoneria e lirë ka qenë gjithnjë në qendër të përpjekjeve të tilla. Historia e Europës është jashtëzakonisht e spikatur për këtë. Kjo është arsyeja pse udhëheqësi i botës katolike, Papa Leo XIII, posaçërisht vuri në shënjestër masonerinë e lirë në qarkulloren Humanum Genus (1884) ku ai përshkruajti synimet e kësaj organizate në këtë mënyrë:

Megjithatë, në këtë periudhë, partizanët e së keqes duket se janë duke u bashkuar dhe duke luftuar me një vrull të përbashkët, të udhëhequr dhe të ndihmuar nga ajo shoqatë fuqishëm e organizuar dhe e shtrirë gjithandej e quajtur Masonët e lirë. Duke mos mbajtur më të fshehta qëllimet e tyre, ata tani po ngrihen me guxim kundër Zotit Vet. Ata po

planifikojnë shkatërrimin e Kishës së shenjtë publikisht dhe haptazi dhe këtë me synimin e përcaktuar që plotësisht t'i rrëmbejnë kombet e Botës së Krishterë. 58

Kjo analizë papnore e bërë në fund të shekullit të 19të është plotësisht e vërtetë. Kur i shqyrtojmë botimet bashkëkohore masonike, shohim se synimi themelor i kësaj organizate është të shfuqizojë besimet fetare në shoqëri. Një lozhë masonësh turk deklaroi në një rën prej pamfleteve të saj se si religjioni do të shfuqizohet përmes “përhapjes së shkencave pozitive në shoqëri.”

Në fund dëshiroj të them këtë: Misioni më human dhe më masonik që na takon në është që të mos shmangemi nga shkencat dhe gjykimi pozitiv, ta përhapim këtë duke pranuar se kjo është mënyra më e mirë dhe e vetme për evolucionin dhe të drejtojmë publikun nga shkencat pozitive. Fjalët në vijim të Ernest Renan janë shumë të rëndësishme: “Nëse publiku drejtohet dhe shkollohet me shkencat dhe gjykimin pozitiv, atëherë besimet e kota të religjioneve përfundimisht do të anulohen.” 59

Ajo që nënkuptohet këtu me anë të “shkencës pozitive” është në thelb “shkencë pozitiviste” domethënë, filozofia materialiste që mohon gjithçka që nuk është përfituar me anë të eksperimentit dhe vëzhgimit. Misioni i masonerisë së lirë, në anën tjetër, ka për qëllim që ta imponojë këtë filozofi në njerëz në emrin e “shkencës” dhe kështu të shfuqizojë të gjitha besimet fetare. Teoria e evolucionit ka një rol shumë vendimtar në këtë fushatë indoktrinuese, siç bëhet e qartë poashtu në citimin e lartpërmendur. Masoneria e lirë konsideron se kultivimi i besimit në evolucion në shoqëri është detyra e saj më e lartë.

Kjo lidhje organizative është një faktor shumë i rëndësishëm që përbën bazën e arsyes se pse si teoria e evolucionit ashtu edhe filozofia materialiste dhe degëzimet e tyre janë promovuar me aq këmbëngulje në të gjitha këndet e botës. Organizata e masonerisë së lirë dhe degët e tyre kanë luajtur një rol të rëndësishëm në propagandën e rregullt që po zbatohet kundër besimeve fetare gjatë disa shekujve të fundit. Kjo është arsyeja pse themeluesit e sistemeve filozofike të ndryshme – nganjëherë edhe kundërthënëse – që mohojnë ekzistencën e Allahut kanë qenë të gjithë masonë.

FILOZOFËT MASON

Siç e cekëm më lartë, themeluesit e sistemeve filozofike anti-fetare janë në të vërtetë pjesë e një lufte sistematike që zhvillohet kundër religjionit. Për këtë arsye zbulojmë se shumica e filozofëve të cilët i themeluan këto sisteme janë pjesë e organizatës së masonerisë së lirë, e cila qëndron në qendër të luftës kundër religjionit.

Në këtë kontekst, filozofët të cilët na tërheqin vëmendjen menjëherë janë intelektualët francez të cilët ishin lajmëtarët e Revolucionit Francez. Këta njerëz jo vetëm që kritikuan autoritetet fetare por gjithashtu ndezën një armiqësi të dhunshme kundër religjionit. Në mesin e tyre janë Diderot, autori i Sistemit të Natyrës, të cilës i referohet si “Biblës së Materializmit”; Voltaire, i cili ishte gjithashtu një materialist i flaktë dhe kundërshtar i religjionit; materialisti radikal Montesquieu; Jean-Jacques Rousseau, i cili konstruktivoi një “religjion” të ri të tij dhe “Enciklopedistët”, të cilët të gjithë ishin anti-fetar të zjarrtë. Organi i masonëve turk, revista Mimar Sinan, thotë për këta individë:

Revolucioni Francez i vitit 1789 u përgatit nga ideologët mason. Deklarata e të drejtave të njeriut që përmban parimet e lirisë, barazisë dhe vëllazërisë/miqësisë u shkrua

me frymëzimin dhe udhëzimin e padronëve tonë si Montesquieu, Voltaire, Rousseau dhe Diderot. 60

Revista e Masonëve, gjithashtu e botuar prej masonëve turk shkruan:

Pionierët të cilët rrëzuan sistemin feudal në Francë dhe filluan Revolucionin e Madh ishin Montesquieu, Voltaire, J.J. Rousseau, materialisti udhëheqës Diderot dhe Enciklopedistët të cilët u grumbulluan/mblohdën rreth tij. Ata të gjithë ishin masonë. 61

Idetë materialiste dhe anti-fetare që u zhvilluan gjithnjë e më shumë në vitet që pasuan Revolucionin Francez arritën kulmin e tyre në shekullin e 19të. Kur shikojmë udhëheqësit e kësaj lëvizjeje, përsëri ndeshemi me masonerinë e lirë.

Veç kësaj, vlen gjithashtu të përmendet se kishte shumë Çifutë në mesin e këtyre figurave. Kjo dëshmon se Çifutët të cilët, në aleancë me masonët, luftojnë për të dobësuar religjionet Hyjnore si Krishtërimi dhe Islami dhe mbrojnë botëkuptimin materialist, i shërbejnë qëllimit të njëjtë në baza filozofike.

PRAPASKENAT E SOCIALIZMIT

Një grup i çuditshëm u themelua në Bavari në Gjermaninë jugore në vitin 1776. themeluesi i këtij grupi, i cili e quajti veten “Illuminati” (dmth “të Ndriritur”) ishte një profesor i drejtësisë që quhej Adam Veishaupt. Kjo shoqatë është interesante në dy aspekte: ishte një shoqëri shumë e fshehtë dhe i kishte vënë vetes një program politik shumë ambicioz. Në këtë program të shkruar nga Eeishaupt, dy qëllimet fundamentale të kësaj shoqërie u identifikuan:

1. Shfuqizimi i të gjitha monarkive dhe qeverive sistematike.
2. Shfuqizimi i të gjitha religjioneve teiste (hyjnore).

Qëndrimi i kësaj shoqërie ndaj religjionit ishte tejet armiqësor. Sipas historianit anglez Majkëll Hauard, Veishaupt kishte një “urrejtje të sëmure” ndaj religjioneve hyjnore të çfarëdo lloji. 62

Shoqëria ishte në të vërtetë një lloj lozhe masonike. Veishaupt ishte një mason i lirë i vjetër dhe ai e kishte organizuar atë në pajtim me stilin tradicional të organizimit të lozhave masonike. Të Ndriritur u zhvilluan tejet shpejtë. Në vitin 1780, me pjesëmarrjen e Baron Fon Knige, njërit prej padronëve më të mëdhenjë të lozhave masonike gjermane, fuqia e shoqërisë u rrit shumë. Veishaupt dhe Knige po vendosnin themelet për një revolucion në Gjermani që ishte socialist në çdo gjë veçse në emër. Mirëpo, kur qeveria e zbuloi se çfarë po përgatiteshin të bënin, Veishaupt dhe Knigge e panë si një gjë të urtë që ta shpërndanin shoqërinë. Aktivitetet e saj u shkrinë në lozhat e tyre të rregullta masonerisë së lirë. Ky bashkim ndodhi në vitin 1782.

Në fillim të viteve 1800, u themelua një shoqëri e re në Gjermani që përpiquej që të vazhdonte traditën e Të Ndriturve në Gjermani. Shoqëria quhej “Shoqëria e Të Ndershmëve”. Me kohë, emri i saj u ndryshua në “Shoqërinë e Komunistëve”. Kreu i kësaj shoqërie deshi të krijojë një program politik për këtë grup dhe dy njerëzit e parë që i lutën që të shkruajnë programin ishin dy intelektual të ashpër komunist: Karl Marksi dhe Frederik Engelsi! Këta dy shkruan Manifestin Komunist sipas udhëzimeve të Shoqërisë së Komunistëve. Një prej parimeve të njohura botërisht të këtij Manifesti ishte se religjioni ishte “opiumi i popullit” dhe trakti/pamfleta arsyetonte se eliminimi i besimeve fetare ishte

njëra prej parakushteve për “shoqërinë ideale pa klasa”, e cila u prezentua si e vetmja shpresë e shpëtimit të njerëzimit. Duhet të ceket se të dy si Marks si edhe Engelsi ishin me prejardhje çifute.

Dominimi i hershëm i masonëve dhe çifutëve në lëvizjen socialiste vazhdoi në vitet që pasuan. Disa prej masonëve dhe çifutëve që përkrahën lëvizjen socialiste ishin:

Ferdinand Lasalle: Lasalle, një shok i ngusht i Marksit, mbrojti idenë e një diktature revolucionare komuniste.

Victor Adler: Si dora e djathtë e Engelsit, Adleri bëri përpjekje të konsiderueshme për të predikuar komunizmin.

Djali i tij Fridrih Adler u bë udhëheqës i Partisë Komuniste të Austrisë.

Mozes Hes: i lindur në një familje konzervative çifute, Hesi ishte një socialist dhe shok i ngusht i Marksit. Ai ishte gjithashtu një Cionist energjik. Ai i hapi rrugën lëvizjes Cioniste në Evropë me librin e tij Roma dhe Jerusalem dhe punoi për të themeluar një shtet çifut në Palestinë. Ai ishte poashtu një mbrojtës i zjarrtë i Darwinizmit gjatë gjithë jetës së tij.

Xhorxh Lukas: Anëtar i një familje të pasur çifute, Lukas shkroi shumë libra që mbronin komunizmin. Ai ndihmoi në përhapjen e ideologjisë komuniste në mesin e të rinjëve. Ai ishte një figurë udhëheqëse e revolucionit që solli komunizmin në pushtet në Hungari.

Vladimir I. Lenin: Një çifut, pikërisht sikurse shumica e udhëheqësve të lëvizjes Bolshevike në Rusi, Lenini u bë themelues i njërit prej regjimeve totalitare më të përgjakshme në botë.

Herbert Markus: Djali i një familjeje çifute, Herbert Markus riinterpretoi Marksizmin dhe përgatiti bazat për trazirat studentore të vitit 1968. Ai nxiti lëvizjet e majta të kolegjit që u përhapën në mbarë botën dhe u zhvilluan në një ideologji anarkiste që ka sjellur – dhe ende sjellë – vdekjen në numër të madh të njerëzve të rinjë.

NJË FILOZOFI DHE AGJENDA E FSHEHTË E SAJ

Kur i hedhim një sy historisë së filozofisë, shohim se ka shumë filozofë ateist dhe anti-fetar të cilët dallohen për nga identiteti i tyre masonik. Në mesin e tyre janë mendimtarët si Dejvid Hjum, Holbah, Shelling, Xhon Stjuart Mill, Auguste Komte, Markiz de Sad dhe sociologët si Emil Durkheim, Ferdinand Tonis, Herbert Spenser, Zigmund Frojd, Henri Bergson dhe Erih From. Të gjithë këta janë me prejardhje çifute dhe të gjithë ata u përpoqën t’i largojnë njerëzit prej fesë dhe të vendosin një rregull shoqëror dhe moral që ishte krejtësisht jofetar. Nënkuptohe fare mirë se Çarlls Darvini dhe pikëpamjet e tij gëzonin një vend të posaçëm në mesin e këtyre figurave.

Pika më e rëndësishme për t’u cekur këtu është se filozofitë mosbesuese dhe materialiste të prodhuara prej gjithë këtyre mendimtarëve dhe prej mijëra të tjerëve si ata, u shërbejnë interesave të veçantë politik dhe shoqëror. Siç thamë në fillim, arsyeja më e rëndësishme pse njerëzit mohojnë Allahun është ndjenja e jorehatisë së tyre në raport me religjionin, religjionin që është rezultat i natyrshëm i besimit në Allahun. Duke e mohuar të vërtetën e religjionit për shkak se i kundërvihet interesave të tyre apo të interesave të

qarqeve që ata përfaqësojnë, këta njerëz kanë gjetur strehim në ateizëm për të përfituar përkrahje për veten e tyre.

Për këtë arsye, argumentet e qarta të ekzistencës së Allahut nuk vërehen prej këtyre njerëzve. Apo më saktë, nuk kanë dëshirë që ato argumente të shihen. Këta njerëz përpiqen shumë të ndalojnë/pengojnë besimin në ekzistencën e Allahut dhe përhapin këtë mosbesim në shoqëri në përgjithësi. Përfundimisht shfaqen masat të cilat ose nuk besojnë në Allahun apo që e kanë “harruar” Atë siç përmendet në Kur’an. (Sure Teube: 67)

Kjo është arsyeja pse shumica e njerëzve kalojnë jetërat e tyre pa e lavdëruar Allahun fare, duke menduar se jetojnë të pavarur prej Tij. Megjithatë, njeriu nuk duhet të mashtrohet nga kjo “turmë mendjelehtësh”, sepse Allahu tashmë na ka informuar në Kur’an se pjesa më e madhe e njerëzimit nuk beson (Sure Rra’d: 1). Ajeti vijues gjithashtu na paralajmëron për të njëjtën gjë:

Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e Allahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë. (Sure En’am: 116)

(Për informim të hollësishëm, shih: Rendi i Ri Masonik nga Harun Jahja)

Dëmet e modelit të shoqërisë që nuk beson në Allahun

Allahu shpall në Kur’an se Ai ka krijuar njerëzimin sipas një natyrshmërie në ajetin: “Përqëno vetëveten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fé), feja e Allahut sipas së cilës i krijoi njerëzit, s’ka ndryshim të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu.” (Sure Rum: 30). Kjo natyrshmëri e njerëzimit mbështetet në të qenit e tij rob/shërbues i Allahut dhe në të besuarit në Të. Pasiqë njeriu është i paaftë t’i plotësojë dëshirat dhe nevojat e tij të pakufishme vet, ai natyrisht ka nevojë që t’i përulet Allahut dhe t’i drejtohet Atij.

Nëse individi jeton në pajtim me këtë natyrë, ai arrin siguri, paqe, lumturi dhe shpëtim të vërtetë. Nëse e mohon këtë natyrë dhe harron Allahun, ai e kalon jetën e tij në dëshprim, frikë, ankth dhe mjerim.

Kjo rregullë, e cila vlen për njeriun, vlen poashtu edhe për shoqëritë. Nëse një shoqëri përbëhet prej njerëzve të cilët e besojnë Allahun, ajo bëhet një shoqëri e drejtë, paqësore, e lumtur dhe e urtë. Padyshim, e kundërta vlen poashtu. Nëse një shoqëri është e pavetëdijshe për Allahun, atëherë rregullimi i një shoqërie të tillë është i rrënuar në themel, është i korruptuar dhe primitiv.

Kur të analizohen shoqëritë që ia kanë kthyer shpinën Allahut, kjo gjë mund të shihet lehtë. Njëri prej rezultateve më të rëndësishme të të menduarit jofetar është shfuqizimi i idesë së moralitetit dhe zhvillimi i shoqërive krejtësisht të korruptuara/çoroditura. Duke thyer kufijtë fetar dhe moral dhe duke u kujdesur në veçanti për kënaqjen e dëshirave njerëzore, kjo kulturë është një sistem i shtypjes në kuptimin më të plotë të fjalës. Në një

sistem të tillë, të gjitha llojet e degjenerimit prej çoroditjes seksuale e deri te varësia nga droga inkurajohen. Përfundimisht, janë formuar shoqëri të cilave ju mungon dashuria njerëzore dhe janë egoiste, injorante, të cekta dhe absurde.

Në një shoqëri në të cilën njerëzit jetojnë vetëm për kënaqjen e dëshirave të tyre vetjake, padyshim se nuk është e mundshme që të mbahet paqja, dashuria dhe miqësia. Në një shoqëri të tillë, raportet njerëzore varen prej interesave të ndërsjella. Mbisundon një ndjenjë e jashtëzakonshme e mosbesimit. Kur nuk ka arsye që njeriu të jetë i sinqertë, i ndershëm, i besueshëm apo i sjellshëm, asgjë nuk qëndron në udhën e shtirjes, pavërtetësisë apo tradhëtisë. Anëtarët e shoqërive të tilla e kanë “hedhur Allahun pas shpine (me mospërfillje/me përbuzje)” (Sure Hud: 92) dhe kështu kurrë nuk e kanë pranuar frikën ndaj Allahut. Pasiqë ata nuk mundën “të bëjnë një vlerësim të drejtë të Allahut”, ata janë të shkujdesur ndaj ditës së gjykimit dhe ditës së llogarisë. Për ata, ferri nuk është asgjë më shumë se një ide që paraqitet në librat fetar. Asnjëri prej tyre nuk mendon se ata do të duhet të japin llogari për veten e tyre në praninë e Allahut pas vdekjes së tyre për të gjitha mëkatet/gjynahet që i kanë bërë gjatë jetërave të tyre në këtë botë ose që përfundimisht të ndëshkohen me një ndëshkim të përjetshëm në ferr. Edhe nëqoftëse mendojnë për këtë, ata supozojnë se do të hyjnë në parajsë pasiqë të “pagojnë për mëkatet e tyre”, siç shprehet kjo në këtë ajet:

Për shkak se ata thonë: "Neve nuk do të na djegë zjarri vetëm për pak ditë të numëruara, e ajo që shpifën për fenë e tyre, i mashtroi keq. (Sure Ali Imran: 24)

Pra, ata janë të prirur të kalojnë jetërat e tyre duke bërë ç'mos për të kënaqur dëshirat dhe nevojat e tyre.

Kjo gjendje natyrisht se çon deri te çoroditja etike dhe rrënimimi moral që ne shohim në shumë shoqëri sot. Sipas gjykimit të tyre ata supozojnë se “kemi ardhur në këtë botë veçse një herë dhe do të jetojmë vetëm nja 50 – 60 vjet dhe pastaj do të vdesim, pra le t'i shfrytëzojmë gjërat më të mira këtu”. Sistemi i të menduarit i bazuar në këtë gjykim të gabueshëm mund të sjellë me vete të gjitha llojet e padrejtësisë, prostitucionit, vjedhjes, krimit dhe imoralitetit. Njeriu që pajtohet me këtë mund të përfshihet në gjithfarë krimesh, vrasjesh apo mashtrimesh. Kur secili individ nuk mendon për tjetër përveç kënaqjes së nevojave dhe dëshirave të tij, çdokush tjetër, duke përfshirë familjen dhe shokët e tij, kanë një rëndësi të dorës së dytë. Individët tjerë në shoqëri nuk kanë kurrfarë rëndësie.

Në një strukturë shoqërore e cila mbështetet në raporte interesi në një shkallë të madhe, mosbesimi i ndërsjellë i njerëzve ndalon/pengon krijimin e paqes si në nivelin shoqëror ashtu edhe në atë individual dhe bën që njerëzit të jetojnë përherë në një gjendje dyshimi, ankthi dhe pavendosmërie. Duke mos e ditur se prej kujt, kur ose si do të bëhen keqbërjet në një shoqëri të tillë, njerëzit jetojnë shpirtërisht në një gjendje frike dhe ankthi. Mosbesimi dhe dyshimi i përgjithshëm bëjnë që ata të jetojnë jetëra shumë të mjerueshme. Në një shoqëri ku shpërfillen të gjitha vlerat morale, pikëpamja e njerëzve për nocionet si familja, ndershmëria dhe dëlirësia janë fare alarmante, sepse ata nuk i frikësohen Allahut.

Në shoqëri të tilla, jetërat e njerëzve nuk mbështeten në dashurinë dhe respektin e ndërsjellë. Pjesëtarët e tyre nuk ndjejnë nevojë që të tregojnë respekt ndaj njëri tjetrit. Ata

nuk shfaqin qëndrim dashamirës ndaj njëri tjetrit pa një arsye të mirë. Në të vërtetë, ata kanë plotësisht të drejtë që sjellen në këtë mënyrë, kur kemi parasysh të gjykuarit e padijshëm të tyre. Atyre u është thënë gjatë gjithë jetës së tyre se kanë evoluar prej kafshëve dhe se shpirtërat e tyre do të humbin përgjithmonë pas vdekjes së tyre. Prandaj ata e konsiderojnë të pakuptim të respektojnë një trup me prejardhje prej majmuni që do të kalbet nën tokë dhe që s' do ta shohin më kurrë. Sipas logjikës së tyre të çoroditur, “gjithë të tjerët si edhe ata vet do të vdesin dhe do të varrosen nën dhe, trupat e tyre do të kalben dhe shpirtërat e tyre do të zhduken. Prandaj, përse do të lodheshin ata të bënin vepra të mira ndaj njerëzve dhe të vet-flijohen?” Me të vërtetë, këto mendime përshkrijnë ndërdijen e secilit që nuk beson në Allahun ose, prandaj, në ahiret. Në shoqëritë ku nuk ka besim në Allahun, nuk ka bazë për paqe, lumturi dhe siguri.

Qëllimi i gjithë asaj që kemi thënë nuk është të sugjerojë se “degjenerimi shfaqet në shoqëritë në të cilat nuk ka besim në Allahun, prandaj duhet të ketë besim në Allahun.” Në Allahun duhet të besohet sepse Allahu ekziston dhe kushdo që e mohon Atë bën një mëkat të madh para Tij. Qëllimi jonë kur lajmërojmë se shoqëritë në të cilat nuk ekziston besimi në Allahun bëhen të korruptuara është që të theksojmë se pikëpamjet fundamentale të këtyre shoqërive janë të gabuara. Pikëpamjet e gabuara sjellin pasoja të këqija. Shoqëria e cila bën mëkatën më të madh të mohimit të Allahut, padyshim se do t'i përjetojë pasojat më të tmerrshme. Këto pasoja vlen të përmenden sepse tregojnë se sa e gabuar është kjo shoqëri.

Karakteristika e përbashkët e shoqërive të tilla është të qenit e tyre të mashtruar si tërësi. Siç theksohet në ajetin: Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e Allahut. (Sure En'am: 116), se kur shumica e shoqërisë ndanë një karakter të përbashkët krijon një psikologji “të masës” që përforcon mosbesimin tashmë ekzistues. Allahu përshkruan shoqëritë e tilla që janë të pavëmendshme ndaj Tij dhe ahiretit si “të padijshme” në Kur'an. Madje edhe nëse pjesëtarët e saj mund të studiojnë fizikën, historinë, biologjinë apo shkencën të ngjashme, ata nuk posedojnë ndjenjën dhe vetëdijën për të pranuar fuqinë dhe pushtetin e Allahut. Dhe në këtë kuptim janë të padijshme.

Pasiqë pjesëtarët e një shoqërie të padijshme nuk janë të devotshëm ndaj Allahut, ata largohen nga rruga e Tij në mënyra të ndryshme. Ata pasojnë njerëz të cilët janë rob/shërbyes të paaftë /jokompetent të Allahut pikërisht sikurse ata vet, duke i marrë ata si shembuj dhe duke përkrahur idetë e tyre si të vërteta absolute. Përfundimisht një shoqëri e padijshme përfundon si një shoqëri e mbyllur që gjithnjë e më shumë e verbon veten, duke u ndarë vazhdimisht nga arsyeja dhe vetëdija. Siç e kemi cekur në fillim, aspekti i këtij sistemi që më së tepërmi bie në sy është se pjesëtarët e një shoqërie të tillë veprojnë në harmoni me indoktrinimin anti-fetar.

Allahu e përshkruan në Kur'an me anë të një parabole/alegorie të mahnitshme se si një jetë e tillë, që mbështetet në bazë të pavlerë dhe të çoroditur, është e paracaktuar të fundoset:

A është pra më i mirë ai që ndërtesën e vet e themeloi në devotshmëri dhe në kënaqësi të Allahut, apo ai që ndërtesën e vet e themeloi buzë bregut gadi për t'u

shembur e bashkë me të bie në zjarrin e xhehennemit? Allahu nuk i udhëzon njerëzit zullumqarë. (Sure Teëbe: 109)

Edhe një gjë duhet të mbajmë në mend: secila shoqëri dhe secili person ka mundësi të lirohet prej indoktrinimit, mënyrës së të jetuarit dhe filozofisë së padijenisë. Allahu u dërgon atyre të dërguar të cilët i paralajmërojnë ata dhe i informojnë për ekzistencën e Allahut dhe ahiretit dhe të cilët u tregojnë kuptimin e vërtetë të jetës. Dhe bashkë me të dërguarit e Tij Ai u dërgon librat e drejtë që u përgjigjen të gjitha pyetjeve që rrjedhin mu prej vetëdijes së njerëzve. Ky është ligji i Allahut që ka ekzistuar përjetësisht. Në ditët tona, udhëzuesi i gjithë njerëzve është Kur'ani, i cili tregon rrugën e drejtë dhe i nxjerr njerëzit prej errësirës në dritë. Njerëzit do të gjykohen në pajtim me ato që ata parapëlqejnë. I dërguari që u solli njerëzve librin kështu u bëri thirrje atyre:

Thuaj: "O ju jerez, juve ju erdhi e vërteta nga Zoti juaj, e kush e pranon udhëzimin, e bën këtë për të mirën e vetes së vet, ndërsa kush e merr të shtrembëren, ai e ka humbur veten. Unë nuk jam rojë e juaj!" (Sure Junus: 108)

Banesa e vërtetë e premtuar: Ahireti

Do të duhej të ishte e qartë për çdokend që posedon mençuri dhe vetëdije se asnjëri prej objekteve që ekzistojnë, asnjëra prej ngjarjeve që ndodhin dhe asnjëri prej ligjeve që ekzistojnë në këtë gjithësi nuk janë as të pavlera dhe as të paqëllimshme. Struktura dhe qëndrueshmëria e gjithësisë, siç kemi treguar në kapitujt e mëparshëm, mbështeten në barazpesha shumë të brishta. Ato barazpesha dëshmojnë në mënyrë të padiskutueshme se gjithësia u KRIJUA. Duke qenë kështu, a mund të thuhet se gjithësia u krijuar më kot?

Padyshim se jo.

Qëllimi kërkohet madje edhe në veprimin më të vogël të bërë prej dikujt që banon në tokë, që madje nuk zën vend as sa edhe një grimcë pluhur në mesin e miliarda galaktikave. Pra, sa do të ishte e arsyeshme të pohohet se e tërë gjithësia u krijua kot së koti?

Allahu i informon njerëzit se ata nuk janë krijuar më kot:

A menduat se Ne u krijuam kot dhe se ju nuk do të ktheheni te Ne (për të dhënë llogari)? (Sure Mu'minun: 115)

Ekzistenca e jetës në tokë është mundësuar nga një varg dukurish të mrekullueshme që shtrihen prej Big Bengut e deri te atomet, prej atomeve deri te galaktikat dhe prej galaktikave deri te planeti ynë. Jeta në tokë është e tillë sa që çdo nevojë e saj është planifikuar në mënyrë të përkryer dhe është krijuar në mënyrën më të përshtatshme: dielli në qiell që siguron gjithë energjinë e nevojshme, rezervat e deponuara nën tokë dhe një botë e pajisur gjithandej me miliona specie të bimëve dhe shumëllojshmëri kafshësh. Përkundër të gjitha ngjarjeve të mrekullueshme që i kemi përshkruar, njerëzit akoma mund të refuzojnë ekzistencën e Krijuesit të tyre. Duke e parë të arsyeshme që të formohen në njeri

prej një spermatozoidi, këta njerëz nuk besojnë se do të ringjallen pas vdekjes siç na bën me dije Kur'ani dhe bëjnë vërejtje të parëndësishme. Allahu na ka tërhekur vërejtjen në Kur'an ndaj të gjykuarit të shtrembëruar të mosbesimtarëve dhe u është përgjigjur atyre:

Ai na sjellë Neve shembuj, dhe harron Krijimin e Tij: Ai thot: "Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur? Thuaj: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim. (Sure Ja Sin: 78-79)

Allahu – “Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën” – ka krijuar gjithçka në gjithësi për një qëllim të veçantë dhe në këtë mënyrë ka shpjeguar qëllimin e krijimit të njeriut: “për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është ngadhnjyesi, mëkatëfalësi.” (Sure Mulk: 2) Siç shpjegohet në këtë ajet, kjo botë është vend i sprovës dhe si i tillë është i përkohshëm. Ekziston një fund për të gjithë njerëzit sikurse edhe për botën, koha e së cilës është paracaktuar prej Allahut. Njerëzit janë përgjegjës që të jetojnë jetërat e tyre të shkurtëra që u janë dhuruar në pajtim me kushtet e përcaktuara prej Allahut dhe të përshkruara në Kur'an. Në ahiret ata do të shpërblehen për atë që kanë vepruar këtu.

NDËSHKIMI I PËRJETSHËM

Gjatë këtij libri kemi përshkruar argumentet e dukshme të ekzistencës së Allahut, mbrojtësit e sistemit që mbështetet në mohimin e Allahut dhe llojin e kontekstit të shoqërisë që ata përpiqen të themelojnë.

Gjithçka që kemi diskutuar gjer më tani ka të bëjë me “jetën e kësaj bote”. Megjithatë, ajo që pason vdekjen, domethënë, “ahireti” poashtu meriton vëmendje serioze.

Ata që punojnë për të përparuar sistemet të cilat mbështeten tërësisht në mosbesimin në Allahun u ofrojnë një jetë të dhimbshme pasuesve të tyre në këtë botë. Këta njerëz do të bëjnë gjithashtu që pasuesit e tyre të vuajnë një ndëshkim të rëndë në ahiret. Atje, ata assesi nuk do t’u kushtojnë vëmendjen që u kushtonin këtyre njerëzve të marrë të cilët i pasuan në këtë botë. Përkundrazi, atje, ata do të përkujdesen vetëm për të shpëtuar vetveten siç shpallet në ajetin vijues:

Secili njeri që ka dëmtuar veten (duke mosbesuar), po të ishte e tij çdo gjë që ekziston në tokë, ai do ta flijonte atë (për të shpëtuar)... (Sure Junus: 54).

Qëndrimi i atyre të cilët përkrahin mosbesimin në këtë botë shprehet poashtu edhe në ajete tjera:

Sa herë që një grup hyn në të, e mallkon atë të mëparshmin derisa kur të arrijnë në të të gjithë, grupi i fundit i tyre thotë për grupin e parë: "Zoti ynë, këta (paria) na kanë humbur neve (nga rruga e drejtë), pra shtojni dënimin me zjarr atyre!" Allahu do të thotë: "Për secilin (grup) është (dënimi) i shtuar, por ju nuk po dini. Të parët e tyre (paria) të mbaramëve të tyre ju thotë: " Ju nuk keni përparësi ndaj nesh (pse vetë keni bërë kufur), shijoni pra dënimin për atë që keni bërë!" (Sure A'raf: 38-39)

Siç është e qartë, nuk përbën me të vërtetë ndonjë dallim të madh nëse njeriu është pjesëtar i atyre që prijnë në mosbesim apo i atyre që mbesin prapa. Si pasojë, të dyjat grupet vuajnë humbje të madhe dhe e meritojnë dënimin e përjetshëm për mëkatet që kanë bërë në këtë botë. Në Kur'an, Allahu ka përshkruar në hollësi gjendjen shpirtërore dhe rrethanat në të cilat do të jenë këta njerëz dhe ndëshkimin që do të vuajnë në ditën e ringjalljes, në ditën e llogarisë dhe xhehenem.

DITA E RINGJALLJES

Kur Allahu përmend ditën e ringjalljes në Kur'an, Ai e quan atë “ditën kur thirrësi (Israfil) kumton një send të tmerrshëm (të panjohur)... (Sure Kamer: 6) Llahtari i kësaj dite është diçka që qeniet njerëzore nuk mund ta dinë sepse kurrë nuk kanë parë diçka të tillë.

Vetëm Allahu e din kohën e ardhjes së kësaj dite. Njohuria e njerëzve për këtë ditë është e kufizuar me atë që rrëfëhet në Kur'an. Dita e ringjalljes do të vie papritur kur askush nuk e prë.

Kjo ditë mund t’i zë njerëzit kur punojnë në zyren e tyre, flenë në shtëpinë e tyre, bisedojnë në telefon, lexojnë një libër, qeshin, qajnë apo dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë.

Për më tepër, ky pushtim do të jetë aq i llahtarshëm sa që askush nuk ka parë diç të tillë gjatë tërë jetës së tij.

Dita e ringjalljes fillon kur t'i fryhet Surit (Sure Mudeththir: 8-10). Kur të jetë dëgjuar ky zë në mbarë botën, ata që nuk e kanë përdorur kohën që u është dhënë nga Allahu për të fituar kënaqësinë e Tij do të pushtohen prej një frike të madhe. Allahu përshkruan në Kur'an ngjarjet e llahtarshme që do të ndodhin atë ditë:

Por jo, ora/dita (e gjykimit) është koha që u është premtuar (për shpërblimin e plotë të tyre), dhe ajo orë/ditë do të jetë më e vështira dhe më e hidhura. (Sure Kamer: 46)

Siç rrëfëhet në këto vargje, fryrja e Surit pasohet me një dridhje të fuqishme dhe me një gjëzim aq të të fuqishëm sa të shurdhojë veshët. Prej fuqisë së këtij gjëzimi, malet do të fillojnë të dridhen dhe të rrëshqasin me tokën nën to (Sure Zilzal: 1-8).

E kodrat shkapërderdhën e bëhen copë e thërmi (Sure Vakia: 5). Në atë çast, njerëzit shumë mirë e kuptojnë se sa të parëndësishme janë gjërat që ata kanë dashur aq shumë deri atëherë. Të gjitha vlerat materiale që ata kanë ndjekur gjatë jetërave të tyre zhduken papritur:

Prandaj, kur të vijë vala e madhe (kijameti), Atë ditë njeriu përkuqton se çka ka punuar. E Xhehennemi shfaqet sheshazi për ta parë të gjithë. (Sure Nazi'at: 34-36)

Në atë ditë, madje edhe malet prej gurëve, tokës dhe shkëmbinjëve do të bëhen si leshi i shprishur. (Sure Kari'a: 5) Njeriu tashmë bëhet i vetëdijshëm se kjo fuqi nuk është fuqia e natyrës. Sepse në atë ditë natyra poashtu përulet. Një frikë dhe tmerr i llahtarshëm mbizotëron gjithçka ndodhë në atë ditë. Njerëzit, kafshët dhe natyra janë të gjitha të pushtuara nga ky llahtar. Njerëzit shohin se oqeanet përzihen (Sure Infitar: 3) dhe vlojnë si zjarr i flakëruar (Sure Tekvir: 6).

Qiejt fillojnë të dridhen mu sikurse toka dhe fillojnë të çahen, në një mënyrë deri atëherë të paparë. Ngjyra e kaltërt e zakonshme e qiellit me të cilën janë mësuar njerëzit i ngjanë dhe bëhet si kallaji i shkrirë. (Sure Me'arixh: 8) Në këtë ditë, gjithçka në qiej që japte dritë papritur errësohet; dielli mbështjellët (dhe errësohet), (Sure Tekvir: 1), hëna ndahet më dysh (Sure Kamer: 1) dhe dielli e hëna bashkohen. (Sure Kijame: 9)

Shtatzënat humbasin fëmijët e tyre për shkak të frikës së llahtarshme të asaj dite. Kjo frikë fëmijët i bën të thinjur (pleq) (Sure Muzemmil: 17). Fëmijët ikin prej nënave të tyre, gratë prej burrave të tyre dhe familjet prej njëra tjetrës. Allahu jap arsye për këtë në Kur'an:

E kur të vijë ushtima (krisma e kijametit), atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet, Prej nënës dhe prej babait të vet, Prej gruas dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet. (Sure Abese: 33-37)

DITA E LLOGARISË

Pasiqë të kenë ndodhur të gjitha këto ngjarje në ditën e ringjalljes siç përshkruhet më lartë, i fryhet Surit për herë të dytë. Ky zë shënon nismën e ditës në të cilën çdo njeri do të ringjallet. Atë ditë toka mbushet përplot me njerëz që ngriten prej varreve të tyre ku ata qëndruan të varrosur ndoshta me qindra dhe mijëra vite. Ringjallja e njerëzve në atë ditë dhe gjendja e hutimit në të cilin do të jenë ata zbulohen prej Kur'anit:

Dhe i fryhet Surit, kur qe, duke u ngutur prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre. E thonë: "Të mjerët ne! Po kush na ngriti prej ku ishim të shtrirë në varre?" E, kjo është ajo që premtoi Zoti dhe vërtetuan të dërguarit. Ajo nuk është tjetër, përveç një zë i fuqishëm dhe ata të gjithë paraqiten para Nesh. Sot pra, askujt nuk i bëhet asnjë e padrejtë dhe nuk shpërbleheni me tjetër vetëm për atë që vepruat. (Sure Ja Sin: 51-54)

Në atë ditë, gjithçka për çka njerëzit ishin të prirur të mendojnë, gjithçka që ata nuk deshën të kuptojnë dhe gjithçka prej asaj që iu shmangën shfaqet haptazi. Atyre nuk u mbetet më asnjë mjet i ikjes apo mohimit.

Në momentin kur këta njerëz, me vulën e poshtërimin në fytyrat e tyre dhe koka të ulura, dalin prej varreve të tyre dhe mblidhen, toka shkëlqen prej dritës dhe libri i secilit njeri i sjellet pranë dhe i jepet atij.

Në këtë ditë të takimit, kur mizëri të mëdha njerëzish të papara deri atëherë mblidhen, gjendja e besimtarëve dhe e mosbesimtarëve padyshim që është e ndryshme. Në Kur'an kjo rrëfëhet si më poshtë:

Kujt t'i japet libri i vet nga e djathta e tij, ai do të thotë: "O ju, ja, lexojeni librin tim!" Unë kam qenë i bindur se do të jap llogarinë time. Dhe ai atëherë është në një jetë të kënaqshme. (Sure Hakka: 19-21)

Ndërkaq, kujt i jepen librat e veta nga e majta, ai thotë: "O i mjeri unë, të mos më japë fare libri im. Dhe të mos dijsa fare se çka është llogaria ime. Ah, sikur të kishte qenë ajo (vdekja e parë) mbarim i amshueshëm për mua. Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetencë imja. (Sure Hakka: 25-29)

Në këtë ditë, as edhe një padrejtësi sa një atom nuk i bëhet askujt. Çdokush shpërblehet plotësisht sipas asaj që ka bërë në këtë botë. Një ditë e vështirësisë së skajshme për mosbesimtarët, kjo ditë është ajo në të cilën jeta e tyre e përjetshme në xhehennem bëhet e sigurt.

Ajetet në vazhdim qartë zbulojnë atë që i pret, në Ditën e Llogarisë, ata që këmbëngulin në mohimit e Allahut gjatë jetërave të tyre dhe të cilët pasuan thirrësit e qëllimeve të pavlera në Ditën e Llogarisë:

Dhe i fryhet Surit dhe bie i vdekur çka ka në qiej dhe në tokë, përveç atyre që do Allahu (të mos vdesin), pastaj i fryhet atij herën tjetër, kur ja, të gjithë ata të ngritur e presin (urdhërin e Zotit). Toka është ndriçuar me dritën e Zotit të vet, libri (shënimet

mbi veprat) është vënë pranë dhe sillen pejgamberët e dëshmitarët, e kryhet mes tyre gjykimi me drejtësi, e atyre nuk u bëhet padrejtë. Dhe, secili njeri shpërblehet me atë që ka vepruar, e Ai më së miri e di se ç'punuan. E ata që nuk besuan sillen në grupe të Xhehennemi, e kur arrijnë te ai, dyert e tij hapen e roja e tij u thotë atyre: "A nuk u patën ardhur juve të dërguar nga mesi juaj t'ju lexojnë shpalljet e Zotit tuaj, t'ju tërheqin vërejtjen për ballafaqimin tuaj në këtë ditë?" Po, (na kanë ardhur...) thonë ata, por vendimi i dënimit domosdo është bërë realitet kundër jobesimtarëve! U thuhet: "Hyni nëpër dyer të Xhehennemit, aty do të jeni përgjithmonë, sa vend i keq është për kryelartët!" (Sure Zumer: 68-72)

XHEHENNEMI (FERRI)

Mëkati më i madh që mund të bëj një njeri është të ngrit krye kundër Allahut, Krijuesit dhe Dhuruesit të Jetës. I krijuar për të qenë rob/shërbyes i Allahut, njeriu, nëse bie në kundërshtim me qëllimin e krijimit të tij, natyrisht se meriton një ndëshkim që i shkon për shtati keqbërjes së tij. Xhehennemi është vendi në të cilin ky ndëshkim zbatohet. Shumica e njerëzve kalojnë tërë jetën e tyre në njëfarë dehjeje pa menduar fare për këtë. Njëra prej arsyeve më të rëndësishme për këtë dehje është paaftësia e tyre për të bërë një vlerësim të saktë të Allahut. Shumë njerëz e vlerësojnë Allahun për vetitë e Tij të dhembshurisë, mëshirës dhe faljes; ata nuk ndejnë një frikë të thellë dhe të thekshme ndaj Allahut siç do të duhej të ndjenin. Kjo bën që këta njerëz të jenë të pandjeshëm ndaj urdhërave dhe këshillave të Allahut. Allahu paralajmëron njerëzit në veçanti në lidhje me këtë rrezik në Kur'an:

O ju njerëz, kini kujdes ndaj Zotit tuaj dhe kini frikë prej ditës kur prindi nuk mund t'i bëjë dobi fëmijës së vet, e as fëmija nuk mund t'i bëjë asnjë dobi prindit të vet. Premtimi i Allahut (për thevab ose azab) është i sigurt, pra të mos ju mashrojnë jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashrojnë ndaj Allahut djalli mashtrues. (Sure Lukman: 33)

Me të vërtetë, Allahu, Zotëruesi i emrave dhe vetive më të bukura, është i dhembshur, i mëshirshëm dhe falës. Megjithatë, duhet poashtu të mos harrohet se Allahu, në të njëjtën kohë, është përjetësisht i Drejtë, Sunduesi i gjithçkaje dhe Imponuesi, se Allahu është pranë besimtarëve por larg prej idhujtarëve, mosbesimtarëve dhe dyfytëreshve; se Ai është Zoti i ndëshkimit; dhe se xhehennemi është vendi ku vetitë e Tij të fundit do të mishërohen në mënyrën më të përkryer.

Njerëzit, për disa arsye, kanë besime të paragjykuara në lidhje me këtë çështje. Ata pandehin se pasiqë vdesin, do të shkojnë në xhehennem për të paguar për mëkatet që kanë bërë në këtë botë, por që pastaj do të shkojnë në parajsë pasiqë të ketë përfunduar ndëshkimi i tyre dhe do të banojnë atje përgjithmonë. Allahu, megjithatë, na bën me dije në Kur'an se jeta si në xhehennem ashtu edhe në xhennet (parajsë) do të zgjas përjetësisht dhe se askush nuk do të lirohet prej ndonjëres prej tyre pos nëse Allahu ashtu dëshiron.

Dhe ata thonë: "Neve nuk do të na kapë zjarri vetëm për disa ditë të numëruara!" Thuaj: "A mos keni marrë prej Allahut ndonjë premtim, e Allahu nuk e thyen premtimin e

vet, ose jeni duke thënë për Allahun atë që nuk e dini? Po, (do të ju kapë zjarri) ai që bën keq dhe që e vërshojnë gabimet e tij, ata janë banues të zjarrit, aty janë përgjithmonë. E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, ata janë banues të Xhenetit, aty janë përgjithmonë. (Sure Bekare: 80-82)

Njerëzit do të ndeshen me mundime të tilla si zjarri, nxehtësia, errësira, tymi, ngushtësia, verbëria, shtrëngimi, uria, etja, ujë të qelbëzuar, ujë të valë dhe druri helmues i zekumit. Përveç ndëshkimeve që shkaktojnë plagë fizike, ata gjithashtu do të përjetojnë një torturë të madhe shpirtërore që depërton deri në loçkë të zemrës. (Sure Humeze: 4-9) Mundimet e tmerrshme të cilave do t'u nënshtrohen në xhehennem njerëzit të cilët shpërfillin ekzistencën e Allahut përshkruhen në hollësi në Kur'an. Vargjet zbulojnë se sa e rëndësishme është kjo çështje për njeriun. Tërbimi i xhehennemit është aq i madh sa që nuk mund të krahasohet me asnjë fatkeqësi në këtë botë. Allahu e përshkruan këtë përfundim të tmerrshëm që i pret mosbesimtarët në Kur'an:

Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai pa tjetër do të hidhet në Hutame. E çka din ti se ç'është Hutame? Është zjarri i Allahut i ndezur fort. Që depërton deri në loçkë të zemrës. Ai i mbyll ata, ua zë frymën. Ata janë të lidhur në pranga të njëpasnjëshme. (Sure Humeze: 4-9)

Atë ditë sheh fytyra të përulura, Të lodhura e të rraskapitura (nga mundimi). Ato hyjnë në zjarrin të ndezur fort, U jepet të pijnë prej një kroi të valë. Ata nuk kanë ushqim tjetër pos një barishte me ferra helmuese. Që as nuk jep fuqi, as nuk largon uri. (Sure Gashije: 2-7)

Ne për jobesimtarët kemi përgatitur zingjirë, pranga e zjarr. (Sure Insan: 4)

Ja, ky është Xhehennemi, të cilin kriminelët e mohonin. Ata do të sillen vërdallë ndërmjet atij (zjarrit) dhe ujit të valë deri në kulminacion. (Sure Rahman: 43-44)

Po për ata që nuk besuan është zjarri i Xhehennemit. Ata as nuk gjykohen që të vdesin (të rehatohen) e as nuk u lehtësohet ndëshkimi. Kështu e ndëshkojmë secilin që është shumë i pabesë. Dhe ata do të klithin aty: "O Zot ynë, nxirrna e të bëjmë vepra të mira, e jo si ato që i bënim!" Po a nuk u dhamë juve jetë aq sa që ai ka dashur të mendojë, ka mundur të mendojë gjatë asaj kohe, madje juve u ka ardhur edhe pejgamberi, pra shijoni, se për zullumçarët nuk ka ndonjë ndihmëtar. (Sure Fatir: 36-37)

Ata do të tubohen, do të jenë të përmbysur me fytyrat e tyre në Xhehennem, të tillëve u përket vendi më i keq, ndaj ata janë më të humburit në rrugën e tyre. (Sure Furkan: 34)

Që posa të duket ai prej një vendi të largët, ata ia dëgjojnë atij vëlimin edhe kërhamzën e tij (Xhehennemit). E kur të hudhen duarlidhur në një vend të ngushtë në

të, aty do të kërkojnë shkatërrimin (vetëzhdukjen). Tash mos kërkon vetëm njëherë shkatërrimin, por atë kërkon shumëherë. (Sure Furkan: 12-14)

BANESA E VËRTETË E PREMTUAR PËR BESIMTARËT: XHENNETI (PARAJSA)

Pra, për atë që kanë vepruar nuk di askush për atë kënaqësi (të zemrës e shpirtit) që u është caktuar atyre si shpërblim. (Sure Sexhde: 17)

Xhenneti është banesa e premtuar për besimtarët për besimin e tyre në Allahun dhe për përkushtimin e tyre ndaj Tij. Parajsa, siç përshkruhet në shumë vargje, është një vend i rrethuar me shumëlloj mirësish dhe është banesa e lumturisë së përhershme. Allahu shpërblen besimtarët me parajsë si shpërblim për veprat e tyre në këtë botë.

Xhenneti është një vend ku vetia “e Gjithëmëshirshme” (mëshira e të Cilit është vetëm për besimtarët, Mëshirëploti, I Cili i shpërblen ata të cilët përdorin me vend të mirat e Tij me të mira më superiore/të larta dhe të përhershme) e Allahut zbulohet. Prandaj, parajsa është një vendbanim i kënaqësisë që strehon gjithçka që shpirti i njeriut mund të dëshirojë dhe madje edhe më shumë siç përshkruhet në këto vargje.

Në mendjet e disa njerëzve, fjala “xhennet” ngjallë nocione mjaft të kufizuara, sepse ata pandehin që xhenneti të jetë një vendbanim vetëm i bukurisë natyrore, siç është një livadh i hirshëm. Megjithatë, ekziston një dallim i madh në mes të nocionit/idesë së kufizuar si një vend që përmban gjithçka që një person mund të dëshirojë:

Aty do të kenë çka t'u dëshirojë shpirti dhe gjithçka që mund t'u kënaqë syrin. Ju do të jeni aty përgjithmonë. (Sure Zuhuf: 71)

Në një varg tjetër na tregohet se në xhennet ka madje edhe më shumë se çka do të mund të dëshironte njeriu:

Ata aty kanë çfarë të dëshirojnë, e te Ne ka edhe më shumë. (Sure Kaf: 35)

Me fjalë tjera, përkundër besimit të përgjithshëm, parajsa ka mirësi të panumërta për të ofruar, mirësi të tilla të papara për qeniet njerëzore gjatë jetërave të tyre në këtë botë dhe madje të paimagjinueshme për ta. Besimtarëve do t'iu dhurohet jetë e amshueshme në xhennet si shpërblim për bindjen e tyre ndaj Allahut në jetën e kësaj bote dhe për shkak se kanë jetuar sipas dëshirave të Tij.

Xhenneti që u është premtuar besimtarëve përshkruhet në vargje të ndryshme:

E, përgëzoi ata që besuan dhe bënë vepra të mira se ata do të jenë në Xhennete në të cilët rrjedhin lumenj. Saherë që u japet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata thonë: "Ky është që me te u ushqyem edhe më parë". Ngase, u sillet ushqim i ngjashëm

(vetëm në formë, e jo edhe në shije). Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë. (Sure Bekare: 25)

E ata, të cilët iu ruajtën (mosbesimit dhe punëve të këqija) janë në xhennete e mes burimeve. (u thuhet) Hyni në to, të shpëtuar (prej çdo të keqeje) të siguruar (nga vdekja). Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfarëdo urrejtje, e ata në mbështetëse qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit duke qenë të vëllazëruar. Ata aty nuk i godet kurrfarë lodhje dhe nuk do të nxirren kurrë prej tij. (Sure Hixhr: 45-48)

Të tillët e kanë vendin në Xhennetin e Adnit, nën të cilin rrjedhin lumenj; e aty stolisen me rrathë të artë dore dhe ata veshin rrobe të gjelbërta prej mëndafshi të hollë e të trashë, janë mbështetur aty në shtretër. Sa shpërblim i mrekullshëm është dhe sa vend i bukur është ai. (Sure Kehf: 31)

Ata të Xhennetit tash janë të angazhuar me kënaqësi. Ata dhe shoqet e tyre janë nën hijet të mbështetur në kolltukë. Aty kanë pemë dhe çka të duan. Kanë "Selam", thënie e Zotit mëshirues! (Sure Ja Sin: 55-58)

Vërtet, ata që i patën frikë Zotit, janë në vende të qeta. Janë në Xhennete e në burime që rrjedhin. Veshin petka nga mëndafshi e kadifeja, ulur ballë për ballë. Ja kështu, edhe i martojmë më bardhoshe me sy të bukur, të mëdhenjë e të shkëlqyeshëm (me hyrija). Aty kërkojnë t'u sillen çdo lloj peme dhe aty janë të sigurt. Aty nuk do të përjetojnë vdekjen, përveç asaj të parës në dynja. Ata i shpëtoi (Allahu) prej vuajtjeve të Xhehennemit. (Ato të mira) Janë dhuratë nga Zoti yt, e ai është shpëtim i madh. (Sure Duhan: 51-57)

E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, atyre do t'u bëjmë vend të lartë në Xhennet në të cilin rrjedhin lumenj, aty janë përgjithmonë; sa i mirë është shpërblimi për atë që vepruan. (Sure Ankebut: 58)

NJË PARALAJMËRIM PËR ATA QË DO TË MUND T'I SHPËTONIN VUAJTJES SË PËRJETSHME

Padyshim, çdokush është i lirë të jetojë si dëshiron në këtë botë dhe të zgjedhë rrugën që dëshiron. Askush nuk ka të drejtë të ushtrojë zor/detyrim mbi dikend tjetër. Megjithatë, si ata që besojnë në ekzistencën dhe drejtësinë e përjetshme të Allahut, është detyrë e jona solemne t'i paralajmërojmë njerëzit të cilët do të mund të refuzonin Allahun dhe të cilët janë të pavetëdijshëm për gjendjen dhe drejtimin e tyre të tanishëm. Allahu na ka bërë me dije për seriozitetin e gjendjes së këtyre njerëzve:

A është më i mirë ai që ndërtesën e vet e themeloi në devotshmëri dhe në kënaqësi të Allahut, apo ai që në ndërtesën e vet e themeloi buzë bregut të shembur e

**bashkë me të bie në zjarrin e xhehennemit? Allahu nuk i udhëzon njerëzit zullumqarë.
(Sure Teube: 109)**

Ata të cilët me qëllim ia kthejnë shpinën fjalëve të Allahut ose të cilët në mënyrë të pavetëdijshme nuk e pranojnë Krijuesin e tyre, s' do të kenë mundësi shpëtimi në ahiret. Nëse nuk pendohen dhe udhëzohen drejt Allahut, I Cili i krijoi ata, do të vuajnë ndëshkimet më të mëdha të mundshme. Ndëshkimi i përjetshëm që i prët ata shpallet në këtë mënyrë në Kur'an:

Ndërsa ata që nuk i besuan argumentet Tona, ata janë të së majtës. Kundër tyre është zjarri i mbyllur. (Sure Beled: 19-20)

Rruga drejt shpëtimit prej ndëshkimit të përjetshëm dhe të merituarit e xhennetit të amshueshëm është e qartë:

Të kesh besim të sigurtë në Allahun para se të jetë tepër vonë.

Të kalosh jetën tënde duke kërkuar kënaqësinë e Tij.

PARALAJMËRIM

Kapitullin që do ta lexoni tani zbulon një fshehtësi vendimtare të jetës suaj. Duhet ta lexoni me shumë vëmendje dhe në tërësi sepse ka të bëjë me çështjen që ka gjasa të bëjë ndryshime fundamentale në botëkuptimin tuaj për botën e jashtme. Tema e këtij kapitulli nuk është vetëm një pikëpamje, një qasje tjetër apo një mendim tradicional apo filozofik; është një fakt të cilin çdokush, që beson apo nuk beson, duhet ta pranojë dhe i cili poashtu është vërtetuar nga shkenca sot.

Një qasje krejtësisht tjetër ndaj materies

Njerëzit të cilët mendojnë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me mençuri për mjedisin që i rrethon kuptojnë se gjithçka në gjithësi – e gjallë apo e pajetë – duhet të jetë krijuar. Çështja është se “Kush është Krijuesi i të gjitha gjërave?”

Është e qartë se “fakti i krijimit”, i cili zbulon veten në çdo aspekt të gjithësisë, nuk mund të jetë rezultat/pasojë i vet gjithësisë. Për shembull, një insekt nuk mund të ketë krijuar veten. Sistemi diellor nuk mund të ketë krijuar apo organizuar veten. As bimët, njerëzit, bakteriet, eritrocitet (rruazat e kuqe të gjakut), as fluturat nuk mund të kenë krijuar vetveten. Poashtu mundësia se të gjitha këto mund të kishin zënë fill “rastësisht” është madje e papërfytyrueshme.

Prandaj vijmë në përfundimin vijues: Gjithçka që shohim është krijuar, por asgjë që ne shohim nuk mund të jenë “krijues” të vetvetes. Krijuesi ndryshon dhe është më superior se gjithçka që ne shohim me sytë tonë, një fuqi superiore që është e padukshme por ekzistenca dhe vetitë e të cilës shfaqen në gjithçka që ekziston.

Kjo është pika në të cilën ata të cilët e mohojnë ekzistencën e Allahut përmbahen. Këta njerëz janë të kushtëzuar të mos besojnë në ekzistencën e Tij përveç nëse e shohin Atë

me sytë e tyre. Këta njerëz, të cilët shpërfillin faktin e “krijimit”, janë të detyruar të injorojnë vërtetësinë e “krijimit” të dukshme në mbarë gjithësinë dhe përpiqen të dëshmojnë se gjithësia dhe të gjitha gjallesat në të nuk janë krijuar. Teoria e evolucionit është një shembull qendror për përpjektjet e tyre të kota për këtë qëllim.

Gabimi themelor i atyre të cilët e mohojnë Allahun ndahet prej shumë njerëzve të cilët nuk e mohojnë me të vërtetë ekzistencën e Allahut por kanë një përfytyrim të gabueshëm të Tij. Ata nuk e mohojnë krijimin por kanë besime paragjyquese në lidhje me atë se “ku” është Allahu. Shumica e tyre mendojnë se Allahu është lartë në “qiel”. Ata heshturazi e paramendojnë se Allahu është prapa një planete shumë të largët dhe ndërhyjnë në “punët e tokës” kohë pas kohe ose ndoshta fare nuk ndërhyjnë. Ata paramendojnë se Ai krijojë gjithësinë dhe pastaj e la në dorë të fatit, duke i lënë njerëzit të përcaktojnë fatet e tyre.

Mirëpo të tjerët kanë dëgjuar se në Kur’an shkruan se Allahu është “gjithkund” por nuk mund ta marrin me mend se ç’do të thotë kjo saktësisht. Ata mendojnë se Allahu përfshinë gjithçka si radio valët apo si një gaz i padukshëm, i pakapshëm.

Megjithatë, ky dhe besime tjera që nuk janë në gjendje të qartësojnë se “ku” është Allahu (dhe ndoshta për shkak të kësaj e mohojnë Atë) të gjitha janë të bazuara në një gabim të përbashkët. Ata paragjykojnë pa asnjë bazë për këtë dhe kështu lëvizin drejt mendimeve të gabueshme për Allahun. Cili është ky paragjykim?

Ky paragjykim ka të bëjë me natyrën dhe karakteristikat e materies. Ne kështu jemi të kushtëzuar në supozimet tona për ekzistencën e materies sa që kurrë nuk mendojnë nëse ajo ekziston apo nëse ajo është vetëm një hije. Shkenca moderne hedh poshtë këtë paragjykim dhe zbulon një realitet shumë të rëndësishëm dhe domethënës. Në faqet vijuese, ne do të përpiqemi të qartësojmë këtë realitet madhështor të cilin e thekson Kur’ani.

Bota e sinjaleve elektrike

I gjithë informacioni që kemi për botën në të cilën jetojmë na transmetohet përmes pesë shqisave tona. Bota të cilën ne e njohim përbëhet prej asaj që shohin sytë tonë, ndjejnë duart tona, nuhatin hundët tona, shijojnë gjuhët tona dhe dëgjojnë veshët tonë. Neve kurrë nuk na shkon mendja se bota “e jashtme” do të mund të ishte gjithçka tjetër përveç asaj që shqisat tona na paraqesin, pasi që kemi qenë të varur vetëm prej këtyre shqisave që prej lindjes sonë.

Hulumtimet bashkëkohore në shumë fusha të ndryshme të shkencës tregojnë për një kuptim krejtësisht tjetër dhe krijojnë dyshim serioz për shqisat tona dhe botën që ne e përceptojmë me anë të tyre.

Pikënisja e kësaj qasjeje është se idea e një “bota të jashtme” e formuar në trurin tonë është vetëm një përgjigje e krijuar në trurin tonë përmes sinjaleve elektrike. E kuqja e mollave, fortësia e drurit dhe veç kësaj, nëna juaj, babai, familja e juaj dhe gjithçka që ju posedoni, shtëpia juaj, puna dhe rreshtat e këtij libri, përbëhen vetëm prej sinjaleve elektrike.

Frederik Vester shpjegon pikën që ka arritur shkenca në lidhje me këtë çështje:

Deklaratat e disa shkencëtarëve që pohojnë se “njeriu është një përfytyrim, çdo gjë e përjetuar është e përkohshme dhe mashtruese dhe kjo gjithësi është një hije”, duket se vërtetohet nga shkenca e ditëve tona. 63

Filozofi i famshëm, Xhorxh Berkli komentoi për këtë çështje si më poshtë:

Ne besojmë në ekzistencën e objekteve vetëm pse ne i shohim dhe i prekim ato dhe ato reflektohen tek ne përmes perceptimeve tona. Megjithatë, perceptimet tona janë vetëm ide në mendjen tonë. Pra, objektet që ne kapim përmes perceptimeve nuk janë asgjë tjetër veçse ide dhe këto ide në thelb nuk janë askund veçse në mendjen tonë... Pasiqë të gjitha këto ekzistojnë vetëm në mendje, atëherë do të thotë se ne gënjehemi prej mashtrimeve kur paramendojmë që gjithësia dhe gjërat të kenë një ekzistencë jashtë mendjes. Pra, asnjëra prej gjërave që na rrethon nuk ekziston jashtë mendjes sonë. 64

Për të qartësuar këtë çështje, le ta marrim parasysh shqisën e të pamurit, e cila na siguron informacionin më gjithëpërfshirës për botën e jashtme.

Si shohim, dëgjojmë dhe shijojmë?

Veprimi i të pamurit realizohet në mënyrë progressive. Grumbuj drite (fotonet) udhëtojnë prej objektit te syri dhe kalojnë nëpër thjerrë në pjesën e përparme të syrit ku ato përthyhen dhe kthehen mbrapsht në retinë në pjesën e prapme të syrit. Këtu, drita goditëse shëndrrohet në sinjale elektrike që barten përmes neuroneve në një pikë të vogël në qendër të trurit pas një vargu procesesh. Veprimi i të pamurit ndodhë në të vërtetë në këtë pikë të vogël në pjesën e prapme të trurit, e cila është sterrë e zezë dhe krejtësisht e izoluar prej dritës.

Tani, le të marrim parasysh këtë proces në dukje të zakonshëm dhe jo të mrekullueshëm. Kur themi: “ne shohim”, ne në fakt jemi duke parë efektet e implulseve që arrijnë sytë tonë dhe ndikojnë në trurin tonë, pasi që të jenë shëndrruar në sinjale elektrike. Domethënë, kur themi: “ne shohim”, ne në të vërtetë jemi duke vëzhguar sinjalet elektrike në mendjen tonë.

Të gjitha imazhet që ne shohim në jetërat tona formohen në qendrën e të pamurit tonë, e cila përbëhet prej vetëm disa centimetrave kub të vëllimit të trurit. Të dyja, si libri që jeni duke e lexuar tani dhe pejzazhi i pafund që shihni kur kundroni horizontin zënë vend në këtë hapsirë të vogël. Një gjë tjetër që duhet të mbajmë në mend është se, siç kemi cekur më parë, truri është i izoluar prej dritës; brendia e tij është absolutisht e errët. Truri nuk ka kurrfarë kontakti me dritën.

Këtë rrethanë interesante mund ta shpjegojmë me një shembull. Le të pandehim se përpara nesh ekziston një qiri të ndezur. Ne mund të ulemi përballë këtij qiriri dhe ta vështrojmë atë gjatë. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe, truri jonë kurrë nuk ka çfarëdo kontakti të drejtpërdrejtë me dritën origjinale të qiririt. Madje edhe kur ne e shikojmë dritën e qiririt, brendia e trurit tonë është plotësisht e errët. Ne e vështrojmë një botë shumëngjyrëshe dhe të ndritshme brenda trurit tonë të errët.

R. L. Gregori jap shpjegimin vijues për aspektet e mrekullueshme të të pamurit, diçka që ne e marrim si aq të vërtetë:

Ne jemi aq të mësuar me të pamurit, sa që nevojitet një tejkallim i imagjinatës për të kuptuar se ka probleme që duhen zgjidhur. Por merreni parasysh këtë fakt. Neve na janë dhënë imazhe të vogla të shtrembëruara të kthyera mbrapsht në sytë tonë dhe ne shohim objektet e plota të veçuara në hapësirën që na rrethon. Prej mostrave të simulimit në retina ne perceptojmë botën e objekteve dhe kjo nuk është asgjë më pak se një mrekulli. 65

E njëjta rrethanë vlen për të gjitha shqisat tjera tonat. Zëri, prekja, shija dhe aroma të gjitha përçohen në tru si sinjale elektrike dhe perceptohen në qendrat përkatëse të trurit.

Shqisa e të dëgjuarit funksionon në një mënyrë të ngjashme me atë të të pamurit. Veshi i jashtëm kap tingujt me anë të veshit të jashtëm dhe i drejton ato tek veshi i mesëm. Veshi i mesëm përçon dridhjet e tingujve tek veshi i brendshëm dhe i rritë ato. Veshi i brendshëm i përkthen dridhjet në sinjale elektrike, të cilat i dërgon në tru. Pikërisht sikurse në rastin e syrit, veprimi i të dëgjuarit në fund ndodhë në qendrën e të dëgjuarit në tru. Truri është i izoluar prej tingullit pikërisht sikur që është i izoluar prej dritës. Prandaj, pa marrë parasysh se sa zhurmshëm është jashtë, brendia e trurit është plotësisht e heshtur.

Sidoqoftë, madje edhe tingujt më të lehtë perceptohen në tru. Kjo është aq precize sa që veshi i një njeriu të shëndoshë dëgjon gjithçka pa asnjë zhurmë apo pengesë atmosferike. Në trurin tuaj, i cili është i izoluar prej tingujve, ju dëgjoni simfonitë e një orkestre, dëgjoni secilën zhurmë të një vendi përplot me njerëz dhe perceptoni të gjithë tingujt përbrenda një spektri të gjerë frekuencash, prej shushurimës së një gjethe deri te gjëmimi i një aeroplani reaktiv. Megjithatë, po të matej niveli i tingullit në trurin tuaj me anë të një pajisjesje të ndjeshme në atë moment, do të shihet se aty mbizotëron një heshtje e plotë.

Perceptimi jonë i aromës formohet në mënyrë të ngjashme. Molekulat e paqëndrueshme të emetuara prej gjërave si vanila apo një trëndafil arrijnë receptorët në qimet delikate në regjionin e epitelit të hundës dhe përfshihen në një bashkëveprim. Ky bashkëveprim përçohet në tru në formë të sinjaleve elektrike dhe perceptohet si aromë. Gjithçka që ne nuhasim, qoftë e këndshme apo e pakëndshme, nuk është asgjë tjetër veçse perceptim i trurit i bashkëveprimit të molekulave të paqëndrueshme pasi që ato të jenë shëndrruar në sinjale elektrike. Ju perceptoni aromën e një parfumi, një luleje, një ushqimi që ju pëlqen, të detit apo të erërave të tjera që ju pëlqejnë apo nuk ju pëlqejnë, në trurin tuaj. Vet molekulat kurrë nuk arrijnë trurin. Pikërisht sikurse me të dëgjuarit dhe të pamurit, ajo që arrin trurin tuaj janë thjeshtë sinjalet elektrike. Me fjalë të tjera, të gjitha erërat që keni pandehur – prej se keni lindur – se u takojnë objekteve të jashtme janë vetëm sinjale elektrike që ju i ndjeni përmes organeve tuaja shqisore.

Në mënyrë të ngjashme, ekzistojnë katër tipe të ndryshme të receptorëve kimik në pjesën e përparme të gjuhës së njeriut. Këto u përkasin katër shijeve: të njelmët, të ëmbël, të thartë dhe të hidhët. Receptorët tonë të shijimit shëndrrojnë këto perceptime në sinjale elektrike përmes një zingjiri të proceseve kimike dhe i përçojnë ato në tru. Këto sinjale perceptohen si shije nga ana e trurit. Shija që ju e përjetoni kur hani një çokollatë apo një frut që ju pëlqen është interpretimi i sinjaleve elektrike nga ana e trurit. Kurrë nuk mund ta arrini objektin në botën e jashtme; kurrë nuk mund të shihni, të nuhatni apo të shijoni vet çokollatën. Për shembull, poqese këputen nervat e të shijuarit që shkojnë në tru, shija e gjërave që ju hani nuk do të mund të arrijë trurin; do ta humbni plotësisht ndjenjën tuaj të shijimit.

Në këtë pikë, ndeshemi me një fakt tjetër: Kurrë nuk mund të jemi të sigurt se ajo që përjetojmë kur e shijojmë një ushqim dhe çka përjeton një person tjetër kur ai shijon të njëjtin ushqim apo çfarë ne perceptojmë kur e dëgjojmë një zë dhe çka një person tjetër percepton kur dëgjon të njëjtin zë janë të njëjta. Linkoln Barnet thot se askush nuk mund ta

dijë nëse një person tjetër e percepton ngjyrën e kuqe apo dëgjon notën C në të njëjtën mënyrë siç e percepton ai vet. 66

Shqisa jonë e të prekurit nuk dallon prej shqisave tjera. Kur e prekim një objekt, i gjithë informacioni që na ndihmon të njohim botën e jashtme dhe objektet transmetohet në tru përmes nervave shqisore që ndodhen në lëkurë. Në trurin tonë formohet ndjenja e të prekurit. Përkundër asaj që besohet botërisht, vendi ku ne perceptojmë nuk është në majet e gishtërinjëve tonë apo në lëkurat tona por në qendrën e të perceptuarit të prekjes në trurin tonë. Për shkak të interpretimit të nxitjeve elektrike të trurit që vijnë aty prej objekteve, ne i përjetojmë ato objekte në mënyrë të ndryshme si të forta, të buta, të nxehta apo të ftohta. Të gjitha hollësitë që na ndihmojnë të njohim një objekt i përfitojmë prej këtyre nxitjeve. Në lidhje me këtë, mendimet e dy filozofëve të famshëm, B. Rasel dhe L. Vitgenshtajn, janë si vijon:

Për shembull, nëse një limon ekziston me të vërtetë apo jo dhe si u krijua nuk mund të diskutohet dhe hetohet. Një limon përbëhet thjeshtë prej një shije të perceptuar me anë të gjuhës, një arome të perceptuar me anë të hundës, një ngjyre dhe trajte të perceptuar me anë të syrit; dhe vetëm këto veçori të tij mund të jenë temë e ekzaminimit dhe vlerësimit. Shkenca kurrë nuk mund ta njoh botën fizike. 67

Është e pamundshme për ne që të arrijmë botën fizike. Të gjitha objektet rreth nesh janë një përmbledhje e perceptimeve si të pamurit, të dëgjuarit dhe të prekurit. Duke përpunuar të dhënat në qendrën e të pamurit dhe në qendrat tjera shqisore, trurët tonë, gjatë jetërave tona, nuk ballafaqohen me “originalin” e materies që ekziston jashtë nesh por më tepër me kopjen e formuar brenda trurit tonë. Në këtë pikë ne çorientohemi duke supozuar se këto kopje janë shembuj të materies së vërtetë jashtë nesh.

“Bota e jashtme” brenda trurit tonë

Prej fakteve fizike të përshkruara gjer më tani, mund të vijmë në këtë përfundim. Gjithçka që shohim, prekim, dëgjojmë dhe perceptojmë si “materie”, “botën” apo “gjithësinë” janë vetëm sinjale elektrike që ndodhin në trurin tonë.

Dikush që e han një frut nuk përballlet me frutin e vërtetë por me perceptimin e tij në tru. Objekti i konsideruar nga personi si një “frut” përbëhet në të vërtetë prej përshtypjeve elektrike të formës, shijes, aromës dhe cilësisë së frutit në tru. Po të dëmtoheshin papritur nervat e të pamurit që shkojnë në tru, imazhi i frutit do të zhdukej papritur. Një çkyqje në nervin që shkon prej sensorëve në hundë deri te truri plotësisht do të ndërprente shqisën e të nuaturit. Thënë thjeshtë, fruti nuk është asgjë tjetër veçse interpretimi i sinjaleve elektrike nga ana e trurit.

Një tjetër gjë që duhet ta kemi parasysh është ndjenja e largësisë. Largësia, për shembull largësia në mes juve dhe këtij libri, është vetëm një ndjenjë e hapësirës së formuar në trurin tuaj. Objektet që duken të jenë të largëta në shikimin e një personi ekzistojnë gjithashtu edhe në tru. Për shembull, dikush i cili vështron yjet në qiell pandeh se ato janë me miliona vite drite largë prej tij. Mirëpo, ajo që ai “sheh” janë në të vërtetë yjet brenda vetvetes, në qendrën e shikimit të tij. Ndërsa ju lexoni këta rreshta, ju, në të vërtetë, nuk jeni brenda dhomës ku ju pandehni se jeni; përkundrazi, dhoma është brenda juve. Megjithatë,

duhet të mbani në mend se trupi juaj, poashtu, është një përfytyrim i formuar brenda trurit tuaj.

E njëjta gjë vlen për të gjitha perceptimet tjera tuajat. Për shembull, kur mendoni se po e dëgjoni zërin e televizionit në dhomën pranë tuajës, ju jeni duke përjetuar në të vërtetë zërin përbrenda trurit tuaj. Ju nuk mund ta dëshmoni as se ekziston një dhomë pranë tuajës dhe as se zëri vie prej televizionit në atë dhomë. Të dyja, zëri që ju mendoni që po vie prej disa metra larg dhe biseda e një personi mu pranë jush perceptohen në qendrën e të dëgjuarit prej disa centrimetrash katror në trurin tuaj. Përveç kësaj, në këtë qendër të perceptimit, asnjë koncept si i djathtë, i majtë, përpara apo prapa nuk ekziston. Domethënë, zëri nuk vie tek ju nga ana e djathtë, nga ana e majtë apo prej së larti; nuk ekziston asnjë drejtim prej nga vie zëri.

Aromat që ju perceptoni janë poashtu të ngjashme me to; asnjëra prej tyre nuk arrin tek ju prej një distance të madhe. Ju pandehni se efektet përfundimtare të formuara në qendrën e të nuhaturit tuaj janë aroma e objekteve në botën e jashtme. Megjithatë, mu sikurse përfytyrimi i një trëndafili është në qendrën tuaj të të pamurit, ashtu edhe aroma e trëndafilit është në qendrën tuaj të nuhatjes; nuk ekziston as trëndafili dhe as aroma që i takon atij në botën e jashtme.

“Bota e jashtme” që na paraqitet përmes perceptimeve tona është vetëm një përmbledhje e sinjaleve elektrike që arrijnë trurët tonë. Gjatë jetërave tona, truri jonë përpunon këto sinjale dhe ne jetojmë pa e ditur se gabojmë kur pandehim se këto janë verzionet origjinale të gjërave që ekzistojnë në “botën e jashtme”. Ne çorientohemi sepse kurrë nuk mund të arrijmë vet materien me anë të shqisave tona.

Veç kësaj, përsëri trurët tonë interpretojnë dhe u mveshin kuptim sinjaleve që ne pandehim të jenë “bota e jashtme”. Për shembull, le të marrim parasysh shqisën e të dëgjuarit. Trurët tonë shëndrrojnë valët e tingujve në “botën e jashtme” në një simfoni. Me fjalë të tjera, muzika është poashtu një perceptim i krijuar prej trurëve tonë. Në të njëjtën mënyrë, kur ne shohim ngjyrat, ajo që arrin në sytë tonë janë thjeshtë sinjale elektrike të valëve me gjatësi të ndryshme. Përsëri trurët tonë shëndrrojnë këto sinjale në ngjyra. Nuk ekzistojnë ngjyra në “botën e jashtme”. As nuk është molla e kuqe, as nuk është qielli i kaltër, e as drunjët të gjelbërt. Ata janë ashtu siç janë vetëm për shkak se ne i perceptojmë si të tillë. “Bota e jashtme” varet krejtësisht prej perceptuesit.

Madje edhe dëmtimi më i vogël në retinë e syrit shkakton verbërinë e ngjyrave. Disa njerëz e perceptojnë ngjyrën e kaltër si të gjelbërt, disa të kuqen si të kaltër dhe disa i perceptojnë të gjitha ngjyrat si nuansa të ndryshme të ngjyrëhirit. Në këtë pikë, nuk ka rëndësi nëse objekti i jashtëm është apo nuk është i ngjyrosur.

Mendimtari i shquar Berkli shtjelloi këtë fakt poashtu:

Në fillim, besohej se ngjyrat, erërat, etj., “vërtetë ekzistojnë”, por më pas pikëpamje të tilla u braktisën dhe u pa se ato ekzistojnë vetëm në varësi prej shqisave tona. 68

Si përfundim, arsyeja që ne i shohim objektet e ngjyrosura nuk është sepse ato janë të ngjyrosura apo sepse kanë një ekzistencë të pavarur materiale jashtë neve. E vërteta për materien qëndron më tepër në faktin se të gjitha cilësitë që ne ua përshkruajmë objekteve janë brenda neve dhe jo në “botën e jashtme”.

Pra çfarë mbetet prej “botës së jashtme”?

A është ekzistenca e “botës së jashtme” e domosdoshme?

Gjer më tani, kemi folur vazhdimisht për një “botë të jashtme” dhe një botë të perceptimeve të formuara në trurët tonë, duke qenë këto të fundit ato që ne shohim. Megjithatë, pasi që në të vërtetë kurrë nuk mund të arrijmë “botën e jashtme”, si mund të jemi të sigurt se një botë e tillë me të vërtetë ekziston?

Në të vërtetë nuk mundemi. Pasi që secili objekt është vetëm një grumbull/përmbledhje perceptimesh dhe ato perceptime ekzistojnë vetëm në mendje, më e saktë është të thuhet se e vetmja botë që me të vërtetë ekziston është bota e perceptimeve. E vetmja botë që ne njohim është bota që ekziston në mendjen tonë: ajo që është projektuar, regjistruar dhe që është bërë e gjallë aty; shkurt, ajo që është krijuar brenda mendjes sonë. Kjo është bota e vetme për të cilën mund të jemi të sigurt.

Kurrë nuk mund të dëshmojmë se perceptimet që ne vështojmë në trurin tonë kanë korrespondues material. Ato perceptime do të mund të vinin në mënyrë të besueshme prej një burimi “artificial”.

Kjo është e mundshme të vëzhgohet. Nxitjet e rreme mund të prodhojnë një “botë materiale” të imagjinuar tërësisht në trurin tonë. Për shembull, le të paramendojmë një instrument regjistrimi shumë të zhvilluar në të cilin të gjitha llojet e sinjaleve elektrike do të mund të regjistroheshin. Së pari, le të transmetojmë të gjitha të dhënat në lidhje me një ambient/mjedis (duke përfshirë edhe imazhin e trupit) në këtë instrument duke i shëndrruar ato në sinjale elektrike. Së dyti, le të marrim me mend se truri do të mund të mbijetonte i ndarë prej trupit. Më në fund, le të lidhim instrumentin regjistruar me tru me anë të elektrodave që do të funksionojnë si nerva dhe të dërgojmë të dhënat e regjistruara më parë në tru. Në këtë gjendje, do të fitonit përshtypjen se po jetoni në këtë ambient të krijuar artificialisht. Për shembull, lehtë do të mund të besoni se jeni duke ngarë makinën shpejtë në një autostradë. Kurrë s’do të mund të bëhej e mundshme të kuptoni se ju përbëheni prej asgjëje pos trurit tuaj. Kjo për arsye se ajo që nevojitet për të formuar një botë brenda trurit tuaj nuk është ekzistenca e botës reale por më parë nxitjet. Është plotësisht e mundshme që këto nxitje do të mund të vinin prej një burimi artificial, siç është një magnetofon.

Në lidhje me këtë, filozofi i shquar Bertrand Rasel shkruajti:

Sa i përket shqisës së të prekurit kur shtypim tavolinën me gishtat tonë, ai është një trazim elektrik në elektronet dhe protonet në majat e gishtërinjëve tonë, i prodhuar, sipas fizikës moderne, me anë të afërsisë së elektroneve dhe protoneve në tavolinë. Poqese i njëjti trazim në majat e gishtërinjëve tonë do të shkaktohej në ndonjë mënyrë tjetër, ne do të duhej të kishim këto ndjesi, përkundër faktit se atje nuk do të kishte tavolinë. 69

Me të vërtetë është shumë lehtë që të mashtrohemi dhe të besojmë se perceptimet, pa asnjë korrespondues material, janë të vërteta. Ne shpesh përjetojmë këtë ndjenjë në ëndrrat tona, në të cilat përjetojmë ngjarje, shohim njerëz, objekte dhe ambiente që duken plotësisht reale. Megjithatë, ato nuk janë asgjë veçse perceptime të thjeshta. Nuk ekziston ndonjë dallim thelbësor në mes të ëndrrës dhe “botës reale”; të dyja këto përjetohej në tru.

Kush është Perceptuesi?

Siç kemi rrëfyer gjer më tani, nuk ka dyshim se bota të cilën mendojmë se e banojmë dhe të cilën e quajmë “botë të jashtme” perceptohet brenda trurit tonë. Megjithatë, këtu lind

një pyetje me rëndësi parësore. Nëse të gjitha ngjarjet fizike që ne i njohim janë perceptime të brendshme, çfarë është puna me trurin tonë? Pasiqë trurët tonë janë pjesë e botës fizike mu sikurse duart tona, këmbët apo çfarëdo objekte tjera, poashtu duhet të jetë një perceptim pikërisht sikurse të gjitha objektet tjera.

Një shembull në lidhje me ëndrrat do të ndriçojë këtë çështje më tej. Le të mendojmë se ne i shohim ëndrrat brenda trurit tonë në pajtim me atë që është thënë gjer më tani. Në ëndërr, ne do të kemi një trup të imagjinuar, një dorë të imagjinuar, një sy të imagjinuar dhe një tru të imagjinuar. Poqese do të pyeteshim gjatë përjetimit të ëndrrës “ku po e shikoni këtë?” ne do të përgjigjeshim “E shikoj në trurin tim”. Mirëpo, nuk bëhet fjalë për kurrfarë truri, por një kokë të imagjinuar dhe një tru të imagjinuar. Shikuesi i këtyre përfytyrimeve nuk është truri i imagjinuar në ëndërr, por një “qenie” që është shumë më “superiore” se ai.

Ne e dimë se nuk ekziston një dallim fizik në mes të mjedisit të një ëndrre dhe mjedisit që e quajmë jetë reale. Kështuqë kur të pyetemi në mjedisim që e quajmë jetë reale pyetjen e mësipërme “ku shikoni”, do të ishte poaq e pakuptim të përgjigjemi “në trurin tonë” si në shembullin e mësipërm. Në të dyja rrethanat, qenia që sheh dhe percepton nuk është truri, i cili në fund të fundit është një copë mishi.

Kur e analizojmë trurin, shohim se në të nuk ka asgjë përveç lipideve dhe molekulave të proteinës, të cilat ekzistojnë poashtu edhe në organizmat e tjerë të gjallë. Kjo nënkupton se përbrenda kësaj cope mishi që ne e quajmë “truri” jonë, nuk ekziston asgjë që do të vëzhgonte përfytyrimet, që do të formonte ndërgjegjen/vetëdijën apo që do të krijonte qenien që ne e quajmë “uni”.

R. L. Gregori bën fjalë për një gabim që njerëzit e bëjnë në lidhje me perceptimin e imazheve në tru:

Ekziston një joshje/ngasje, e cila duhet shmangur, të themi se sytë prodhojnë përfytyrimet/pamjet në tru. Një përfytyrim në tru paraqet nevojën e një lloj syri të brendshëm për ta parë atë – por kjo do të kërkonte edhe një sy tjetër për ta parë përfytyrimin e saj... dhe kështu me rradhë, në një lëvizje mbrapsht të pafund të syve dhe përfytyrimeve. Kjo është e pakuptim. 70

Kjo është pikërisht çështja që i vënë materialistët, të cilët nuk pranojnë si të vërtetë asgjë përveç materies, në një gjendje të vështirë: kujt i takon “syri brenda” që sheh, që percepton atë që sheh dhe reagon?

Karl Pribram u përqendrua poashtu në këtë çështje të rëndësishme, në çështjen se kush është perceptuesi, në botën e shkencës dhe filozofisë:

Filozofët që prej grekëve kanë spekuluar në lidhje me “fantazmën në makinë”, “njeriun e vogël përbrenda njeriut të vogël” dhe kështu me rradhë. Ku është Uni - qenia që përdor trurin? Kush e ka njohurinë e vërtetë? Apo, siç e tha njëherë Saint Francis i Assisit: “Ajo që ne po kërkojmë është se kush shikon”. 71

Tani, mendoni për këtë: Libri në dorën tuaj, dhoma në të cilën jeni, thënë shkurt, të gjitha përfytyrimet përpara jush shihen brenda në trurin tuaj. A janë atomet që shohin këto imazhe? Atomt e verbëra, të shurdhëta, të pandërgjegjshme? Pse disa prej atomeve kanë fituar këtë cilësi ndërsa të tjerat nuk i kanë fituar? A përbëhen veprimet e të menduarit, kuptuarit, të mbajturit në mend, të qenit i kënaqur/i lumtur, të qenit i brengosur dhe gjithçka tjetër prej reagimeve elektrokimike në mes të këtyre atomeve?

Kur mendojmë për këto çështje, shohim se nuk ka kuptim që të kërkojmë ndonjë vullnet në atome. Është e qartë se qenia që sheh, dëgjon dhe ndjenë është një qenie mbi-materiale. Kjo qenie është “e gjallë” dhe nuk është as materie dhe as një përfytyrim i materies. Kjo qenie krijon lidhje me perceptimet përballë saj duke përdorur imazhin e trupit tonë.

Kjo qenie është “shpirti”.

Përmbledhja e perceptimeve që e quajmë “bota materiale” është një ëndërr që vëzhgohet prej këtij shpirti. Mu sikurse trupat që posedojmë dhe bota materiale që shohim në ëndrrat tona nuk kanë realitet, gjithësia ku jetojmë dhe trupat që posedojmë gjithashtu nuk kanë realitet material.

Qenia e vërtetë është shpirti. Materia përbëhet vetëm prej perceptimeve që shikohen prej shpirtit. Qeniet inteligjente që shkruajnë dhe lexojnë këta rreshta nuk janë secila një grumbull atomesh dhe molekulash dhe reaksionesh kimike në mes tyre, por një “shpirt”.

Qenia e vërtetë absolute

Të gjitha këto fakte na sjellin ballë për ballë me një çështje shumë të rëndësishme. Nëse ajo që ne e pranojmë të jetë bota materiale përbëhet vetëm prej perceptimeve që shihen prej shpirtit, atëherë cili është burimi i këtyre perceptimeve?

Për të dhënë përgjigje në këtë pyetje, duhet të kemi parasysh këtë: materia nuk ka një ekzistencë vet-qevisëse vetvetiu. Pasiqë materia është një perceptim, është diçka “artificiale”. Domethënë, ky perceptim duhet të jetë shkaktuar nga një fuqi tjetër, që nënkupton se duhet të jetë krijuar. Për më tepër, ky krijim duhet të jetë i vazhdueshëm. Po të mos kishte krijim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, atëherë ajo që quajmë materie do të zhdukej dhe do të humbiste. Kjo mund të krahasohet me një televizion në të cilin shfaqet një pamje për aq kohë sa zgjatë transmetimi i sinjalit. Pra, kush bën që shpirtërat tonë të shohin yjet, tokën, bimët, njerëzit, trupat tonë dhe gjithçka tjetër që ne shohim?

Është fare e qartë se ekziston një Krijues, I Cili ka krijuar tërë gjithësinë materiale, domethënë, shumën e perceptimeve dhe e vazhdon krijimin e Tij pa ndërprerje. Pasiqë ky Krijues shfaqë një krijim kaq madhështor, Ai padyshim se ka pushtet dhe fuqi të amshueshme.

Ky Krijues na e prezanton Vetveten. Ai ka shpallur një Libër dhe përmes këtij Libri na e ka përshkruar Vetveten, gjithësinë dhe arsyen e ekzistencës sonë.

Ku Krijues është Allahu dhe emri i librit të Tij është Kur’ani.

Faktet se qiejt dhe toka, domethënë, gjithësia nuk është e qëndrueshme, se prania e tyre është bërë e mundshme vetëm me anë të krijimit të tyre prej Allahut dhe se ato do të zhduken kur Ai t’i jap fund krijimit të Tij, të gjitha janë shpjeguar në një ajet si vijon:

Allahu i mban qiejt dhe tokën që të mos zhduken, e nëse zhduken, s'ka askush pos Tij që mund t'i mbajë; Ai është që nuk ngutet, është që falë. (Sure Fatir: 41)

Siç e kemi përmendur në fillim, disa njerëz nuk kanë kanë dijeni të vërtetë për Allahun dhe kështu e imagjinojnë Atë si një qenie të pranishme dikund në qiej dhe që në të vërtetë nuk ndërhyr në punët e dynjasë. Baza e kësaj logjike në të vërtetë mbështetet në

mendimin se gjithësia është një përmbledhje/grumbull i materies dhe se Allahu është “jashtë” kësaj bote materiale, në një vend tejet të largët. Në disa religjione të rrejshme, besimi në Allahun kufizohet në këtë mënyrë të të kuptuarit.

Megjithatë, siç kemi kuptuar deri më tani, materia përbëhet vetëm prej ndjesive. Dhe e vetmja qenie e vërtetë absolute është Allahu. Kjo nënkupton se vetëm Allahu ekziston; gjithçka tjetër përveç Tij janë qenie hije. Si pasojë, është e pamundur të mendohet për Allahun si të ndarë dhe jashtë gjithë kësaj mase të materies. Padyshim se Allahu është “gjithkund” dhe përfshinë gjithçka. Ky realitet shpjegohet në Kur’an si në vijim:

Allahu! S'ka zot pos Tij. I Gjalli, Vigjiluesi. Nuk e zë të koturit, e as gjumi. E Tija është ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë te Ai, pos me lejën e Tij? Ai e di se ç'po u ndodhë dhe ç'do t'u ndodhë. Dhe asgjë nga dija e Tij nuk mund të përvetësojnë, pos sa të dojë Ai. Ndërsa pushteti i Tij përfshin qiejt dhe tokën. E nuk lodhet duke i ruajtur (mirëmbajtur), ngase Ai është i Larti, Madhështori. (Sure Bekare: 255)

Se Allahu nuk është i kufizuar nga hapësira dhe se Ai përfshinë gjithçka theksohet në një ajet tjetër si vijon:

Të Allahut janë edhe lindja edhe perëndimi, dhe ngado që të ktheheni, aty është anë e Allahut. Vërtetë, Allahu është i gjerë (në bujari) dhe i gjithëdijshëm. (Sure Bekare: 115)

Pasiqë qeniet materiale janë secila një perceptim, ato nuk mund të shohin Allahun; por Allahu e sheh materien që Ai krijoi në të gjitha format e saj. Në Kur’an, kjo shpallet në këtë mënyrë:

“Të pamurit (e njerëzve) nuk mund ta përfshinë Atë, e Ai e përfshinë të pamurit.” (Sure En’am: 103)

Domethënë, ne nuk mund ta përfshijmë qenien e Allahut me sytë tonë, por Allahu ka përfshirë plotësisht brendinë, anën e jashtme, shikimet dhe mendimet tona. Ne nuk mund të pëshpërisim as edhe një fjalë pos me dijeninë e Tij dhe madje as që mund të marrim frymë.

Gjersa vështrojmë këto perceptime shqisore gjatë jetërave tona, qenia më e afërt me ne nuk është asnjëra prej këtyre ndjesive, por Allahu Vet. Fshehtësia e ajetit vijues në Kur’an fshihet në këtë realitet: “Ne e kemi krijuar njeriun dhe dimë se ç’pëshpëritë ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari i qafës së tij.” (Sure Kaf: 16) Kur një person mendon se trupi i tij përbëhet vetëm prej “materies”, ai nuk mund ta kuptojë këtë fakt të rëndësishëm. Poqese ai e merr trurin e tij për “veten e tij”, atëherë vendi që ai e merr të jetë jashtë vetes është 20 – 30 cm larg tij. Megjithatë, kur e kupton se nuk ekziston asgjë si materia, dhe se gjithçka është imagjinatë/përfytyrim, idetë si jashtë, brenda, larg apo afër humbasin kuptimin. Allahu ka përfshirë atë dhe Ai është “pafundësisht pranë” tij.

Allahu i bën me dije njerëzit se Ai është “pafundësisht pranë” tyre me ajetin “ E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam vërtetë afër (tyre).” (Sure Bekare: 186). Një ajet tjetër rrëfen të njëjtën gjë: “Ne të thamë se Zoti yt përfshinë tërë njerëzimin (me dijen e Vet).” (Sure Isra: 60)

Njeriu çorientohet kur mendon se qenia më e afërt me të është vetvetja. Allahu, në të vërtetë, është madje më pranë nesh se ne vetë. Ai na ka tërhekur vëmendjen për këtë në ajetin “Përse, pra kur arrin shpirti në fyt, E ju në atë moment shikoni (se ç’po i ngjet). E Ne jemi më afër tek ai se ju, por ju nuk shihni. (Sure Vakia: 83-85) Siç njoftohemi në këtë ajet, njerëzit jetojnë të pavetëdijshëm për këtë fakt të jashtëzakonshëm sepse ata nuk e shohin atë me sytë e tyre.

Në anën tjetër, është e pamundshme për njeriun, i cili nuk është asgjë tjetër pos një qenie hije, të ketë fuqi dhe vullnet të pavarur prej Allahut. Ajeti “E Allahu ju krijoi juve edhe atë që ju e punoni.” (Sure Saffat: 96) tregon se gjithçka që ne përjetojmë ndodhë nën kontrollin e Allahut. Në Kur’an, ky realitet theksonet në ajetin “Ti nuk gjuajte, kur gjuajte, por ishte Allahu që gjuajti” (Sure Enfal: 17) përmes të cilit theksohet se asnjë veprim nuk është i pavarur prej Allahut. Meqenëse qenia njerëzore është një qenie hije, ai vet nuk e kryen aktin e gjuajtjes. Megjithatë, Allahu ia jap kësaj qenieje hije ndjenjën e vetvetes. Në të vërtetë, Allahu i kryen të gjitha veprimet. Poqese dikush i merr veprimet që bën si të tijat, ai qartë ka për qëllim të mashtrojë veten.

Ky është realiteti. Njeriu mund të mos dëshiroj të pranojë këtë dhe mund të mendojë për vetveten si për një qenie të pavarur prej Allahut; por kjo nuk ndryshon asgjë. Natyrisht se mohimi i tij jo i urtë është përsëri i përfshirë në vullnetin dhe dëshirën e Allahut.

Gjithçka që ju posedoni është iluzore në brendi

Siç mund të shihet qartë, është një fakt shkencor logjik se “bota e jashtme” nuk ka realitet material dhe se ajo është një përmbledhje përfytyrimesh që përjetësisht i paraqiten shpirtit tonë prej Allahut. Sidoqoftë, njerëzit zakonisht nuk përfshijnë apo më me dëshirë nuk do të përfshinin, gjithçka në konceptin e “botës së jashtme”.

Mendoni në lidhje me këtë çështje me sinqeritet dhe guxim. Do të kuptoni se shtëpia juaj, mobili/orentidë, vetura – të cilën ndoshta e keni blerë tani së voni, zyra, stollitë, llogaria bankare, garderoba, bashkëshortja, fëmijët, kolegët dhe gjithçka tjetër që ju posedoni janë në të vërtetë të përfshira në këtë botë të jashtme imagjinare që ju shfaqet. Gjithçka që ju shihni, dëgjoni apo nuhatni – thënë shkurt – që ju perceptoni rreth jush me pesë shqisat tuaja është pjesë e kësaj “bote imagjinare”: zëri i këngëtarit tuaj më të preferuar, fortësia e karriges në të cilën jeni të ulur, një parfum aroma e të cilit ju pëlqen, dielli që ju mban ngrohtë, një lule me ngjyra të bukura, një zog që fluturon para dritares suaj, një motobarkë që lëvizë shpejtë mbi ujë, kopshti juaj pjellor, kompjuteri që ju përdorni në punë, apo një pajisje hi-fi (të kualitetit të lartë) që posedon teknologjinë më të përparuar në botë...

Ky është realiteti, sepse bota është vetëm një përmbledhje përfytyrimesh të krijuara për të sprovuar njeriun. Njerëzit sprovohen gjatë gjithë jetërave të tyre të kufizuara me perceptime që nuk kanë realitet. Këto perceptime paraqiten qëllimisht si joshëse dhe tërheqëse. Ky fakt përmendet në Kur’an:

Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj gjërave të këndshme, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të jetës së kësaj bote, por te Allahu është e ardhmja më e mirë. (Sure Ali Imran: 14)

Shumica e njerëzve e flakin tej religjionin e tyre për shkak të joshjes ndaj pronës, pasurisë, rezervave të grumbulluara të arit dhe argjendit, dollarëve, llogarive bankare, kartave të kreditit, dollapeve përplot me rroba, veturave të modeleve të fundit, thënë shkurt, ndaj të gjitha formave të mirëqenies që ata ose posedojnë ose përpiqen të posedojnë. Ata përqendrohen vetëm në këtë botë ndërsa e harrojnë ahiretin. Ata janë të mashtruar nga dukja “e zbukuruar dhe joshëse” e kësaj bote dhe dështojnë në mbajtjen e namazit, dhënien e lëmoshës të varfërve dhe në kryerjen e ibadetit (adhurimit) që do të bëjë që ata të jenë prej të shpërblyerëve në ahiret. Ata në vend të kësaj thonë: “Kam gjëra për të bërë”, “Kam ideale”, “Kam përgjegjësi”, “Nuk kam kohë të mjaftueshme”, “Më duhet të përfundojë disa gjëra” dhe “Do ta bëj në të ardhmën”. Ata i kalojnë jetërat e tyre duke u përpjekur që të përparojnë vetëm në këtë botë. Në ajetin: “Edhe atë që dinë nga jeta e kësaj bote, është dije e cekët (sipërfaqësore), por ndaj jetës së përjetshme (ndaj Ahiretit) ata janë plotësisht të verbëruar (të paimentuar).” (Sure Rum: 7) përshkruhet kjo ide e gabuar.

Fakti që ne e përshkruajmë në këtë kapitull, domethënë se çdo gjë është një përfytyrim, është shumë i rëndësishëm për shkak të implikimeve të tij që i bën të gjitha dëshirat/epshet dhe kufijtë të pakuptim. Verifikimi i këtij fakti e bën të qartë se gjithçka që njerëzit posedojnë apo mundohen të posedojnë – pasuria e fituar me lakmi, fëmijët për të cilët mburren, bashkëshortet që i konsiderojnë si më të afërtat, shokët, miqët e tyre më të dashur, statusi shoqëror që ata besojnë të jetë një epërsi, shkollat që ata kanë ndjekur, pushimet në të cilat kanë qenë – nuk janë asgjë tjetër pos iluzion i thjeshtë. Prandaj, të gjitha përpjekjet, koha e shpenzuar dhe lakmia dëshmohen të jenë të kota.

Kjo është arsyeja pse njerëzit padashur bëhen budallenjë kur krenohen me pasurinë e tyre dhe pronat apo me “jahtat, helikopterët, fabrikat, aksionet, çifligjet dhe tokat” e tyre sikur ato përnjëmend të ekzistonin. Ata njerëz të pasur të cilët me mburrje lundrojnë në jahtat e tyre, tregojnë veturat e tyre, flasin vazhdimisht për pasurinë e tyre, supozojnë se pozitat e tyre i rrathisin ata më lartë se gjithkënd tjetër dhe vazhdojnë të mendojnë se janë të suksesshëm për shkak të gjithë kësaj, do të duhej në të vërtetë të mendojnë se në çfarë gjendje do ta gjejnë veten e tyre me të kuptuar se suksesi nuk është asgjë tjetër veçse një iluzion.

Këto skena janë parë shumë herë në ëndrra poashtu. Në ëndrrat e tyre, ata kanë gjithashtu shtëpi, vetura të shpejta, stoli tejet të çmueshme, dëngje dollarësh dhe sasi të mëdha të arit dhe argjendit. Në ëndrrat e tyre, ata kanë poashtu pozita të larta, posedojnë fabrika me mijëra punëtorë, posedojnë pushtet për të sunduar shumë njerëz dhe vishen me rroba që i bëjnë të gjithë t’i admirojnë. Pikërisht sikurse dikush i cili u krenua për pronat e tij në ëndrrat e tij, do të dukej qesharak me të zgjuar, ai me siguri se do të duket poaq qesharak që krenohet për përfytyrimet që ai sheh në këtë botë. Të dyja si ajo që ai sheh në ëndrrat e tij ashtu edhe ajo që sheh në këtë botë janë thjeshtë përfytyrime në mendjen e tij.

Ngjashëm, mënyra se si njerëzit reagojnë ndaj ngjarjeve që i përjetojnë në këtë botë do t'i bëjë ata të ndihen të turpëruar kur ta kuptojnë realitetin. Ata të cilët me egërsi luftojnë kundër njëri tjetrit, tërbohen, mashtrojnë, marrin mito, bëjnë falsifikime, gënjejnë, me zili mbajnë paratë e tyre, u bëjnë keq njerëzve, i rrahin dhe i mallkojnë të tjerët, bëhen shumë agresiv, janë përplot pasion për zyre dhe pozitë, janë ziliqar dhe tregohen në publik, do të turpërohen kur të kuptojnë se të gjitha këto i kanë bërë në një ëndërr.

Pasiqë Allahu i krijon të gjitha këto përfytyrime, Zotëruesi Përfundimtar i çdo gjëje është vetëm Allahu. Ky fakt theksohet në Kur'an:

Vetëm të Allahut janë ç'ka në qiej dhe në tokë. Allahu ka përfshirë çdo send. (Sure Nisa: 126)

Është marrëzi e madhe të flaket tej religjioni për hir të pasioneve imagjinare dhe kështu të humbet jeta e amshueshme. Për më tepër, kjo do të shpie njeriun në fatkeqësi të përjetshme.

Në këtë fazë, një gjë duhet të kuptohet. Nuk është thënë këtu se “pronat, pasuria, fëmijët, bashkëshortet, shokët, pozita që keni me të cilat ju bëheni koprrac, heret a vonë do të zhduken, dhe prandaj ato nuk kanë ndonjë kuptim”, por se “gjithçka që juve ju duket se posedoni nuk ekziston, por ato janë vetëm ëndrra që përbëhen prej përfytyrimeve të cilat Allahu ju tregon për t'ju sprovuar”. Siç e shihni, ekziston një dallim i madh në mes të këtyre dy formulimeve.

Edhe pse njeriu nuk dëshiron të pranojë këtë menjëherë dhe më me dëshirë do të mashtronte vetveten duke pandehur se gjithçka që ka njeriu ekziston me të vërtetë, njeriu në fund do të vdes dhe në ahiret gjithçka do të jetë e qartë kur të rikrijohemi. Atë ditë “I mprehtë është shikimi i njeriut” (Sure Kaf: 22) dhe gjithçka do të shohim shumë më qartë. Megjithatë, poqese i kemi kaluar jetërat tona duke ndjekur qëllimet imagjinare, do të dëshirojmë që kurrë t'mos e kishim jetuar këtë jetë dhe do të themi: “Ah, sikur të kishte qenë ajo (vdekja e parë) mbarim i amshueshëm për mua. Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetencë imja.” (Sure Hakka: 27-29)

Ajo që një njeri i mençur do të duhej të bënte, në anën tjetër, është të përpiqet të kuptojë realitetin më madhështor të gjithësisë këtu në këtë botë, derisa ende ka kohë. Përndryshe, ai do të kalojë gjithë jetën e tij duke vrapuar pas ëndrrave dhe do të përballet me një ndëshkim të rëndë në fund. Në Kur'an, gjendja e fundit e atyre njerëzve të cilët vrapojnë pas iluzioneve (apo vegimeve) në këtë botë dhe harrojnë Krijuesin e tyre, theksohet si më poshtë:

E veprat e atyre që nuk besuan janë si valët (nga rrezet e diellit) në një rrafshinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t'i afrohet atij nuk gjen asgjë, por aty e gjen Allahun dhe Ai do t'ia japë llogarinë e tij. Allahu është i shpejtë në llogaritje. (Sure Nur: 39)

Të metat logjike të materialistëve

Që nga fillimi i këtij kapitulli, theksohet qartë se materia nuk ka qenie absolute, siç pohojnë materialistët, por është më tepër një përmbledhje e përshtypjeve shqisore të krijuara prej Allahut. Materialistët i rezistojnë këtij realiteti të dukshëm, i cili asgjëson filozofinë e tyre, në një mënyrë tejet dogmatike dhe paraqesin kundër-teza të pabaza.

Për shembull, njëri prej mbrojtësve më të mëdhenjë të filozofisë materialiste në shekullin e 20të, një marksist i zjarrtë, Xhorxh Policer, dha “shembullin e autobusit” si “dëshminë më të madhe” për ekzistencën e materies. Sipas Policerit, filozofët të cilët mendojnë se materia është vetëm një perceptim gjithashtu ikin kur shohin se një autobus është gadi për t’i shkelur dhe kjo është prova e ekzistencës fizike të materies. 72

Kur një materialisti tjetër të famshëm, Xhonson, iu tha se materia është një përmbledhje e perceptimeve, ai u përpoq të “provojë” ekzistencën fizike të gurëve duke i shqelmuar ata. 73

Një shembull i ngjashëm është dhënë nga Fridrih Engelsi, mentor i Policerit dhe themelues, së bashku me Marksini, i materializmit dialektik. Ai shkruajti: “po të ishin pastat që i hamë ne thjeshtë perceptime, ato nuk do të mund ta shuanin urinë tonë”. 74

Ekzistojnë shembuj të ngjashëm dhe disa fjali fyese si “e kuptoni ekzistencën e materies kur të goditeni me shpullë në fytyrë” në librat e materialistëve të famshëm si Marksi, Engelsi, Lenini dhe të tjerët.

Çregullimi në të kuptuar që i hap udhë këtyre shembujve të materialistëve është të interpretuarit e tyre të shpjegimit se “materia është një perceptim” si “materia është një mashtrim i dritës”. Ata mendojnë se perceptimi kufizohet me shikim dhe se aftësitë tjera si të prekurit kanë korrespondues fizik. Një autobus që rrëzon një njeri i shtynë ata të thonë: “ja, u përplas, prandaj nuk është një perceptim”. Ata nuk kuptojnë se të gjitha perceptimet e përjetuara gjatë një ndeshjeje me autobus, siç janë fortësia, përplasia dhe dhimbja, formohen poashtu në tru.

Shembulli i ëndrrave

Shembulli më i mirë për të shpjeguar këtë realitet është ëndrra. Një person mund të përjetojë ngjarje shumë reale në ëndërr. Ai mund të rrokulliset poshtë shkallëve dhe të thyej këmbën e tij, mund të ketë një aksident të rëndë me veturë, të ngujohet nën autobus apo të hajë një pastë dhe të ngopet. Ndodhi të ngjashme me ato të përjetuara në jetën tonë të përditshme poashtu përjetohe në ëndrra me të njëjtën ndjenjë bindëse të vërtetësisë së tyre dhe duke ngjallur të njëjtat ndjenja në ne.

Një person që ëndërron se është goditur prej një autobusi mund t’i hap sytë në një spital përsëri në ëndërrën e tij dhe të kuptojë se është gjymtuar, por e tërë kjo është një ëndërr. Ai mundet poashtu të ëndërrojë se vdes në një ndeshje me veturë, se engjujt e vdekjes e marrin shpirtin e tij dhe jeta e tij në ahiret fillon. (Ngjarja e fundit përjetohe në të njëjtën mënyrë në këtë jetë, e cila, mu sikurse ëndrra, është një perceptim.)

Ky person percepton në mënyrë shumë të mprehtë përfytyrimet, zërat, ndjenjën e fortësisë, dritës, ngjyrave dhe të gjitha ndjenjave tjera që i përkasin ngjarjes që ai përjeton në ëndërrën e tij. Perceptimet që ai percepton në ëndërrën e tij janë poaq të natyrshme sa edhe ato në jetën “reale” të tij. Pasta që ai han në ëndërrën e tij e ngop atë edhe pse ajo është

thjeshtë një perceptim shqisor i ëndrrës, sepse të qenit i ngopur është poashtu një perceptim shqisor i ëndrrës. Megjithatë, në realitet, ky person është i shtrirë në shtratin e tij në atë moment. Nuk ka shkallë, trafik apo autobusë për të marrë parasysh. Personi që ëndërron i përjeton dhe i sheh perceptimet dhe ndjenjat që nuk ekzistojnë në botën e jashtme. Fakti se në ëndrrat tona, përjetojmë, shohim dhe ndjejmë ngjarje pa korrespondues fizik në “botën e jashtme” në mënyrë shumë të qartë zbulon se “bota e jashtme” e jetërave tona të zgjuara poashtu përbëhet absolutisht prej perceptimeve të thjeshta.

Ata që besojnë në filozofinë materialiste, posaçërisht marksistët, tërbohen kur iu thuhet për këtë realitet, për thelbin e materies. Ata përmendin shembuj prej të gjykuarit sipërfaqësor të Marksit, Engelsit apo Leninit dhe bëjnë deklaratë emocionale.

Megjithatë, këta persona duhet të mendojnë se ata poashtu mund t’i bëjnë këto deklarime edhe në ëndrrat e tyre. Në ëndrrat e tyre, ata mund poashtu të lexojnë “Kapitalin”, të marrin pjesë në takime, të përleshën me policinë, të goditen në kokë dhe të ndjejnë dhimbjen e plagëve të tyre. Po të pyeten ata në ëndrrat e tyre, ata do të mendojnë se ajo që e përjetojnë në ëndrrat e tyre gjithashtu përbëhet prej “materies absolute”, pikërisht sikurse supozojnë se gjërat që shohin kur janë të zgjuar janë “materie absolute”. Mirëpo, qoftë në ëndrrat e tyre apo në jetën e tyre të përditshme, gjithçka që ata shohin, përjetojnë apo ndjejnë përbëhet vetëm prej perceptimeve.

Shembulli i lidhjes së nervave paralelisht

Le të marrim parasysh shembullin e ndeshjes me veturë të dhënë nga Policeri në të cilin ai foli për dikend që rrëzohet prej një veture. Po të ishin nervat e personit të rrëzuar që shkojnë prej pesë shqisave të tij në trurin e tij, të lidhura me trurin e një personi tjetër, p.sh me trurin e Policerit, me një lidhje paralele, në momentin kur autobusi e goditi atë person, poashtu do të godiste Policerin e ulur në shtëpi në të njëjtën kohë. Të gjitha ndjesitë e përjetuara nga ai person që do të pësonte aksidentin do të përjetohehin nga Policeri, pikërisht sikurse kënga e njëjtë e dëgjuar prej dy altoparlantëve të lidhur me magnetofonin e njëjtë. Policeri do të ndjente, shihte dhe përjetonte frenimin e autobusit, prekjen e autobusit në trupin e tij, përfytyrimet e krahut të thyer dhe gjakut, thyerjet, përfytyrimet e hyrjes së tij në sallën e operacionit, fortësinë e allçisë dhe pafuqinë e krahut të tij.

Secili person tjetër i lidhur me nervat e këtij njeriu paralelisht do të përjetonte aksidentin prej fillimit e deri në fund mu sikurse Policeri. Po të binte ky njeri në komë, ata të gjithë do të binin në komë. Veç kësaj, po të regjistroheshin të gjitha perceptimet që lidhen me aksidentin e makinës në një pajisje dhe po t’i transmetoheshin të gjitha këto perceptime një personi vazhdimisht, autobusi do ta rrëzonte në tokë këtë person shumë herë.

Pra, cili prej autobusëve që i godet ata njerëz është i vërtetë? Filozofia materialiste nuk ka një përgjigje të qëndrueshme në këtë pyetje. Përgjigja e saktë është se ata të gjithë përjetojnë aksidentin me makinë me të gjitha hollësitë e tij në mendjet e tyre.

I njëjti parim vlen për shembujt e biskotës dhe gurit. Po të ishin nervat e organeve shqisore të Engelsit, I cili kishte ndjenjën e ngopjes dhe plotësisë së pastës në stomakun e tij pas ngrënjes së një paste, të lidhura me trurin e një personi të dytë paralelisht, ai person gjithashtu do të ndihej i ngopur kur Engelsi hëngri pastën dhe u ngop. Po të ishin nervat e

Xhonsonit, i cili ndjeu dhimbje në këmbën e tij kur e goditi me forcë një gur, të lidhura me një person të dytë paralelisht, ai person do ta ndjente të njëjtën dhimbje.

Pra, cila pastë apo cili gur është i vërtetë? Filozofia materialiste përsëri dështon në dhënien e një përgjigje të qëndrueshme në këtë pyetje. Përgjigja e saktë dhe e qëndrueshme është kjo: të dy, si Engelsi ashtu e dhe personi i dytë kanë ngrënë pastën në mendjet e tyre dhe janë ngopur; të dy, si Xhonsoni ashtu edhe personi i dytë kanë përjetuar plotësisht momentin e goditjes së gurit në mendjet e tyre.

Le ta bëjmë një ndryshim në shembullin që dhamë për Policerin: le t'i lidhim nervat e njeriut të goditur nga autobusi me trurin e Policerit dhe nervat e Policerit të ulur në shtëpinë e tij me trurin e njeriut që goditet nga autobusi. Në këtë rast, Policeri do të mendojë se një autobus e ka goditur atë edhe pse ai është i ulur në shtëpinë e tij. Njeriu i cili në të vërtetë është i goditur nga autobusi nuk do ta ndjente kurrë efektin e aksidentit dhe do të mendonte se është i ulur në shtëpinë e Policerit. Logjika e njëjtë do të mund të aplikohet për shembujt e biskotës dhe gurit.

Siç shohim, nuk është e mundur për njeriun që të tejkaloj shqisat e tij dhe të lirohet prej tyre. Në këtë drejtim, shpirti i njeriut mund t'i nënshtrohet të gjitha llojeve të paraqitjes së ngjarjeve fizike edhe pse nuk ka një trup fizik dhe një ekzistencë materiale dhe i mungon pesha materiale. Nuk është e mundur për një person të kuptojë këtë sepse ai supozon që këto përfytyrime tre-dimensionale janë të vërteta dhe është i sigurt për ekzistencën e tyre sepse, si çdokush tjetër, ai varet prej perceptimeve të përjetuara nga organet e tij shqisore.

Filozofi i famshëm britanik Dejvid Hjum shpreh në këtë mënyrë mendimet e tij në lidhje me këtë fakt:

Sa më përket mua, kur kredhem thellë në atë që unë quaj vetja ime, gjithnjë pengohem nga ndonjë perceptim i veçantë apo tjetër, të nxehtësisë apo ftohtësisë, të dritës apo hijes, dashurisë apo urrejtjes, dhimbjes apo kënaqësisë. Kurrë nuk mund ta zë veten në çfarëdo kohe pa ndonjë perceptim dhe kurrë nuk mund të vëzhgojë çfarëdoqoftë përveç perceptimit. 75

Formimi i perceptimeve në tru nuk është Filozofi por Fakt shkencor

Materialistët pohojnë se ajo që jemi duke e thënë këtu është një pikëpamje filozofike. Megjithatë, të pohohet se “bota e jashtme”, siç e quajmë ne, është një përmbledhje e perceptimeve nuk është çështje filozofike por një fakt i kulluar shkencor. Mënyra se si përfytyrimi dhe ndjesitë formohen në tru mësohet në shkollat mjekësore në hollësi. Këto fakte, të vërtetuara nga shkenca e shekullit të 20të e veçanërisht nga fizika, qartë tregojnë se materia nuk ka një realitet absolut dhe se, në një mënyrë, çdokush shikon “monitorin në trurin e tij”.

Çdokush që beson në shkencë, qoftë ai ateist, budist apo dikush që mbronë çfarëdo pikëpamje tjetër, duhet ta pranojë këtë fakt. Një materialist mund ta mohojë ekzistencën e Krijuesit e megjithatë nuk mund ta mohojë këtë realitet shkencor.

Paaftësia e Karl Marksit, Fridrih Engelsit, Xhorxh Policerit dhe të tjerëve për ta kuptuar një fakt kaq të thjeshtë dhe të dukshëm është ende befasuese, edhe pse niveli i të

kuptuarit shkencor i kohës së tyre ishte ndoshta i pamjaftueshëm. Në kohën tonë, shkencat dhe teknologjia janë tejet të përparuara dhe zbulimet më të vonshme e bëjnë më të lehtë që ky fakt të kuptohet. Materialistët, në anën tjetër, janë të vërshuar si me frikën e të kuptuarit të këtij fakti, madje edhe pjesërisht, ashtu edhe me të kuptuarit se si ai përfundimisht hedh poshtë filozofinë e tyre.

Frika më e madhe e materialistëve

Për një kohë, asnjë përgjigje e rëndësishme nuk erdh prej qarqeve materialiste turke në lidhje me çështjen e ngritur në këtë libër, domethënë, fakti se materia është një përfytyrim i thjeshtë. Kjo na dha përshtypjen se argumenti jonë nuk ishte bërë aq i qartë dhe se kërkonte shpjegim të mëtejshëm. Mirëpo, së shpejti, u zbulua se materialistët ndiheshin mjaft të brengosur për popullaritetin e kësaj çështjeje dhe ndjenin një frikë të madhe prej saj.

Për një kohë, materialistët zëshëm kanë shfaqur frikën dhe panikun e tyre në publikimet, konferencat dhe debatet e tyre. Fjalimet e tyre të shqetësuara dhe të pashpresë nënkuptojnë se ata po vuajnë një krizë të rëndë intelektuale. Rrënimin shkencor të teorisë së evolucionit, të ashtuquajturës bazë të filozofisë së tyre, tashmë e kishte përjetuar si një tronditje të madhe. Tani, ata fillojnë të kuptojnë se fillojnë të humbasin vet materien, e cila është një shtyllë më e rëndësishme për ta se Darwinizmi dhe janë duke përjetuar një tronditje edhe më të madhe. Ata deklarojnë se kjo çështje është “kërcënimi më i madh” për ta dhe se ai në tërësi “rrënon strukturën e tyre kulturore”.

Njëri prej atyre që në mënyrën më të zëshme shprehi shqetësimin dhe panikun që ndjenë qarqet materialiste ishte Renan Pekunlu, një akademik si edhe autori i botimit periodik Bilim ve Utopya (Shkenca dhe Utopia) e cila e ka marrë mbi vete detyrën e mbrojtjes së materializmit. Si në artikujt e tij në Bilim ve Utopya ashtu dhe në debatet në të cilat ishte i pranishëm, Pekunlu e prezentoj librin Mashtrimi i Evolucionit të Harun Jahjasë si “kërcënimin” numër një për materializmin. Ajo që trazoi Pekunlun edhe më tepër se kapitujt që e zhvlerësonin Darwinizmin ishte pjesa të cilën jeni duke e lexuar tani. Pekunlu u dërgoi këtë porosi lexuesve dhe auditorit të tij, duke qenë këta të fundit vetëm një grusht njerëzish: “mos lejoni që të kaploheni prej indoktrinimit të idealizmit dhe mbani besimin tuaj në materializëm”. Ai citoi Vladimir I. Leninin, udhëheqësin e revolucionit të përgjakshëm komunist në Rusi, si referencë. Duke e këshilluar çdokend që të lexoj librin qindvjeçar të Leninit të titulluar Materializmi dhe Empirio-Kriticizmi, Pekunlu përsëriti këshillat e Leninit: “mos mendoni për këtë çështje ose do të humbni lidhjen me materializmin dhe do të kaploheni nga religjioni”. Në një artikull që ai shkruajti në botimin e lartpërmendur periodik, ai citoi këta rreshta prej Leninit:

Me të mohuar të realitetit objektiv, që na japet në ndjesi, tashmë e ke humbur çdo armë kundër fideizmit, sepse ke rrëshqitur në agnosticizëm apo subjektivizëm – dhe kjo është e tëra që kërkon fideizmi. Një kthetër e vetme e zënë në kurth dhe zogu humbet. Dhe burrat tonë të gjithë janë zënë në kurthën e idealizmit, domethënë, në një fideizëm të holluar, delikat; ata u zunë në kurth prej momentit kur muarën “ndjesinë” jo si në përfytyrim të botës së jashtme por si një “element” të posaçëm. Ajo nuk është ndjesia e askujt, mendja e askujt, shpirti i askujt, vullneti i askujt. 76

Këto fjalë qartë vërtetojnë se fakti të cilin Lenini, në panik, kuptoi dhe deshti ta largojë si nga mendja e tij ashtu edhe nga mendjet e “shokëve” të tij, gjithashtu shqetëson materialistët bashkëkohor në mënyrë të ngjashme. Megjithatë, Pekunlu dhe materialistët e tjerë vuajnë një fatkeqësi edhe më të madhe; pasi që ata janë të vetëdijshëm se ky fakt tani po paraqitet në mënyrë shumë më të qartë, më të sigurt dhe më bindëse se 100 vjet më parë. Për herë të parë në histori kjo temë po shpjegohet në mënyrë aq të papërballeshme. Sidoqoftë, pamja e përgjithshme është se një numër i madh i shkencëtarëve materialist ende marrin një qëndrim shumë sipërfaqësor ndaj faktit se “materia nuk është gjë tjetër pos iluzion”. Çështja e shpjeguar në këtë kapitull është njëra prej çështjeve më të rëndësishmeve dhe më ngazëllyese që njeriu mund ndonjëherë të takoj në jetën e tij. Nuk ka gjasa që ata të jenë ndeshur me një çështje aq vendimtare më parë. Prapseprap, reagimet e këtyre shkencëtarëve apo mënyra si ata i përdorin në fjalimet dhe artikujt e tyre lënë të kuptohet se sa i cekët dhe sipërfaqësor është të kuptuarit e tyre.

Reagimet e disa materialistëve ndaj çështjes së diskutuar këtu tregojnë se besnikëria e tyre e verbër ndaj materializmit i ka shkaktuar një farë dëmtimi logjikës së tyre. Për këtë arsye, ata janë tepër larg të kuptuarit të kësaj çështjeje. Për shembull, Alatin Senel, poashtu një akademik dhe autor i Bilim ve Utopya, shfaqti ndjenja të ngjashme si Renan Pekunlu duke thënë: “Harroni rrëniën e Darwinizmit, çështja që është vërtetë kërcënuese është kjo”. Duke ndjerë se vet filozofia e tij nuk ka bazë, ai bëri kërkesa si “vërtetoni atë që thuani!” Ajo që është më interesante, ky shkrimtar vet ka shkruar rreshta që zbulojnë se ai nuk mund ta kuptoj këtë fakt, të cilin ai e konsideron si kërcënim.

Për shembull, në një artikull në të cilin ai bëri fjalë në veçanti për këtë çështje, Senel pranon se bota e jashtme perceptohet në tru si një parafytyrim. Megjithatë, ai vazhdon më tutje për të pohuar se përfytyrimet ndahen në dy: në ato që kanë korrespondues fizik dhe në ato që nuk kanë dhe se përfytyrimet që i takojnë botës së jashtme kanë korrespondues fizik. Për ta mbështetur këtë pohim të tij, ai e jap “shembullin e telefonit”. Në përmbledhje, ai shkruan: “Nuk e di nëse përfytyrimet në trurin tim kanë korrespondues në botën e jashtme apo jo, por e njëjta gjë vlen kur unë flas në telefon. Kur unë flas në telefon, unë nuk mund ta shoh personin me të cilin jam duke biseduar por këtë bisedë mund ta konfirmoj kur të takohem me të më vonë.” 77

Duke thënë kështu, ky shkrimtar në të vërtetë don të thot këtë: “Poqese dyshojmë në perceptimet tona, mund ta shikojmë vet materien dhe të verifikojmë realitetin e saj.” Megjithatë, kjo është qartë një ide e gabuar, sepse është e pamundshme për ne që të arrijmë vet materien. Ne kurrë nuk mund të dalim prej mendjeve tona dhe të dijmë se çfarë gjendet “jashtë”. Nëse zëri në telefon ka një korrespondues apo jo mund të konfirmohet nga personi në anën tjetër të telefonit. Mirëpo, ky konfirmim është poashtu i imagjinuar, i cili përjetohet në mendje.

Këta njerëz poashtu përjetojnë ngjarje të njëjta në ëndrrat e tyre. Për shembull, Seneli mundet gjithashtu të shoh në ëndrrën e tij se flet në telefon dhe pastaj ta konfirmojë këtë bisedë nga personi me të cilin ka folur. Pekunlu mundet të ndjejë në ëndrrën e tij “një kërcënim serioz” dhe duke i këshilluar njerëzit të lexojnë librin qindvjeçar të Leninit. Megjithatë, pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, këta materialistë kurrë nuk mund ta mohojnë

se ngjarjet që ata i kanë përjetuar dhe njerëzit me të cilët kanë folur në ëndrrat e tyre nuk janë tjetër pos perceptime.

Kush, pra, do të konfirmojë nëse përfytyrimet në tru kanë apo nuk kanë korrespondues? Qeniet hije në tru? Padyshim se është e pamundur për materialistët të gjejnë një burim të informacionit që mund t'u jap të dhëna në lidhje me pjesën e jashtme të trurit dhe ta konfirmojë këtë.

Duke pranuar se të gjitha perceptimet formohen në tru, por duke supozuar se njeriu mund të dalë "jashtë" kësaj dhe t'i konfirmojë perceptimet me anë të botës reale të jashtme, zbulon se kapaciteti intelektual i këtij personi është i kufizuar dhe se të gjykuarit e tij është i shtrembëruar.

Mirëpo, çdo person me nivel normal të të kuptuarit dhe gjykuarit mundet lehtë të kuptojë këto fakte. Çdo person i paanshëm e din, në raport me gjithë ç'kemi thënë, se është e pamundshme për atë të provojë ekzistencën e botës së jashtme me shqisat e tij. Megjithatë, duket se besnikëria e verbër ndaj materializmit shtrembëron aftësitë e të gjykuarit të njerëzve. Për këtë arsye, materialistët bashkëkohor shfaqin të meta të rënda logjike në të gjykuarit e tyre mu sikurse mentorët e tyre të cilët u përpoqën të "provojnë" ekzistencën e materies duke shqelmuar gurë apo duke ngrënë pasta.

Duhet thënë poashtu se kjo nuk është një situatë e habitshme, sepse paaftësia për të kuptuar është një veçori e përbashkët e mosbesimtarëve. Në Kur'an, Allahu shpall veçanërisht se ata janë "njerëz që nuk kuptojnë." (Sure Maide: 58)

Materialistët kanë rënë në kurthën më të madhe në histori

Atmosfera/ndjenja e panikut që përshkoi qarqet materialiste në Turqi, prej të cilave ne këtu kemi përmendur vetëm një numër të vogël shembujsh, tregon se materialistët ndeshen me një disfatë të plotë, me të cilën kurrë më parë në histori nuk janë ndeshur. Se materia është thjeshtë një perceptim është vërtetuar nga shkenca moderne dhe është paraqitur në mënyrë shumë të qartë, të hapur dhe energjike. Materialistëve u mbetet vetëm të shohin/kuptojnë dhe të pranojnë rrënimin e botës së tërë materiale në të cilën ata besojnë verbërisht dhe në të cilën mbështeten.

Mendimi materialist ka ekzistuar gjithnjë gjatë historisë së njerëzimit. Duke qenë shumë të sigurt në veten e tyre dhe në filozofinë në të cilën besojnë, materialistët ngritën krye kundër Allahut I Cili i krijoi ata. Skenari që ata formuluan pohonte se materia nuk ka as fillim e as mbarim dhe se të gjitha këto nuk mundën kurrësesi të kenë një Krijues. Për shkak të mendjemadhësisë së tyre, ata mohuan Allahun dhe gjetën strehim në materie, e cila menduan se kishte ekzistencë reale. Ata ishin aq të sigurt në këtë filozofi sa që menduan se kurrë nuk do të ishte e mundshme të paraqitej një shpjegim që do të vërtetonte të kundërtën.

Kjo është arsyeja pse faktet e treguara në këtë libër në lidhje me natyrën reale të materies i befaskan këta njerëz aq shumë. Ajo që është thënë këtu shkatërroi tamam bazën e filozofisë së tyre dhe nuk la vend për diskutim të mëtutjeshëm. Materia, mbi të cilën ata mbështetën të gjitha mendimet e tyre, jetët, mendjemadhësinë dhe mohimin e tyre, u zhdukën papritur. Si mund të ekzistojë materializmi kur materia nuk ekziston?

Njëra prej vetive të Allahut është thurja e Tij e kompleteve kundër mosbesimtarëve. Kjo shpallet në ajetin: “Ata bënë plane, e Allahu i asgjësonte, se Allahu është më i miri që asgjëson (dredhitë).” (Sure Enfal: 30)

Allahu i zuri në kurth materialistët duke i bërë ata që të supozojnë se materia ekziston dhe, duke bërë kështu, i poshtëroi ata në mënyrë të paparë. Materialistët i muarën pronat e tyre, pozitën, gradën, shoqërinë të cilës i takojnë, gjithë botën dhe gjithçka tjetër të ekzistojnë me të vërtetë dhe u bënë mendjemëdhenjë ndaj Allahut duke u mbështetur në to. Ata ngritën krye kundër Allahut duke qenë mburravec dhe shtuan mosbesimin e tyre. Duke bërë kështu, ata u mbështetën plotësisht në materie. Mirëpo, atyre u mungon arsyeja aq shumë sa që nuk janë në gjendje të mendojnë se Allahu i përfshinë ata krejtësisht. Allahu na lajmëron për gjendjen drejt të cilës shkojnë mosbesimtarët si rezultat i kokëfortësisë së tyre:

A mos po të kurdisin ndonjë kurth? Po ata që nuk besuan Allahun bijnë vetë në kurth. (Sure Tur: 42)

Kjo është sipas të gjitha gjasave disfata e tyre më e madhe në histori. Duke u bërë mendjemëdhenjë, materialistët janë mashtruar dhe kanë pësuar një disfatë të rëndë në luftën që ata e nisën kundër Allahut duke ngritur diçka monstruoze kundër Tij. Vargu: “Dhe ashtu (sikurse në Mekë) në çdo qytet kemi bërë kriminelët e tij pari, në mënyrë që të bëjnë dredhi në të, por nuk mashtrojnë tjetër kë pos veten e tyre dhe prapëseprapë nuk kuptojnë” bën të ditur se sa të pavetëdijshëm janë këta njerëz që ngrejnë krye kundër Krijuesit të tyre dhe se si do të përfundojnë ata (Sure En’am: 123). Në një varg tjetër fakti i njëjtë rrëfëhet kështu:

Ata përpiqen ta mashtrojnë Allahun dhe ata që besuan, por në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë. (Sure Bekare: 9)

Ndërsa mosbesimtarët përpiqen të thurin komplot, ata nuk e kuptojnë një fakt shumë të rëndësishëm i cili theksohet me fjalët: “ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes dhe nuk e hetojnë këtë!” në këtë varg. Ky është fakti se gjithçka që ata përjetojnë është një imagjinatë e projektuar që të perceptohet prej tyre dhe të gjitha komplotet që ata sajojnë janë thjeshtë përfytyrime të formuara në trurin e tyre mu sikurse çdo veprim tjetër që ata kryejnë. Marrëzia e tyre i ka bërë ata të harrojnë se janë krejtësisht vetëm me Allahun dhe, prandaj, ata janë të zënë në kurth prej vet planeve të tyre devijuese.

Jo më pak se ata mosbesimtarë që jetuan në të kaluarën, ata që jetojnë sot ndeshen me një realitet që do t’i shpartallojë planet e tyre dinake me themel. Me vargun: “...e pafuqishme me të vërtetë është dinakëria e Shejtanit” (Sure En’am: 76), Allahu thot se këto komplete janë të dënuara të përfundojnë me dështim ditën kur ato u kurdisën. Ai i përgëzon besimtarët me vargun: “...dinakëria e tyre nuk do t’ju dëmtojë aspak.” (Sure Ali Imran: 120)

Në një varg tjetër Allahu thot: “E veprat e atyre që nuk besuan janë si valët (nga rrezet e diellit) në një rrafshinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t’i afrohet atij nuk gjen asgjë.” (Sure Nur: 39). Materializmi gjithashtu, shëndrrohet në “vegim” për të pabindurit pikërisht siç bëhet e ditur në këtë varg; kur t’i afrohen atij, zbulojnë se nuk është

asgjë përveç një iluzioni. Allahu i ka mashtruar ata me një vegim të tillë dhe i ka mashtruar ata në perceptimin e gjithë kësaj përmbledhjeje të përfytyrimeve si të vërtetë. Gjithë ata njerëz “të shquar”, profesorët, astronomët, biologët, fizikanët dhe gjithë të tjerët pa dallim prej gradës dhe postit të tyre thjeshtë mashtrohen sikurse fëmijët dhe poshtërohen sepse e muarën materien si zot të tyre. Duke e marr një përmbledhje të përfytyrimeve si diçka absolute, ata mbështetën filozofinë dhe ideologjinë e tyre në të, u përfshinë në diskutime serioze dhe përvetësuan fjalimin/predikimin e ashtuquajtur “intelektual”. Vetën e konsideruan mjaft të mençur për të ofruar një argument në lidhje me të vërtetën e gjithësisë dhe, ajo që është më e rëndësishme, për të polemizuar për Allahun me inteligjencën e tyre të kufizuar. Allahu shpjegon gjendjen e tyre në vargun në vijim:

E, ata (mosbesimtarët) e kurdisën një dredhi (mbytjen e Isait), Allahu iu kundëvu dredhisë së tyre, Allahu është asgjësuesi më i fuqishëm kundër atyre që bëjnë dredhi. (Sure Ali Imran: 54)

Është e mundshme që t’ju iket disa kompleteve; megjithatë, ky plan i Allahut kundër mosbesimtarëve është aq i paepur sa që s’ka mundësi për t’i ikur. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë ata ose kujt i luten ata, kurrë s’do të mund të gjejnë ndihmues tjetër pos Allahut. Siç na informon Allahu në Kur’an: “ata nuk do t’i gjejnë vetes as mbrojtës e as ndihmës tjetër përveç Allahut.” (Sure Nisa: 173)

Materialistët kurrë nuk kanë pritur të bijnë në një kurthë të tillë. Duke i pasur të gjitha mjetet e shekullit të 20të në dispozicion të tyre, ata menduan se do të mund të këmbëngulnin në mohimin e tyre dhe t’i tërhiqnin njerëzit në mosbesim. Allahu përshkruan këtë mentalitet të përhershëm të mosbesimtarëve dhe fundin e tyre si vijon në Kur’an:

Ata përgatiten një kurth e Ne ua shpërblyem kurthtin duke mos e hetuar ata. Pra, vështro se çfarë ishte përfundimi i dredhisë së tyre. Në të vërtetë, Ne zhdukëm të gjithë ata dhe popullin e tyre. (Sure Neml: 50-51)

Kjo, është ajo çka nënkuptojnë këto vargje në një nivel tjetër: materialistët janë detyruar të kuptojnë se gjithçka që ata posedojnë nuk është tjetër veçse një iluzion dhe prandaj gjithçka që ata posedojnë është asgjësuar. Duke qenë dëshmitarë se pasuritë, fabrikat, ari, dollarët, fëmijët, bashkëshortet, shokët, shkalla dhe pozita dhe madje edhe vet trupat e tyre, të gjitha që ata konsiderojnë se ekzistojnë, t’ju ikin prej duarve të tyre, ata “asgjësohen” në fjalët e vargut të 51të të Sures Neml. Në këtë pikë, ata nuk janë më qenie materiale por shpirtëra.

Padyshim se të kuptuarit e kësaj të vërtete është situata më e vështirë e mundshme për materialistët. Fakti se gjithçka që ata posedojnë është vetëm një iluzion është i barazvlershëm, me vet fjalët e tyre, me “vdekjen para se të vdiset” në këtë botë.

Ky fakt i lën ata të vetmuar me Allahun. Me vargun:

“Ti, më le Mua dhe atë që e krijova të vetmuar”, Allahu na thërret t’i kushtojmë vëmendje faktit se çdo qenie njerëzore është, në të vërtetë, tërësisht e vetmuar në praninë e Tij. (Sure Mudeththir: 11). Ky fakt mahnitës përsëritet në shumë vargje tjera:

Në të vërtetë ju na erdhët një nga një (të vetmuar), ashtu si ju krijuam së pari; keni lënë prapa shpinës atë që u patëm dhënë... (Sure En’am: 94)

Dhe në ditën e kijametit secili do t’i paraqitet Atij i vetmuar. (Sure Merjem: 95)

Kjo, në një nivel tjetër, është ajo që vargjet tregojnë: ata që materien e marrin si zotin e tyre janë krijuar prej Allahut dhe tek Ai kthehen. Ata ia kanë nënshtruar vullnetet e tyre Allahut pa marrë parasysh nëse duan apo jo. Tani ata presin ditën e gjykimit kur secili prej tyre do të thirret për të dhënë llogari, sado që ata nuk janë të gatshëm ta kuptojnë këtë.

Përfundim

Çështja që e kemi shpjeguar gjer më tani është njëra prej të vërtetave më të mëdha që do t'ju tregohet ndonjëherë në jetën tuaj. Duke dëshmuar se e gjithë bota materiale është në të vërtetë një “qenie hije”, kjo çështje është çelësi për të kuptuar qenien e Allahut dhe krijimin e Tij dhe i të kuptuarit se Ai është qenia e vetme absolute.

Personi i cili kupton këtë çështje kupton se bota nuk është ai lloj vendi që shumica e njerëzve kanë menduar të jetë. Bota nuk është një vend absolut me një ekzistencë të vërtetë siç supozohet prej atyre që bredhin kot nëpër rrugë, përleshën nëpër pijetore, tregohen nëpër kafene luksoze, mburren për pasurinë e tyre apo të cilët ua kushtojnë jetërat e tyre qëllimeve boshe. Bota është vetëm një përmbledhje e përfytyrimeve, një iluzion. Të gjithë njerëzit që kemi cituar më lartë janë vetëm qenie hije të cilat shikojnë këto perceptime në mendjet e tyre; e megjithatë, nuk janë të vetëdijshëm për këtë.

Ky koncept është shumë i rëndësishëm sepse ai gërryen themelet e filozofisë materialiste që mohon ekzistencën e Allahut dhe bën që ajo të rrënohet. Kjo është arsyeja pse materialistët si Marksi, Engelsi dhe Lenini ndienë panik, u xhindosën dhe paralajmëruan pasuesit e tyre “që të mos mendojnë” për këtë ide kur t'ju thuhet për të. Këta njerëz janë aq të mangët mentalisht sa që ata nuk mund të kuptojnë madje edhe se perceptimet formohen përbrenda trurit. Ata supozojnë se bota që ata shikojnë në trurin e tyre është “bota e jashtme” dhe nuk mund të kuptojnë dëshminë e qartë për të kundërtën.

Kjo mosdije është rrjedhojë e mençurisë së pakët që Allahu u ka dhënë mosbesimtarëve. Siç thot Allahu në Kur'an, mosbesimtarët “Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë, sy me të cilat nuk shohin dhe veshë me të cilat nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, sepse ata janë të pavëmendshëm (ndaj paralajmërimit).” (Sure A'raf: 179)

Mund të bëni kërkime përtej kësaj pike duke përdorur fuqinë e të arsyetuarit tuaj personal. Për këtë, duhet të përqendroheni, t'ia përkushtoni vëmendjen tuaj dhe të mendoni mbi mënyrën se si i shihni objektet përreth jush dhe mënyrën se si e ndjeni prekjen e tyre. Nëse mendoni me kujdes, do të mund të ndjeni se qenia inteligjente që sheh, dëgjon, prek, mendon dhe lexon këtë libër në këtë moment është vetëm një shpirt dhe vështron perceptimet e quajtura “materie” në një ekran. Personi i cili e kupton këtë konsiderohet të jetë larguar nga sfera e botës materiale që mashtron pjesën më të madhe të njerëzimit dhe të ketë hyrë në sferën e ekzistencës së vërtetë.

Ky realitet është kuptuar nga një numër i teistëve apo filozofëve gjatë historisë. Intelektualët Islamik si Imam Rabbani, Muhyiddin Ibn al-'Arabi dhe Mevlana Jami e kuptuan këtë prej shenjave të Kur'anit dhe duke përdorur arsyen e tyre. Disa filozofë perëndimor si Xhorxh Berkli kanë kuptuar realitetin e njëjtë përmes arsyes. Imam Rabbani shkruajti në Maktubat-in (Veprat/Punimet) e tij se e tërë gjithësia materiale është një “iluzion dhe supozim (perceptim)” dhe se e vetmja qenie absolute është Allahu:

Allah... Substanca e këtyre qenieve të cilat Ai i krijoi nuk është tjetër pos mosqenie... Ai i krijoi të gjitha në sferën e shqisave dhe iluzioneve... Ekzistenca e

gjithësisë është në sferën e shqisave dhe iluzioneve dhe nuk është materiale... Në të vërtetë, nuk ekziston asgjë jashtë përveç Qenies së Madhërueshme (E Cila është Allahu). 78

Imam Rabbani në mënyrë të qartë deklaroi se të gjitha përfytyrimet që i paraqiten njeriut janë vetëm iluzione dhe se ato nuk kanë origjinalet e tyre “jashtë”.

Ky cikël i imagjinuar paraqitet në imagjinatë. Shihet në shkallën në të cilën paraqitet, mirëpo, me syrin e mendjes. Jashtë, duket sikurse shihet me syrin e kokës. Megjithatë, nuk është kështu. Nuk ka as një përcaktim dhe as një gjurmë jashtë. Nuk ka ndonjë rrethanë për të parë. Madje edhe fytyra e një personi e reflektuar në një pasqyrë është e njëjtë. Nuk ka ndonjë qëndrueshmëri jashtë. Padyshim, si qëndrueshmëria ashtu edhe përfytyrimi janë në IMAGJINATË. Allahu e di më së miri. 79

Mevlana Jami deklaroi të njëjtin fakt, të cilin ai e zbuloi duke ndjekur shenjat e Kur'anit dhe duke përdorur mençurinë e tij: “Çfarëdo që ekziston në gjithësi është shqisat dhe iluzionet. Ato janë ose si reflektimet në pasqyrë ose hije”.

Mirëpo, numri i atyre të cilët e kanë kuptuar këtë fakt gjatë historisë ka qenë gjithnjë i kufizuar. Dijetarë të mëdhenj si Imam Rabbani kanë shkruar se mund të mos ishte një gjë e mençur/e urtë që masave t’ju tregohet ky fakt sepse shumica e njerëzve nuk janë në gjendje ta kuptojnë atë.

Në kohën në të cilën jetojmë, kjo është bërë një fakt empirik me anë të dëshmive të paraqitura nga shkenca. Fakti se gjithësia është një qenie hije përshkruhet në një mënyrë aq konkrete, të qartë dhe të saktë për herë të parë në histori.

Për këtë arsye, shekulli i 21të do të jetë një pikë kthese kur njerëzit në përgjithësi do t’i kuptojnë realitetet hyjnore dhe do të drejtohen në turma tek Allahu, Qenia e vetme Absolute. Besimet materialiste të shekullit 19të do të dërgohen në grumbujt e mbeturinave të historisë, qenia dhe të krijuarit e Allahut do të kuptohen, pafundësia dhe amshueshmëria do të kuptohen, njerëzimi do të lirohet prej vellove qindvjeçare, mashtrimeve dhe paragjykimëve që e hutojnë atë.

Nuk është e mundshme që kjo rrjedhë e pashmangshme të ndalohet nga çfarëdo qenie hije.

Relativiteti i kohës dhe Realiteti i fatit

Gjithçka që u rrëfye gjer më tani demonstroi se “hapësira tre-dimensionale” nuk ekziston në realitet, domethënë ajo është një paragjykim i bazuar në tërësi në perceptime dhe se njeriu e çon gjithë jetën e tij në “pafundësi”.

Të pohohet e kundërta do të ishte sikurse të mbrohej një besim paragjykes tejet i largët prej arsyes dhe të vërtetës shkencore, sepse nuk ekziston një provë e vlefshme e ekzistencës së botës materiale tre-dimensionale.

Kjo hedh poshtë supozimin parësor të filozofisë materialiste që përbën bazën e teorisë së evolucionit, supozimin se materia është absolute dhe e amshueshme. Supozimi i dytë mbi të cilin mbështetet filozofia materialiste është supozimi se koha është absolute dhe e amshueshme. Ky është poaq paragjykes sa edhe i pari.

Perceptimi i kohës

Ajo që ne perceptojmë si kohë është, në të vërtetë, një metodë me anën e së cilës një moment krahasohet me një tjetër. Këtë mund ta shpjegojmë me një shembull. Për shembull, kur një person e godet një objekt, dëgjon një tingull të caktuar. Kur ai godet të njëjtin objekt pesë minuta më vonë, dëgjon një tingull tjetër. Ky person e percepton se ekziston një interval në mes të tingullit të parë dhe të dytë dhe këtë interval e quan interval “kohe”. Mirëpo kur ai dëgjon tingullin e dytë, tingulli i parë që dëgjoji nuk është asgjë më shumë se një përfytyrim në mendjen e tij. Është thjeshtë një copëz informacioni në kujtesën e tij. Personi e formulon konceptin e “kohës” duke krahasuar momentin në të cilin jeton me atë që ai ka në kujtesën e tij. Po të mos bëhej ky krahasim, nuk mund të ketë ndonjë koncept të kohës.

Ngjashëm, një person bën një krahasim kur e sheh dikend që hyn në një dhomë nga një derë dhe që ulet në një karrigë në mes të dhomës. Kur ky person të jetë ulur në karrigë, përfytyrimet në lidhje me momentet kur ai hap derën, hyn në dhomë dhe arrin deri tek karriga grumbullohen si copëza informacionesh në tru. Perceptimi i kohës ndodhë kur njeriu krahason njeriun që ulet në karrigë me ato copëza informatash.

Thënë shkurt, koha ekziston si rezultat i krahasimit të bërë në mes të disa iluzioneve të deponuara në tru. Po të mos kishte njeriu kujtesën, atëherë truri i tij nuk do të bënte interpretime të tilla dhe prandaj kurrë nuk do të formonte konceptin e kohës. E vetmja arsye pse dikush llogaritë të jetë tridhjetë vjeçar është sepse ai ka akumuluar informacionin në lidhje me ato thridhjetë vjet në mendjen e tij. Po të mos ekzistonte kujtesa e tij, atëherë ai nuk do të mendonte për ekzistencën e një periudhe të tillë paraprirëse dhe do të përjetonte vetëm “momentin” e vetëm në të cilin ai jeton.

Shpjegimi shkencor i pafundësisë

Le të përpiqemi ta qartësojmë këtë çështje duke cituar shpjegimet e shkencëtarëve dhe dijetarëve të ndryshëm në lidhje me këtë çështje. Në lidhje me çështjen e rrjedhës së kohës në drejtimin e kundërt, intelektual i famshëm dhe profesori i gjenetikës fitues i çmimit Nobël, Fransua Jakob, deklaroi si vijon në librin e tij *Le Jeu des Possibles* (E mundshmja dhe ekzistuesja):

Filmat e luajtur mbrapsht na mundësojnë të imagjinojmë një botë në të cilën koha rrjedhë në drejtim të kundërt. Një botë në të cilën qumështi ndahet nga kafeja dhe kërcen jashtë filxhanit për të arritur në enën e qumështit; një botë në të cilën rrezet e dritës emitohen prej mureve për t'u përmbledhur në një kurthë (qendër të gravitacionit) në vend se të shpërndahet me vrull prej një burimi të dritës; një botë në të cilën një gur kthehet në pëllëmbën e një njeriu me anë të një bashkëpunimi të mahnitshëm të pikave të panumërta të ujit që mundësojnë që guri të kërcej jashtë ujit. Mirëpo, në një botë të tillë në të cilën koha ka tipare aq të kundërta, proceset e trurit tonë dhe mënyra se si kujtesa përpilon/grumbullon informatat, do të funksiononte ngjashëm në drejtim të kundërt. E njëjta gjë vlen për të kaluarën dhe të ardhmën dhe bota do të na shfaqej pikërisht në mënyrën se si na paraqitet tani. 80

Pasiqë truri është i mësuar me një rrjedhë të caktuar të ngjarjeve, bota nuk funksionon siç u rrefye më lartë dhe ne supozojmë se koha rrjedhë gjithnjë përpara.

Megjithatë, ky është një vendim që merret në tru dhe është relativ. Në realitet, ne kurrë nuk mund të dijmë se si rrjedhë koha apo nëse ajo rrjedhë ose jo. Ky është një tregues i faktit se koha nuk është një fakt absolut por vetëm një lloj perceptimi.

Relativiteti i kohës është një fakt i verifikuar poashtu nga njëri prej fizikanëve më të rëndësishëm të shekullit të 20të, Albert Ajnshtajni. Linkoln Barnet, shkruan në librin e tij Gjithësia dhe Dr. Ajnshtajni:

Bashkë me hapësirën absolute, Ajnshtajni hodhi poshtë idenë e kohës absolute – e një rrjedhe univerzale të kohës të qëndrueshme, të pandryshueshme dhe të paepur, që rrjedhë prej të kaluarës së pafund në të ardhmën e pafund. Paqartësia më e madhe që ka rrethuar Teorinë e Relativitetit buron prej mosdashjes së njeriut të pranojë se ndjenja e kohës, sikurse ndjenja e ngjyrës, është një formë perceptimi. Mu sikurse hapësira është thjeshtë një rregull i mundshëm i objekteve materiale, ashtu edhe koha është një rregull i mundshëm i ngjarjeve. Subjektiviteti i kohës shpjegohet më së miri me vet fjalët e Ajnshtajnit. “Përvojat e një individi” thot ai, “na shfaqen të rregulluara në një varg ngjarjesh; në këtë varg ngjarjet e vetmuara të cilat i mbajmë në mend na shfaqen të renditura sipas kriterit ‘më heret’ dhe ‘më vonë’. Prandaj, për individin, ekziston një Unë-kohë apo kohë subjektive. Kjo në vetvete nuk është e matshme. Unë mundem, me të vërtetë, t’u shoqërojë numra ngjarjeve, në mënyrë të tillë që një numër më i madh shoqërohet me ngjarjen më të vonshme se sa me një ngjarje më të hershme.” 81

Siç citohet në librin e Barnetit, Ajnshtajni vet theksoi se: “hapësira dhe koha janë forma të intuitës, të cilat nuk mund të ndahen prej ndërgjegjes më shumë se konceptet tona të ngjyrës, formës apo madhësisë.” Sipas Teorisë së Relativitetit të Përgjithshëm: “koha nuk ka ekzistencë të pavarur të veçuar nga renditja e ngjarjeve me të cilat e masim atë.” 82

Pasiqë koha përbëhet prej perceptimit, ajo varet tërësisht nga perceptuesi dhe prandaj është relative.

Shpejtësia me të cilën rrjedhë koha ndryshon në pajtim me referencat që ne përdorim për ta matur atë sepse nuk ekziston një orë e natyrshme në organizmin e njeriut për të treguar saktësisht se sa shpejtë kalon koha. Siç shkruajti Linkoln Barnet: “Sikur që nuk ekziston një gjë e tillë si ngjyra pa një sy për ta dalluar atë, ashtu edhe një çast apo një orë apo një ditë nuk është asgjë pa një ngjarje për ta shënuar atë.” 83

Relativiteti i kohës përjetohet qartë në ëndrra. Edhepse ajo që shohim në ëndrrat tona duket të zgjas për orë të tëra, në të vërtetë, zgjatë vetëm disa minuta dhe madje disa sekonda.

Le të mendojmë për një shembull për ta qartësuar këtë çështje më tej. Le të pandehim se jemi të vendosur në një dhomë me një dritare të vetme që është dizajnuar në mënyrë të posaçme dhe se ne jemi mbajtur aty për një periudhë të caktuar. Le të ketë një orë në dhomë ku mund të shohim sasinë e kohës që ka kaluar. Në të njëjtën kohë, le të jetë se nga dritarja e dhomës shohim diellin që lind dhe perëndon në intervale të caktuara. Disa ditë më vonë, përgjigja që ne do të japim në pyetjen për sasinë e kohës që kaluam në dhomë do të mbështetej si në informacionin që do të kishim grumbulluar duke shikuar në orë kohë pas kohe dhe në llogaritjen që do të kishim bërë duke iu referuar asaj se sa herë dielli lindi dhe perëndoi. Për shembull, mund të llogarisim se kaluam tri ditë në këtë dhomë. Mirëpo, nëse personi i cili na vendosi në atë dhomë do të thot se ne kishim kaluar vetëm dy ditë në

dhomë dhe se dielli që kishim parë prej dritares u prodhua artificialisht me anë të një makine simuluese dhe se ora në dhomë u rregullua posaçërisht për të punuar më shpejtë, atëherë llogaritja që do të kishim bërë do të ishte e pakuptim.

Ky shembull konfirmon se informacioni që kemi për shpejtësinë e kalimit të kohës bazohet në referenca relative. Relativiteti i kohës është një fakt shkencor poashtu i vërtetuar me anë të metodologjisë shkencore. Teoria e Relativitetit të Përgjithshëm e Ajnshtajnit pohon se shpejtësia e kohës ndryshon varësisht prej shpejtësisë së objektit dhe pozitës së tij në fushën e gravitacionit. Me rritjen e shpejtësisë, koha shkurtohet dhe ngjeshet/përmbledhet; ngadalësohet sikur të arrinte në pikën e “ndalimit”.

Le ta shpjegojmë këtë me një shembull të dhënë nga Ajnshtajni. Imagjinoni dy binjakë, njëri prej të cilëve qëndron në tokë ndërsa tjetri shkon të udhëtojë në gjithësi me një shpejtësi të afërt me atë të dritës. Kur të kthehet, udhëtari do të shoh se vëllau i tij është bërë shumë më i vjetër se ai. Arsyeja është se koha rrjedhë shumë më ngadalë për personin i cili udhëton me shpejtësi të afërta me shpejtësinë e dritës. Le të marrim parasysh një baba që udhëton në gjithësi dhe djalin e tij tokësor. Poqese babai do të ishte njëzet e shtatë vjeçar kur do të nisej dhe djali i tij tre vjeçar; kur do të kthehej babai në tokë tridhjetë vjet më vonë (kohë tokësore), djali do të ishte tridhjetë e tre vjeçar ndërsa babai i tij do të ishte vetëm tridhjetë vjeçar. 84 Ky relativitet i kohës nuk shkaktohet me ngadalësimin apo shpejtimin e orëve ose me ngadalësimin e një burimi mekanik. Kjo më tepër është rezultat i periudhave të ndara të funksionimit të tërë sistemit të ekzistencës materiale, e cila shkon aq thellë sa edhe grimcat nën-atomike (më të vogla se atomi). Me fjalë të tjera, për personin që e përjeton atë, shkurtimi i kohës nuk përjetohet si veprim në një film me lëvizje të ngadalësuar. Në një ambient të tillë ku koha shkurtohet, të rrahurat e zemrës së njeriut, riprodhimi i qelizave dhe funksionet e trurit, etj, të gjitha funksionojnë më ngadalë se ato të njeriut që lëviz më ngadalë në tokë. Sidoqoftë, personi vazhdon jetën e tij të përditshme dhe nuk e heton shkurtrimin e kohës fare. Me të vërtetë shkurtimi madje as nuk bëhet i dukshëm derisa të bëhet krahasimi.

Relativiteti në Kur'an

Përfundimi në të cilin vijmë me anë të zbulimeve të shkencës moderne është se koha nuk është një fakt absolut siç supozohet prej materialistëve, por vetëm një perceptim relativ. Ajo që është më interesante është se ky fakt, i pazbuluar deri në shekullin e 20të nga shkenca, iu shpall njerëzimit në Kur'an katërmëdhjetë shekuj më parë. Ka referenca të ndryshme në Kur'an për relativitetin e kohës.

Është e mundshme të shohim në shumë vargje të Kur'anit faktin e vërtetuar shkencërisht se koha është një perceptim psikologjik i varur nga ngjaret, ambienti dhe rrethanat. Për shembull, e tërë jeta e një njeriu është një kohë shumë e shkurtër siç informohemi në Kur'an:

Atë ditë kur Ai ju thërret, kurse ju i përgjigjeni të përulur e duke lavdëruar Atë, e ju duket se nuk qëndruat (në dynja) vetëm pak kohë! (Sure Isra: 52)

Dhe ditën kur Ai do t'i tubojë ata, (atyre u duket) sikur nuk qëndruan (në dynja) vetëm një moment të ditës, atëherë njihen mes vete. (Sure Junus: 45)

Disa vargje tregojnë se njerëzit e perceptojnë kohën në mënyra të ndryshme dhe se nganjëherë njerëzit mund ta perceptojnë një periudhë shumë të shkurtër si një periudhë shumë të gjatë. Biseda në vijim e zhvilluar ndërmjet njerëzve gjatë gjykimit të tyre në ahiret është shembull i mirë për këtë:

Ai thotë: "E sa vjet keni kaluar në tokë?" Ata thonë: "Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë të ditës, pyeti ata që dinë numërimin!" Ai thotë: " Njëmend pak keni qëndruar, vetëm sikur ta dinit!" (Sure Mu'minun: 112-114)

Në disa vargje tjera Allahu shpall se koha mund të rrjedhë me ritme të ndryshme në ambiente të ndryshme:

Ata kërkojnë prej teje që t'ua shpejtosh dënimin, por Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, sepse një ditë te Zoti yt është sa një mijë vjet që llogaritni ju. (Sure Haxhxh: 47)

Atje ngjiten engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) në një ditë që zgjat pesëdhjetë mijë vjet. (Sure Me'arixh: 4)

Ai e rregullon çështjen (e të gjitha krijesave) prej qiellit në tokë, pastaj ajo (çështje) ngrihet tek Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa një mijë vjet. (Es-Sexhde 5)

Këto vargje janë shprehje e qartë e relativitetit të kohës. Se ky rezultat, i cili vetëm së voni u kuptua nga shkencëtarët në shekullin e 20të, iu komunikua njeriut 1,400 vjet më parë në Kur'an është një tregues i shpalljes së Kur'anit nga Allahu, I Cili përfshinë gjithë kohën dhe hapësirën.

Shumë vargje tjera të Kur'anit zbulojnë se koha është një perceptim. Kjo është e qartë në veçanti në tregimet. Për shembull, Allahu i ka mbajtur Shokët e Shpellës, një grup të besimtarëve të përmendur në Kur'an, në një gjumë të thellë për më shumë se tre shekuj. Kur ata u zgjuan, menduan se kishin qëndruar në atë gjendje për një kohë të shkurtër dhe nuk kishin dijeni se sa gjatë kishin fjetur:

Ne u vumë mbulojë mbi veshët e tyre (i vumë në gjumë) në shpellë për disa vite me rradhë. Pastaj ata i zgjuam (prej gjumit) për të parë se cili prej këtyre dy grupeve do të llogariste më së miri kohën që kishin kaluar. (Sure Kehf: 11-12)

Ashtu (sikurse i vumë në gjumë) i zgjuam ata që të pyesin njëri-tjetrin (se sa kanë fjetur). Njëri prej tyre foli e tha: "Sa keni ndejur?" Ata thanë: "Kemi ndejur një ditë ose një pjesë të ditës!" Disa thanë: "Zoti juaj e di më së miri se sa keni ndejur,

prandaj dërgoni njërin prej jush me këtë argjend (monedhë argjendi) në qytet, e të zgjedhë ushqim më të mirë, e t'ju sjellë atë juve dhe le të ketë shumë kujdes e të mos i jap të kuptojë askujt për ju". (Sure Kehf: 19)

Situata e treguar në ajetin e mëposhtëm është poashtu dëshmi se koha është në të vërtetë një perceptim psikologjik.

Ose (nuk je i njohur) me shembullin e atij që kaloi pranë një fshati që ishte rrënuar në kulmet e tij, e tha: "Si e ngjallë Allahu këtë pas shkatërrimit të tij?" e Allahu e bëri të vdekur atë (pyetësin - Uzejrin) njëqind vjet, pastaj e ringjalli dhe i tha: "Sa qëndrove (i vdekur)?" Ai tha: "Një ditë, ose një pjesë të ditës!" Ai (Allahu) Tha: "Jo, por ke ndejur (i vdekur) njëqind vjet, shikoje ushqimin dhe pijen tënde si nuk është prishur, e shikoje edhe gomarin tënd (si i janë shkapërderdhur eshtrat). E për të bërë ty argument për njerëzit (e bëmë këtë sprovë), shiko se si i kombinojmë eshtrat e pastaj i veshim me mish. E kur iu bë e qartë atij tha: "U binda se me të vërtetë Allahu ka mundësi për çdo send!" (Sure Bekare: 259)

Vargu i mësipërm thekson në mënyrë të qartë se Allahu, I Cili krijoi kohën, është i pavarur prej saj. Njeriu, në anën tjetër, është i varur prej kohës, gjë që është e përcaktuar prej Allahut. Sikurse në këtë varg, njeriu është madje i paaftë të dijë se sa gjatë ka fjetur. Në një gjendje të tillë, të pohohet se koha është absolute (siç bëjnë materialistët në të menduarit e tyre të shtrembëruar) është një gjë e paarsyeshme.

Fati

Ky relativitet i kohës e qartëson një çështje shumë të rëndësishme. Relativiteti është aq i ndryshueshëm sa që një periudhë që ne na duket e gjatë me miliarda vjet mund të zgjas vetëm një sekond në një perspektivë tjetër. Veç kësaj, një periudhë vigane e kohës që shtrihet prej fillimit të botës deri te fundi i saj mundet madje të mos zgjas as edhe një sekond por vetëm një çast në një dimension tjetër.

Ky është pikërisht thelbi i konceptit të fatit – një koncept që nuk kuptohet mirë nga shumica e njerëzve, posaçërisht nga materiastët të cilët e mohojnë atë në tërësi. Fati është dijenia e përkryer e Allahut për të gjitha ngjarjet e kaluara dhe të ardhme. Shumica e njerëzve e vënë në dyshim faktin se si Allahu mundet tashmë të dijë për ngjarjet që ende nuk janë përjetuar dhe kjo bën që ata të dështojnë në të kuptuarit e vërtetësisë së fatit. Megjithatë, “ngjarjet akoma të papërjetuara” janë të tilla vetëm për ne. Allahu nuk është i varur nga koha apo hapësira sepse Ai Vet i ka krijuar ato. Për këtë arsye, e kaluara, e ardhmja dhe e tashmja janë të gjitha të njëjta për Allahun; sepse për Atë gjithçka tashmë ka ndodhur dhe ka përfunduar.

Në librin Gjithësia dhe Dr. Ajnshtajni, Linkoln Barnet shpjegon se si Teoria e Relativitetit të Përgjithshëm na shpie te ky përfundim. Sipas Barnetit, gjithësia mund të “përfshihet me gjithë madhësinë e saj vetëm nga një intelekt kozmik”. 85 Vullneti që Barneti e quan “intelekti kozmik” është urtësia dhe dijenia e Allahut, I Cili mbizotëron tërë gjithësinë. Mu sikurse mund të shohim me lehtësi fillimin, mesin dhe fundin e një sundimtari dhe të gjitha elementet në mes si një tërësi, Allahu e njeh kohën nga e cila jemi të varur sikurse ajo të ishte një moment i vetëm që prej fillimit e deri në fund të saj. Mirëpo,

njerëzit përjetojnë ngjarjet vetëm kur të vie koha e tyre dhe bëhen dëshmitarë të fatit që Allahu ka krijuar për ta.

Është poashtu e rëndësishme të tërheqim vëmendjen ndaj cektësisë së kuptimit të shtrembëruar të fatit që dominon në shoqërinë tonë. Ky besim i shtrembëruar i fatit është një paragjykim se Allahu ka përcaktuar një “fat” për çdo njeri por se këto fate mundën ndonjëherë të ndryshohen prej njerëzve. Për shembull, njerëzit bëjnë deklarata sipërfaqësore për një pacient i cili kthehet prej pragut të vdekjes si “ai mposhti fatin e tij”. Askush nuk është i aftë të ndryshojë fatin e tij. Personi i cili u kthye nga pragu i vdekjes, nuk vdiq saktësisht sepse ai e kishte të paracaktuar të mos vdes në atë kohë. Për ironi, është fati i këtyre njerëzve që mashtrojnë vetveten duke thënë “Unë e mposhta fatin tim” se do të thonë ashtu dhe do ta mbajnë këtë mendësi.

Fati është dijenia e amshueshme e Allahut dhe për Allahun, I Cili e njeh kohën si një moment të vetëm dhe I Cili mbizotëron gjithë kohën dhe hapësirën; gjithçka është vendosur/përcaktuar dhe ka përfunduar në lidhje me fatin. Ne poashtu kuptojmë prej asaj që Ai rrëfen në Kur’an se koha është një për Allahun: disa ngjarje që ne na duket të ndodhin në të ardhmën rrëfehen në Kur’an në atë mënyrë sikur ato të kishin ndodhur tashmë shumë kohë më parë. Për shembull, vargjet që përshkruajnë llogaritë që njerëzit duhet t’i japin Allahut në ahiret rrëfehen si ngjarje të cilat kanë ndodhur shumë kohë më parë:

Dhe i fryhet Surit dhe bie i vdekur ç’ka në qiej dhe në tokë, përveç atyre që do Allahu (të mos vdesin), pastaj i fryhet atij herën tjetër, kur ja, të gjithë ata të ngritur e presin (urdhërin e Zotit). Dhe toka ndriçohet me dritën e Zotit të vet, dhe Libri (shënimet mbi veprat) vëhet pranë dhe sillen pejgamberët e dëshmitarët, e kryhet mes tyre gjykimi me drejtësi, dhe atyre nuk u bëhet padrejtë... E ata që nuk besuan sillen në grupe në Xhehennem... E ata që ishin të devotshëm ndaj Zotit të tyre, sillen në grupe në Xhennet” (Sure Zumer: 68-73)

Disa vargje të tjera për këtë çështje janë:

E do të vijë secili njeri bashkë me të dhe grahësi edhe dëshmitari. (Sure Kaf: 21)

E qielli çahet, pse ai atë ditë është i raskapitur. (Sure Hakka: 16)

Dhe për shkak se ata duruan, i shpërbleu me Xhennet dhe me petka mëndafshi. Aty janë të mbështetur në koltukë dhe aty nuk shohin as diell (vapë) e as të ftohtë. (Sure Insan: 12-13)

E Xhehennemi shfaqet sheshazi për atë që e sheh. (Sure Nazi’at: 36)

E sot, (në ditën e gjykimit), ata që besuan do të tallen me jobesimtarët. (Sure Mutaffifin: 34)

Kriminelët e shohin zjarri dhe binden se do të hudhen në të, dhe se nuk do të gjejnë shtegdalje prej tij. (Sure Kehf: 53)

Siç mund të shihet, ndodhitë që do të ndodhin pas vdekjes sonë (nga këndvështrimi jonë) rrëfohen në Kur'an si ngjarje të kaluara tashmë të përjetuara. Allahu nuk është i varur nga korniza relative e kohës në të cilën ne jemi të ngjuar. Allahu i ka paracaktuar këto gjëra në pafundësi: njerëzit i kanë realizuar tashmë ato dhe të gjitha këto ngjarje janë përjetuar dhe kanë mbaruar. Ai përkujton në ajetin e mëposhtëm se çdo ngjarje, e madhe apo e vogël, është e përfshirë në dijeninë e Allahut dhe është e evidentuar në një libër:

Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kur'ani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se ne jemi prezentuesit tuaj, kur ju ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t'i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurt. (Sure Junus: 61)

Brenga e materialistëve

Çështjet e diskutuara në këtë kapitull, domethënë e vërteta që përbën bazën e materies, amshueshmërisë dhe pafundësisë, janë me të vërtetë tejet të qarta. Siç u përshkrua më heret, këto përfundimisht nuk janë asnjë lloj filozofie apo mënyre e të menduarit, por përfundime shkencore që është e pamundshme të mohohen. Përveç të qenit e saj një realitet teknik, dëshmitë poashtu nuk pranojnë asnjë alternativë tjetër të arsyeshme apo logjike në lidhje me këtë çështje: gjithësia është një qenie iluzore me tërë materien që e përbën atë dhe me të gjitha krijesat që jetojnë në të. Ajo është një përmbledhje perceptimesh.

Materialistët e kanë shumë të vështirë ta kuptojnë këtë fakt. Për shembull, po të kthehemi tek shembulli i autobusit të Policarit: edhe pse Policeri teknikisht e dinte se nuk mund të dilte jashtë perceptimeve të tij ai mund ta pranonte këtë vetëm në raste të caktuara. Domethënë, për Policerin, ngjarjet ndodhin në tru deri në përplasjen me autobus, por posa të ndodhë ndeshja me autobus, gjërat dalin jashtë trurit dhe marrin realitet fizik. E meta logjike e këtij argumenti është më se e qartë. Policeri ka bërë gabimin e njëjtë si materialisti Xhonsen i cili tha: “Unë e shqelmoj gurin, ndiej dhimbje në këmbë, prandaj ai ekziston”. Policeri nuk mund ta kuptonte se tronditja e përjetuar pas ndeshjes me autobus ishte gjithashtu vetëm një perceptim.

Arsyeja e ndërtdijes pse materialistët nuk mund ta kuptojnë këtë çështje është frika e tyre ndaj asaj me çka do të përballen kur ta kuptojnë atë. Linkoln Barnet na tregon se disa shkencëtarë “e dalluan” këtë çështje:

Bashkë me reduktimin e tërë realitetit objektiv në një botë-hije të perceptimeve nga ana e filozofëve, shkencëtarët janë bërë të vetëdijshëm për kufizimet shqetësuese të shqisave të njeriut. 86

Çdo referim që i bëhet faktit se materia dhe koha janë perceptime shkakton frikë të madhe tek materialisti, sepse ato janë të vetmet nocione në të cilat ai i konsideron si qenie absolute. Ai, në njëfarë mënyre, i merr ato si idhuj për t'i adhuruar; sepse mendon se materia dhe koha (përmes evolucionit) e krijuan atë.

Kur ai ndien se gjithësia në të cilën ai mendon se jeton, bota, vet trupi i tij, njerëzit tjerë, filozofët e tjerë materialist nga idetë e të cilëve ai ndikohet dhe, shkurt, gjithçka është një perceptim, ai ndihet i pushtuar nga një llahtar. Gjithçka prej çka ai është i varur, në çka ai beson dhe në çka ai gjenë mbështetje papritur zhduket. Ai ndjenë një shije të dëshpërimit të cilën ai do ta përjetojë me të vërtetë në ditën e gjykimit, siç përshkruhet në vargun: “Dhe ata (idhujtarët) i dorëzohen Allahut, e atë çka ata e trillonin u asgjësohet.” (Sure Nahl: 87)

Prej këtij momenti e tutje, ky materialist përpiqet ta bind veten për realitetin e materies dhe shpikë “dëshmi/prova” për këtë qëllim. Ai e godet me grushtin e tij murin, shqelmon gurë, bërtet, çirret, por s’ mundet kurrë t’i ikë realitetit.

Sikurse dëshirojnë që ta largojnë këtë realitet prej mendjeve të tyre, ata poashtu dëshirojnë që edhe njerëzit e tjerë ta flakin atë. Ata janë poashtu të vetëdijshëm se nëse njerëzit në përgjithësi e njohin natyrën e vërtetë të materies, natyra primitive e vet filozofisë së tyre dhe mosdija e botëkuptimit të tyre do të zhveshet që ta shohin të gjithë dhe nuk do të mbetet asnjë bazë ku ata do të mund t’i mbështesin pikëpamjet e tyre. Këto druajtje janë arsyet pse ata janë aq të trazuar nga faktet e rrëfyera këtu.

Allahu shpall se shqetësimet e mosbesimtarëve do të shtohen në ahiret. Në ditën e gjykimit, atyre do t’ju drejtohet në këtë mënyrë:

Përkujto ditën kur Ne i tubojmë të gjithë dhe u themi atyre që na shoqëruan shokë: "Ku janë ata të shoqëruarit tuaj, që i trillonit?" (Sure En'am: 22)

Pas kësaj, mosbesimtarët do të jenë dëshmitarë se pronat e tyre, fëmijët dhe të afërmit e tyre, të cilët ata kishin supozuar të jenë të vërtetë dhe që ia kishin përshkruar Allahut shokë, t’i lënë ata dhe të zhduken. Allahu na informon për këtë në ajetin: “Shih, se si bëjnë gënjeshtria kundër vetes dhe si u shkoi huq ajo që trillonin!” (Sure En'am: 24)

Përfitimi i besimtarëve

Ndërsa fakti se materia dhe koha janë perceptime i shqetëson materialistët, e kundërta vlen për besimtarët. Ata që besojnë gëzohen shumë kur e kuptojnë atë që fshehet pas materies, sepse ky realitet është çelësi i të gjitha çështjeve. Me këtë çelës, të gjitha fshehtësitë zbërthehen. Njeriu me lehtësi kupton shumë çështje që paraprakisht kishte vështirësi për t’i kuptuar.

Siç u tha më heret, çështjet e vdekjes, xhennetit, xhehennemit, ahiretit, dimensioneve që ndryshojnë dhe pyetjet e tilla si “Ku është Allahu?” “Çfarë ekzistonte para Allahut?” “Kush krijoi Allahun?” “Sa do të zgjas jeta në varr?” “Ku janë xhenneti dhe xhehennemi?” dhe “Ku ekzistojnë tani xhenneti dhe xhehennemi?” marrin përgjigje me lehtësi. Do të kuptohet se me çfarë lloj rregulli krijoi Allahu tërë gjithësinë nga asgjëja, aq shumë sa që, me këtë fshehtësi, pyetjet “kur?” dhe “ku?” bëhen të pakuptim sepse nuk mbetet më as koha dhe as hapësira. Kur të kuptohet pafundësia, do të kuptohet se gjithçka ndodhë në një moment të vetëm: për asgjë nuk pritet dhe koha nuk kalon, sepse gjithçka tashmë ka ndodhur dhe ka përfunduar.

Me zbërthimin e kësaj fshehtësie, bota shëndrrohet në parajsë për besimtarin. Të gjitha brengat shqetësuese materiale, shqetësimet dhe frikat zhduken. Njeriu e kupton se e tërë gjithësia ka një sundues të vetëm, se Ai e ndryshon tërë botën fizike ashtu si dëshiron Ai dhe se gjithçka që njeriu duhet të bëj është t'i drejtohet Atij. Ai atëherë ia nënshtron vetveten plotësisht Allahut “për t’ju përkushtuar shërbimit të Tij”. (Sure Ali Imran: 35)

Të kuptuarit e kësaj fshehtësie është përfitimi më i madh në këtë botë.

Me këtë fshehtësi, zbulohet një realitet tjetër shumë i rëndësishëm i përmendur në Kur’an: se “Allahu është më afër njeriut se damari i qafës së tij” (Sure Kaf: 16). Kjo rrethanë mund të shpjegohet me lehtësi me realitetin e pafundësisë. Ky ajet poashtu mund të kuptohet më mirë me të kuptuarit e kësaj fshehtësie.

Kjo është e vërteta e kulluar. Do të duhej rrënjosur mirë se nuk ekziston tjetër ndihmues dhe furnizues për njeriun përveç Allahut. Nuk ekziston asgjë përveç Allahut; Ai është qenia e vetme absolute tek E Cila njeriu mund të kërkojë strehim, Të Cilës njeriu mund t’i lutet për ndihmë dhe të llogaris në shpërblim.

Ngado që të kthehemi, është prania e Allahut.

Përfundim

Padyshim, asgjë s'mund të jetë më e rëndësishme se krijimi i njeriut dhe njohja e Krijuesit të tij. Ajo që kemi bërë gjatë këtij libri është që të përpiqemi të kuptojmë një temë që është me rëndësi të dorës së parë për çdo person.

Mendojmë se është e domosdoshme që ta përkujtojmë lexuesin në këtë pikë se njeriut nuk i nevojiten informata të shumta për të kuptuar se gjithësia dhe gjithçka në të, duke e përfshirë vetveten e tij, janë krijuar. Është në sferën e vetëdijes dhe arsyes së një fëmije të vogël poaq sa është në atë të një të rrituri të kuptojë se ai u krijua. Fjalët e profetit Ibrahim në Kur'an janë një shembull shumë i mirë për atë që nënkuptojmë.

Profeti Ibrahim një kohë jetoi në një bashkësi që nuk besonte në Allahun dhe adhuronte shtylla totemi në vend të Tij. Edhe pse ai kurrë nuk kishte marrë ndonjë mësim për ekzistencën e Allahut, e kishte kuptuar me arsyen dhe vetëdijen e tij se ishte krijuar – për më tepër, se ishte krijuar prej Allahut, I Cili i krijoi qiejt dhe tokën. Kjo në Kur'an rrëfëhet kështu:

E kur atë e mbuloi nata, ai e pa një yll e tha: "Ky është Zoti im!" E kur ai u zhduk (perëndoi), tha: "Unë nuk i dua ata që humbën". Kur e pa hënën të posa lindur tha: "Ky është Zoti im! e kur perëndoi ajo, tha: Nëse Zoti im nuk më udhëzon, unë do të jem prej njerëzve të humbur!" Kur e pa diellin të lindur, tha: "Ky është Zoti im, ky është i madh!" e kur ai perëndoi, tha: O populli im, unë jam i pastër nga ajo që ju i shoqëroni!" Unë me veten time i drejtohem Atij që krijoi qiejt e tokën, larg besimeve të tjera; unë nuk jam prej atyre që i përshkruajnë shok Allahut! (Sure En'am: 76-79)

Siç shohim në shembullin e Profetit Ibrahim, çdo njeri që posedon arsye dhe vetëdije dhe ajo që është më e rëndësishme, i cili "nuk refuzon me padrejtësi dhe mendjemadhësi" është në gjendje të kuptojë se gjithësia u krijua dhe, për më tepër, se ajo u krijua me një rregull dhe plan madhështor.

Nuk ka dyshim se gjendja e atyre të cilët nuk pranojnë ekzistencën e Allahut, përkundër të gjitha argumenteve të dukshme të shpalosura për t'i parë të gjithë, është fare e habitshme për ata që posedojnë arsye dhe vetëdije. Në Kur'an, deklarohet kështu për ata të cilët nuk besojnë në fuqinë dhe krijimin e Allahut:

E nëse ti (Muhammed) çuditësh (përse të përgënjeshtrojnë), është edhe më e çuditshme thënia e tyre: "A do të kemi krijim të ri pasi të jemi bërë dhe?" Këta janë ata që mohuan Zotin e tyre, ata do të ndëshkohen me pranga në qafë. Pra këta janë banues të zjarrit ku do të qëndrojnë përgjithmonë. (Sure Rra'd: 5)

Këto që u rrëfyen në këtë libër janë më të rëndësishme se çdo gjë tjetër në jetën tuaj. Ndoshta gjer më tani nuk keni qenë në gjendje t'ia kushtoni vëmendjen e duhur rëndësisë së kësaj çështjeje apo ndoshta ka mundësi që madje kurrë më parë nuk keni menduar për këtë.

Megjithatë, të jeni të sigurt se të pranosh/njohësh Allahun, I Cili ju ka krijuar, është më e rëndësishme dhe më e ngutshme se çdo gjë tjetër që ju mund të bëni.

Mendoni për ato që Ai ju ka dhuruar: ju jetoni në një botë të planifikuar/projektuar në hollësi deri në detalin më të vogël dhe të krijuar posaçërisht për ju. Ju nuk kishit dorë në këtë proces. Ju i hapët sytë tuaj një ditë dhe e gjetët veten në mes të mirësive të panumërta. Ju mund të shihni, mund të dëgjoni, ju mund të ndjeni...

Dhe kjo është kështu sepse Ai ka dëshiruar një krijim të tillë. Në një varg thuhet:

Allahu ju nxorri nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues. (Sure Nahl: 78)

Siç theksohet në këtë ajet, është Allahu dhe askush tjetër I Cili ju ka dhuruar gjithçka që ju posedoni dhe I Cili krijoi gjithësinë në të cilën jetoni. Prandaj, ejani dhe nënshtrojuni Allahut dhe jeni falënderues ndaj Tij për të gjitha mirësitë me të cilat Ai ju ka pajisur dhe në këtë mënyrë fitoni një shpërblim të amshueshëm. Nëse e bëni të kundërtën, do të tregoni mosmirënjohje dhe veten do t'i një ndëshkimi që, me vullnetin e Allahut, do të zgjas përjetë.

Të jeni të sigurt: Ai ekziston dhe Ai është shumë pranë jush...

Ai sheh dhe dëgjon gjithçka që ju bëni dhe dëgjon çdo fjalë që e shqiptoni...

Dhe të jeni të sigurt se çdo njeri, duke ju përfshirë edhe juve, shpejt do t'i jap llogari Atij...

Engjëjt thanë: "Larg nga të metat je Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet, Ti je i Gjithëdijshëm dhe i Urtë!" (Sure Bekare: 32)